

**FLAMUR
TOPI**

BIBLIOTEKA
SHTETIT

1-32
85



DASHURIA E ROBOTEVE


844-52

T85

FLAMUR TOPI

DASHURIA E ROBOTËVE

tregime e novela fantastike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI

V D E K J A E R O B O T I T

Një mëngjes të ftohtë janari (natë më e ftohtë se ajo s'mbahej mend që prej shumë kohësh në qytetin N.), u gjend nën urë një fëmijë i ngrirë.

Gjysmë të vdekur e dërguan në njërin nga spitalet e qytetit.

Atje, Dr. Olafi, pas përpjekjesh të stërmundueshme e përmendi fëmijën, duke i bërë kështu sfidë vdekjes, mbase për të njëqindtën herë...

Dr. Olafi përbloindi në pak rreshta historinë e sëmundjes së fëmijës. Ai s'mbante mend currë të kishte plotsuar një Anamnesis Vitae më të shkurtër se ajo.

«Jose Parnas, (nga emëri dhe mbiemri ai duhet të jetë me origjinë meksikane — mendoi mjeku), jetim, lindur në qytetin tonë, u gjend nën urë. Pastaj vazhdonte përshkrimi klinik.

* * *

Ai e la një çast stilografin mbi tryezë dhe u ngrit. Iu afrua dritares, prej nga shquhej midis mjegullës së mëngjesit ura me këmbët e saj gjigante të ngulura thellë në anët e lumit. Ura qe kufiri midis dy botëve; sipër kishte një jetë plot gjallëri, ritmë e gaz të shfrenuar, poshtë qe mjerimi; aty jeton njeriu i shpellave që ha ç'të gjejë në rrugët e qytetit të madh dhe fle i mbuluar me gazeta. Iu bë se nga honet e nënurës, erdhë gjë tek dritarja e tij fragmenti i një bisede me zë të ndrydhur e të ulët, sikur ata njerëz ta ndienin veten të huaj në atë qytet.

Si mund të jetë banimi i tyre në regjistrat e bashkisë së qytetit? I paditur! Po megjithatë adresa e tyre është e saktë, sado që s'kanë portë, as numër, as hyrje, as shkallë. Ata i njch

mirë policia. Po Josen e njihte? Qe i bindur se Jose kishte lindur nga prindër të mjerë. (Emigrantët janë zakonisht të varfér). Mbësë Jose ka qenë fëmija i dhjetë a i dymbëdhjetë (për gjithësisht të varférit lindin shumë fëmijë). Dhe pastaj braktisja, diku në cepat e qytetit të madh, në këmbët e urës, në ndonjë stol parku, në ndonjë taksi buzë rruge, duke i lënë trashëgim një emër të thjeshtë, shkruar trashë, nga një dorë e pastërvitur. I shkreti fëmijë! S'ka për t'i njojur kurrë prindët, me gjithëse çdo çast ai do të ëndërrojë për takimin fatlum, të parritur, në të madhin takim (me takime të tillë janë të mbushura fund e krye romanet e shkruara nga kolitukët e sfungjertë), mbësë ajo ëndërr e takimit fatlum do ta shoqërojë Jozënë téré jetën e tij, do të jetë një ëndërr e gjatë sa edhe vetë jeta e tij e do të shuhet mbësë bashkë me të ...

Kaluan shumë ditë e megjithatë i sëmuri i dhomës nr. 5 nuk ndihej aspak mirë. Kishte marrë një të ftohur të rëndë në të dy anët, dhe kjo e bënte më serioze gjendjen e fëmijës që vuante nga një komunikim interartrial (sëmundje e rëndë e zemrës e fituar që në lindje). Në dhomën e tij ishin shtruar edhe gjashtë fëmijë të tjerë, më të vegjël se Jozë. Çdo ditë, të vegjelje u vinin prindët dhe i gëzonin duke u sjellë lodra, ushqime, fruta, émbëlsira dhe libra. Megjithatë, Jozë nuk ndihej i vëtmuar. Ishte mësuar me gjendjen e tij dhe nuk priste vizita. Askush nuk i afrohej (veç personelit të shërbimit), dhe ai i mbyllur në vëtvete shikonte rrëth e qark pa bërë zë, pa shfaqur mendime. Një muaj pasi qe shtruar, e vizitoi një zonjë rrëth të pesëdhjetave, përfaqësuese e një shoqërie mirëbërëse. Ajo bisëdoi pak me të, e kapi lehtë nga faqet me një buzëqeshje të shtirur dhe i la një pako të vogël émbëlsirash dhe kullën e famshme të Eifelit, që i kujtoi Jozes nënurën e tij. Kaluan shumë ditë të tjera dhe zonja s'erdi më. Kjo gjë duhej t'i bënte përshtypje fëmijës, por ai tashmë qe mësuar të braktisej.

Ai ishte braktisur apo kishte thithur për të parën herë ajrin e rëndë të qytetit të huaj, pra që kur qe lindur. Çdo lloj braktisjeje tjetër atij i dukej një lodër përpëra më të madhes

sfidë që i kishte bërë jeta apo kishte hapur sytë, apo kishte marrë frymë dhe kishte lëshuar të qarën e parë, për të lajmëruar se erdhi në jetë. Qyteti e pat gjelltitur në barkun e tij të madh, pa kurrfarë vështirësie të qarën e fëmijës së porsalindur. Kështu që atë s'e kishin gjetur menjëherë, sado që u shqye së qari. Atë e gjetën vetëm të nesërmen, e gjetën ahere kur fëmija në të vërtetë nuk qante, dhe s'po kërkonte më ndihmë. Që lodhur së qari, që lodhur së jetuari, sado që kishte lindur vetëm një ditë më parë.

* * *

Bri dhomës së Jozesë, u shtrua djaloshi Peter Wintersi, i biri i konstruktorit të famshëm të robotëve, inxhinjerit Robertson. Fëmijët u mësuan aq shumë njëri me tjetrin, saqë që gjë e vështirë t'i ndanin atë mëngjes shkurti, kur Jozenë tetëvjeçar e veçuan në dhomën e të sëmurit rëndë. Gjendja e rëndë së Jozesë e dëshpëroi Robertsonin.

— Doktor Armstrong, a nuk do të meritonte fëmija një kujdes disi më të posaçëm? Me sa shoh, ai është i sëmuri më i rëndë i klinikës suaj! — i tha atë mëngjes, drejtore të spitalit Dr. Armstrongut, i cili pas largimit të Dr. Olafit, kishte mbetur mjeku i vetëm i klinikës.

— Jemi në ditë të vështira, profesor... Financimi shtetëror për këtë vit na është shkurtuar gjysmë për gjysmë dhe unë kam qenë i detyruar ta pakësoj personelin në një shkallë të ndjeshme... Po për këto arësy, Olafi u detyra ta linte klinikën tonë i pakënaqur nga pagesa. Për 100 shtretër kam vetëm tri infermieri shërbimi dhe kësisoj është e pamundur të lë në dispozicion të fëmijës njérën syresh qoftë edhe për një ditë. Veç të tjerave, profesor, klinika ime po harxon ca si shumë përfëmijën, ndërkokë, që s'kemi asnje siguri se bashkia do të paguajë përtë. Përqindja e shoqërive mirëbërëse s'mjafton as për ushqimin e tij.

— Më falni doktor, po ju pak më parë thatë se fëmija s'ka fare oreks dhe se prej ditësh s'ka futur gjë në gojë.

— Ah, jo, këtu nuk kam parasysh ushqimin që duhej të

mirrte nga goja, por atë që ia japim nëpërmjet infuzionesh të glukozës, vitaminave...

— Ahere shpenzimet për të po i përballoj unë, Armstrong. Sa ju detyrohem?

— I dashur Robertson, pavarësisht nga përpjekjet tona, fëmijës s'i mbetet shumë kohë për të jetuar. Është në gjendje të rëndë... Ka një sërë komplikacionesh dhe në gjendjen e tij fizike ndërhyrja operatore do të qe një orvatje e kotë...

— Pra?

— Pra, ne s'jemi aq të pashpirt, i dashur Robertson, sa të mos e përballojmë atë për...

— Për atë pak kohë që i mbetet, — ndërhyri profesori me një ironi therëse.

Armstrongu pohoi me kokë.

— Pra, ju s'keni ndër mend të vini për fëmijën një kujdestare të posaçme?

— Jo! Nuk mund ta bëjmë këtë gjë. Për të do të kujdesohemi veçanërisht, por s'mund të angazhojmë tërë kohën një-rën nga infermieret tona. Nuk na e lejon ndërgjegjja që, për hir të një të sëmuri pa shpresë shërimi, të rrezikojmë të vegjlit e tjerë.

Robertsoni u mendua një çast.

— Çdo të thoshit Armstrong, sikur unë t'ju sillja një person të specializuar për ndihmë të të sëmurëve?

— Më falni, profesor, por s'kam ndërmend të marr në punë të tjerë njerëz.

— Dëgjomëni deri në fund, i dashuri Armstrong. Ju s'do të paguani për të asnje cent, megjithëse ai do të qëndrojë tërë kohën këtu. S'do të ketë nevojë të ushqehet dhe as do të jeni i detyruar t'i gjeni vënd për të fjetur.

— Qenka tepër interesant?...

— Kur ta njihni, besoj se do ta çmoni dhe më shumë, i dashur Armstrong.

— S'po ju kuptoj, i nderuar profesor! — thirri Armstrongu kinse i habitur — por sidoqoftë, silleni. Nga përshkrimi juaj po bëhem dhe unë kureshtar ta njoh sa më parë.

→ Po ky qenka një robot! Bah, kjo s'më shkonte ndërmend! Ç'mund të bëjë ky, profesor?

— Shumë më tepër nga ç'mund të bëjë personeli juaj gjysmak. Ai është pjella ime e fundit. U detyrova ta konstruktoj me shpejtësinë maksimale. Është, pra, një fëmijë e lindur parakohc, por sidoqoftë, i përsosur. Ai do të sfidojë sistemin e vjetëruar të shërbimit dhe përfëmijën do të bëhet... s'di akoma si ta përcaktoj me fjälë... Ai ka përfëmijën do të rrojtur përfëmijën, ose do të vdesë së bashku me të.

— Aha, i shtrenjti Robertson, mos doni të thoni se roboti juaj ka shpirt, se ai ndien, se ai, ah, po më vjen të qesh, se ai prap, mund edhe të qajë?

— Po, ai c do fëmijën, c do me gjithë zemër, apo jo Robi?

— Pooo, proofoesoor! — u dëgjua përgjigja e Robit, zëri i trashë, pakëz i zvarritur dhe me një tingellim të veçantë metalik. Unëës e duaaa shumëë Joooseeenëës — Shuumëës

Armstrongu u praps, sa i mahnitur aq edhe i frikësuar nga ajo shpikje djallëzore, sic e quaiti me mend.

— Ky është një gjeni ose përbindsh, Robertson! Pohoni, pra, se ai është një përbindsh metalik... Ç'paskeni bërë kështu? S'kam parë kurrë Robot, që mund të flasë kështu, pa program! Si e bëtë, si e bëtë këtë? — pyeti me zë të ulët doktori, duke ndicer drithma rrënqethësc nëpër trup.

— Ti ke një tru elektronik, apo jo, Robi? — iu kthye robotit, Robertsoni.

— Po! Unë kam tru elektronik, — iu përgjigj Robi.

— Ti je më i zgjuar sesa njerëzit, Robi?

— !

Roboti s'u përgjigj.

— Mos u habitni, Armstrong! Ai nuk mund t'i përgjigjet çdo pyetjeje, truri i tij ka të regjistruar dhjetëmijë pyetje, përgjigje dhe shprehje, të cilat zakonisht i zotërojnë fëmijët e kësaj moshe sa ç'është edhe Jose. Për këtë kam punuar ngshtësisht me psikologun e famshëm, Jorn Tomas. Pra, mund të jeni i qetë. Ai s'është aq i zgjuar sa ç'duket. Po ashtu, zonjushet infermieri le të qetësohen edhe ato. Robi s'ka pér t'i konkuruar. Ai është krijuar vetëm pér këtë fëmijë e mbasë ka pér të vdekur pér të.

— Përse ke ardhur ti, Robi, në këtë botë? — pyeti Robertsoni robotin.

— Unë kam ardhur përf të ndihmuar fëmijën — u përgjegj Robi.

— Po sikur të mos jeni në gjendje ta ndihmoni dhe ai të vdesë?

— ?!...

Përsëri Robi s'u përgjigj.

— Ai nuk e njeh fjalën vdekje. Pra është një robot optimist. Ai nuk pajtohet me vdekjen e fëmijës, dhe as me vdekjen e tij.

Armstrongu e vështronë si i shushatur.

Robertsoni pyeti përsëri Robin.

— Fëmija është më mirë Robi?

— Po, fëmija është më mirë.

— Ti je vëllai i tij, Robi?

— Po, unë jam vëllai i tij. Jepma dorën! Jepma dorën!

Jepma dorën! Robi e përsëriste shpesh këtë frazë, dhe kjo e habit profesorin, ç'i duhej dora robotit?

— Profesor, pse ua kërkon gjithnjë dorën roboti? — pyeti Armstrongu, që ndërkohe e kishte mbledhur vehten.

— Si një robot me zemër të madhe, ai s'mund të rrojë pa këtë bashkim duarsh. Veçse, dora duhet të jetë e ngrohtë, miqësore. Rreziku i tij mbeten duart e ftohta.

Armstrongu qeshi.

— Si? Nuk më besoni? Është e tepërt, t'jua shpjegoj të gjitha me hollësi, sepse do t'i shihni me sytë tuaj ato që është në gjendje të bëjë Robi im. Apo jo, Robi?

— ?!

Robi modest nuk u përgjigj.

Konstruktori e kishte dëshiruar pikërisht të tillë.

Siq pritej, Joseja dhe Robi u miqësuant shpejt, ashtu siq miqësohen shpejt fëmijët midis syresh. Në fillim, përf të voglin, roboti qe një kukull e madhe, e ndërtuar ndryshtë nga tjerat e sigurisht më e madhe, por ai u habit jashtë mase e qe-

* * *

shi me zë të lartë, kur Robi apo erdhi në dhomë, u prezantua:

— Le të njihemi! Unë quhem Robi, po ti kush je?

Fëmija i tha emrin. Pastaj, Jose e pyeti në kishte nënë e baba. Robi iu përgjegj se kishte vetëm babanë dhe e quanin Robertson ...

Sa vjeç je? — pyeti fëmija robotin. Robi u përgjigj se apo kishte mbushur tetëvjeç.

— Pra, paskemi një moshë! — foli fëmija i kënaqur.

— Po, ne jemi vërsnikë! — pohoi Robi.

— Robi, po pse je veshur kështu tërë hekur? — e pyeti fëmija, duke i ledhatuar gjymtirët e çelikta.

— Një ditë, kur shkonja rrugës, më sulmuani qentë dhe më hëngrën vithet. Që nga ajo ditë u veshan kështu dhe qentë s'më kanë ngacmuar më. Ata nuk mund të hafnë hekur.

Fëmija qeshi me gjithë zemër. Robi na qenkësh shakaxhi. Fëmija i bëri edhe shumë pyetje të tjera, të cilave Robi iu përgjigj menjëherë. Por njërsës pyetje Robi s'mundi t'i përgjigjej. Fëmija e pyeti së ç'do të thotë të vdesësh dhe Robi heshti.

Fëmija e pyeti sërisht duke ngulur këmbë ta mësonte atë gjë.

Robi kishte shtrënguar nofullat e çelikta.

Dukej si i humbur, si të mos kishte dëgjuar gjësendi.

— Ti Robi, je i keq! Të, nuk përgjigjesh!

— Unë s'jam i keq. Unë jam i mirë. Edhe ti je i mirë.

Fëmija buzëqeshi dhe u pajtua me Robin.

Pastaj fëmija i kërkoi ujë. Robi rendi të çezma e mbushi gotën me ujë të freskët dhe ia solli.

* * *

Prej shumë ditësh Robi qëndron i ulur në poltronë, aty pranë kokës së fëmijës. Fëmijës i del gjumi në mes të natës dhe e sheh gjithnjë syhapur Robin e dashur.

— Robi! Po ti, pse nuk fle? Ke ditë pa fjetur! Ti ke përtu sëmurur, Robi, — thotë me shqetësim fëmija.

Por Robi e qetëson. I thotë, se s'është e vërtetë se ai s'ka fjetur. Bile, ka bërë një goxha gjumë edhe ashtu ndenjur. Madje,

ka parë edhe ca ëndrra të bukura, që veç tij s'mund t'i shohë ndonjë tjeter. Fëmija i lutet t'i tregojë ndonjërën syresh.

Robi nis t'ia tregojë e fëmija shqyhet së qeshuri.

Dr. Armstrong e dëgjon nga dera gjysmë e hapur.

Ai qesh ndën buzë.

— Një të tillë psikoterapi, zor se do ta bëja kaq mirë! — mendon. — Ky Robi, qenka djalli vetë!

Dr. Armstrong hap derën dhe i flet në emër Robit, por Robi nuk i përgjigjet. Armstrong i flet për diçka tjeter, por Robi përsëri hesht.

Fëmija qesh.

— Ai flet vetëm me mua! Robi eshtë vëllai im, — thotë me krenari. — Apo jo, Robi?

— Po! Robi flet me fëmijët. Robi flet me profesor Robertsonin! — përgjigjet Robi, duke tundur lehtë kokën (në të vërtetë kjo eshtë buzëqeshja e tij. Ai s'di të buzëqeshë ndryshe.)

I prekur në sedër, sikur të paskësh biseduar me një njeri të vërtetë, Armstrongu buzëqesh me hidhërim dhe del jashtë, duke përplasur derën plastike. Fëmija përkëdhel Robin, ndërsa ky tund lehtë kokën. Ai i dhuron fëmijës së dashur buzëqeshjen. Ai s'mund të buzëqeshë ndryshe, veçse kështu.

* * *

— Eja të flemë bashkë sonte! — i tha një mbrëmje fëmija.

— Jo! Unë nuk fle në shtrat. Unë fle në divan — përgjigjet Robi.

Megjithëse fëmija i lutet shumë, Robi nuk tundet nga e tija.

— Unë, nuk fle në shtrat, nuk fle!

Fëmija hidhërohet, mënd qan, por ja, sërisht kërkesa perio-dike «Jepma dorën, jepma dorën» e zbut fëmijën, ai bindet, i jep dorën dhe pas pak e zë gjumi i rëndë i ctheve. Fëmija fle. Dora e çeliktë e Robit mbështetet mbi ballin e dirsur të të vog-lit. Zhiva e gishtërinjve, gjaku i vërtetë i Robit, lëviz me shpcjtësi. Faqet llampa të Robit skuqen papritur.

Fëmija ka temperaturë të lartë.

Robi del nga dhoma duke pëshpëritur.

«Ndihmë! Ndihmë! Ndihmë!»

Infermieren e shërbimit e ka zënë gjumi dhe ai e zgjon me dorën e çeliktë. Ajo ngrihet e trembur dhe e pyet se ç'ka ndodhur.

Robi nuk përgjigjet, por pëshpërit me këmbëngulje të dhimbshme «Ndihmë, ndihmë!...»

E alarmuar, ajo vështron termometrin në ballin e Robit, që ka arritur thuajse kufirin maksimal, vështron faqet e skuqura të Robit dhe nxiton drejt të voglit.

Fëmija qe goditur ndën urë rëndë dhe pa asnje shpresë, sikur ura t'i kishte derdhur në krahëror veç të ftohtit edhe peshën e betonit qindravjeçar, kalldrëmin e mbiurës, shinat e hekurta, automjetet e panumërt të kalimtarëve, gjithçka të rëndë, që kallonte mbi të, duke ia vështirësuar frysma marrjen pak e nga pak.

Natën e fundit Roboti u shtri të flinte krahas tij. Jo, ai si Robi, nuk deshi të shtrihej, por fëmija donte të mbështete diku kokën që i digjej zjarr, dhe për këtë arsy e mori dorën e çeliktë ndën kokë. Fëmijën e zuri gjumi shpejt dhe gjaku i Robit, zhiva e bardhë lëvizi me shpejtësi të llahtarshme në arteriet prej qelqi. Faqet iu skuqën më shumë se një natë më parë dhe i shkreti Robi, nisi të pëshpëriste për ndihmë. Ai duhej të ngrihet, por koka e fëmijës, që digjej flakë dhe që mbështetetë mbi gjymtyrët e tij, s'e linte të lëvizte.

Një çast, fëmija u përmend.

— Çfarë ke, Robi?! — pyeti ai. — Ç'ka ndodhur?

Por Robi pëshpëriti me insistim frazën e alarmit, kurse fëmija përsëri e humbi mendjen e ra në një gjumë të thellë.

I shkreti Robi! Thirri për një kohë të gjatë e pastaj s'u ndic më.

Atë natë, infermierja e shërbimit flinte në kolktukun e butë. Derën e poshtme e kishte mbyllur dhe përparrë se Dr. Armstrongu të hynte në klinikë, duhej të shtypte butonin e ziles. Kështu së paku asnjeri s'kishte mundësi ta gjente në gjumë gjatë shërbimit.

Sa për Robin, ajo s'para shqetësohej.

Qe e sigurtë se konstruktori nuk e kishte bërë robotin për t'i kallzuar. Dr. Armstrongut infermieret që flinin gjatë shërbimit.

Në mëngjes kur infermierja e shërbimit të natës hyri në dhomën e Jose Parnas, klithi e tmerruar.

Në shtrat shtrihej trupi pa jetë i fëmijës (ajo ishte mësuar ta njihte vdekjen edhe së largu), kurse pranë tij që Roboti, shtrirë edhe ai, me njëren nga gjymtyrët ndën kokën e Jozesë. Edhe Robi dukej pa jetë, sikur të dy të kishin vdekur në të njëjtën kohë.

Dr. Armstrongu mbeti edhe ai si i ngrirë.

— S'kam parë kurrë një vdekje si kjo! — foli si me vete, i mbështetur në pragun e derës.

— Dy vdekje të tillë! — dëgjoi prapa krahëve zërin e dridhur të Profesorit, — sepse edhe ai ka vdekur...

— Robi?

— Po, Armstrong, edhe Robi ka vdekur.

— Si mund të vdesë një robot, profesor?!

— Më lehtë nga ç'mund të vdesë çdonjéri nga ne. Ai e deshi shumë fëmijën, e deshi si vetë jetën, e vdiq bashkë me të, ndërkokë që personeli juaj i shërbimit shihte ëndërra qiellorë, zoti Armstrong.

— Vdekja e djalit qe e pashmangshme, profesor. Ajo pritej. Ajo do të ndodhët një ditë, por më falni, mua më shqetëson vdekja e çuditishme dhe misterioze e robotit. A thua, Robi ta ketë ndier humbjen gjer në një shkallë të tillë?!

— Robi, ushqëhej me ngrrohtësinë e trupit të fëmisë. Mjaf-tonte prekja e trupit të tij, ose të paktën, afërsia e madhe ndaj trupit, që të funksiononte mekanizmi i tij i komplikuar. Vdekja e ftoku Josenë e dashur, pra edhe Robin besnik e të dhembshur.

— Më falni — tha doktor Armstrongu — këtu çështja është shumë e thjeshtë. — Meqenëse Robi ushqëhej me nxehësinë e trupit të Joses, a nuk është për të njëlloj sikur ta lidhim me një trup tjetër? A nuk do të vihet përsëri në funksionim mekanizmi i tij?

— Pikërisht këtu qëndron sekreti i Robit. Ai qe llogaritur të jetonte pa nxehësinë e trupit rrëth 120 minuta, prandaj e kërkonte dorën vazhdimisht. Vdekja e Josesë dhe ftohja e tij solli ndryshime të shumta edhe në brendësi të tij. Praktikisht ai ka dalë jashtë përdorimit, po ndërkohë tregon se askush nuk është përkujdesur për të sëmurin që nga mesnata. Sikur ju, Armstrong, personeli juaj i shërbimit, të ishit sa një Robi, të kishit «shpirtin» e tij, mbësë fëmija e gjorë... Por ç'them kësh-tu? As Robi dhe as mijëra robotë si ai, as ju, s'do të jeni në gjëndje për t'u ndryshuar fatet të sëmurëve të ndënurave...

Lamtumirë, Jose i shtrenjtë! Lamtumirë dhe ti, o Robi! Dhe dëgjo, Armstrong! I varrosni bashkë, sepse e kanë dashur shumë njëri-tjetrin, shumë, a më ku ton, doktor, shumë...

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

— Tu nani shap më tashëzullimin e sëmundjeve së veshtrive, —

SHQETËSIMET E ZOTIT GRIPP!...

Udhëheqësi i viruseve, mikrobeve më të vegjël, i mbiquajtur ndryshe Gripp, vështroi me kënaqësi hartën e botës e me të madh tha:

— Kështu, zotërinj të shtabit, pushtuam tërë botën! — Lejomëni të përgëzoj me gjithë zemër virusin A-2, marshimi i të cilit në krye të ushtriç shumëmiliardëshe, ka qenë triumfal.

Anëtarët e tjerë të shtabit: A-1, B, C dhe D duartrokitën me zell.

— Mbështetje na ka shpëtuar ndonjë vend? — vërejti pas pak me një farë dyshimi Grippi, — prandaj hapni sytë mirë.

— Një vend i vogël, fare i vogël, imzot, Shqipëria.

— Të pushtohet menjëherë! — bërtiti Grippi i pangopur. Menjëherë!

— Si urdhëron, imzot! Qysh prej një muaji ushtritë tona janë përqëndruar në kufijtë e saj.

— Hyrja s'ka për të qenë e lehtë! — foli qetë-qetë virusi A-1.

— Ç'do të thuash me këtë? — pyeti Grippi, duke ungrysur.

— Imzot, unë me ushtritë e mia kam qenë edhe njëherë tjetër në atë vend.... Ata e kanë organizuar mjekësinë në mënyrë të shkëlqyer. Shteti atje tregon një kujdes të jashtëzakonshëm për shëndetin e njerëzve. Mjekimet në spitale janë falas, ilaçet shumë, shumë të mira e të lira, numri i mjekëve çdo vit bëhet më i madh, e... ku numërohen të gjitha? Unë memzi shpëtova disa vite më parë. Humbje më të mëdha se atje, nuk kam pësuar në ndonjë vend tjetër.

— Mos kërkon të na frikësosh? — pyeti A-2 pa ia shqitur sytë.

— Oh, jo, aspak, desha vetëm t'ju paralajmëroj.

— Mjaft dërdëllite A-njësh! — S'kemi kohë për të hum-

bur. Le të pleqërojmë së bashku, anëtarë të nderuar të shtabit, se në ç'mënyrë do të futemi në Shqipëri.

— Unë kam hartuar një plan, — u hodh A2.

— Pa hë A-dysh, fol, po të dëgjojmë — e nxiti Grippi.

— Nesër, që në mëngjes, do të hedhim diversantët virusë në pikat më kyçë të komunikacionit, në aeroportet dhe portet. S'andejmi drejt e në Shqipëri, me të parët njerëz që do të udhëtojnë.

— Po sikur shteti i tyre të ketë marrë masa të rrepta sigurimi? — pyeti virusi B.

— Për këtë mos u shqetësoni, miku im! Një gjë të tillë e kemi pasur parasysh në hartimin e planit tonë.

Shtabi e duartrokëti nxehësisht virusin A-2 që, megjithëse shumë i ri (kishte lindur në vitin 1968), qe vërtet goxha i mënçur.

* * *

Fshehurazi, diversantët virusë iu ngjitën dy pasagjerëve që udhëtonin për në Shqipëri dhe nxituan të fshiheshin në grykët e tyre. Grupin që kishte pushtuar grykën e udhëtarit të parë, e kryesonte vetë virusi A-2. Ai e kishte porositur veçanërisht komandantin e grupit të dytë, të mos ndihej i gjallë. gjersa të kalonin kufirin.

A-2 i qëlloi të udhëtonte me makinë, kurse grupit të dytë me aeroplan. Kështu pra u ndanë.

* * *

S'do mend, grupi i dytë mbërriti shumë shpejt. Në aerodrom, të porsaardhurin e izoluan menjëherë, në një dhomë të veçantë. S'vonoj shumë dhe udhëtarit iu afroan njerëz të veshur me bluzë të bardha. Njerëz të çuditshëm! Pa hundë e gojë. Në vënd të tyre kishin një pllakë katërkëndëshe të bardhë. Sa i habitur dukej komandanti virus! S'u kishte qëlluar ndonjëherë të kishin të bënin me të tillë njerëz. Seç i vunë një tub qelqi nën sjetull, seç i panë e pastaj thanë:

— Ethe s'ka. Le të presim ca!

Por njerëzit kishin punën e tyre. Komandanti virus s'kishte ndërmend të priste. Mikrobeve s'u durohej gjersa të gjallëronin qelizat e trupit të njeriut, armiqtë e tyre të përjetshëm. Pra kishte një arsy me shumë për të mos iu bindur porosisë së veçantë të Grippit dhe virusit A-2. Pas 8 orësh, ai dhe ushtarët e tij do të sulmonin.

Midjetë është tani që është * * * midjetë është që qenë

Po, po, ishte një sulm i befasishëm, i papërmbajtshëm. Qenë kaq të vegjël, sa me lehtësi hynin ndën dyert e kështjellave qeliza dhe jo dhjetë apo njëqind, por miliona viruse... .

— Tani që hymë brenda qelizave, vëllezër, s'ka forcë të na nxjerrë s'andejmi. Ata mëndjemëdhenjtë, Penicilina, Streptomycina, Tetraciklina, Sulfaleksi a ndonjë tjeter, le t'u shesin mend mikrobeve të tjera, pa neve... s'kanë ç'na bëjnë.

— Po sikur të hyjnë këtu brenda kështjellave qeliza? — pyeti një ushtar virus.

Komandanti virus qeshi.

— He, he, veç nesh, asnë mikrob tjeter, asnë nga ato ilaqë mëndjemëdha s'mund të futet brenda.

— Një urra për komandantin tonë të madh! — thirrën plot gaz ushtarët virusë.

— Gripp! Gripp! Gripp! — jehoi përgjigjja.

Pas dhjetë orësh njerëzit me maska të bardha i yunë përsëri atë shkopin e vogël, të hollë e të qelqtë njeriut që kishte ardhur me aeroplan. Folën midis tyre me një gjuhë që mikrobet s'e merrnin vesh, por dukej sheshazi se diçka nuk po shkonte mirë dhe sipas planit të kryekomendantit Gripp.

Temperatura po rritej me shpejtësi e bashkë me të edhe shqetësimi i njerëzve me maska të bardha.

Jo! A-2 s'kishte ndërmendi të nxitohej. Komandanti virus e ushtarët e tij e pësuan keq. Sulman pa mënd në kokë, ngritën temperaturën 40 a më shumë gradë, kokën e udhëtarit e luajtën mendsh nga dhimbjet që i shkaktuan, dhe njerëzit me maska kaq deshën. Kuptuan se udhëtarit qe pushtuar nga viruset dhe s'e lanë të lirë. E izoluan atë dhe bashkë me të miliardat e diversantëve që me siguri do të vdisnin. Çështje ditësh. Pra kishin zbuluar veten dhe e kishin lënë A-2 krejt të vëtmuar.

* * *


Si kurrë ndonjëherë, Grippi u bëri një pritje të shkëlqyer dhe madhështore komandantëve të mikrobeve të zakonshëm: Stafilokokut, Streptokokut, Pneumokokut, Bacilit të turbekulozit e shumë të tjerëve.

— Vizita juaj, zotërinj të nderuar, është një nder i madh për mua dhe për ushtrinë tonë të lavdishme, — tha Grippi në fjalimin e tij të përshëndetjes. Megjithëse shumë më të vegjël se juve, ne jemi bërë miq të mëdhenj. Forca jonë ka qëndruar gjithnjë në bashkëvëprimet tona. Ne, viruset e Grippit, kemi dobësuar rezistencën e kështjellave qeliza dhe ju, o miq, në mjaft raste keni vazhduar punën tonë. Këtë vit ju keni arritur suksese të dukshme në botë. Fill pas ofensivës tonë, keni sulmuar edhe ju dhe keni shkaktuar bronkopneumonira, bronkite, pneumonira etj. Për nderin tuaj, miq të nderuar, viruset artillerë do t'ju përshëndesin me dhjetë breshëri.

Sheshi i madh oshëtiu dhjetë herë radhazi nga të shtënët dhe thirrjet e zgjatura, Griipp, Griipp, Griipp! Pastaj të prirë nga Grippi, të ftuarit hynë brenda në çadrën e kryekomandanit virus.

Jo, A-dyshi s'kishte aspak ndërmend të nxitohej e të shpërthente një betejë të përgjakshme! Udhëtarin, në një rast të tillë, do ta izolonin menjëherë dhe ai bashkë me diversantët me siguri kish për t'u zhdukur nga antiviruset e prodhuar nga trupi. Por ai, do të pushtonte një numër të paktë qelizash dhe shumë virusë diversantë kishin marrë urdhër të mos u rezistonin gjatë antiviruseve të trupit, dhe kështu udhëtarin do të kalonte një formë shumë të lehtë të sëmundjes. Pak rrufë, pak kolllë, pakt dobësi e asgjë më shumë. A mund të gjendej ndonjë mjek budalla në botë, që për kaq gjë, të jepte alarmin? Pra, do ta mbanin ca ditë të izoluar e pastaj...

— Ha, ha, ha! A-dyshi qeshi me gjithë shpirt me përfytyrimet e bukurë që iu ngjallën në mendje. Kishte për të bërë kërdinë.



* * *

Po atë mbrëmje, një lajmëtar virus, i solli një telegram urgjent nënshkruar nga Grippi. A-dyshi e lexoi me një frymë: «A-dysh!

Viti i ri po afro! Eshtë çasti më i volitshëm. Duhet të shfrytëzosh në maksimum këtë festë tradicionale të njerëzve. Sapo informohemi se shqiptarët janë nga natyra mikëpritës e bujarë. Më 31 dhjetor ata grumbullohen në lokale të mëdha, ose tri-katër familje së bashku, kurse më 2 janar shkëmbenjë vizita tek njëri-tjetri. Një rast i tillë nuk duhet humbur. Ndër-kohë, informohu më saktë, për organizimin e atjeshmë të mje-kësisë, furnizimin me ilaçe, numrin e personelit shëndetësor. spitalet, për gjithçka që ka të bëjë me sulmin tonë të ardhshëm.

A-dyshi ferkoi duart mjaft i kënaqur. Një kryekomandanti të tillë si gjendej shoku. Ishte imençur, i zoti dhe i shkathë ky Grippi!

* * *

Gëzimi i A-dyshit nuk zgjati shumë. Në mbrëmje zbuluesit e tij i sollën lajme shumë të këqija. A-njëshi kishte thënë të vërtetën: «Shqiptarët ishin në gadishmëri të plotë. Rezervat e ilaçeve qenë të pafund dhe, gjallë e mori, qenë kaq të lira. Autoambulancat, mjekët ndihmësimjekët, farmacistët, infermierët të kallnin datën. Ngjanin një ushtrie që është gati për tu hedhur në sulm.»

Sikur të mos mjaftonin tërë këto, ushtritë e bashkuara të aspirinave e fenaskoneve, kishin zënë pozicione të fortifikuara edhe nëpër kinkaleritë e qyteteve e fshatrave. Shkurt, që një vend «i mallkuar». Të sëmurëve, jo vetëm që u jepeshin ditë pushimi, por edhe u paguheshin të holla për ato ditë. Këto e tronditën dhe e pikelluan shumë.

Eh! Eh! — A-dyshi pohereti thollë i loddur dhe i dergol një informacion të shpejtë Grippit. Përgjigja s'voni i të vinte. «A-dysh!

Nuk bën tē dëshpërohesh kështu. Ushtria jonë është e pa-thyeshme.

Shteti i atjeshëm vërtet ka marrë masatë shumta si asnjë vend tjetër, por ne duhet tē shfrytëzojmë shkujdesjet e disa njerzve. Kështu, kur tē shihni se një njeri i sëmurë kollitet pa mbajtur shaminë para hundës e gojës, shfrytëzoje menjëherë rastin!

Kur tē shihni se ndonjë familje nuk e ka izoluar tē sëmu-rin as me mjetin më tē thjeshtë, me një perde: ja pra edhe një mundësi tjetër. Shfrytëzoje pra!

Të shëndoshët vizitojnë tē sëmurët, a do rast tjetër më tē mirë? Pushtoni po ashtu, teatrot, kinematë, stadiumet e myllura, shkollat, çdo vend ku ka grumbullim njerëzish dhe fitorja me siguri do të jetë jona.

Grippi

* * *

Shqipëri Grippi

Gippi kishte zënë vend në krye tē tryçës katërkëndëshe. Të ftuarit s'lia hiqnin sytë kryekomandantit tē madh, Gipp.

— Po, zotërinj, jo më kot format e lehta tē sëmundjes njerëzit i quajnë «tradhtarë», «Kalë Troje». Është kaq e vështirë t'i dallosh nga një e ftohur e zakonshme, shumë e vështirë. Me një taktkë tē tillë, ne depërtuam në mbarë botën.

Ju njoftoj me kënaqësi, se edhe në Shqipëri ne mundëm tē futemi. Pas shtatë ditësh, udhëtarin e blokuar. Kishte e rrufë, pak kollë e asnjë më shumë. Atë mbrëmje, A-dyshi dhe diver-santët e tij, ngriten me nxitim çadrat në grykët e së shoqes dhe tē tre fëmijëve. Nuk vonuan t'i vinin për vizitë fqinjët dhe A-dyshi i shkathët nuk humbi kohën. Gjatë tre ditëve që vijuan, udhëtarin ynë ka pasur takime tē shumta, pa ka udhëtar me autobus, pa ka vajtur edhe në kinema. Kështu që ushtarët tanë, tashmë janë shpërndarë në shumë pika tē qytetit.

— Kur do tē shpërthejnë betejën, zoti Gipp? — pyeti mi-krobi Stafilokok.

— Së shpejti, i dashur, së shpejti. Disa janë urdhëruar tē shpërthejnë brenda 18 orëve, tē tjerë gjëra në tē tretën ditë. Si-pas rastit do tē shpërthejnë betaja tē përgjakshmë dhe disi më

të lehta. Kemi nevojë edhe për forma të lehta, apo jo? — u buzëqeshi ai me dinakëri të pranishmëve. Mikrobeve u vajtën buzët vesh më vesh nga kënaqësia dhe e duartrokitën.

* * *

„Ditët e para të janarit. A-dyshi kishte ditur të shfrytëzon-
te me zotësi shkujdesjet e njerëzve dhe të shtrihej shumë.

C'e mbante A-dyshin! Kishin ardhur ditë të bukura për
të. Miliardat e ushtarëve të tij po përparonin me shpejtësi
nga kryeqyteti për në viset e tjera të vendit.

„Urime A-dysh, urime, vëlla! Po e bën fora! — i shkruante
Gippi. Sulmoni, vëllezër, sulmoni egërsisht! Bashkërendoni ve-
primet tuaja me ushtritë e bashkuara të mikrobeve të tjera! Sa
më shpejt, aq më mirë. Duhet pritur një kundërsulm i fuqishëm
nga ana e personelit shëndetësor. Merrni masa! Luftë të mbarë,
vëllezër!

Juaji Gippi!».

* * *

„Gippi nuk që gabuar. Kundërofensiva s'vonoi. Shqiptarët
shpërthyen një kundërsulm të përgjithshëm që s'qe parë kurrë.
Autoambulancat shkonin e vinin. Farmacitë punonin gjer na-
tën vonë. Mjekët e të tjerët punonin me orë të zgjatura. Të së-
murët pushonin të qetë, gjersa viruset mposhteshin. Ushtritë
e ilaçeve, të Aspirinës, Fenoskonit, Pyramidonit, Sulfaleksit,
qenë bërë të papërbajtshme. Nga ana e tyre Bipenicilinat,
Streptomicinat dhe Tetraciklinat, shpartallonin menjëherë mi-
krobe të tjera, që donin t'u zinin vendin viruseve të dërrmu-
ar të A-dyshit. Gippi kishte nisur të shqetësohej seriozisht.
Dalngadalë po mbylleshin të gjitha shtigjet. Kinematë u mby-
llën, teatrot po ashtu. U kishte mbetur edhe një shpresë, fëmijët,
por ah, c'dëshpërim!

Shkollat u mbyllën. Njerëzit nga ana e tyre po tregohe-
shin gjithnjë e më të kujdeshëm.

Të shëndoshët, e veçanërisht të vegjlit, nuk takoheshin

me tē sëmurët. Ata që u shërbenin, mbanin maska katërkëndëshe, në fijet e mpleksura tē tē cilave mbeteshin si në rrjetë shumë virusë tē këqija. Enët e përdorura nga tē sëmurët i zienin me ujë tē vluar e viruset e gjorë tē A-dyshit përcëllloheshin. Dyshemetë i lanin çdo ditë me ujë tē ngrohtë, e ushtritë e viruseve përfundonin në kanalet e gropave tē zeza.

Ata që kolliteshin apo tështiteshin, mbanin përpara gojës e hundës shaminë e përsëri viruset përplaseshin atje me forcë e thyenin kokat. Dhomat i ngrohnin mirë, po edhe i ajrosnin herë pas here, e ushtarët virusë binin përdhc, pa frymë, njëri pas tjetrit.

Sado që ushtarët zinin vend në grykët e tē shëndoshëvc, djalli rozë, «permanganat» i thoshin, i digjte e i përvëlonc tē tërë.

A-dyshi po e shihte vdekjen me sy hapur. Gati s'i besohej, se në këtë vend tē vogël, ushtria e tij do tē gjente fundin e kobshëm e tē turpshëm dhe me mend i dha tē drejtë vëllait më tē madh, A-njëshit.

Natë e ftohtë janari. Miliarda ushtarë virusë, tē raskapitur e tē dëshpëruar pa masë, tē gjymtar e tē sakatosur, zvarrise-shin plot mund pér nga kufiri... Atje, A-dyshi që printe, u ndal dhe ktheu kokën pér tē fundit herë. Shqipëria shkëlqente në miliona vezullime tē embla dritash. — «Në këtë vend, pér pak dhc do tē kisha gjetur vdekjen — mendoi. Mënd qau nga inati.

Si do t'i dal përrapa zotit Gripp unë, pushtuesi i mbarë botës? — tha me vete e po atë kohë ndjeu t'i këputeshin këmbët nga frika.

Iu bë se dëgjoi thirrjet entuziaste e plot mburrje tē ushtarëve tē tij para se tē vinin në këtë vend: «Gripp! Gripp! Gripp», e gati-gati iu mor fryma nga ankthi mundues.

Gjithë merak mendonte si do t'i dilte përrapa zotit Gripp, si do t'i raportonte e si do tē mund tē justifikohej.

— Disfatë, disfatë e plotë — thoshte me vete duke zvarrisur këmbët me zor drejt shtabit tē zotit Gripp.

KU R M Z E M R A B L I H E T 18 67
KU R M Z E M R A B L I H E T 18 67

«Zemra ime është e shëndoshë. E ofroj atë për kërkime kundrejt një shume të hollash. Jam gati edhe ta shes në disa rrëthana të caktuara.»

DORIS HAROT
47-vjeçar, San-Paolo, Brazil.
(Nga shtypi).

«Jam baba i tre fëmijëve dhe gjendja ime ekonomike është e mjeruar. Kam dëgjuar se ka institucionë, të cilat janë të interesuara për të blerë sy. Kështu që edhe unë jam gati të ofroj për shitje njërin nga sytë e mi, me qëllim që të mund të shpëtoj familjen time». *Die Shërbimtarët e Sosiale Sigurimit*

XHOVANI DE MARTINO — 25-vjeçar, Itali. (Nga shtypi).

Ndërtesa tetëkatëshe e fabrikës së prodhimit të maqinave të thjeshta llogaritëse ishte më e larta në periferinë e varfër të qytetit. Ajo lëshonte hijen e saj vezulluese mbi çatitë e ulta të barakave dhe kasollave të varfra që e rrëthonin, duke i bërë të dukeshin më të mjera në varfërinë e tyre, për shkak të kontrastit të fortë të fasadave të veshura me pllaka mermeri dhe xhamë akulli. Por në qendrën e qytetit të madh me siguri do të dukej mikroskopike ndaj grataçielevë më të reja që ngriheshin e ngriheshin lartë në një garë të ethëshme për t'ia kaluar njëratjetrës. Kështu që as ndërtesa tërë shkëlqim dhe bile as maqina e zotit Luis, e blerë para tre vjetësh (në qytet muajt e fundit kishin filluar të qarkullonin maqina supermoderne të një firme

të njohur botërore, përpëra të cilave ajo e zotit Luis dukej jashtë dynjallëkut dhe e dalë mode), nuk i kishte habitur punëtorët e tij dhe kur e krahasonin me zotin Rydiger, (Rüdiger) pronarin e kombinatit më të madhu metalurgjik të vendit, ku punonin mbi njëzet mijë punëtorë, teknikë e inxhinierë, padroni iu dukej si një zot punishtëje.

E megjithatë edhe zoti Luis, edhe ndërtesa tetëkatëshe, rëndonin mbi supet e katërqind punëtorëve e teknikëve, me një peshë jo më të vogël sesa gjiganti i Rydigerit (sepse të katërqindët qenë të detyruar të bënë punën e njëmijë vëtëve). Kështu që herë pas here, në këtë qytet shpërthenin demonstrata e greva, që ishin aq të shpeshta sa edhe shirat tropikale e vetëtimat zhurmëmëdhë e plot shkëlqim, për të cilat krahina e tyre i kishte shoqët të rralla. Pikërisht për këtë qyteti i tyre thirrëj dikur edhe qyteti i shtrëngatës, i bëbullimave dhe i vetëtimave, i erës së fortë dhe i përrrenjeve të rrëmbyeshëm, një emër fort i gjatë, i krijuar nga vendasit e hërvës, i cili në shekuj pësoi transformime të habitëshme për të marrë së fundi një emër farc të thjeshtë, një emër sintezë, qyteti i Mjegullës. S'kishte emër më të goditur se ky! Mjegullës së përherëshme natyrale të këtij vendi iu shtua gjatë viteve mjegulla shumëngjyrëshe dhe artificiale e uzinave, fabrikave e kombinateve, dhe kjo re tymi, pluhuri e grimcash kimikatesh u bë për qytetin N., qelli i tyre i përhershëm dhe kupola e saj ruante ngjyrën gri dimër e verë. Banorët e qytetit vuanin nga një etje gati e sëmurë për një copë qicell të kaltër, për një copë diell të shndritëshëm, për ajër të lehtë, mbushur me aroma lulesh, me njomështinë e barit e të tokës. Nga ky qytet stina e pranverës që larguar përfundimisht, sepse bloza e zezë ngjyroshtë me trishtimin e saj çdo lule që guxonte të hapte petalet.

Ja, pra, në qytetin «Mjegull» pesë vjet më parë pati ardhur emigrantë Emiguela dhe që vendosur aty me të shoqen dhe me të shtatë fëmijët. Më e madhja, në atë kohë, s'i kishte mbushur të dymbëdhjetë vjetët. Dhe që më i varfér se të varfërit vendas, të cilët së paku problemin e banesës (sado që ato qenë baraka që mezi mbaheshin në këmbë) e kishin zgjidhur e kësisoj kishin nga një kolibe sa për të futur kokën. Emiguela me familjen e tij flinte atje ku e zinte nata.

Fabrika e Z. Luis porsa qe hapur, dhe Emiguela rendi për tē kërkuar punë. E pranuan dhe e futën në një proces pune të thjeshtë, që kategorizohej si i dorës së tretë e ku si pasojë edhe rroga që e mirrte, ishte po ashtu e kategorisë së fundit. Por falë energjisë së madhe dhe nevojave të ngutshme familjare, ai pунонте ditë e natë si kalë. Brenda tre vjetve arriti të ekte përpara dhe tē merrej me punime të stërholluara që i përkisnin kategorisë së parë. Rroga iu shtua dhe ai filloi ta ndiente më tē lehtë barrën e familjes.

Nga baraka e bashkatdhetarit tē vet Tekieras, ai dhe familia u transferuan në një barakë tē re. Por ndërkokë, Emiguela dyzetvjeçar kish filluar tē ndiente në brendësi tē tij ndryshme disi tē pakuptueshme. Tre vjet më parë, sado që shumë më i mjerë, ishte më i guximshëm, qoftë edhe përballë zotit Luis. Kurse tani, sado që jetonte më mirë, qe bërë ca frikacak dhe (djalili ta marrë, ai s'ë ka aq tē lehtë ta pranojë këtë tē vërtetë) pakëz servil. Këtë mëngjes, kur papritur u gjend ballë për ballë me z. Luis, e përshëndeti duke u përkulur më shumë nga ç'duhej. Ai u skuq lehtë, kur ndeshi vështrimin qortues tē Tekieras, por në fund tē fundit edhe Tekiera duhet ta kuptonte. Babai i shtatë fëmijëve duhet tē jetë i kujdesshëm, dhe duhet tē përpigjet që padroni tē kujdes me sy tē mire. Nga kjo gjë veç tē mirave, s'vjen ndonjë e keqe.

Dile më vonë, sitenat e fabrikave, tē uzinave e tē kombinave tē qytetit tē Mjegullës dhanë sinjalin për fillimin e grevës së madhe. Të gjithë në fabrikën tetëkatëshe e lanë punën dhe dolën në oborrin e madh, tē heshtur e hijerëndë si vdekja, kurse Emiguela nuk lëvizi nga vendi. Në sallën e madhe, tē zbrazët e tē heshtur, dëgjoi hapat e njohur tē z. Luis. Ai nuk ngriti kokën dhe as e ktheu për ta parë, por e ndjeu t'i afrohej nga çapet, që sa vinin e bëheshin më tē rëndë.

— Ju qenkeni, z. Emiguela? Vetëm ju, paskeni qëndruar këtu? Emiguela nuk u përgjigj.

— Unë s'kam për t'u harruar. Jo! Me tē vërtetë, unë s'kam për t'ju harruar! Në çdo rast, tanë e tutje, ju mund tē mbështeteni tek unë.

Emiguela nuk e ndjeu veten më tē qetë as kur zoti Luis, duke u larguar, i rrahu shpatullat miqësisht.

Ç'bëhej jashtë? Ç'thonin për të? Po, s'kish më asnje pikë

dyshimi. Ai ishte një grevëthyes. Por thuamë Tekiere, thuamë, a mund të jetë babai i shtatë fëmijëve një grevëthyes?

Vonë në mbrëmje, ndërsa dilte nga fabrika, në portën e madhe të saj, dikush e priste. Njeriu ishte në gjysmerrësirë. Emiguela u pushtua nga dyshimi dhe frika instiktive. Atë ditë kishte sfiduar 400 punëtorë dhe ishte bërë grevëthyes. Po sikur i dërguari të ishte nga ata të sindikatës? Një krismë në errësirë dhe... asgjë më! Shtatë të vegjël të mbetur rrugëve. Por u qetësua dhe pshërëtiu thellë i lehtësuar, kur dëgjoi zërin e njo-hur të Tekieras.

* * *

— Dhe shpreson, i dashur, në zemërgjerësinë e z. Luis? Për interesin e tij, ai do të sakrifikonte pa i ardhur aspak keq. Ti i trembesh papunësisë si vdekjes, por kështu i vecuar je më i rrezikuar. E ku ta dish? Një aksident, një sëmundje, një gjyntim dhe e gjejmë veten befas në mes të katër udhëve, pa asnje pesos. Mjerë ai që mbetet i vetëm dhe lum ai, Emiguela, që ka krahun e fortë të shokëve! Ti më kupton, të flas kështu, sepse jemi miq dhe unë të dua. S'më vjen aspak mirë të të mbajnë **në gojë. Ai Heze barkmadhi desh të të vinte atje në salë hujr punoja, por mezi e mbajnëm.**

BESËS EMIGUELA U ÑXËH

— Po ç'kanë, ç'kanë me mua, djalli ta hajë? C'po u bëj unë atyre? Mos u kam hyrë në hak? Kam parë vetëm punën time. Përse s'e lini njeriun të lirë, të bëjë si t'i dojë qejfi? U dashka domosdo t'ju bindem juve, të bëj çfarë të më thonë të tjerët? Fundi, mua nuk më pëlqen të më têrheqin nga hunda, e të më shpien nga të duan. Dhe dëgjo, Tekieras, lërmë të qetë edhe ti, edhe ata shokët e tu! Grevat, demostratat, a vetë luftën, po të duan, le t'i bëjnë të rinjtë. Mua s'më keni me vete. Kam grua, kam fëmijë. Të isha i vetëm, nuk do të pyesja gjatë, sepse, që ta dish, jetën e quaj një angari, një torturë cfilitëse dhe do t'i kisha dhënë fund me kohë, pa më ardhur aspak keq, të betohem, aspak keq!

— Unë s'kam ç'të të them më shumë, veç të kujtoj se delen që shkëputet nga vatha, e ha ujku, dhe duhet ta dish mirë se je

duke shkuar në pyll midis ujjërve. Sa s'është vonë, kthehu në gjirin e shokëve, që të duan të mîrën dhe përpiken për ty...

— Lërmë, lërmë Tekieras! Jam nginjur me propagandën tuaj! Ajo s'më ka dhënë gjer më sot as edhe një pesos.

— Ajo ka për t'u dhënë nesër fëmijëve tanë, i dashur Emiguela, botën, botën e madhe e të gjerë, dhe kjo tingëllon kaq e madhërishëm, kaq bukur, sa ne nuk duhet të kursejmë asgjë.

I ekzaltuar nga fjalët, ai s'e vuri re Emiguelën tek largohej me xhaketën e hedhur supevë, në rrugicën e ngushtë të kapelepunuesve meksikanë.

* * *

Pas dy vjetësh, përballë ndërtesës së z. Luis, filloj të ngrihej uzina gjigante e prodhimit të makinave elektronike. Për ndërtimin e saj punonin mjetet më të fundit të teknikës dhe punëtorë nga më të kualifikuarit, të ardhur nga veriu. Punohej ditë e natë me një ritëm të çmendur. Ajo rritej, jo me javë e me ditë, por çdo orë! Blloqe të tëra gjigante, të gatshme, vendoseshin në vendet e tyre nga vinça të fuqishëm. Ndërkohë që vazhdonte puna për ndërtimin e kateve të tjera, në ato që ishin bëre gati, mobiluar e pajisur më së miri, fillonte menjëherë prodhimi i makinave elektronike. Makinat ishin të ndërlikuara, ishin të fjalës më të fundit e, megjithatë, për habinë e të katërqind punëtorëve të fabrikës së Luisit, në to punonin shumë pâk punëtorë të specializuar (të ardhur dhe ata nga veriu). Fabrika e Luisit, dukej se po jetonte ditët e fundit. Uzina superautomatike, pas dhjetë ditësh, lëshoi hijen e përjetëshme në katin e parë të fabrikës së Luisit, duke e dënuar të jetonte pa diellin e qytetit të Mjegullës. Tamam në këtë kohë, Luisi u detyrua të pushonte pesëdhjetë punëtorë. Uzina ngrihej e ngrihej, për të lëshuar pastaj hijen e përjetëshme në katin e dytë. Përsëri z. Luis u detyrua të pushonte pesëdhjetë punëtorë të tjerë. Rreziku i papunësisë i shtyu punëtorët në greva e pastaj në demonstrata të fuqishme, por ata u shtypën me gjak nga policia e qytetit të «Mjegullës», Hija e përjetëshme po shtrihej duke e gllabëruar brenda vetes ndërtesën tetëkatëshe dikur të madhe e të bukur.

Makinat llogaritesc tē Luisit, qē dikur gëzonin famë tē mire, filluan tē dukeshin primitive përparar atyre tē veriut, qē qenë edhe më tē lira. Numri i blerësve tē tij, sa vinte e bëhej edhe më i vogël.

Zoti Luis' u gjend një mbrëmje i vdekur në dhomën e tij. Në dorën, e shtrënguar fort nga kontrakturat e vdekjes, mbante një revolver, tē cilili mungonte në krëhër vëtëm një plumb.

Të katërqind njerëzit e fabrikës së Luisit qenë flakur në mes tē katër udhëve! Të katërqindët, ah jo, duhet tē themi tē 399-tët, sepse përsëri Emiguela nuk deshi tē përzihej me ta; kësaj radhe jo inga dëshira tē rrinte mënjanë, por ngaqë i vinte turp dhe rëndë. Pse qe ndarë prej tyre, kur fatine tij s'mund ta veçonte? Jo, më mirë le tē vuante pasojat e sjelljes së tij tē dikurshme, kështu së paku e ndiente veten më tē qetë. Kur shokët i ofruan një shumë modestë tē hollash nga fondi i tyre i përbashkët i ndihmës reciproke tē mbledhur prej vitesh, ai përsëri nuk pranoi, madje me kokëfortësi. Tekieras, në emër tē tē 399-ve, nguli këmbë që t'i merrte, gjersa tē gjente një punë tjetër. Emiguela nuk pranoi; si ishte e munduri ta ndihmonin, kur ai si grevëthyes, ua kishte bërë borxh dhe i kishte dëmtuar? Sjella e tyre e preku dhe, që tē mos pranonte, gjeti një shkak. I tha Tekieras se kishte lënë mënjanë ca pesos për ditë tē vështira dhe kështu mundi ta qetësonte.

Të tretën ditë, ndërsa dilte nga shtëpia, me një buzëqeshje tē dëshpëruar u premtoi tē vegjëlvet se në mbrëmje do tē sillte doemos diçka, dhe po mendonte samirë do tē ishte, sikur shokët t'i ofronin një ndihmë tē vogël. Nuk donte kurrsesi që fëmijët tē vdisnin para tij.

Që kur pat ardhur në këtë qytet tē huaj, s'kishte njojur rrugë tjetër veç asaj fabrikë-shtëpi dhe anasjelltas. Dhe bash përkëtë, qendra e qytetit, tē cilën s'e kishte parë prej një viti,

i bëri një përshtypje të pashoqë, me gjithë gjendjen e tij për të qarë hallin. Qendra s'kish pasur rrugë me kate, që i shembëllën një kërmilli gjigant, me ato rrotullime spirale e ndërlikime të jashtëzakonshme. Në vend të ndërtuesave të vjetra, kishin mbirë si kërpudhat pas shiut, magazina, hotele dhe dyqane të mëdha e të vogla, që mbanin emra pronarësh të huaj, ardhur më shumë nga veriu. Qyteti kishte më shumë njerëz, më shumë makina, të cilat ecnin me shpejtësi të llahtarshme (ai priste plot ankth, nga çasti në çast, t'i shihnin sytë ndonjë përplasje të kobshme, porse një gjë e tillë nuk ndodhi gjatë atyre dy orëve që qëndroi i mbështetur në parmakët e rrugës së sipërme). Një çast mendoi, se po të hidhej nga ajo lartësi e të binte poshtë, në shinat e hekurta të tramvait, gjithçka do të përfundonte për gjithmonë, gjithçka...

«Unë do ta kisha bërë këtë! — mendoi Emigucla, pa ia ndarë sytë rrugës më të poshtme, të kredhur në mjegullën që sa vinte e shtohej. — Jo, jo, ti nuk më dhimbesh! — iu drejtua vetes, si të qe një person i dytë. — Unë të urrej, megjithëse edhe keq më vjen për ty. Nuk është krejt fajt yt. Dhe do të isha hedhur sigurisht do ta kisha bërë këtë, po fëmijët e mi gruaja! Cili kishte për të qenë fundi i tyre? E lexove gazetë e djeshme? — pyeti pastaj veten. Ç'gazetë? Ja pra, atë që e gjete hedhur përtokë. Diç kishin mbështjellë me të. Ah, po, pq e lexova! Me sa kujtoj, ai kishte mbytur me gaz veten, gruan e fëmijët. Dhe qe emigrant, si unë. Jo, këtë s'kisha për ta bërë kurë! Nuk më vjen keq për veten time, po sakrifica duhet të ketë një kuptim. Duhet t'u shërbejë diçka fëmijëve të mi, që ata të rrojnë... Dhe, po qe se ata rrojnë, kjo do të thotë, se edhe unë, megjithëse i vdekur, jam përséri i gjallë, i gjallë se ata janë mishi dhe gjaku im».

* * *

Atë natë, i duhej me çdo kusht të conte diçka në shtëpi. Në fillim shkoi në stacionin e trenit, pastaj në atë të metrosë. Mbarti çfarë mundi e pa bërë naze, duke konkuruar deri edhe me hamejtë më të humbur. (Për atë ditë ish hamalli më i lirë i qytetit të Mjegullës.)

Vonë pasdite, me 50 pesos në xhep, i lodhur e i këputur, u ul në një nga stolat e parkut të qytetit. Stolat qenë me dy anë dhe një mbështetse. Një plak lexonte me zë gazeten e mbrëmjes dhe ai, gati duke dremitur, dëgjonte leximin e ngadalshëm, të huaj e të largët, si t'i përkiste një bote tjetër.

«Qeni i vogël, i milioneres së njojur Elizabeta Rëvua, ishte i sëmurë rëndë, gati pashpresë shërimi. Me aeroplan të posaçëm. atë mbrëmje, arriti nga veriu një mjek i dëgjuar qensh. Elizabeta që tepër, tepër e shqetësuar!... (Sipas gazetarit, ajo mënd i kishte mbushur sytë). Fabrikanti Argelo, shpenzoi plot 6.000 pesos, në një mbrëmje kushtuar ditës së të varfërve, ku ai dhe miqtë ngritën shumë dollë dhe morën premtimë mallëngjyese për t'u ndryshuar fatet të gjorëve».

Emiguela mënd qeshi.

«Do të isha kurioz, — mendoi, — se si do të më përshkruanin mua, këta gazetarë të mençur. Por, mbase një ditë, edhe do të shkruajnë. Atyre u pëlqejnë sensacionet. P.sh. atyre do t'u pëlqente që unë të hidhesha nga grataçeli, ta zëmë nga kati i 100-të. Do të më fotografonin në pozicione të ndryshme, barkazi, më shpinë, brinjazi, do të intervistonin fëmijët jetimë, gruan e do të më bënин heroin e ditës, të një dite të vetme. E nesërmja kërkon gjithnjë heronj të rinj...»

Me «budallallëqet» e saj, gazeta iu duk tèrheqëse dhe ai vuri përsëri veshin të dëgjonte. Lajmi ishte nga më të çuditëshmit e asaj gazete, mbase i të gjitha gazetave botuar atë mbrëmje dhe atij iu duk shpresëdhënës. Ai përpri çdo fjala të artikullit. «A do të gjëndet zemër e shëndoshë për z. Pedros?»

Emiguela s'mbante mend të kishte lexuar a dëgjuar ndonjëherë, një histori aq idiote dhe aq qesharake sa ajo! — Po të mos isha në këtë gjendje të mjerë, do të isha shkulur së qeshuri, — mendoi. Por shpejt u ngrys. Gazeta vetëm përkohësisht ia kishte larguar mendjen nga familja që priste ushqime dhe të holla. Solli ndërmend ecejaket e lodhshme të ditës, ato pak pesos të fituara me mundim dhe mendoi me dëshpërim se s'do të mund të siguronte jetën e fëmijëve edhe për një javë. Sa për të gjetur punë tjetër, të ngjashme me atë që bënte në fabrikë, kjo s'duhej menduar. Kishte njerëz që prisnin prej muajsh përpara kinateve thuajse gjithnjë të myllura të zyrave të punës, ku çdo

ditë gjeje tabelën me të njëjtin mbishkrim: «Për sot nuk ka vendë të lira». Ajo pritje dukej se s'do të mbaronte kurrë!
«Po sikur t'i shisja zemrën time z. Pedro? Vërtet, po sikur ta bëja këtë? Do të fitoja një shumë të hollash e do t'u si-guroja fëmijëve e gruas kthimin në vendlindje e vite disi më të mira, gjersa të rriten të vegjlit e të bëhen zot të vetes. Po, me sa duket, për mua s'ka rrugë tjetër. Dhe më mirë të vdes kështu, sesa në një moment krize të fortë të hidhem nga parmakët e katit të sipërm të rrugës për t'i dhënë fund jetës. Vdekja ime s'kishte për t'i lehtësuar ato të mjerë, veç do të shpejtonte fundin e tyre. Kurse kështu do të vdisja i qetë, oh kaq i qetë! Çudi! S'kisha menduar kurrë se vdekjen do ta prisja kështu. Ç'është ky gjëzim që ndjej? Apo vallë jam çmendur dhe s'kuuptoj ç'mendoj e ç'bëj... Jo, aspak, unë ndjehem tanikaq mirë, kaq të lehtë e ndjekam vreten, që kur më lindi ky mendim në kokë, sa s'di as vetë si ta shfaq.

Ai qeshi me zë të lartë, fërkoi duart i kënaqur dhe i zgjati, si të donte t'u rrëmbente pleqve gazeten. Pleqtë kthyen kokën dhe vështruan njëri tjetrin në sy.

— Sot ka shumë të çmendur! — tha njëri syresh.

— Sikur po shtohen çdo ditë, si kjo mjegulla mbi qytetin tonë — tha tjetri duke palosur gazeten tridhjetëfaqëshe të ditës përpara fytyrës me leshra të kërcyera të të «çmendurit», që me gishtërinjtë gjysmë të thyer ua kërkonte me ngulm atë shuk letre të mbledhur me mundim.

Në shtëpinë e zotit Pedro, hynin e dilnin vizitorë të shumtë. Policët privatë, sipas urdhrit të prerë të Dr. Albertos, me përjashtim të personelit të shërbimit, nuk lejonin të hynte kush në dhomën e të sëmurit, porse gjendja e tij sa vinte e rëndohej. (Z. Pedro vuante së fundit edhe nga mania e persekucionit). Ai ankohej për çdo gjë, për shërbimin e keq të Dr. Albertos e të personelit të tij, për kohën e mjegulltë e gjithnjë me lagështirë, për të shqoqën që tërë jetën mbeti shterpë dhe nuk i dha të paktën një fëmijë, një djalë a një vajzë që do të trashëgonë milionat, për lajmërimin në gazetë që ende s'po i përgjigjej

njeri, për grevën e punëtorëve të plantacioneve, që, sipas tij, duhet të ishte shtypur më egërsisht, për diellin e zbetë të qytetit të mjegullës, oh atë ditë çdo gjë i dukej e shëmtuar, e keqe, e ne-veritëshme! .

Plaku, shtypi nervoz butonin e ziles së alarmit. Njëra nga të tri dyertë e dhomës u hap, dhe në prakun e saj u duk infermierja e shërbimit të natës.

— Sillmëni Dr. Alberton! Sillmani shpejt! — thirri. (në qoftë se do ta quanim kështu atë zë të dobët e të mekur).

Doktori nuk vonoi t'i vinte pranë.

— Me sa duket edhe ti beson se unë do të vdes, se unë duhet të vdes?

Sytë e Pedros flakëruan nga një zemërim i papërmbarjat.

— Qetësohuni z. Pedro, qetësohuni, ju lutem, çdo shqetësim është në dëm të shëndetit.

— Mjaft më me këto këshilla të budallallepsura! S'jam i çmendur të besoj se një zemër e goditur nga infarkte të rënda, u shëruaka me këshillat tuaja, me dietë, ilaçe e regjim shtrati! Mua më duhet një zemër e re, një zemër e re, a më kuption q'të them?... Ku vanë mijërat e dollarëve që ke marrë nga unë? Ku? Ç'u bë me kufomat e shtypura nga makinat?

— Gjer tani na kanë sjellë tri kufoma, por asnjëra s'është e saktë. Dy syresh janë shtypur keqas dhe, duhet të pranojmë, se kjo s'është aspak një gjë e lehtë. Të shtypësh vetëm kokën dhe të lesh të paprekur gjoksin, kjo është një gjë fort e vështirë! Viktima, në çastet e rrezikut, bën ç'është e mundur të shpëtojë. Ju e kuptioni, instikti i vetëmbrojtjes...

— Kush dreqin ua mësoi këtë! Cili? — mallëkoi nëpër buzë Pedroja — Ç'moshë kishin? — pyeti pas pak.

— Njeri ishte 35-vjeçar, kurse tjetri 25-vjeçar.

— Vdiqën në vend?

— Nuk duhej të vdisnin ndryshe!...

— Po i treti?

— Të paktën, kufoma qe më e saktë. U godit në kokë, por...

— Por??!

— Zemra e tij ishte e sëmurë rëndë. Nuk duhej të rronte më shumë se tre vjet.

— Po tani? Ç'bëhet tani?

- Vazhdojnë kërkimet. Kjo punë s'është e lehtë.
— Po sikur, Alberto, të vrnisnit një njeri?
— Kjo është e pamundur! Kardiokirurgu, profesor doktor Karlos, bën transplantime zemrash nga kufomat tek të gjallët, vetëm pasi është siguruar se i aksidentuari ka mbaruar plotësisht dhe me lejën e prindëve, ose të familjarëve.
— Po ç'qenka ky Karlos? S'do të pranonte, bie fjala 500.000 dollarë dhe të mbyllte sytë?
— Jo! Këtë s'do ta bënte! Karlosi është i ndershëm.
— Po kësaj, a do t'i bënte ballë ndershëmëria e tij? — plaku Pedro mblodhi gishtin, duke dashur të imitonë këmbëzën e armës.
— Ju siguroj se përsëri ai s'do të bindej!
— Oh, i mjeri, i mjeri unë, ç'njerëz të pazot që më kanë rrëthuar! Oh, qenka e thënë që milionat e fituara me gjak e djersë të më shkojnë në dreq! Qenka e thënë të vdes, të më hanë krimbat, kurse ju qenër doni të më zhvatni, ju doni vdekjen time, i gjori unë...
Z. Pedro nisi të qante, si fëmijë.

* * *

- Ndonëse kishte ardhur i pari, Emigucla priti në sallonin e vogël të mjekut gjersa mbeti i vetëm.
— Çfarë ju dhemb? — e pyeti Dr. Albertoja, duke ia ngurllur sytë me vërejtje fytyrës së tërhequr dhc anemike, të parruar prej ditësh.
— Jo, s'jam i sëmurë dhe nuk ankohem për asgjë, por...
— Por çfarë atëherë? Përse keni ardhur? — pyeti Albertoja i mërzitur dhe me padurim.
— Lexova gazetën. Bëhej fjälë për. z. Pedro dhe për ju.
— Ah, po! — u gjallërua papritur doktori, duke hequr dorë nga sistemi i tryezës së punës dhc duke vështruar me interes të porsaardhurin.
— Mos jeni shofer dhe?!...
— Jo!

— Ah, për pak kujtova se kishit sjellë ndonjë kufomë.

— Juve ju duhet një zemër?

— Po, po! Një zemër e re dhe e shëndoshë, do të duhej patjetër për z. Pedro!

— C'do t'ë thoshit, sikur unë, t'ju gjeja një zemër të shëndoshë?

— Ne do t'ju ishim shumë mirënjohnës dhe...

— Sa paguani për të? Kjo gjë më intereson tanit.

— S'ia vlen të flasim përkëtë; mjafton të hapësh gojen! Z. Pedro është miliarder. Por, thomëni, ç'zemër pasken gjetur?

E keni shtypur, e keni vrarë? Flisni, flisni, pa frikë!

— Unë do t'i jap z. Pedro zemrën time! Po, po, zemrën time.

— Zemrën tuaj?! — Doktori u praps i habitur në poltronë e tij lëkundëse.

— Por shpejt e mblođhi veten dhe mendoi, se duhej të ishte më i kujdeshëm. I porsaardhuri mund të ishte inspektori i policisë, gazetar, mashtrues, vjedhës, vrasës, provokator. Ai ia nguli sytë fort Emiguelës dhe s'ëpat aspak të vështirë të kuptonte se me kë kishte të bënte.

— Por, përpara se të vemi tek z. Pedro për marrëveshjen, duhet të sigurohem i përgjendjen e zemrës suaj. Një zemër e sëmurë nuk i vlen z. Pedro, besoj se nuk më keqkuptoni!

— Një zemër prefekte dhe e shkëlqyer! — tha me vete, pas ekzaminimesh të kujdesëshme, dhe ftyrëngrysur u kthye nga viktima.

— Si ju duket zemra ime? — pyeti me zë të dridhur Emiguela.

— Fort e shëndoshë s'është, por edhe e keqe s'më duket. Them se zemra e juaj ka për t'i pëlqyer z. Pedro.

* * *

Atë e futën te z. Pedro dhe e ulën në një poltronë, ndërsa plaku ende flinte. Një çast doktorin e thirrën dhe punëtori mbe-

ti ballë për ballë me plakun 85-vjeçar. Ai vështroi me vërejtje fytyrën e rrumbullakosur nga dhjami dhe njëkohësisht të fshkur, kokën tullace me ato pak leshra të zbardhura (rrëmu-jë njëra mbi tjetrën, me sa dukej nga rrotullimet e shqetësuara të netëve pa gjumë), gojën tërë rrudha, gjysmë të hapur, ku paksa zbuloheshin dhëmbët e fundit, veshët e mëdhenj e qesharakë, hundën e shëmtuar, dhe mendoi me keqardhje, se në ç'trup do të futej (mbase që të nesërmend) zemra e tij, në një trup që në të vërtetë kishte mbaruar me kohë.

S'pati kohë të gjykonte më shumë, sepse pas pak plakut hapi sytë dhe vështroi i përgjumur Emiguelën.

— Cili je ti? — pyeti rreptë, duke shtremberuar turintjtë.

— Ai ka ardhur t'ju japë zemrën e tij! — ndërhyri doktori që porsa u duk në pragun e derës.

Plaku Pedro kërkoi shpjegime më të hollësishme e më së fundi pyeti se sa pesos kërkonte.

— Unë dua të siguroj familjen time përnjë kohë të gjatë pas vdekjes sime, — shpjegoi Emiguela.

— Rreth sa mund të ishte shuma? — pyeti Pedroja.

— Unë do të dëshëroja 500.000 dollarë, zotëri! — foli Emiguela me gjysmë zëri.

— 500.000 dollarë?! — zëri i Pedros tingëlloi i inhabitur ironik.

Emiguela nuk u përgjigj.

— Pse s'thoni, dashkeni të bëheni një farë milioneri me zemrën tuaj??

Emiguela u skuq dhe gati sa nuk bërtiti. Doktori, që e kish psikologjisur mirë dhe nuhatur shpejt gjendjen, iu kthye Pedros:

— Ai po ju jep zemrën z. Pedro, dhe kjo s'është kaq e thjeshtë. E kuqtoj, ju jeni i sëmurë, nervat tua ja janë të acaruar, por, besomani mua këtë punë. Shpresoj se me zotin Emiguela do të merremi vesh...

— Bëni ç'të doni! — foli ai si i lodhur dhe mbylli sytë përsëri, duke e kuptuar mjekun e tij...

Pas një bashkëbisedimi të gjatë e aspak të lehtë për Dr. Alberton, Emiguela mundi të bindej për t'ia dhënë zemrën e tij z. Pedro për 300.000 dollarë. Pasi mori deklaratën ku përshkrusheshin me hollësi të gjitha kushtet që duhej të përbusheshin nga Pedroja, Emiguela firmosonjë deklaratë të preqatitür që më parë nga Dr. Alberto, ku ai pohonte, se me vullnetin e tij të lirë dhe pa asnjë detyrim ai dhuronte zemrën e tij plakut Pedro (Kështu Dr. Albertoja u dilte përpara të këqijave, bie fjala ndjekjeve penale të policisë së qytetit të Mjegullës). Pastaj Emiguela u la i «lirë» për të kaluar të fundit natë të jetës së tij midis gruas e fëmijëve.

Kur doli në rrugë, mbi qytetin e Mjegullës kishte rënë mbrëmja. Qe natë e bukur, e jashtëzakonshme për këtë qytet.

Kishte ardhur pranvera dhe mjegulla qe pakësuar prej shirave. Prej ditësh punëtorët e shumë uzinave dhe fabrikave kishin shpallur grevën e përgjithshme dhe, meqenëse në qytetin e mjegullës nuk punohej, oxhaqet villnin me pak mjegull artificiale gazrashë e pluhurash shumëngjyrëshe. U kujtua se ish ende shumë i ri (sapo kishte mbushur 47 vjetët) për të vdekur në një mënyrë të jashtëzakonshme, si s'kish vdekur tjetër njeri në atë vend të huaj. Dhe ai, si Emiguela, s'kish për të arritur gjer këtu, nëse s'do të ish ndarë nga ata, që prej shumë netësh e kishin bërë qytetin e mjegullës ta zinte gjumi më shpejt, e të pasurve si Pedroja t'u dukeshin netët të gjata.

Ai dëgjoi hapa të dyshimta dhe ktheu kokën. Dy hije me kapele republike në kokë, rrëshqitën me kujdes nga gjysmerrësira e rrugës kryesore në errësirën e plotë të parkut.

«Ata po më ndjekin, — mendoi, — por unë e prisja një gjë të tillë dhe nuk habitem për këtë. Kujtojnë se mua më dhimbsetjeta, se unë kam frikë dhe se i penduar do t'i zhdukem nga sytë. Por në të vërtetë unë s'kam frikë jo, jo, s'kam. Që nga çasti kur erdha në këtë vend, duke shpresuar në diçka më të mirë, ndiej se diçka brenda meje është kthyer e po molepset. Të gjitha

rrugët i kam të zëna dhe unë s'di nga t'ia mbaj. Po sikur të mbështetësha te fjalët e Luisit, kur më premtoi se mund të më ndihmonte? E përsë mund të jetoj një këto kushte? Fundi është një. Por jo, jo! Fundi s'është një. S'ka si të jetë një. Tekieras mund të vritet në demonstratë, dhe të ketë një fund të madh. Kurse imbarimi im? A s'bëra pazarllék me të? A s'ia shita një maskarai, një shushumje plakë, që s'ngopet së thithuri gjak? Është e vërtetë, se gjithçka e bëra përfëmijët e mi, përgruan, për jetën e tyre, por ta s'do të kishte qenë më mirë të kisha mbytur vete në dhë ata me gaz?! A do ta kisha bërë këtë? A mund ta bëja këtë? Si? Të kthehesha ahere, kur mbeta si ata, në mes të të katër rrugëve? Oh, s'mundem më, jo, s'mundem më, jo, jo, jo!

Ai filloi të qeshte me të madhe si i çmendur, ndërsa ecte si i dehur, duke u lëkundur e duke iu marrë këmbët e pastaj ra përdhe.

Hijet me kapele republike, nxituan drejt tij.

Kur erdhë në vete, vështrimi i tij ende, i mjegulluar shqoi Dr. Alberton, që i qëndronte mbi kokë. Dalngadalë mjegulla u davarit dhe Emiguela picërrroi sytë, ngaqë gjithçka që e rrethonte qe e bardhë. Ishte në spital. Ai përsëri vështroi mjekun. Shprehja e fytyrës së tij kishte diçka qortuese.

Në qoftë se s'do t'i kishim parashikuar të gjitha, përpak sa nuk fluturove në quell, o engjëll i pafajshëm. Krizat e zemrës e të trurit, janë fenomene të zakonshme në këto raste. . .

— Çfarë pësova? — pyeti Emiguela, pa mundur t'i kujtonë ato që i kishin ndodhur një orë më parë.

— Thuaj pate fat që ishte krizë nervore dhe jo zemre, përndryshe ajo do të bëhej e pavlefshme përz. Pedro dhe familjes sate i shpëtonin nga duartë të 300.000 dollarët.

— Gjersa ju e keni blerë zemrën time, ato të holla më takojnë mua, çfarëdo që të pësoj.

— Jo, o engjëll i mirë, e harruat deklaratën e nënshkruar nga Pedroja?! Ju keni të drejtën t'i merrni ato të holla, më fal-

ni, familja desha tē them, nē çastin kur zemra është shkëputur nga trupi dhc, pra, s'ju përket më juve. Sepse sa kohë që ajo është nē trupin tuaj, z. Pedro s'mund tē jetë i qetë. Ju mund tē arratiseni me zemrën tuaj, ose z. Pedro mund tē pësojë ndonjë krizë tē rëndë vdekjeprurëse, dhc atëherë zëmra jôte s'do t'i hynte më nē punë.

— Pra kurrë s'do t'i shoh me sy tē hollat?

— Mjerisht jo! Pór kjo s'është ndonjë e keq e madhc. Ju duhet tē kujdeseni pér zemrën deri nē fund (ai fliste kaq i qetë e i shpenguar, sikur tē ishte fjala pér një finale interesante tē lojës së regbisë). Pra, tē mos vuani shpirtërisht, tē mos mendoni gjëra tē zymta, tē zotëroni plotësisht veten që zemra, nē çastin e transplantimit, tē jetë nē gjendje tē mirë.

— Po sikur unë tē mos pranoja t'ia jepja zemrën z. Pedro, sikur unë tē pendohem, megjithëse gjer tani s'kam ndonjë mendim tē tillë?

— Përséri, o engjell i dashur, ju jeni i humbur! Nuk dua t'ju frikësoj, por më pëlqen tē jem i singertë deri nē fund. Pendimi dhe têrheqja juaj do tē ishte një fyerje e pa masë pér z. Pedro dhe këtë do ta paguanit me jetën, duke humbur edhe tē 300.000 dollarët... Pra qetësuhuni! E vëtmja gjë që duhet t'ju preokupojë, është fitimi i madh që po ju sjell akti juaj, kur mund tē vdisnit edhe fare kot. Vetëm këtë dhe asnjë tjeter... Poro-sia ime e fundit është tē ruani zemrën si një vazo tē brishtë kristali, që tē mos u bjerë nga dora, se poira, e u thërmua, s'u mbetet gjësendi vëç kujtimit.

— Pra, s'do tē më lejoni t'i shoh pér herë tē fundit tē afërmit e mi? — foli ai me tē lutur.

— Ne ta dhamë këtë mundësi dhe bëmë keq. Shpesh takime tē tilla kanë përfundime tragjike. Ju s'arritët tē veni as në shtëpi dhe falenderoni fatin që e parashikuam këtë gjë dhc u ndoqëm pas.

Ishte e qartë, ata ruanin zemrën e tij, por jo atë vetë. Për ata njeriu dhe zemra qenë dy qenie tē ndryshme.

Jo! Ai is'e kishte humbur aspak mendjen që tē mos kuptonte cinizmin e poshtër tē «engjejve ruajtës» që e ndiqnin hap pas hapi, pér çdo kundërshtim iu duk i kótë, çdo ballafaqim me atë ujk me fytyrë njeriu nuk kishte asnjë kuptim. Lotë dhembjeje dhe inati i rridhninçurg dhe ai vetëm pshëretinte.

— Të paktën, ju duhet të më lejoni të takoj një bashkat-dhetarit tini, të cilat duan i jep porositë e fundit dhe çekun. Weç atij s'i besoj njeriu tjetër! Po! Thoni po, ndryshe s'kam për të vdekur pa bëre gjemën e pas ju mbytur me këto duar, o në-përke ferri, o dreq!

I trembur, mjeku Albertos, bëri dy-tre hapa mbrapa:

— Mos u bëj merak, Emiguela, do të ta sjellim. Si quhet ai? — pyeti me ton kirise të bujtë dhe si i penduar.

Përparrë se të përgjigjej, ai i iuhodhi një vështrim gjithë marraz e shpërtheu me duf. — Tekieras! — tha pas pak. Banon në rrugën e emigrantëve meksikanë. Në mos e gjetshi atje, kërkojeni mbi barrikadë dhe s'keni për t'u munduar gjatë. —

* * *

Makina e Dr. Albertos, vonë në mbrëmje, ndaloj përparrë vilës së profesor Karlosit. Nga dera e prapme dolën njëherësh dy burra të veshur me pardesy të zeza, të shndritshme, njëri prej të cilëve nxitoi t'i hapte derën Dr. Alberto që përgjumej. Të tre ngjitën shkallët e vogla të vilës dhe u gjendën përparrë derës së madhe.

— Kush eshtë? — u dëgjua zëri i trashë i profesorit. — Dr. Albertoja! — u përgjigj mjeku i habitur me këtë të papritur, që ishte me siguri pjellë e fundit e mekanizmave të ndërlikuara të vëzhgimit.

— Po dy të tjerët?

— Ndihmësit e mi!

Dera u hap dalngadalë përparrë syve të tyre, dhe Albertos iu duk si të qe futur befas në një botë nga ato të romanëve fantastike. Ata ngjitën shkallë të tjera me bindjen, se çdo hap i tyre ndiqej nga profesor Karlosi. Kur po i afroheshin studios, dera e saj u hap vetveti dhe ata u gjendën ballë për ballë me tryezën e punës së profesor Karlosit. Ai hoqi syzet dhe u ngrit t'i përshëndeste.

— Si u bë z. Pedro? — pyeti duke i dhënë dorën, ish-nxenësit të tij, Albertos.

— Rëndë, për të mos thënë pa shpresë.

— Lexova gazetën, ku botohej informacioni i hollësishëm i gjendjes së tij. Mund t'ju them se artikull më sarkastik nuk kam pasurrast të lexoj prej vitesh.

— Ne s'kemi parë asgjë sarkastike, profesor! Aty përshkruhet gjendja reale e z. Pedro.

— Po ai fragment i artikullit, ku porositen shoferët të sjellin kufoma tek ju, pasi t'u kenë «marrë» leje, a nuk iu duket një ironi therëse edhe për rrugën e shtrimbër, në të cilën ka hyrë transplantimi i zemrave?

— Nuk ju kuptoj, koleg! — iu drejtua Albertoja, pa përmendur, qëllimisht, titullin e tij, profesor.

— Dua të them se transplantime të tilla u hapin rrugë spekulimeve e krimeve nga më të shëmtuarat! Do të isha kurioz të dija, sa kufoma kanë ardhur për z. Pedro?

— Tri gjithsejt! — u përgjigj pa qejf Albertoja.

— A i dini ju, Alberto, rrethanat e vërtëta të aksidentimit? Kujto pra! Një udhëtar shkon në punë të tij, në një nga rrugët e qeta të qytetit; prapa tij vjen një makinë. Ai shkon buzë rruges për t'i lënë vend të bollshëm kalimi, por shoferi s'i ndahet dhe përpara se udhëtarit të ketë kohë të dyshojë, një klithmë, një përplasje dhe fund...

— Kjo është vetëm fantazia juaj, profesor! Ju s'keni asnje fakt të vetëm që të provoni sa thatë.

— A mund të besoni se rrugët kanë qenë fare të shkreta dhe së s'ka pasur ndonjë qytetar, që të dëshmojë për ndjekjen plot zikzake të viktimës për ta shtypur pastaj, buzë trotuarit? Por ai është dëshmitar i vetëm dhe atij s'i besuan në polici, ose më mirë, atij nuk deshën t'i besonin, gjersa z. Pedro ka nevojë për zemrën e dikujt.

— Akuzat tuaja, profesor, janë të pathëmelta, por megjithatë ne do të mbyllim sy e veshë e do të bëjmë sikur s'dëgjuam, kur është fjala për njërin nga transplantuesit më të mëdhenj të botës.

— S'është nevoja të sakrifikonit kaq shumë, doktor, por mos më humbisni kohën, thomëni pra, ç'kérkonit nga unë?

— Kemi gjetur një zemër të re dhe atë duhet t'ia transplantoni ju zotit Pedro!

Profesori nuk foli, por më vështroi në heshtje dhe i përqëndruar.

— Jo profesor, nuk është shaka kjo që ju thashë. Në kemi blerë zemrën e njëjë personi të gjallë, i cili na e dha me dëshirën e tij, pa asnjë detyrim dhe kundrejt një shumë të mirë. — Pse nuk thoni, Alberto? Z. Pedro dhe ju paskeni pasuruar një të vdekur, një të varfër që do të shkojë në atë botë i ngushëlluar! Mos i vallë, kjo që edhe dëshira e tij?

— Albertoja nxori një letër dhe ia zgjati. — Lexojeni! Janë fjalët e tij, është firma e tij:

Karlosi lexoi me vërejtje. Tre të tjerët s'ia ndanin sytë. Profesori u zbehet:

— Është letra më o tmerrshme që kam lexuar ndonjëherë! — tha dukenja kthyer. — Të nái besoni, profesor! Atë s'ka detyruar askush! Ai erdhë vetë tek unë, me bindjen e tij.

— Pasi kishte lexuar gazeten, padyshim?

— Po, po, profesor. Ai kishte lexuar lajmërimin në gazetten, e mbërëmjes së të shtunës. — Nga pamja e jashtme duket se askush nuk e detyroi, të shesë zemrën e tij, jetën e tij, — u hodh Karlosi. Por në të vërtetë dikush e ka detyruar ta bëjë këtë gjë. Ai duhet të zhdukëj familjarisht ose të sakrifikohej në mënyrën më të tmerrshme, më të padëgjuar, duke shitura së gjalli zemrën e tij. Dhc ai zgjodhi këtë të dytën.

— Ai mund të qe hedhur nga grataçiali, ose mund të mbystë fëmijët dhe veten me gaz, mos kjo rrugë që do ta kishit konsideruar, fare të zakonëshme do të qe më e mirë? Dhe s'ka ditë që gazetat të mos njofojnë për tragedira të tilla familjare. Përse u dashka mbivlerësuar ky rast, si më tragjiku i të gjitha tragedive, që kanë ndodhur në këtë qytet?

Profesori dukej se mendohet për diçka.

— Ç'do të thoshit, sikur klinika jonë t'i paguajë të treqindmijë dollarët dhe Emiguela të lihej i qetë?

— Gjë që s'bëhet! — tha prerasi Albertoja. Pedroja nuk ka nevojë për të holla! Këtë ju e dini shumë mirë!

Vetëm ndërhyrja e shpejtë mund ta shpëtojë, mbasë do të duhet ta operojmë që nesër.

— Mos doni të thoni, se këtë ndërhyrje do ta bëj unë? — Albertoja pohoi në heshtje. — Karlosi kryqëzoi me nervozizëm duart. — Në qoftë se keni ardhur për këtë, mund t'ju them, se

jeni munduar kot. Unë s'do të bëj një ndërhyrje të tillë kriminale, përderisa gjer më sot, s'kam gjetur një rrugë tjeter më të drejtë, sepse duhet ta dini, Alberto, edhe transplantimin e zemrave të kufomave e quajt jo më pak çnjerëzore, gati-gati të përbindshme.

— Dhe ju shpresoni se keni për ta ndihmuar kështu Emiguelan? — Albertoja qeshi me cinizmë. — Ahere, mund t'ju qetësoj duke ju vënë në dijeni se ai s'ka për të dalë i gjallë nga klinika, përparrë se të japë zemrën për Pedron, sepse kjo është dëshira e tij. Sa për ju, mendoj se nuk ka arsyë të tregoheni shumë sentimental dhe kjo është në të mirën tuaj. Tek nuk garantohet jeta e kryetarit të bashkisë së qytetit, që, siç dihet, ruhet shumë më mirë sesa një profesor. Ah, jo, mos më keqkuptoni dhe mos e merrni këtë si një kërcenim!... Nga ana tjetër, mospranimi juaj, ju siguroj se ka për ta dëshpëruar Emiguelën, sepse kështu po i hiqni edhe mundësinë e fundit për t'i lënë diçka familjes, përparrë se...

— Ju siguroj i dashur koleg, se kërcenimet tuaja s'më trembin as edhe një fije floku. Albertos, o mik i «dashur», megjithëm mend besoni se mund t'ia shkëputni vdekjes nga kthethrat atë koleksion sëmundjesh? Ç'dobi do t'i sillte një zemër e re? Ai është i kalbur, ai ka vdekur me kohë. Në qoftë se z. Pedro s'arrin ta kuptojë këtë të vërtetë, ne njerëzit e shkencës s'duhet të kemi iluzione të kota...

— Sidoqoftë, profesor, ne do të presim, por, mendojmë, se duhet të presim gjatë. Z. Pedro nuk duhet të presë gjatë, ndryshtë ai s'ka për të vdekur përparrë se milionat e tij t'i përdorë për t'ju shkatërruar ju e bashkëpunëtorët tuaj dhe t'ju bëjë të mallëkoni çastin që refuzuat një punë kaq me leverdi. Dhc s'keni shumë kohë për t'u menduar! Në gazetën e sotme është botuar deklarata e gangsterit Bob Stayer rreth vrasjes së shefit të policisë, brenda në zyrën e tij. «Ne s'i falim kurrë ata që bëhen pengesë në rrugën tonë. Ne nuk do të vdesim përparrë se të kemi lëshuar litarët e arkivolëve të tyre në gropën e thellë e të zezë dhjetëpash». Por edhe z. Pedro s'është aspak më i butë. Në fund të fundit ju jeni mjek. Me anën morale e etike të problemit le të merren të tjerët. Duhet të pranoni, kjo është këshilla ime e fundit...

* * *
Ata dolën, kurse profesor Karlosi rrotulloi gjashtë herë disku në telefonit, me gishterinjtë që i dridhesin nga nervozizmi, për të formuar një numër.

— Hello, jeni ju, doktor Roberti? Ejani pa humbur kohë tek unë, pasi të keni marrë një informacion tek zoti Rivol për Cor 85... Merrni në shtëpi edhe doktor Jançon.

I lodhur, ai lëshoi dorezën e telefonit dhe fshiu me pëllëm-bë djersët, që i kishin mbuluar ballin.

Përbindësh, ja se ç'është Albertoja! — tha e bëri dy-tre hapa drejt poltronës rrotulluese për t'u shtrirë dhe për të harruar, mundësish për të harruar gjithçka, përparrë se të merrte një vendim të prerë, por që tanë e ndiente se qe dorëzuar, sepse po përpinqej të gjente argumente se çështjeve të tjera jashtë fushës së mjekësisë, nuk i përkiste atij t'u jepte rrugë zgjidhje.

Mbrëmja e fundit për Emiguelan. E mbanin në një dhomë me grila të mbyllura, pas të cilave kryqëzoheshin hekura të trasha të cilësisë së mirë; poshtë ndiheshin ecejaket e parreshitura të rojes. Ai e dinte këtë dhe nuk habitej për masat e rrepta që ishin marrë për zemrën e tij. Ajo nuk duhej të arratisëj nga klinika e Dr. Albertos. Po ashtu, e dinte se edhe të dera, rrinte një rojë tjetër e veshur me një bluzë të bardhë. Ndryshe nga çdo herë tjetër, Emiguela u shtri të flinte në kre vat në anën e majtë dhe jo në të djathjtë, sepse duke rënduar me peshën e trupit të vet mbi zemrën, i ndiente më mirë të rrahurat e saj.

«Unë tërë jetën kam fjetur në të djathjtë, por sonte, më pëlqen të të ndiej më pranë, të ndiej më mirë të rrahurat e tua. Do të isha kurioz të dija, nëse je e mërzitur tanë që po largohesh prej meje dhe do të rrahësh, paskëtaj, brenda një trupit tjetër, madje, në trupin e një plaku??

Papritur atij i erdhi ndërmend një pyetje e jashtëzakonshme (Gjatë jetës së vet ai i kishte bërë vetes pyetje nga më të ndryshmet, por kurrë s'i kishte vajtur ndërmend, se do të ishte i pari njeri i të gjitha kohrave, që i drejtohej i unit të tij me pyetjen më të habitshme, njëkohësisht edhe më të tmerrshme).

«Ke përlëtë mbetur e pastër dhe e cendershme, edhe në trupin e tij, apo gjaku i helmët i z. Pedro odoitë veprojë edhe mbi ty?»

A thua ka të bëjë zemra me mendimet dhe i ndjenjat? Po të ishte kështu, do të më vinte keq përfyrty, sepse pasionet e tij s'kanë qenë kurrë të mirë, dha ti doli ndieje veten të huaj në atë trup. Por nuk besoj shkencëtarët thonë se zemra është përsosnjë pompë që thithë shtyn gjakun, kaq dhe asgjë tjetër. Kështu duhet të jetë, kjo do të më lehtësononte. Ndryshe, vdis që tani, përpara se të gdhijë dhei profesor Karlosi të të marrë në duar!»

Por shpejt mendimet iu ngatërruan ndën efektin e narkotikut, që Albertoja i kishte dhënë një orë më parë, kapakët e syve i ndjeu të rendë dhe... Emiguela filloi të shihte èndërrat e fundit, që ndillte një zemër e vrarë dhe e shqetësuar, një zemër që të nesërmen s'do t'i përkiste më atij.

— Pra, mund të shpresojmë për një ndërhyrje të aférme dhe të shpejtë? — pyeti me interesim Dr. Amagoja, drejtori i spitalit të shtetit.

— Ju e dini mirë, iunë kurrë s'kam operuar i vetëm dhe bota, pa të drejtë, më ka njojur dhe mbiçmuar si një transplantues të shquar zemrash, duke harruar se pa bashkëpunëtorët e mi s'do të kisha arritur ndonjë sukses. Kështu që më duhet të bisedoj me ata, përpara se t'u përgjigjem, dhe po jua them se, po të qefjala për z. Pedro, do t'ua kisha dhënë përgjigjen që tani. Që kurse, fillova transplantimet, e ndiej veten të zotëruar nga një shqetësim i pashpjegueshëm; ankthi tronditës prej vitesh

s'më kav lënë aspak tē qetë, sa kohë që tūnë transplantoj zemra kufomash, që mua m'i sjellin në klinikë, si tē parikthyeshëm në jetë; si tē vdekur tē sigurtë, por se në tē vërtetë, zemra e tyre është ende eugjallë, se po tē që evdekuri transplantimi do tē ishte pakuptim.

— Zemra e tyre ka qenë e gjallë... por, sipas radhës, cdhe qelizat e saj do tē vdisnin pas pak kohësh tē një i aksidentuar më Kokë tē shtypur e tē bërë petë! — ndërpreu Dr. Amagoja. Dhe ju s'pëni tjetër gjë, vëçse ia shkëputni zemrën kufomës dhc nëlfakti i përgjigjet omi shumë shpejt. Si nuk e ka!

Pra ajo kufomë, duhej tē jetë e kënaqur, sepse zemra i shpëtoi shkatërrimit, vdekjes? Por sa njerëzore është kjo, Amago? Sa kohë që edhe qelizat më tē fundit jetojnë, ai trup s'duhet kohsideruar i vdekur; kuptohet, bëhet fjalë gjithnjë për një tē aksidentuar më vitalitet tē lartë dhet jo për një Pedro! Por kush më siguron se nuk janë bërë spékulime në emër tē tē gjithë këtyre transplantimeve? Po rasti i Emiguela, a s'është kriminal, a s'është i ürryer dhet i poshtët, a s'duhet varur Dr. Alberto ja dhe ajo kufomë që e thërrasin Pedro? Ja, pra, për ç'arsyc kam vite që punoj përdicka më tē madhe e më tē mirë, sesa një transplantim zemrash tē gjalla.

Zotin Pedro dhe Emiguelan i shtrinë në dy tryeza opçacioni pranë njëra-tjetrën. Në fillim Emiguelas i lidhën duart dhe këmbët dhe ai u bind si një foshnjë. Z. Pedro nuk pranoi tē lidhej. Ai tha se s'kishte ndërmend tē ikte nga tryeza opçatore dhe instrumentisti i bëri me shenjë ndihmësit tē vet tē prisite sa tē qetësohej pacienti. Ndërkohë profesori dhe mjekët e tjerë kirurgë bënин pregatitjet më tē fundit në dhomën ngjitur, që ndahej më një perde tē tejdukëshme, tē bardhë. Z. Pedro dhe Emiguela u vështruan një çast sy në sy. Z. Pedro u mundua t'i búzëqeshtë viktimës, por arriti vetëm tē ngërdheshej. Emiguela nuk reagoi. Vështrimi i tij, pa asnje pikë shprehjeje, që drejtuar në fytyrën e Pedros, kështu që s'mirrej vesh (të pakstën, z. Pedro s'kishte si tē mirre vesh) se ç'mendime tē trishtueshme e kishin ngurtësuar e mermerosur aq keqas;

sa nuk ngjante më si c një dyzetështatëvjeçari. Ngadalë vështrimi gati i mjegulluar iu sqarua, dhe z. Pedro u detyrua një çast të mënjanjojë lehtësisht kokën, ngaqë s'mundi ta përballonë. Ai lexoi në sytë e Emiguelas një urrejtje të thellë, e cila e turbulloi në ato çaste dhe ndjeu se duhet të thoshte diçka.

— Z. Emiguela, nuk duhet kështu! Unë do të kisha pranuar edhe një zemër kufome, po tamam në këtë kohë ju vetë, me dëshirën tuaj, më ofruat, kupton?...

Dhe këtë, sipas mendimit tuaj, e bëra nga qejfi, me vullnetin tim të lirë, pa asnë detyrim... Në qoftë se thua se erdha me dëshirën time, përsëri gënjen! Ti, dhe shokët e tu padronë, më detyruat, pa më thënë me gojën tuaj që t'ju jepnja zemrën time. Jo, jo, këtë s'ma thatë! Ju nuk u thoninjerëzve të hidhen nga gratacieli apo nga urat e larta dhe as të mbysin veten me gaz. Këtë gjë, ata kurdoherë e bëjnë me dëshirën e tyre dhe pa asnë detyrim.

Ai qante pa zë dhe nuk dihej në qante nga dhembja, apo urrejtja. Një çast u pushtua nga dëshira e papërmabjashme për të këputur rripat e për t'iu hedhur në grykë atij plakushi, që i kishte blerë jetën kundrejt një shume të hollash... Por lidhjet ishin tepër të forta dhe ai vetëm u përpëlit. Duke e parë veten të pafuqishëm, ai lëshoi një klithmë ngjethëse të gjatë, klithmë dhe ofshamje dhe bëri prapë përpjekje të mundimshme për t'u shkëputur.

— Nuk dua, nuk dua të vdes, nuk dua! — thërriste. Lëshomëni! Në djall vafshi! Jam tepër i ri...

Dr. Albertoja hyri në dhomë.

— Çfarë ke, i dashur? — pyeti, duke i rënë lehtësisht faqeve.

— Zgjidhmëni! Lërmëni të shkoj! — bërtiti Emiguela.

— Po ai, z. Pedro, a ka për t'ju lejuar të talleni me të? Po fëmijët, gruaja, çeku, deklarata juaj? Më i përfituar kështu, sesa të marrësh fund me një plumb në zemër. Tani rrugë tjetër nuk ka.

Emiguela lëshoi një ofshamë të thellë dhe u këput si një shpend, që porsa i kanë prerë kokën.

— Bën mirë të flesh! — i tha Albertoja, dhe përpëra se Emiguela të aprovonte ose të kundërshtonte propozimin e fundit, mjeku i afroi pranë gojës e hundës, një tub të hollë plastik.

Emiguela ra në gjumin e thellë narkotik. Z. Pedro pshëritiu i lehtësuar.

— Më në fund! — tha i lehtësuar duke shikuar kirurgët, me në krye profesor Karlosin, që atë çast po hynin në sallë.

Megjithëse doktor Albertoja nguli këmbë të asistonte në operacion, profesor Karlosi nuk pranoi. Kur drejtori i spitalit, Amagoja, u përpinq ta bindte për këtë, Karlosin u nxeh dhe e ndjeu veten të fyter.

— C'kuptimi ka Amago, asistimi i Albertos? C'rol i kanë ngarkuar? Të më survejojë? Apo të më ndihmojë? Në qoftë së ju, Amago, jeni i bindur se një patolog, që s'është shqar as në specialitetin e tij, do të më qe i nevojshëm, gaboheni rëndë.

— Ai është mjeku personal i zotit Pedro — vërejti Amagoja.

— C'do të thotë kjo? Mos duhet t'i jap bisturinë në dorë?

— Ata nuk kërkojnë të ndërhyjnë. Fjala është vetëm për praninë e Albertos në operacion, siç do të asistonte p.sh. një student mjeksie.

— Përgjigjja ime është e prerë, zoti Amago! Sikurse në qindra operacione të tjera, do të operoj me grupin e kirurgëve të mi. Në të kundërtën, unë heq dorë. Ju ma njihni kokën.

— Mirë, mirë — foli Amagoja me ton të zbutur dhe duke bërë një têrheqje të detyruar. — Të paktën lejojeni të ndjekë operacionin në monitor.

— Dakord, dakord, djalli ta marrë! Koleg më të bezdisur e më të pafytyrë sesa atë, s'kam njojur gjer më sot. Le ta shohë, gjersa shëndeti i Pedros e shqetson kaq shumë. *

Profesori bëri me bisturi një prerje të lakuar ndën sisën e majtë të Emiguelës. Kolegët nxituan të shtrëngonin midis dhëmbëve të klemëve arteriet dhe venat e prera.

Një çerek ore më vonë, ata kishin mbërritur në zemër.

— Siç e shihni, një zemër e shkëlqyer, e fuqishme. Gjy-

nah, me të vërtetë, t'i implantohej një plakushi, të cilit s'kishte për t'i sjellë asnjë dobi. Albertoja është padyshim tregëtar i shqar zemrash — tha profesori, pa ua ndarë sytë rrahjeve ritmike të zemrës së Emiguelës.

— Them, sa mirë që Albertoja sheh vetëm figurën në monitor, përndryshe do të kishte kërcyer përpjetë nga marazi — foli Roberti, asistenti i parë i profesor Karlosit.

— Le të kënaqë kureshtjen me figurën edhe për disa minuta, sepse edhe atë s'do ta shohë më — tha profesori.

— Do të çmendet! — foli Roberti.

— Edhe më keq le ta pësojë ajo kafshë, që e quan veten mjek — tha profesori. Por le të mos humbim kohë me të. Tani do të krijojmë trukun e shkëputjes së plotë të zemrës nga trupi i Emiguelas. Në kohën kur unë do të afroj gérshérët, ti Janço do të ndërpresësh menjëherë lidhjen televizive. Një veprim i tillë do të mjaftojë për të bindur «kolegun» për transplantimin.

Jançoja, asistenti më i ri i profesor Karlos, iu afroa kameras. Gishtin tregues e vuri mbi një buton, i gatshëm për ta shtypur në momentin e volitshëm.

Përballë monitorit, Albertoja ndiqte me kujdes ligaturën e enëve të zemrës.

— Ja, tani që u lidh edhe arteria pulmonare, ata duhet të fillojnë punën për shkëputjen, — mendoi Albertoja.

Ai pa dorën e madhe të profesor Karlos të mirrte gérshëren nga instrumentisti.

Albertos, instiktivisht iu afroa më pranë monitorit. Tamam në çastin, kur Karlosi bëhej gati të priste aortën, shembëllimi elektronik u zhduk papritur. Albertoja lëshoi një ah shqetësimi e mërzitjeje, u ngrit në këmbë, iu afroa monitorit e nisi të shtypë më kot butonët njëri pas tjetrit. Por pa dobi. Atëherë bëri drejt blokut operator, por atje, një rojë e fuqishme, veshur me të bardha, si një sfinks i ngurtë, e heshtur e gjigante, dukej sikur s'e dëgjonte. U kthyte prapë në dhomën televizive dhe shtypi më kot përsëri butonet dhe gati-gati sa nuk qëlloi me grusht ekranin televiziv.

— I mallëkuar, ku e gjete të prishesh tani! — ulëriu dhe u ul në kolktuk në një pritje të kotë dhe të mundueshme.

Profesori dhe asistentët bënë një qepje të kujdeshshme e të imtë të plagës operatore në gjoksin e Emiguelas.

— Do të mbetet cikatricë e përjetëshme, një kujtim i hidhur, por prapë s'është asgjë kundrejt asaj që i kërkonin Pedroja dhe Albertoja — tha profesori, ndërsa zhvishte dorezat kirurgjikale, për të veshur të tjerat. Është në narkozë? — u kthyte nga Roberti, që sapo vinte nga tryeza operatore e Pedros.

— Ka pesë minuta.

— Fillojmë atëherë!

Gjatë operacionit të plakut Pedro, ata treguan një kujdes dhe vëmendje të madhe sikurse me Emiguelan. Motive të tjera i shtynin për këtë. Qe njeri i pasur dhe i rëndësishëm, e vdekjen në tryezën operatore s'do t'u falnin. Kësaj radhe, duart e Karlosit dridheshin lehtë. Në fillim e vuri re Roberti, pastaj dhe të tjerët.

S'kam operuar ndonjëherë me kaq emocion. Jo, nuk më tremb Pedroja, por Cor 85! Si ka për të funksionuar, për sa kohë, a do ta mbajë ky trup i plakur dhe i vdekur qysh tanis... Eh, s'do t'i hyja kësaj pune kaq shpejt, pa e provuar mirë në kafshë, por fati tragjik i Emiguelas më theu...

— Ne presim me padurim të shohim kryeveprën tuaj, profesor — ndërhyri me takt dhe me respekt i ri u Janço. Karlosi qeshi ndën maskë.

— Mos u nxito Janço. Kryevepra i përket natyrës. Kur bëra zemrën artificiale, pata parasysh gjithnjë ndërtimin dhe funksionin e një zemre natyrale. Shumë krijime të guximshme prej andej e kanë zanafilën. Bateritë që do të ushqehen nga temperatura dhe biorrymat e trupit, janë e vetmja gjë për të cilën mund të krenohem disi.

Në fjalët e fundit, kolegët ndien tonet e një humorit të lehët e të hollë dhe buzëqeshën duke u parë sy më sy.

— Po në qoftë se nuk do të funksionojë, çdo të bëhet me Pedron? — dyshoi një nga asistentët.

— Keni të drejtë kolegë. Punova në heshtje e në sekretin më të madh për Cor 85, dhe shumë gjëra mbeten të panjohura për ju. Por çështja është e thjeshtë. Cor do ta kalojë provën këtu

në klinikë. Në rastin më të keq do t'i vëmë përsëri zemrën e tij.

— Po marrëveshja me Pedron dhe Alberton?

— Ne s'jemi lepuj, koleg. Kërkojmë rrugëdalje, por më në fund kemi nderin, që e ngremë mbi vdekjen tonë...

Tashmë, para syve iu zbulua zemra e plakut Pedro.

— Çudi, si ka qëndruar në këmbë gjer tan! — vërejti profesori, duke çmuar me sy zonat e gjera nekrotike të muskulit të zemrës. Disa infarkte, pér t'u habitur vërtetë! Plak i lezeçëm. Kërkon zemrën e re të një tjetri. Është i pasur e pandeh se milionat i jepin të drejtën pér çdo gjë. Pfu, sa egoist që është treguar! Robert, Janço, prega tituni pér shkëputjen... Gati pér ligaturat?

— Gati profesor!

* * *

Cor 85 nisi të rrahë, në fillim ngadalë dhe me pasigurinë e fillestari, pastaj me forcën dhe ritmin e zakonshëm të një zemre normale.

Një pikë loti e profesor Karlosit ra mbi zemrën e parë artificiale të tipit Cor 85, të cilën Roberti nuk nxitoi ta fshijë (në një operacion të zakonshëm do ta kishte bërë këtë, duke e vlerësuar si prishje të pastërtisë së ndërhyrjes operatore).

Në qoftë se nuk do t'i kishin duart ende të zëna, do t'i qenë hedhur njëri-tjetrit në krahë, por u mjaftuan me shkëmbime vështrimesh të ngazëlliyera që prapa maskave të bardha.

* * *

Vetëm pak minuta, pas injekzionit të lëndës qetësuese, atë e zuri përsëri gjumi. Të tillë gjumi aq të rendë s'kishte bërë tjetër herë. Ai foli shumë nëpër gjumë, «Jepmëni zemrën time, o vjedhës zemrash, o tregtarë modernë zemrash! Jepmë, o plakush, zemrën time, jepma, ndryshe s'kam pér të vdekur, pa të të bërë copë!».

Pushtuar nga ankthi, e shoqja, Marisola, i qëndronte mbi kokë.

Befas Emiguela qeshi nëpër gjumë, qeshi si një fëmijë.

— Tani ai po sheh èndrra të bucura! — mendoi ajo.

Pastaj fizionomia e tij u bë kërcënuese, diç thirri, diç të pakuptueshme, që ajo s'mundi ta merrte vesh.

* * *

Kaloi një copë herë, gjersa Emiguela u përmend mirë. Vështrimi plot ankth, si i një të sëmuri, u ngul te e shoqja. Me duart që i dridheshin shkopsiti kopsat e këmishës. U ngrit përgjysmë. Me një përqëndrim prej të çmenduri, vështroi në gjoks cikatricat e operacionit. Pastaj vuri dorën në zemër. Numëroi me mend, me gojën paksa të hapur, njëqind të rrahura, njëqind të rrahura të fuqishme e ritmike.

— Shtrihu, shtrihu Emiguela, ke temperaturë, shtrihu i dashur!

Mendja po i kthjellohej gjithnjë e më shumë. Sytë e skuqur vështruan me dhembshuri të shoqen.

— Oh, ta dije ç'ëndërr që kam parë, ç'ëndërr të tmerrshme që pashë!

— Ke folur shumë përcart, si asnjëherë tjetër.

— Cili më solli këtu?

— Shokët... Tri ditë që s'u duke në shtëpi, s'i bënë dy orë gjumë, gjersa të gjetën në Spitalin e profesor Karlosit.

— Këto tri ditë veçanërisht, më bindën se i vetëm njeriu s'ia del dot mbanë. Vdes! Detyrohet të shesë gjithçka, më të shtrenjtën gjë, nderin, zemrën, jetën. Të vetëm të ha ujku.

Të dy qeshën.

— Ç'thanë shokët? Do të vijnë prapë?

— Donin ta gdhinin këtu, por mjeku s'i la. Nesër në mëngjes prapë kanë për të ardhur.

Ai psherëtiti i lehtësuar. Ndiente një gaz të pakuptueshëm, një lehtësim të pashpjegueshëm. Ai filloj shpejt të kuptonte arsyet e lumturisë. Ndiente duart e fuqishme të shokëve grevistë të shtrira drejt tij që i thoshin: «Emi, shpëtimin tënd të vërtetë ngajeta plot vuajtje e halle mos e prit nga Karlosi, aq më pak nga Luizët dhe Padrot gjakpirës, por nga klasa jote, nga klasa së cilës ti i përket, ndaj shtrëngoi shokët Emiguela, shtrëngoi dhe mbahu fort pas duarve tona. Ndiqna! Ec, ec, pa frikë! Kështu ti s'ke për të shitur kurrë zemrën tënde! Ne do të rrojmë, Emiguela! Ne jemi të pavdekshëm, Emi! Bota është jona!»

«NJË JETË PËR JETËT...»

Lui, a do ot'ju vijē keq nēse pēpara
jush shkencētarē tē tjerē do tē shpikin
vaksinēn e tērbimit? — ?!

Ajo u mat një copë herë të gjatë përpara se të tërhiqte fillin e hollë dhe delikat të ziles. Me zemër të ngrirë dëgjoi së ndër ethe zhurmën e lehtë të çapeve që zbrisnin. Instiktivisht dora e saj shtrëngoi fort dorën e të birit, Edmondos. Çapet i ndjeu më të afërtë. — Dera u hap dhe vështrimi i saj ndeshi në sytë seriozë, por njëkohësisht të qetë e të ëmbël të të pangojohurit.

— Kë kërkon? — pyeti i zoti i shtëpisë, duke përkëdhelur fëminë.

— Pasterin, Lui Pastérin, atë dua... — u përgjigj gruaja, duke marrë zemër nga pritja e ngrrohtë e parizianit të panjohur.

Burri buzëqeshi.

— Flisni! Ünë jam ai që kërkon.

— Ju qenkeni Lui? — thirri gruaja e zhgënjer, e cila në vend të këtij njeriu të veshur thjesht e aq dashamirës, kishte përfytyruar një tjetër Pastër, hijerëndë e kryelartë, autoritar dhe të rrethuar nga brerorja e suksesit, si ikonat e lashta.

Ajo diç deshi të thoshte, por e tronditur siç qe, nuk mundi veçse të belbëzonte fraza të shkëputura e pa lidhje, si të ishte në një gjendje deliriumi¹⁾...

— Edi, shko tē blesh një pástë tek ai dyqani! — iu drejtua fëmijës, duke i dhënë një frang, tē cilin fëmija e rrëmbeu me gaz.

1) Kllapie.

I vogli, duke çaluar prej një plaje të thellë në këmbën e djathtë, u largua ngadalë... Ajo e ndoqi një copë herë me sy, e befas, si shpërthimi i beftë, i zymtë e zhurmëmadh i një vullkani nënujor, thirri:

— Zoti im, e di mirë, ç'e pret tim bir ngaqë e ka kafshuar një qen i tèrbuar... por nuk dua ta besoj, se e kam të vetëm. Përveç tij, s'kam askënd tjetër në jetë... Një rreze shprese më lindi që kur mora vesh se ju, zoti im... Për juve s'ka gjë të pamundur, ndryshe s'do të kisha marrë një rrugë kaq të gjatë, ndryshe s'do ta kisha munduar atë të mjerë, ndryshe do të kisha vdekur një mijë herë para tij.

Ajo ktheu përsëri kokën nga i vogli i saj e, papritur, duke ngashëryer, u ul më gjunjë.

— Shpëtojeni, shpëtojeni, zoti Lui! Në goftë se do ta bëni këtë, keni për të marrë bekimin e nënës që do të lutet për juve e përgjithçka të shtrenjtë që keni në këtë botë, gjersa të mbyllië edhe ajo sytë... sepse të holla nuk kam, jam e varfér, zotni, dhe fatkeqe.

I ngashëryer, Pasteri e ngriti me kujdes.

— Do të përpinqem të bëj gjithçka që varet prej meje. «Dum spiro spero» — «Sa rrojmë, le të shpresojmë» — mos e harroni këtë shprehje të urtë latine, nënë e dashur... Le të shpresojmë! — përsëriti me zë të ulët, si të fliste me vete, ndërsa vështrimin e kishte tretur diku në hapësirë.

Sikur hapësira memece dhe e shurdhër të qe aq e ditur, siç përpinqen të na e mbushin mëndjen, atëherë unë i pari do të isha lutar për këtë fëmijë, por mjerisht, asaj ane s'ke ç'të presësh. Duhet filluar... Nga pikërisht?

* * *

Natë vonë. Ai studion akoma në studio. Nga takimi me nënën e Edmondos kanë kaluar dy javë dhe që nga ai çast noacioni kohë, ditë a natë, ka humbur për të çdo kuptim. Ai mbylli orë të tëra në studion me grila të mbyllura e shfleton pa-reshtur qindra, mijëra fletë librash të vjetër e të rinj. Me sa duket, edhe këtë natë ai s'do të mbyllië sy. Por jo, e shoqja s'ka për ta lejuar të lodhet kaqë shumë...

Me çape të kujdeshshme, duke u përpjekur të bëjë sa më pak zhurmë, ajo iu afrua tryezës së tij, admiroi në heshtje për disa çaste fytyrën serioze të kërkimtarit të madh (ndonëse grua e tij, ndonëse atë portret e njihte gjer në hollësitë më të vogla, ajo ushqente për të shoqin një respekt gati-gati mistik, si të ndodhej përpara ndonjërs nga skulpturat e famshme të «Notre Dame de Paris»), pastaj i ledhatoi lehtë flokët e zbardhura dhe foli:

— Eja i dashur, eja, s'bën të lodhesh kaq shumë!

Ai fërkoj ballin e lodhur.

— Lui! — nguli këmbë e shoqja e kësaj radhe me ton të vendosur.

Ai ktheu kokën, i buzëqeshi dhe e vështroi në heshtje, një heshtje e mbushur me mendim, një heshtje që flet (është vërtet gabim të thuash se «Xhokonda» e Leonardo da Vinçit është e heshtur, se ajo s'ka folur kurrë, kur aq bukur, aq qartë flet me heshtjen e saj me miliardat e njerëzve që e sodisin).

«E pra, ti që më ke kuptuar gjithnjë, son te s'do ta bësh një gjë të tillë? Çdo ditë, çdo orë, rreziku për Edmondin, që unë dhe ti e duam aq shumë, bëhet përherë e më i madh. Mendon, vallë, se nga kjo sëmundje e tmerrshme çdo ditë vdesin dy milion njerëz në botë? Një shifër tronditëse, e dashur!».

Pastaj ai i puthi lehtë dorën e saj delikate dhe hodhi sërisht vështrimin në libër. Por s'ishte e lehtë të bindje zonjën Pastër, sepse ajo e quante për detyrë të kujdesej për jetën, shëndetin e shkencëtarit dhe të burrit të saj.

— Lui, tani e tepërove vërtetë! — thirri ajo kinse e pakë-naqur dhe e shoi llampën.

Lui qeshi dhe i shtrëngoi lehtë dorën.

— Eh, gratë, gratë! — tha. — S'është aspak e lehtë, të mos u bindesh atyre...

Sytë iu mësuan shpejt me errësirën. Në dritaren e hapur ndriçonte hëna. Yje të rrallë vezullonin nga larg me shkëlgime të émbla, si të ishin fanarë gjigantë orientimi në atë hapësirë të pafund, të pafund...

— Natë e bukur, Lui!

— Po, e dashur, shumë e bukur!

Papritur e pakujtuar, kur ajo s'e priste, ai ia largoi me vendosmëri duartë dhe ndezi llampën.

— Lërmë, të lutem, të vazhdoj punën, se e kam ndërpërreë në një pikë tepër interesante. Jeta e Edmondos është në rrezik, unë e di mirë, edhe juve ju dhimbset ai fëmijë... Dhe e shoqja e kuption që duhet të dorëzohet. Ajo e ka të qartë se s'është hera e fundit që do të ngulë këmbë në të sajën. E përsëri një lëshim, për hir të atij që sakrifikon jetën për jetën!

Pas pak, ai dëgjoi zhurmën e lehtë të derës që mbyllej. Në dhomë mbretëroi heshtja. Matanë dritares ndriçon hëna, përjashta ka freski e drithë; përpara tij, përkundrazi, shtrihet errësira e mikrobotës, e atij i duhet të ecë, të ecë vazhdimisht të ecë duke këruar si një i verbër në labirinthin e një piramide gjigante.

— Lui, ç'ke kështu?

— Skisha menduar se do të më hynte kaq shumë në zemër ky fëmijë. Besomë, humbja e tij ka për të qenë e dhimbshme.

— Ç'do të thuash me këtë?

— Mjeku i atjeshëm, Dr. Embroja, sapo më njoftoi se dy nga të dhjetë personat e kafshuar nga i njëjtë qen që ka plagosur edhe Edmondin, vdiqën tri ditë më parë. Po, po, tragedia është e pashmangëshme dhe e ndiej veten kaq të pafuqishëm, të çarmatosur përpara një armiku mizor ultramikroskopik, që bën ç'ti dojë qejfi!

— Mos u dënshpéro! Ke bërë zbulime të mëdha dhe besoj verbërisht...

— Dua ta shpëtoj, e dua këtë me gjithë zemër, por është gati e pamundur! Koha s'mjafton as për të mbledhur materialin e sëmundjes. Shkencëtarët anglezë, amerikanë e gjermanë përpinqen prej dhjetëra vitesh, e dashur, dhe asnje rezultat! E çmund të bëj unë në dy javë?

* * *

Kanë kaluar dy javë. Pastëri vazhdon të punojë në laboratori. Ai kërkon me çdo kusht zgjidhjen e shpejtë eksperi-

mentale, praktike, të një ideje gjeniale. Por ja, papritur dera e laboratorit hapet me rrëmbim dhë në pragun e saj duket e shoqja. E verdhë dyllë, e pafuqishme, ajo mbështetet në derë pa mundur të bëjë asnjë çap më tutje. I tronditur, Pastëri nxiton drejt saj.

Kjo pritej. Nuk mund të ndodhë ndryshe veçse kështu!... I ngjet fundit të një tragedie shkpiriane; ti nuk është dëshëron këtë fund, pret diçka tjetër krejt të ndryshme e të kundërt, por logjika e ngjarjeve nuk mund të pranojë tjetër zgjidhje.

Ai kupton, e di ç'duan të thonë sytë e përlotur të saj, ankthi dhe «fletët» e verdha e pa jetë të vjeshtës, që i kanë mbuluar ftyrën (Fletët bien në vjeshtë. Degët e njoma, të shkretat degë, mardhin e dridhen e presin me padurim pranverën. Dhe ajo ka për të ardhur, sado i gjatë dhe i ftotë qoftë ai...).

Fëmijën e gjeti të rrëzuar në dysheme.

— Edi, biri im, çfarë ke? — pyeti duke u përkuluri mbi të.

Fëmija s'u përgjigj.

— Edi! Edi! Edi!

* * *

— Virusi ultramikroskopik, dënon çdo vit dy milion njërzë me një fund të tmerrëshëm dhë ne para tij mbetemi të pafuqishëm, ngrejmë duartë... Logjika njerëzore, logjika jonë e përpiktë shkencore nuk mund të pajtohet me këtë gjendje. Si mund të durohet kjo, e dashur? Një virus qesh e tallet me pamundësinë tonë, me injorancën tonë. Edi, Edi.

— Qetësuhu i dashur, qetësuhu! — i tha e shoqja duke i vajtur pranë. Netët pa gjumë të kanë lodhur. Ti nuk mund ta ndryshosh këtë fund...

— Unë do ta ndryshoj, do ta ndryshoj! A më kupton çfarë po të them?! Edhe sikur t'i kushtoj tërë jetën time. Mijëra Edë presin nga ne! Mijëra, mijëra!

E pafuqishme koka iu var mbi gjoks, si të ishte rënduar ca më shumë nga pesha e mendimeve të stërmundueshme. Sa herë e kishte zënë gjumi kështu, ndenjur mbi karrige? Këtë mund ta dinte saktësisht vetë ai, Lui Pastër...

* * *

Kanë kaluar shtatë muaj që nga ajo ditë e dhimbshme.
Kjo natë është e keqe, e errët pus, me erë e shi të rrëmbyeshëm.

Burrë e grua janë ulur rrëth zjarrit bubulak të vatrës.
Ai lexon i përqëndruar, kurse ajo diçka skedon.

Mbi oxhak, ai ka vënë fotografinë e Edit të vogël. Kujtim tronditës, por një nxitje për intuitën e tij kërkuese. Sytë e zinj e të menduar s'e lënë të plogështohet, të flejë mbi dafinat e zbulimeve të mëdha. Çdo ditë që kalon, ai i afrohet kështjellës së fortë të virusit rrugaç. Fundi është i sigurtë. Dhemjet mposhten vetëm kështu, në pellgun e djersës e të netëve të bardha pa gjumë.

— Lui, dikush është tek porta! Lui! Lui!

— Hë? Çfarë? The gjësendi? — pyet duke ngritur kokën nga libri.

E ka aq të vështirë të kalojë nga një botë në tjetrën, e kjo pasqyrohet në vështrimin e hutuar e të trembur, si të flinte me kapakët e syve hapur.

— Dikush është tek porta...

— Ah, ja po shkoj, po shkoj.

Ai niset të dalë, i bindur si një fëmijë.

Ajo qesh e lumturuar.

— Në radhë të parë ai është njeri, — thotë me vete. — Ai e dashuron çmendurisht jetën dhe njerëzit dhe kjo gjë, si pas mendimit tim, është kyçi i artë i zbulimeve të tij, të cilat, sigurisht, nuk zbritën si një dhuratë nga qielli, por janë frut i një pune titanike...

Nga salloni i poshtëm erdhi gjer këtu zëri i fortë e i cilëtë, me theks jugor i zotit Fransa. Zonja Pastër e çmonte këtë njeri dhe shpresoi se kjo do ta shlodhte sadopak trurin e lo-dhur të të shoqit.

«Një vizitë në kohën e duhur», — tha e nxitoi t'i dilte përpara mysafirit, zotit Fransa, gjithnjë të mprehtë e të gjallë, të shkathët dhe që ambientohej kudo, shtoju këtyre edhe nushatjen disi të veçantë për të rrokur sensacionet publike, falë të cilave z. Fransa kishte bërë përparime të ndritura në rrugën e gazetarisë.

* * *

— ... Këtë herë kam ardhur te ju i shtrenjti Lui, si njëri nga përfaqësuesit më me emër të gazetës më të madhe të qytetit tonë...

— Dhc vetëm si gazetar? — vërejti Lui me një ton qortimi të shtirur.

— Oh, jo, jo, në radhë të parë si një mik i ngushtë dhc i dashur i familjes suaj, Lui. Ha, ha, ha!

Të dy qeshën me zë të lartë dhc vetëm e shoqja qëndroi hijerëndë.

Zoti Fransua e kishte zhgënjer. Gjendja e deprimuar e të shoqit, ja një argument bindës dhe i pakundërshtueshëm, me të cilin ajo kishte përcjellë duarthatë dhjetëra gazetarë vendas e të huaj, të interesuar veçanërisht për punimet e tij të fundit, por kësaj radhe, ajo ndihej e pafuqishme kundrejt mikut të vjetër.

«Sidoqoftë, pas bisedave të punës ata do të kthehen përsëri në tematikën e preferuar të gjahut e kjo do ta çlodhë Luin dhe do ta zbavisë», — mendoi zonja Pastër dhe padashur filloj të ndiqte intervistën prej mjeshtëri të Fransuait, i cili, pothuajse asnjëherë nuk mbante përpara të intervistuarit bllokun e shënimëve, por fiksonte, si në një shirit magnetik, pjesët më të rëndësishme të intervistës dhe më pas qe në gjendje t'i riprodhonte me një përpikmëri të habitshme.

— Lui, ndonëse je modest dhe punimet i publikon vetëm kur pas qindra provash është vërtetuar saktësia e tyre, kësaj radhe, ajo që për ty është e fshehtë, për mijëra të tjera është bërrë tashmë e njojur...

— Nuk ju kuptoj, Fransua, ç'doni të thoni?

— Do të më kuptoni, miku im. Lajmi, se ju po pregatisni një vaksinë kundër tërbimit, ka marrë dhenë...

— Është e pamundur, Fransi, këtë gjë askush nuk e di!

— Dhe as zonja Pastër?!

— Aha, kjo hollësi duhej të më qe kujtuar! — u përgjigj Pastéri duke qeshur.

— Lui, më duhet të shkruaj një artikull për gazeten tonë të Tulonit mbi këtë çështje.

— Po ajo ende s'ka përfunduar Fransua dhe gjersa është kështu.

— Oho, sa për suksesin e saj tanimë në Francë dhe jashtë saj, askush nuk dyshon, sigurisht, nga ata që të njohin mirë. E tani Lui, më thuaj, nga cili parim je nisur për preqatitjen e kësaj vaksine?

* * *

Dhe Lui Pastëri nisi të shpjegonte, kurse Fransuai të jepet përshtypjen e një dëgjuci të thjeshtë kureshtar, porse në të vërtetë truri i tij i regjistronte të gjitha dhe ai përpinqej të mos i shpëtonte qoftë edhe një fjalë.

— Si çdo qenit tjetër e gjallë, edhe mikrobet ndryshojnë në kushte të reja. Në këtë cilësi synuan të gjitha përpjekjet e mia. Nga truri i qenit të ngordhur nga tërbimi, preqatita një emulsion dhe këtë ia injektova një lepuri, ndën cipën e fortë të trurit. Pas disa javësh, lepuri sëmurej me shenjat tipike të tërbimit; sërisht me trurin e lepurit preqatisja një emulsion e këtë ia injektoja një tjetri. Kështu, shpresoj të ndryshoj cilësitë mjaft patogene, apo sëmundjeshkaktuese të këtij virusi të ashtuquajtur «Virus rrugësh».

— Kur shpresoni të preqatisni vaksinën e parë, Lui?

— Pas tre vjetësh.

— A do t'ju vijë keq, nëse e shpikin para jush shkencëtarët anglezë, amerikanë apo ata gjermanë?

— ?!...

— Në një rast të tillë, puna juaj kolosale, kishte për të vajtur dëm. Lavdia do t'u përkiste të tjerëve...

— Fransi! — vërejti me hidhërim Lui. — Si mund të më bëni një pyetje të tillë pikërisht ju?! Kjo gjë do të më gëzonte, ashtu siç duhet të gëzohen ata, nëse e shpik unë më parë, sepse nuk bëhet fjalë më për lavdinë e këtij, apo atij shkencëtarit, por për jetën e miliona të sëmurëve, që shkojnë drejt vdekjes së sigurtë... Një vdekje nga më të tmerrshmet, Fransi, ku vetëdija ruhet gjer në sekondat e fundit të jetës dhe të sëmurët jetojnë dramën e tyre të madhe të parashkuar nga një virus rrugaç, tepër rezistent... Kështu, Fransi, përpara se të hidhemi në gjuetinë e pasur të Amazonës, më lejoni t'ju ofroj një ftesë.

— Çfarë pikërisht? e vogël. Dhe si
— Nëse do të zbuloj vaksinën e parë, atëherë ryshe,
do të vemi diku.
— Në ç'vend, Lui? — pyeti me kureshtje Fransuai.
Pastëri qeshi.
— Tani për tani, Fransi është ende një ekuacion me dy
të panjohura.

Viti 1855. Pastëri ka arritur rezultate të mrekullueshme në
imunizimin e qenve kundër tèrbimit me vaksinën e preqit tij.

Në fund të këtij viti, ai vaksinoi të parin njeri në botë, vo-
gëlushin e nënës alzasianc, Meister (Maishtër).

Gjatë atyre ditëve të paharruara, Pastëri, ndërmjet mijëra
e mijëra letrash, mori një letër origjinale, që s'mund t'i përkiste
askujt, veç firmës së njohur «Fransa». Ai e lexoi me
një frysme:

Lui, o kokë e madhe!

Që kur je bërë kaq harraq?! Ti mund të
harrosh, po deshe, një mijë herë emrin tënd,
punë përt ty, por të harrosh se ke në këtë botë
një mik të shtronjtë tulonez, bah, këtë s'kam për
të ta lejuar kurrën e kurrës!... Çu bë, me atë drejt
ekuacioni? Ç'djall të fshehtë më ke rezervuar në
pritjen madhështore alla pastëriane që do të më
bësh? Të njoftoj se jam «tërbuar» nga gjëzimi...
ftesën, për në varrimin tim të shpejtë, po ta dërgoj
që tani (mos u 'gëzo, shejtan, s'kam përt të vdekur
përparrë se të ha atë kek të bekuar, të gatuar për
shtatë palë qejfe nga zonja P-a-s-t-ë-r). Pas pesë
ditësh, o «Virus shtëpijak dhe i edukuar», më ke
aty. Pritmë, ashtu siç mund të priten, miqtë e nde-
ruar tulonezë! !

I «TËRBUARI» që pret shpëtim,
Fransua.
Tulon. Shekulli XIX. Viti 1855.

* * *

Ata lexuan edhe njëherë tjetër së bashku letrën gazmore dhe qeshën më gjithë zemër.

— Eja të shkojmë, Franci! — foli Lui, të cilin papritur e pushtoi pikëllimi. Mund të kisha vajtur edhe më parë, por ju kam pritur juve...

— Po shishja e vaksinës, ç'ju duhet që e merrni me vete?

— Dua t'ia dhuroj një vogëlushi, të cilin e kam dashur si jetën time e të cilit, në fund të fundit, i detyroj këtë kontribut...

Fransi ngriti supet pa marrë vesh gjësendi dhe e ndoqi pas i heshtur. Të dy, hynë në varrezat e mëdha të Parisit. Fransuai dukej vërtet i habitur.

— Ç'do të bëjmë në këtë vend të heshtjes së përjetëshme, Lui?

Lui nuk u përgjigj dhe ai e quajti të tepërt ta pyeste për së dyti.

U ndalën përpara dy varreve të mermarta; njëri nga të dy, qe i vogël dhe i mbuluar nga lule shumëngjyrëshe plot aromë, tjetri ishte më i ri (bari dhe lulet sapo kishin nisur të nxirrin krye) e më i madh.

Të dy u ulën në gjunjë.

— Janë nënë e bir, Franci. Të voglit i thërrisin Edi. Vdiq nga tërbimi. Një vit më vonë, e gjora mëmë, duke mos duruar humbjen për thessarin e saj të vetëm, e ndoqi pas. M'u lut, përpara se të vdiste, ta varrosja pranë të birit dhe, siç e sheh, e mbajta fjalën që i dhashë. Fjalën që i dhashë... Pak çaste para se të jepte frymën e fundit, pata vegulli të habitshme. Fytyra e tij më shëmbölleu me një glob gjigant bote, ku pasqyroheshin me shpejtësi të mahnitshme fytyra njerëzish të vdekur, që thoshin një fjalë të vetme e të kobshme, «Vdekur nga tërbimi! Vdekur nga tërbimi!». Si rrodhe të mërzitëshme, vegullitë (fani-tjet) më ndoqën këmba-këmbës një vit të tërë. Shpesh më dil-te gjumi dhe e shihja veten të mbuluar nga djersët. Më bëhej se dëgjoja shumë zëra që më thoshin: «Lui, bota nuk mund të presë më! Lui, virusi është bërë i padurueshëm! Lui! Luuuuui! Luiiiiiiiii... Ato zëra ktheheshin papritur në një oshëtimë rrën-qethëse e ankthi gati më mbyste.

Me duart që i dridheshin, ai nxori nga xhepi i xhaketës shi-

shen vockël të vaksinës dhe e vuri mbi varrin e vogël. Dhe si t'i drejtohej Edmondos së gjallë, foli:

— Më fal, që këtë s'munda ta bëja dot më parë. Ndryshe, vogëlush, do t'i gëzoheshe diellit, si miliona vërsnikë. Ti do të më falësh, Edi, sepse atë që s'munda të bëja dot për ty, e bëra për një tjetër vogëlush, djalin alzasian, Meister.

— Eja, i dashur, eja. Nuk duhet të qëndrosh më gjatë këtu!
— i foli Fransi me zë të ulët dhe i futi krahun.

I bindur, si një fëmijë, ai u ngrit.

Së largu, gjer atje, erdhi jehona gazmore e zërave të të vegjelvë që luanin diku, në pyllin pranë. Fransuai shpejtoi hapet. Lui duhej të gjente gjëzimin e humbur në turmën e lumtur të të vegjelvë. Atij i duhej pikërisht një clodhje e tillë.

FL I J I M I

Lajmi se fëmija qe goditur në këmbë, e tronditi Trombosin plak. Plaga ishte e madhe dhe i vogli po humbiste shumë gjak. Arturi gjashtëvjeçar mund edhe të vdiste, në qoftë se nuk do të gjendej ndonjë mënyrë përfshirë ndaluar rrjedhjen e gjakut.

Lajmësi qëndronte ende përpara çadrës, me qëndrim gatitu, në pritje të urdhërave. Sytë i kishin parë një pamje të llahtarshme. Në tubin e madh të arteries ishin hapur vrima të mëdha e s'andejmi gjaku derdhej jashtë pa pushim. Ata pak ushtarë trombocitë që qenë ndodhur aty pranë, ishin përpjekur ta ndalonin rrjedhën e fuqishme, por ajo i kish flakëritur përjashta dhe ata kishin humbur pa gjurmë.

— Ndonëse është kaq i prapë sa s'lë dy gurë bashkë, ndonëse vetëm një javë më parë m'u desh të flijoja përfshirë mijëra ushtarë të mitë, prapë ne s'mund ta lëmë pa e ndihmuar... Lajmëtar! Të mblidhen të gjithë në shesh!... Çdo sekondë e humbur mund t'i kushtojë shtrenjtë... Arturit të vogël, që ne e duam aq shumë.

* * *

— Blijtë e mi! Nuk dua të zgjatem. Jeta e Arturit tonë të shtrenjtë është në rrezik të madh! Mendoni pak, po të humbasë tetëqind gram gjak, ai mund të vdesë. Atëherë edhe qenia jonë s'do të kishte asnje kuptim.

Një pshëritimë e thellë dëshpërimi dhe ankthi, dalë nga gjokset e miliona ushtarëve trombocitë, si një valë dridhme rrëngethëse, përshkoi sheshin.

— Ne, — vazhdoi Trombosi plak, — kemi lindur përfshirë mbrojtur jetën e fëmijës pa marrë parasysh asnje rrezik. A ka

ndonjë midis jush, që s'e ka ditur gjer tani këtë të vërtetë të madhërishme??!

— Urraaaa! Urraaaa! Urraaaa! — iu përgjegjën miliona zëra kumbuse.

Komandanti plak u mallëngjye.

— S'kemi kohë pér të humbur? Ata që dëshërojnë të luftojnë sot pér jetën e fëmijës, le të bëjnë një hap përpara!

E tërë ushtria hodhi një hap.

Një pikë loti rrođhi nga sytë e plakut.

— Faleminderit, djema, që ma gëzuat shpirtin, që më dolët ashtu siç iu kam njojur tërë jetën! Por vetëm një pjesë e ushtrisë sonë do të hidhet në luftë. Të tjerët do të qëndrojnë në gatishmëri. Kush dëshëron të dalë vullnetar, le të bëjë një hap tjetër përpara.

Përsëri, të gjithë ushtarët, hodhën përpara hapin e dytë.

— Oh, atëherë, o bij, më latë një barrë të rëndë! — foli ai.

— Më duhet të vë gishtin e të zgjedh. Është një gjë e vështirë, besomëni, por çasti dhe detyra e kërkojnë...

* * *

U ndanë me dhembje, si vëllezër të mirë e të dashur e u hodhën në rrjedhën e shpejtë të gjakut. Me një dorë notonin, me tjetren mbanin lart shpatat e vogla. U printe Trombosi plak. Të tjerët kishin qëndruar në breg e i përshtendesnin me duar.

Notuan kështu një copë herë, gjersa iu afruan të çarave të mëdha të tubit arterie. Rryma, pranë së çarës, desh e flaku tutje në humnerë Trombosin, por ushtarët e gardës, duke u kapur dorë pér dorë, formuan një mur rrëth tij.

— Shtërngoni fort radhët! — u foli Trombosi plak. Të rrezikosh pér jetën e fëmijës, ky është nderi më i lartë, pér ne, detyra na e mbush zemrën plot trimëri e krenari.

Ata u përqafuan fort, si burra të vërtetë kur shkojnë në luftë, e mandej, pa iu trembur syri, duke klithur fort, u hodhën drejt së çarës së madhe të tunelit «Arterie».

Mijëra ushtarë ranë përdhe, pa frymë, të shpuar mes për mes nga rryma e fuqishme. Më në fund, mbetën Trombosi plak dhe një ushtar i thjeshtë.

Plaku buzëqeshi.

— Zemër, o bir! Edhe unë në betejë jam një ushtar i thjeshtë, një ushtar si ti. Jeta e Arturit, që ne e duam me shpirt e zemër, mbi gjithçka! A je gati, o bir?

— Po, — u përgjigj me zë të mekur ushtari.

Duke klithur, të kapur dorë për dorë, u sulën drejt së çarës, drejt fundit të sigurtë.

Ushtari i thjeshtë, tek jepte shpirt në duart e prijësit, ia nguli sytë fortë, si t'i kërkonte falje, diç belbëzoi, diçka që prijësi s'ia mori vesh, dhe lëshoi kokën menjanë si i këputur.

Trombosi plak vështroi përreth. Nga trupat e të rënëve rridhte pa pushim një lëng i trashë ngjitës, niveli i të cilët po rritet dalngadalë. Nga trupi i madh i tij rridhnin gjithashtu pikat e fundit. Ai po e ndiente afrimin e shpejtë të vdekjes.

Komandanti shfreu i lehtësuar.

— Edhe kësaj radhe, mundëm të bënim diçka për Arturin tonë të vogël! — foli me zë të dobët, të pafuqishëm dhë trupi pa jetë i prijësit, ra pranë atij të ushtarit të thjeshtë.

* * *

Lëngu i trashë ngjitës i trupave të ushtarëve mbuloi kufomat dhe u shndërrua dalngadalë në një rrjetë të kuqe, të thurur imtë e të pakalueshme. Të çarat vdekjeprurëse të tubit të arteries u mbyllën përgjithnjë. Në brigjet, të mallengjyer, ushtarët trombocitë hoqën njëri pas tjetrit kapelet.

— Lavdi atyre që ranë në luftë për jetën! — foli njëri prej tyre.

— Lavdi! — jehoi përgjigjja e milionave ushtarë.

Në heshtjen e thellë që pasoi, te ata guximtarë të padukshëm të ulur më gjunjë, erdhën tingujt e gëzuar të fëmijës që queshte.

— Mami, mami, gjaku ndaloj vetë, gjaku ndaloj! —

Drithma rrënqethëse lumturie përshkuante trupat e ushtarëve.

— A i njeh shpëtimtarët e tu, Arturi im i dashur? — c pyeti e ëma duke e përqafuar.

Por ai ishte ende i vogël, për të thënë se i njihte.

Ushtarët trombocitë vunë lehtë buzën në gaz dhe u shpërndanë në postet e tyre të vrojimit.

DASHURIA E ROBOTËVE

novelë

Në ekspozitën tradicionale «Progres», ku përfaqësoheshin me krijimet e tyre më të mira konstruktorët e shqar të vendeve të ndryshme, vëmendjen e të gjithëve e gozhdoi roboti virtuozi Ditrobi. Babai i Ditis (kështu i pëlqente më shumë ta thërrisnin), shkencëtari Soni, kishte punuar për nxënësin rreth tetë vjet, duke synuar ta bënte Ditrobin e tij një shkencëtar të vërtetë. Dhe s'e kish kursyer aspak mundin dhe dijen. Një planifikim i repte ditor e detyronte robotin e tij të punonte intensivisht katërmbëdhjetë orë rresht. Truri elektronik i Ditrobit thëthinte si i pangopur e pa ndier lodhje mijëra informacione të hollësishme shkencore të ndryshme, ndërsa orientohej e theullohej, sipas një planifikimi për t'ia pasur zilinë, në shkencën astronomike.

«E dua një dijetar të gjithanshëm, por ama të thelluar në një shkencë. Ja, të tillë e dua Ditrobin tim motak!» — kështu u pat deklaruar tetë vjet të shkuara korespondentëve dhe gazetarëve në një konferencë të rëndësishme shtypi, organizuar nga presidenti i organizatës botërore së robotëve.

Pastaj Soni u harrua nga bota dhe për botën. Me një durim dhe këmbëngulje për t'ia pasur zili, heshturazi, ai pregetiste kryeveprën e tij. Bile, as edhe miqtë më të ngushtë nuk ishin në gjendje të informonin në mënyrë të saktë dhe reale korespondentët dhe gazetarët e gazetave të përditshme e revistave të vendit. Ditrobi ish një enigmë, që do t'u zbulohej, sipas zërave që qarkullonin kohët e fundit në qytet, bash në ekspozitën e ardhshme të pranverës. Bota shkencore qe në një pritje të ethshme. E njihnin mirë virtuozitetin e Sonit. Ai gjithmonë i kish-

te befasuar të tjerët. Përfaqësuesja më me zë e opinionit shkencor të vendit «Vitet» (revistë shumë e njohur), jo rastësisht kishte heshtur për punimet e shkencëtarëve të vendeve të tjera. Sipas gjykimeve mburracake të kryeredaktorit të saj, zotit Pip, kupën e artë do ta gjemonin këtë vit dy shkencëtarë të shquar, Biti dhe Liti, të cilët prej kohësh po punonin mbi një projekt të koklavitur. Kryeredaktor Pipi besonte se kishte shanse edhe Soni (sipas një bashkëbisëdimi privat që mundi të bëjë me të tre shkencëtarët), porse duhej të prisnin disa muaj. Nëpër ekspozitat ka edhe të papritura.

Kështu interesni për ekspositen filloi të rritej dhe hapja e saj po pritej si ngjarja më e rëndësishme e vitit në fushën e shkencës.

Ditrobi i justifikoi më së miri shpresat e mëdha që kishin varur te ai krijuesi dhe përkrahësit e tij më të flakët. Shumë shpejt, që në ditët e para, u bë figura më simpatike e ekspositës «Progres» Mizéri vizitorësh (që s'rreshtnin për aq kohë, sa qe e hapur ekspozita) shtyhesin me zhurmë e bënин q'ish e mundur të dilnin më në krye, për t'u përshëndetur e për t'i shtrënguar dorën Ditrobit, të cilën ai ua zgjaste me mirëdashje e pa u lodhur.

Pyetjet, që i drejtuan në fillim, qenë fare të thjeshta, nga ato që zakonisht u bëhen robotëve të rëndomtë. Kaq lehtë, lirshëm shkujdesur dhe me indiferencë iu përgjigj atyre Ditrobi, saqë u la përshtypjen e çuditshme, gati të pabesueshme, se qe një robot mëndjemadh. Veçse, kjo gjë nuk mund të thuhej për Ditrobin, sepse ai nuk e kishte cilësi karakteri këtë gjë dhe në fund të fundit qe përbërë nga aliazhe të komplikuara pa jetë e shpirt.

Të prekur në sedër dhe të pakënaqur nga përgjegjjet e çkujdesura të Ditrobit (por q'ish në fund të fundit ai? Një robot e asgjë më... Një mëndjemadhësi e indiferencë të tillë në përgjigje, ata s'do t'ia kishin falur as edhe Sonit, babait të Ditis) maniakët vizitorë formuluan enkas pyetje të vështira për një robot. Ditrobi iu përgjigj menjëherë dhe me një siguri të çuditshme, duke i lënë të shtangur e të trondit tur pyetësit maniakë. Ah, jo! Roboti po bëhej me gjithëmend i padurueshëm. Me t'iu përgjigjur pyetjes së fundit, kryqëzoi duart mbi krahëronin e çelik-të dhe u duk se buzëqeshi lehtë, fare lehtë (nëse mund të quhet

kështu lëvizja e muskujve të veçantë të gojës), e me një ironi të hollë, siç e interpretuan gazetarët dhe kundërshtarët e flak-të të Sonit.

Armiqtë vendosën ta bëjnë zap Ditin! Robit metalik duhej me çdo kusht t'i mbyllej goja. Ju bënë pyetje që parashiko-heshin në programet mësimore të nxënësve të klasës së njëmbëdhjetë, por përsëri Ditrobi triumfoi duke korrur duartrokitjet, buzëqeshjet dhe vështrimet adhuruese të qindra e mijëra vizitorëve. Suksesi i deriatëhershëm i Ditit qe padyshim i madh. Mjafton të kujtosh se Mimi, njëri nga robotët më perfektë e më të avancuar të ekspozitës, sapo kishte mbaruar klasën e nëntë, ndërkhohë që kufiri maksimal i njohurive të Ditit ende s'u qe bërë i njohur përfundimisht vizitorëve, organizatorëve dhe ekspertere të ekspozitës. Armiqtë e Ditrobit dhe gazetarët kokë-krisur ndryshuan taktkë; duke u kujtuar se me anë të pyetjeve s'po bënин gjë tjetër, veçse po rrisin famën dhe lavdinë e robit mendjemadh, vendosën të mos i flisnin më.

— Pyesni, pyesni, zotérinj! Gjer tani ju më keni drejtuar pyetje shumë të thjeshta! — u tha Ditrobi vizitorëve ditën e tetë pas hapjes së ekspozitës.

Kërkesa e tij u prit me të qeshura dhe ovacione nga mijëra simpatizantë.

Enciklopedistë të njohur i bënë Ditrobit pyetje nga fusha të ndryshme të dijes, pyetje të jashtëzakonshme për t'iu drejtar një roboti, por edhe atyre ai iu përgjigj si s'ka më mirë.

* * *

Lajmi sensacional për robotin Ditrobi mori dheun. Gazetat dhe revistat e të gjithë vendeve, me shkronja të mëdha e tituj të bujshëm që binin në sy, jepnin informata të hollësishme dhe kureshtare mbi cilësitë e jashtëzakonshme të Ditit. Një emision special televiziv u transmetua direkt në rruzullin tokësor, në stacionet ndërplanetare të Hënës, Marsit dhe Afërditës. Intervista e korrespondentit të shkathët Fredi me Ditrobin, ishte nga emisionet më të bukura të transmetuara nga qendra e madhe televizive e vendit organizator të ekspozitës «Progres» gjatë muajve të fundit (Për të parën herë në jetën e

gjatë të televizionit vendas, mirrej në intervistë një robot).

Fredi: Mirëmbërëma, Ditrobi!

Ditrobi: (plot dinjitet). Mirëmbërëma zoti korrespondent!...

Fredi: Para së gjithash, ju falenderojmë për vizitën tuaj shumë fisnikë në qendrën tonë televizive!

Ditrobi: Ju lutem, hyni në temë! Parafrazimet e gjata të etikës televizive, më humbasin kohën e shtrenjtë. Unë jam shkencëtar. Veç kësaj, biseda e zgjatur do të ishte në dëm të xhepit tuaj, zoti Fredi. Sipas marrëveshjes, ju më paguani sonte njëqind dollarë për çdo minut. Një shumë jo dhe e vogël për xhepin tuaj, apo jo Fredi?

Fredi: (duke qeshur). Zoti Ditrobi, shakaja juaj më pëlqeu... Ju betohem, më pëlqeu shumë. Veç mos harroni! Dora juaj metalike është tepër e shkurtër për të boshatisur xhepin e, thellë të qendrës sonë televizive. (Toni ironik dhe therës).

Ditrobi: ju nuk flisni qartë. Unë nuk i fus duart në xhepat e të huajve.

Programi paraprak, përpiluar me shumë kujdes nga shkençëtarë Soni, s'ka mundur të parashikojë një kundërsulm ironik. Asnjëherë, më shumë se tani, Diti s'është dukur kaq i pa-zoti, kaq i çoroditur dhe gati-gati i fyri. Sytë e tij, si të budallallepsur e pa shkëndijë jete, vështruan ngultazi korrespondentin Fredi.

Fredi: (Duke qeshur, orvatet ta nxjerrë nga situata e vështirë atë dhe intervistën e tij televizive bash të rrezikuar). Diti, i dashur Diti, sipas mendimit tuaj, cili nga të njëqind robotët e ekspositës do ta fitojë konkursin e madh «Progres»?

Ditrobi: Roboti Diti, pra unë!

Fredi: Cilin konsideroni deri tani konkuruesin më të fortë?

Ditrobi: Robotin Diti.

Fredi: (Duke qeshur). Pra vetën tuaj?

Ditrobi: Robotit Ditrobi mund t'i ngajë dhe ta konkurojë vetja e vet.

Fredi: (Duke i rrahur shpatullat). Diti, a i keni vënë vetes ndonjë qëllim të madh dhe fisnik në jetë?

Ditrobi: (Duke fërkuar gishtërinjt). Po! Të bëhem një robot miliarder, pra si pasojë, zoti i plotfuqishëm i gjithçkaje njerëzore. Shumica e njerëzve do të më nënshtrohen si shërbëtorë të bindur e kështu do të jem diçka më shumë sesa një robot,

bile diçka më shumë sesa një njeri i zakonëshëm, se qindra-mijëra njerëz të zakonshëm.

Fredi: (Duke i rrahur akoma më shumë përzemërësi shpatullat e gjera, të çelikta). Të lumtë zoti Diti! Ju flisni bukur, bile shumë bukur. Desh harrova, se flisnja me një qenie të komplikuar metalike. Ju jeni me tërë mend shumë pranë njerëzve. Gati-gati, ju jeni një njeri i vërtetë!

Ditrobi; — Jo ende. Trupi im nuk ka mishra, koska dhe gjak si i njerëzve... por dijet e mia enciklopedike do të mbërrthenin paq gjysmën e popullsise së rruzullit tokësor. A nuk pas-kam atëherë të drejtë, të quhem edhe unë një robot-njeri? Ç'janë mishrat, koskat dhe gjaku i dhjetë mijë zezakëve vendas të marrë së bashku, përparrë trurit tim elektronik S. D. 1250? Çfarë e dallon njeriun në fund të fundit nga kafsha?

Fredi: (I trulloosur). Truri, mendja, zoti Diti.

Ditrobi: Nga kjo pikëpamje, i nderuar zoti korrespondent, unë dalkam më shumë njeri se dhjetë mijë të zinxj.

Fredi: Oh, racist i dashur! Ti je kaq i mençur, kaq i ditur. Por s'ke për të qenë, s'ke për t'u bëre kurrë njeri!

Ditrobi: S'm'i hedh ato mua, Fredi, i dashur! Unë do t'ju paguaj mirë, të gjithëve do t'u paguaj si s'ka më mirë dhe ju do të përbetoheni se jam më i virtutshmi «njeri» i botës, më i nder-shmi «njeri» i botës.

Fredi: (Kinse me shaka.) Oh, po ju po më trembni, Diti! Parashikimet tuaja fantastike, më shtyjnë të mendoj, se një ditë prej ditësh, ju mund të bëheni drejtori im! Ha, ha, ha!

Ditrobi: Nga një Ditrobi, zoti Fredi, mund të priten gjëra edhe më të mëdha.

Intervista shumë interesante, zgjati plot një orë. Ditrobi realizoi në mënyrë të shkëlqyer programin special dhënë nga Soni. Roboti po arrinte në kulmet e famës, së cilës do t'ia kishin zili shumë njerëz. U bë shumë shpejt epiqendra e bisedave familjare (prindët këshillonin fëmijët dembelë, që përparonin keq në mësime, të merrnin shembull nga Diti i madh, që me gjithëse sapo kishte mbushur të tetë vjetët, zatéronte një kulturë të gjithanshme), e bisedave video-telefonike ndërkom-bëtare dhe e supratelekomunikimeve ndërplanetare; fotografinë e tij po e botonin tanj jo vetëm në vendet më të dukshme të revistave e të gazetave, por punët arritën gjer atje, saqë

pronari më i madh i restorantit «Afërdita» e vuri fotografinë e Ditrobit krah për krah me atë të presidentit të vendit. U tha, kinse me shaka, se s'qe aspak për t'u çuditur nëse një ditë, do të merrnin vesh se Ditrobi do të emërohej president i shtetit dhe i robotëve! Sipas mendimit të tij, Diti i kishte të gjitha të dhënat. I zoti i restorantit shtoi pastaj, se Ditrobi që cdhe shumë i mençur, kështu që kandidatura për president ish një e drcjtë e madhe dhe e ligjshme, për të cilin ai dhe i tërë rrethi i tij familjar, do të votonin pa iu dredhur dora dhe me kënaqësinë më të madhe. Salla e kishte duartrokitur me shpirt dhc disa syresh, të ndezur nga fantazia, kishin filluar të stisin hamendjet më të shndritshme për të ardhmen e robotit.

* * *

Njerëzit u mësuan keq, madje prisin me padurim e ankth të rejet nga Diti, të cilat u bëheshin në çast të njohura nga sistemi perfekt dhc i organizuar i informacionit. Të gjitha llojet e shfaqjeve dhe të aktiviteteve kulturalo-artistike-sportivë ctj., humbisnin interesimin e spektatorëve e bëheshin pa vlerë, sa kohë që në qëndër të spektaklit s'ish Ai, i madhi Diti. Regjizorët e zgjuar dhe me nuhatje profesionale, filluan pa humbur kohë, xhirimin e filmave me shumë seri, në të cilët heroi i madh i subjekteve të ndërlikuara qe doemos Diti. Si kërpudhat pas shiut, në muret e qytetit filluan të mbinin afishet e reklamave të filmave të regjizorëve të njohur: «Diti akuzon», «Roboti president», «Shkencëtari më i madh i kohërave të reja, Diti», «Aventurat e çuditshme të Dtit» etj. etj.

Dhe s'është aspak për t'u habitur, nëse ndryshë nga çdo konkurs i deriatëhershëm,, komisioni ndërkombëtar i ekspertëve, i kryesuar nga presidenti i shoqatës së robotëve, s'e pa të udhës të diskutonte për çmimin e parë, i cili do t'i jepej robotit më të përsosur. Porse diskutimet e tyre zgjatën sa s'kishin zgjatur të gjitha diskutimet e konkurimeve të mëparshme të marra së bashku. A do të kënaqej Diti me një kupë të artë? C'mund ta kënaqte më atë robot famëmadh? I gjithë fondi i shoqërisë së robotëve nuk barazohej me atë që Diti kishtë arritur të grumbullonte vetëm në të dhjetë ditët e fun-

dit. Pas shumë orësh diskutimesh, të zjarrta, presidenti mori një zarf të bukur, spërkatur me një lloj parfumi të zgjedhur e të shtrenjtë, nënshkruar nga Diti. Ndërsa dridhej nga emociioni dhc padurimi, e hapi me një frysë dhe filloi të lexonte:

I dashur President!

E di mirë! Në këtë hall s'keni qenë tjetër herë. Organizata juaj ndodhet para falimentimit, sepse shpejt bota do të marrë vesh pafuqishmérinë dhe varférinë tuaj të madhe, që gjer tanj ia keni fshehur mjeshtërisht... Por mos, mos u trembni kaq shumë, zotérinj! (Më duket sikur i shoh fytyrat tuaja të shqetësuara, të zbehura, mbuluar nga djersët e ftoshta). Unë e kam gjetur zgjidhjen: Nuk ju kërkoj as edhe një cent të vetëm. Kupa do të më mjaftonte edhe sikur të qe prej kristali....

Këtu presidenti psherëtiu i lehtësuar, dhc anëtarët fshinë si të komanduar djersët e ballit.

«Kam lexuar shumë letra në jctën time, por këtë gëzim s'ma ka sjellë as edhe një letër» — tha ai në intervalin e shkurtër të çlodhjes.

Pastaj, më i përqendruar dhe më i qetë, vazhdoi leximin:

«Pra, unë si Diti, nuk duhet kurrsësi, të dëmtohen finansiarisht, pikërisht nga organizata që ka marrë përsipër mbrojtjen e të drejtave tonë, si robottë që jemi; qenë të mjera e pa asnjë përkrahje njerëzore. Jeta ime është një llogari e përkryer. Bie fjala, llogarisja të merrja si fitues i vendit të parë një shumë kolosale, të cilën, si anëtar modest i organizatës, ua jap me gjithë zemër dhe pa vënë asnjë kusht. Por s'më duket aspak e arsyeshme dhe në asnjë mënyrë dinjitoze, që në krye të shoqatës sonë të robotëve të jetë, sot, një njeri! Më e udhës do të ishte të jetë një robot, pra unë. Anëtarët, hëpërhë, le të mbeten njerëz, sa kohë që nuk mund t'i zëvendësoj

me robotë më të përsosur. Porse presidenti duhet të heqë dorë që tani dhe pa bërë shumë llafe, duke i lidhur një pension mujor të mjafsheshëm. Në rast se propozimi im nuk do të merret parasysh, organizata juaj do të shkatërrohet plotësisht dhe përfundimisht. Ju kujtoj zotërinj, se kam aq të holla, sa të vë kandidaturën për president, duke krijuar organizatën e re të robotëve».

Ditrobi.

Sikur ta kishin goditur në kokë me një send të fortë, presidenti u lëshua i pafuqishëm në shpinoren e kolktukut presidencial.

— Zotërinj, — tha pas pak, — nc qeshëm, u tallëm me zotin Lil, kur ai vuri portretin e robotit krahas atij të presidentit, por më duket se nuk e ka tepruar aspak dhe ka bërë punë me mend. Marshimi i robotëve është i pafrenueshëm. Një ditë, dhe ajo s'ka për të qenë c largët, të gjithë do të jemi të detyruar të varim portretin e tij në faqet më të dukshme të zyrave e të shtëpive tonë. Gjëja më e mirë që mund dhe duhet të bëjmë, është t'ia lëshojmë vendin pa bërë shumë llafe. Pra, po u lë. Nga ky çast, presidenti i shoqatës së robotëve do të jetë zoti *Ditrobi!*

Të pikëlluar, thellësisht të tronditur, anëtarët e këshillit presidencial zbrazën sallën. Oh, çfatkeqësi! Paskëtaj do të drejtosheshin nga një robot prepotent dhe i mençur. Sa probleme që lindnin dhe sa pikëpyetje ngjalli ky imazh në trurin e tyre. S'kishte më asnjë fije dyshimi, se Diti do t'i zëvendëson gra-dualisht, dhe vendin e tyre, herët a vonë, do ta plotësonë me robotë. Do t'u lidhnin një pension të majmë, sa për t'u myyllur gojën, dhe do t'i detyronin të zinin qoshen. Sulmi robotian, ndonëse i qetë, nisur pa bujë e zhurmë, në të njëzet vjetët e ardhshëm, sipas parashikimeve të një personaliteti të rëndësishëm shkencor, do të merrte proporcione shumë të gjera e të ashpra. Presidenti dhe anëtarët e këshillit presidencial e llogaritën veten në numrin e viktimate të para.

— Zotërinj! Ndónëse e dimë mirë, se kush fshihet pas robotit, pra megjithse e dimë se cili është Diti i vërtetë, makinë e përkryer meriton t'i bëhen të gjitha nderet, si të ishte një

njeri i madh, një personalitet i shquar. Desha të them se, makinë duhet kënaqur sa të jetë e mundur më shumë. Ceremonia e shpalljes së robotit më të arritur të ekspositës «Progres», duhet të jetë madhështore! Po atje, në kulmin e entuziazmit të pjesëmarësve, do të deklaroj se për aryse shëndetësore ia lë vendin Ditrobit. Por vëmendje të dashurit e mij! Ekspozimi i letrës, me siguri s'ka pér t'i pëlqyer Ditit dhe do ta inatoste atë nursëz, ndaj pér të mirën tuaj, se unë e hëngra çairin, u këshilloj të mos ndiheni. Pra, unë s'kam marrë ndonjëherë letër nga Ditrobi dhe as ultimatum. Vendimi ynë pér ta shpalloj president, ka qenë kurorëzimi i një dëshire të zjarrtë shumëvjeçare pér t'u dhënë robotëve vendin e merituar në organizatën e tyre. Besoj u kuptuam, zotérinj! — tha, ndërsa griste me delikatesë në sytë e anëtarëve të këshillit presidencial, letrën e parfumuar.

Ceremonia u zhvillua pas një javë dhe që e madhërishme. (pér organizimin e saj u shpenzuan rrëth dy të pestat e buxhetit). Merrnin pjesë tremijë të ftuar nga të gjitha vendet e botës dhe përfaqësues stacionesh ndërplanetare, që të gjithë koka të mëdha, të njohura e të dalluara në fusha të ndryshme të dijes njerëzore.

Një kor prej njëqind robotësh të rëndomtë vendas, kënduan hymnin kombëtar të vendit organizator, që ngjasonte më shumë me një marsh nxitës e të ethshëm luftarak. Të pranishmit u ngritën në këmbë dhe qëndruan të ngrirë si mbi gjëmba, gjersa ajo ulurimë e çjerrë dhe ngjethëse zérash metalikë, që të ngjethëte mishtë, u shua dalngadalë. Në tribunë u ngjit pastaj, presidenti i organizatës së robotëve, që mbajti një fjalim të shkurtër, me fjalë të ëmbla si mjalti, adresuar veçanërisht robotëve vendas pér triumfin e padiskutueshëm që arritin.

Në emër të komisionit të ekspertëve, shpalli më në fund, ndën një stuhi duartrokëtjesh dhe thirrjesh histerike, robotët yje të ekspozitës ndërkomëtare. Në fillim, pér të ngjallur më shumë kureshtjen dhe entuziazmin, shpalli fituesit e vendit të dytë e të tretë. Vendin e tretë e meritoi një robot tjeter i vendit

organizator, kursc të dytin roboti Mimi, i një shteti tjetër të madhe të zhvilluar.

— Zotérinj! Nuk mund të mohoni, se s'e keni ditur që më parë fituesin e ndritur të kësaj ekspozite ndërkombe, robotin shkencëtar, të zgjuarin dhe të mënçurin, fituesin e kuppës së artë... (Tonet e zërit të tij po arrinin kulmet më të larëta, që mund të mbërrihen nga një njeri, që s'ka lindur këngëtar).

Nuk mundi të mbarojë fjalën, sepse mijëra zëra thirrën plot entuziazëm: «Diti! Diti! Diti!»

Presidenti buzëqeshi ëmbël që nga tribuna, se s'kishte buzëqeshur tjetër herë në jetë.

«Ju falenderoj, zotérinj! Duartrokitjet tuaja vërtetojnë se komisioni i ekspertëve ka qenë në udhë të mbarë, kur përcaktoi si robotin më të shkëlqyer, dijetarin e madh, Ditrobi. Pra, i ndruar zoti Diti, jeni i lutur të vini në podiumin e nderit.

Ndërsa përshëndeste me të dyja duart e bashkuara c' të ngritura lartë, si të qe fituesi i ndonjë gare olimpike, Diti përshkoi korridorin c' ngushtë midis radhëve, ndën thirrjet që s'rreshtnin «Diti», «Diti», dhe të ovacioneve që s'pushonin.

— Të ndruar zotérinj! Të ndruara zonja! Shumë të dashurit e mi, vëllezër robotë! Ju falenderoj për nderin që më bëtë! Desha të them për të drejtën legitime që më takonte dhë që ma ofruat me mirëdashje. Kupa e artë dhe posti i thjeshtë i presidentit të robotëve janë ofiqe të bukura, ndonëse, jua them sinqerisht, disi të varfëra për një robot aq të pasur, siç jam unë! Por, besomëni, s'kam shpresuar të pasurohem me anë postesh a kupash ndërkombe, qofshin këto të arta e shumë-kilëshe. Fuqinë time dërrmuese e kam kërkuar dhe mund të them se c' gjeta në forcën e madhe të diturisë, ndaj dhe më doni kaq shumë dhe më respektoni. E këtë forcë e kam vënë në shërbim të pasurimit tim. Dua të bëhem aq i pasur, sa s'është bëre gjer më sot, asnje nga njerëzit, e gjersa në botën tuaj njerëzore, paraja është gjithçka, dua të arrij shumë kulme, të gjitha kulmet që mund të arrihen. Nga pikëpamja e dijeve, edhe tani, në të tetin vit të jetës sime prej roboti, jam më i përparuar se qindra-mijëra njerëz të rrizuillit, jam më i pasur se qindra-mijëra gjashtëdhjetëvjeçarë, pra, a s'paskam të drejtë të kërkoj të më quani, paskëtaj, diçka më shumë se një robot, pra NJERI, më shumë nga ç'e meritojnë këtë emër dhe këtë të drejtë

mijëra të tjërë, e të kërkoj të drejta të barabarta me ju? Ç'më mungon sot? Ç'kishte për t'i munguar një roboti kaq të përsosur, siç jam unë? Thomëni, thomëni hapur, pa pikën e druajtjes, a kë ndonjë gjë, që ndonjë robot tjetër në botë ta bëjë, e unë Ditrobi, të mës e bëj dot?

Askush s'iù përgjigj. Në sallën e madhe pllakosi heshtja: Njerëzit, madje edhe përkrahësit e Ditit, dukeshin të tronditür. Këtë imbrëmje Ditrobi e kishte tepruar. Tani, më tepër se kurre, i dhanë me mend të drejtë shkencëtarit F. Tamias, kur shumë vite të shkuara, në një vepër dyvëllimesh e, kishte parashikuar se të dyqind vjetët e ardhëshëm, do të ishin arenë luftimesh të ashpëra midis njerëzve dhe pjellave të tyre, robotëve, që s'do të duronin më zinxhirët e prangave e të skllavërisë e do të luftonin pa u prapsur për vendin e robotëve në jetë e në shoqëri.

— Unë po pres një përgjigje nga ju zotërinj! — ngulmoi përsëri në kërkësen e tij Diti. — A ka diçka që robotët e tjerë mund ta bëjnë, dhe unë jo?

Diku nga mesi i sallës, u ngrit një shkencëtar i huaj, i ftuar në ekspositë. Flokët e gjatë, të bardhë borë, i lëshoheshin supëve të ngushta e delikate. Sytë e vegjël, të zgjuar e dinakë, vështruan ngultazi dhe me ironi therëse Ditrobin.

— I nderuar Diti! E nderuara makinë e përsosur! — Kësh-tu si ju kanë krijuar, sado larg të kenë vajtur me fantazinë dhc ambicjet e tyre, ju kanë dënuar përjetësisht të mbeteni veç-se një robot, një makinë e asgjë më shumë. Ju jeni shumë larg njeriut të vërtetë, qoftë edhe atij më primitivit, sado që truri juaj elektronik është shumë i mirinformuar. Ju jeni qenie pa shpirt, pa zemër. Asgjë s'ju ka shqetësuar ndonjëherë e mje-rișt, s'do t'ju mundojë shpirtërisht, për gjithmonë. Ç'imbresë po ju lënë fjalët e mia? Ti je një robot skllav. Mund të përgjigjesh vetëm në bazë të programit të parashikuar mjeshtërisht nga Soni... Veç kësaj, ti je një makinë shterpe. Nga kjo pikë-pamje, cdhe njeriu më primitiv është njëqindfish më i fituar dhe më i përparuar se të gjithë shokët e tu robotë, se ty Diti!

Shkencëtari s'e mbajti të qcshurën me argumentin e habit-shëm të riprodhimit, që me sa shihej, s'e kish menduar më parë, por iu kujtua aty për aty.

— E çuditshme! — u tha me zë të ulët, ndërsa ulej, miq-

ve përreth — s'më kishte vajtur ndërmend të diskutoja për cilësinë riprodhuase të makinave, por s'është e thënë. Biseda nis në një shteg e të shpie, dashur pa dashur, në shumë shtigje.

Të gjithë prisnin në tension përgjigjen e Ditrobit. Por roboti heshti. Edhe njëherë tjetër, në intervistën me korrespondentin Fredi, ai s'kishte mundur të përgjigjej. Ato çaste, ndërsa vështronë si i shastisur e i trullo sur në drejtim të sallës, me sytë e qelqtë, pa jetë e pikën e shprehjes, dukej makina më e budallallepsur dhe më e pavlerë e botës.

Dikush nxitoi t'i afrohej. Një mesoburrë, me flokë të shpupurisur, në ije të robotit, futi diçka si një cilindër letre, në ngjyrë të verdhë, e cila, pa pikë dyshimi, duhej të ishte përgjigja e ardhshme e Dtit, përgjigja që pritej të jepej. Ashtu, siç edhe u afrua, burri nxitoi të largohej për t'i shpëtuar turmës së shqetësuar të gazetarëve, që iu qep pas, si re grenzash.

Salla priste. A do të mund të përgjigjej Diti? (Soni duhej ta kishte pasur vështirë të jepte një përgjigje për të qenë).

Në kohën kur të gjithë pritnin përgjigjen e robotit Diti, në sallë buçiti një zë:

— Zotërinj të nderuar! Zotërinj!

Të gjithë ktheyn kokën në drejtimin nga erdhi ai zë i trashë dhe i çjerrë. Ishte ruajtësi i natës të ekspozitës, një burrë i moshuar, veshur me uniformën karakteristike të punonjësve të ekspozitës.

— Ndonëse mbrëmë s'kam bërë një sy gjumë, — i tha ai mbledhjes, — s'më shkohej pa marrë vesh, se kush do të shpalloj roboti më i ndritur. Aty jashtë, ndoqa edhe bisedën shumë tërheqëse të Dtit me shkencëtarin e huaj. Duke marrë shkas, edhe nga një ngjarje e jashtëzakonëshme që më panë sytë këto dy netë, them se vendimi i komisionit të ekspertëve, për të shpallur Ditrobin fituesin e vendit të parë, është pa vend, i nxituar dhe i pamenduar mirë.

Salla gumëzhiu si të ziente valë, nga zërat dhe thirrjet që shprehnin habi.

— Po, zotërinj! Kam parë një ngjarje të jashtëzakonshme, gati-gati të pabesueshme. Jo! S'mund të thoni se më kanë bërë sytë. S'mund të thoni, ah, jo, se kam qenë i dehur. Kam parë skena të mahnitshme të një dashurie të jashtëzakonshme, zotërinj. Dy nga të njëqind robotët e ekspozitës janë dashuruar

marrëzisht. Një dashuri e tillë s'është dëgjuar ndonjëherë! E zemrat e kuqe, o miq, u ndizeshin flakë, si dije të zjarrtë, sa kohë shkëmbenin fjalë të ëmbla e përkëdhelëse të dashurisë. E ç'na është Diti plakush, përpara dy robotëve të rinj, që kanë aq zemër e shpirt, sa duken të jenë më shumë njerëz sesa robotë?! Madje mund t'iu them zotërinj se të dy robotët për të cilët iu fola më duken po aq të ditur sa edhe Ditrobi, në mos më shumë.

Salla gumëzhiu edhe më fuqishëm. Ruajtësi po rrezikonte seriozisht pozitat e Dtit, mendjemad, pas grushtit që i dha shkencëtarit plak.

— Si mund t'i vërtetoni këto që po na thoni? — ndërhyri një anëtar i këshillit presidencial, duke iu kthyer ruajtësit të ekspozitës. A mund t'u besojmë fjalëve që dëgjuam nga goja juaj?

— Oh, fjalët, fjalët, zotërinj, përshkrimi më i bukur sheks-pirian do të ishte i dobët dhe i zbetë për atë dashuri fantastike. Fotografitë me ngjyra që kam bërë natën që shkoi dhe që jua jap me gjithë zemër, ndonëse jo tepër të qarta, janë një pohim gjysmak i së madhërishmes dashuri. Më mirë ejani më shoqëroni këtë natë e së bashku të ruajmë çiftin, gjersa me sytë tuaj të bindeni përsa u thashë... E atëherë do të jeni të detyruar, doemos, të rishikoni qëndrimin tuaj ndaj dy robotëve të heshtur, që ndryshe nga Diti, s'bën më të voglën përpjekje për t'u ekspo-zuar, për t'u dukur e mburrur. Se ata janë vetë thjeshtësia. Tammam këtu qëndron madhështia e tyre. Ata janë si qenie me zemër e shpirt. Gjynah i madh vërtet, t'u thërrasësh makina, t'i quash robotë!

— Kjo gjë edhe mund të bëhet, por duhet marrë doemos edhe mendimi i presidentit të porsazgjedhur, — tha anëtar i këshillit presidencial. Pra, pas njëzet minutash pushim, do të dëgjojmë vendimin e presidentit tonë të nderuar.

* * *

Pas njëzet minutash roboti Diti mbajti këtë fjalim të programuar që më parë nga shkencëtarit Soni:

— Konkurimet s'më trembin! Unë ua kam thënë e rithënë

shumë herë. Mund të bëj çdo gjë që bëjnë robotët e tjerë, ngado qofshin. I zënë shumë, siç kam qenë, me studime të thella e të mëdha, s'kam pasur kohë të ngeshme për t'i u kushtuar dashurisë robotiane. Në qoftë e vërtetë dashuria e dy të rinjve robotë, një ditë prej ditësh, do të dëgjoni se robotesha, pasi u njoh me Ditin u dashurua, braktisi të dashurin dhe adhuron vetëm Ditin. Zotërinj ekspertë, nëse dëshëroni, unë mund të heq dorë përkohësisht nga kupa e artë, sa kohë që po dëgjoj për robotë më të përsosur se unë... Pas shtatë ditësh vendosni përfundimisht dhe pa asnje mëdyshje për atë që meriton të quhet mbreti i robotëve. Pra, mirupafshim sonte, në takimin e madh të dashurisë! T'ju them të drejtën, jam po aq kureshtar sa ju, në mos më shumë, për të parë me sytë e mi, ato çka dëgjova. Mirupafshim!

* * *

Mbrëmja qe e bukur, siç janë mbrëmjet e vakta të majit, e muajit kur lulëzojnë trëndafilit e kuq të dashurisë. Qielli ishte i mbushur plot me yje të shndritshëm. Hëna, si një sy i madh gjigant, në kupë të qiellit, vështronë ëmbël dhe buzagaz të dashuruarit njerëz, që shkëmbenin fjalë të ngrohta, pshëre-tima dhe përqafime të ëmbla e të shqetsuara.

Po afronte dalngadalë mesnata. Sheshi i madh i ekspozitës dukej si i shkretë e i vëtmuar. Robotët e ekspozitës kishin kohë që kishin «rënë të flinin». Shumë kurestarë qenë mble-dhur në sallën televizive, ku ndiqnin ngjarjet nëpërmjet të kamerasave të fshehta. Deri më dympëdhjetë, gjithçka dukej e kredhur në gjumë, aq sa disa filluan të dyshonin për thëniet e rojtarit (që vijonte të përbetohej se gjithçka e kishte parë me sytë e vet). Kamerat televizive panoramonin më kot, majtas e djathtas, sipër e poshtë, në të gjitha anët, për të kapur qysh në çastet e para çiftin e dashruar, meqenëse rojtarit nuk i kujtohej mirë nga cila anë kishin dalë.

Më në fund, në orën dympëdhjetë e pesëmbëdhjetë minuta, çifti u duk të dalë nga pavioni i një vendi të vogël dhe kjo i habitit të gjithë të pranishmit. Kamerat kryesore gjer në atë kohë qenë përqendruar në një pavion tjetër, të një shteti po aq të madh e të zhvilluar (në pavionin e robotit Mimi, me kohë

qenë shfaqur dyshime), sa edhe vendi organizator, dhe vetëm fare rastësish, një kamera e vëtmuar, në një nga ato rrrotullimet e kota, gati të pa arsyeshme, mundi të japë shembëllimin elektronik të shumëpritur. Mësuan shpejt nënshtetësinë e robotëve dhe shumë syresh mblodhën buzët me mosbesim. Të shumtën, surpriza mund të pritej nga ekpsonatet e tri a katër shteteve të mëdha e të përparuara. Realiteti që po u zbulohet nga kamerat televizive, qe krejt i papritur, i paparashikuar dhe tronditës. Një vend i vogël, që ndryshe thirrej edhe «VENDI I DIELLIT» (kaq shumë ditë me diell kishte, kaq shumë kaltërsi qiejsh e ujtrash kishte) po i sfidonte tamam atëherë, kur gjithçka konsiderohej monopol i pandryshueshëm i zbulimeve të reja. Kjo donte të thoshte se shkencëtarët e vendit të vogël kishin punuar në heshtje të plotë, pa u ndier, (ose për më keq, qenë nënvylerësuar dhe i kishin shpëtuar «kontrollit» periodik të spiunazhit shkencor të vendit të madh, që orvatej të mirrte informacione të rregullta mbi shkallën aktuale të zhvillimit shkencor të vendeve të tjera, të shfrytëzonte zbulimet e mundshme e të bënte ç'qe e mundur për të penguar përparimin e mëtejshëm).

Shkencëtarët vendas shfrynë të shqetësuar e të mërzitur.

— Dhëntë i madhi zot, mos qoftë e vërtetë! — uroi me mend zoti Soni.

Qe tepër vonë. Zemërdredhur, Soni ndiqte shëtitjen e qetë të çiftit të ri të robotëve. Në fillim, ata ecën të qetë bri njëri-tjetrit, pa këmbyer fjalë. Pastaj, si të qenë njerëz, robotesha i futi krahun kurse ai e kapi fort në ije. Të dy kthyen kokën nga njëri-tjetri e buzëqeshën lehtë. Ecën një copë herë kështu, pastaj robotesha, duket, pati «dëshirë» të ulej në një lëndinë të gjelbër e plot lule të bukura aromatike.

— Genti, a ulemi këtu? — e pyeti ajo.

— Genti pohoi me kokë.

Të dy u ulën në bar. Një çast, vështruan si të menduar shatrivanin e artë që hidhte currila të hollë uji. Vështruan prapë njëri-tjetrin. Buzëqeshën. Ai i kërkoi dorën dhe ia mori në të tijën.

— Atalanta! Përse je e trishtuar sonte? Nata është e bukur.

— S'u ngjan netëve të vendit tonë, Genti. Më ka marrë malli shumë!

— Edhe mua... Sa kohë do të na mbajnë këtu? Sikur na kanë burgosur...

Roboti i hodhi krahun në qafë dhe e afroi pranë vetes, gjersa faqja metalike dhe e kuqërrëmtë nga «afshi» i dashurisë, preku faqen e tij.

— Të dua, shumë, Atalanta!

— Edhe unë të dua, Genti!

— Kur pashë në ekspozitë robotë të huaj, pata frikë, Atalanta...

— Për çfarë?

— Se mos dashuroheshe me ndonjërin...

— Çudi! S'kam vënë re gjësendi. Asgjë s'kam vënë re. Më je dukur gjithnjë më i bukuri, më i mençuri, më i hirshmi robot i botës!

Të dy qeshën, e faqet e ndezura prush, u rrezellinë.

Ata që po ndiqnin këtë skenë, mbetën si të nemitur.

Të nesërmen herët, me tituj të bujshëm si: «Zoti Soni është deziluzionuar!», «Ditrobi apo robotët e dashuruar?», «Shfaqja më e madhe e shekullit!», «Makina të dashuruara!», «Dashuria fantastike!», «Ditrobi po qan!», «Sfida e vendit të dieillit!» etj. etj., të gjitha gazetat botonin informacione të hollësi-shme nga nata e kaluar; shumë syresh botuan edhe tekstin e plotë të bisedës së robotëve të dashuruar... Numrat specialë të gazetave dhe të revistave u shitën si asnjëherë tjeter. Televizioni transmetuan dhe ritransmetuan disa herë radhazi filmin e shkurtër televiziv «Dashuria e robotëve». Skenaristët e shkathët, që s'humbisnin rastet, filluan menjëherë punën për shkrimin e skenarëve të filmave të rinj me metrazh të gjatë, ku tani, heronj kryesorë, veç Ditit të madh, ishin edhe të dy robotët e dashuruar, dalja në skenë e të cilëve premtonte për subjekte më të ndërlikuara e më interesante. Kureshtja e publikut domos, arriti kulmin. Por deklarata e shpejtuar e Sonit, dhënë korrespondentit të televizonit vendas, zotit Fredi, që nga më të pabesueshmet dhe nga më të guximshmet, që u bë shkas për bastet më të mëdha të vëna ndonjëherë në shkallë botërore.

Në intervistën e tij Soni deklaroi:

«Robotët e dashuruar, nënshtetas të vendit të vogël të dieillit, janë një surprizë vërtet e këndshme për ekspositën tonë tradicionale. Në qoftë se Ditin tim do ta kisha orientuar për nga

zhvillimi shpirtëror, pra nëse do ta kisha bërë të ndjeshëm, atij me siguri kishte për t'i ardhur keq e mbasë do të qe dëshpëruar se si dolën kaq papritur në arenë dy konkurrentë të rinj. Por Ditit tim s'i vë faj... S'është aspak faji i tij, nëse synova ta bëj një enciklopedist të vërtetë dhe s'bëra as dhe më të voglën përpjekje për t'i dhënë «ndjeshmëri». Për Ditin tim s'kishte rrugë të mesme. Duhej ta bëja ose dijetar të madh, ose një robot të «ndjeshëm» e të «dashur». Zgjodha të parën, sepse forca e diturisë është më e madhe se sa forca primitive dhe e pa stazhionuar e dashurisë. A mund të thoni se njerëzit e egër s'e njohin dashurinë? A mund t'u mohoni këtë ndjenjë të lartë, siç e thërrisni, qoftë edhe kafshëve? Natyrisht jo! Po sa u shërben ajo? Ç'do të ishim sot pa forcën hyjnore të diturisë? Ç'është i dashruari injorant? Një hiç! Ndaj e bëra të ditur, pa çka se s'ka «ndjeshmëri» por mos pandehni, se kësaj s'ia arrija dot! Nëse të tetë vjetët që u deshën për ta bërë Ditin atë që shihni sot, do t'i kisha harxhuar për t'i dhënë «ndjenjë», besoj zotërinj, se ai do të bëhej një dashnor i flaktë, që mund t'u merrte mendjen me afshin e zjarrin e tij të dashurisë jo vetëm roboshave, por edhe vajzave e grave më simpatike! Them, besoj, sepse në fund të fundit, do ta kisha bërë një robot të paravarur në dashurinë e tij. Por për Ditin s'është ende vonë të dashurojë. Deklaroj solemnisht, se brenda shtatë ditësh, roboti im do të dijë të dashurojë. E jo vetëm kaq, por me zjarrin dhe afshin e dashurisë së tij, do t'ia marrë kaq shumë mendjen roboshës Atalanta, sa do ta rrëmbejë atë. Të kuptohemi mirë, zotërinj, do ta rrëmbejë atë pa e detyruar, Diti im s'e njeh dhunën, por ajo do t'i vejë pas me vullnetin e saj të lirë. Në mos ia arriftë qëllimit, Diti do të heqë dorë nga kupa e artë dhe mbasë edhe nga titulli i lartë i presidentit të organizatës botërore të robotëve. Pra, ju lutem, të keni mirësinë të duroni vetëm shtatë ditë e shtatë netë, për t'u bindur se forca e dashurisë është tepër e dobët për të mos u tunduar dhe iu dorëzua forcave të tjera të fuqishme, që do të zotërojë Diti im i dashur. Mirëupafshim, pra, pas shtatë ditësh!»

* * *

Konstruktorët e vendit të Diellit, deri ahere të panjohur për botën shkencore, ishin përpjekur shumë vite me radhë të krijojnë robotë që nga pikëpamja «e ndjenjave» të ishin më pranë njerëzve. Megjithëse paraardhësit paralajmëronin për kotësinë dhe dështimin e sigurtë të cilitdo që do të orvatej të krijonte «robotë-njerëz», shkencëtarët e Vendit të Diellit u treguan këmbëngulës të paepshëm për realizimin e ëndrrës së tyre të guximshme. Gërmuan pa u lodhur të gjithë bibliografinë teknike, duke mos nënvylerësuar edhe punimet më fillestare që kolegëve të huaj mund t'u ishin dukur naive e pa ndonjë vlerë të veçantë. Konstruktorët e huaj paraardhës në monografitë e tyre, pasi tregonin historitë e dhimbshme të përpjekjeve shumëvjeçare pa fryt, thuajse të gjithë pohonin me dëshpërim, se u vinte keq për kohën e humbur dhe i këshillonin të rintjtë, të mos i hytin një pune boshe, që s'kishte për të njohur fund tjetër veç dështimeve dhe deziluzioneve të sigurta. Por konstruktoret e Vendit të Diellit, menduan se shumë zbulimeve të mëdha të tilla histori u kishin paraprirë. Të lodhurit dhe të dështarit, gjithnjë kishin paralajmëruar me «dashamirësi» për fundin e hidhur të atyre që s'pranin së punuari për realizimin e hipotezave të guximshme shkencore. Punuan me ngulm dhjetë vjet rresht dhe mundën të zbulonin trurin e ri bio-elektronik, që ishte diçka më shumë se truri i rëndomtë elektronik i robotëve të tjerë të huaj. Të ndihmuar nga mikroskopë elektronikë të fuqishëm dhe nga metoda më të fundit të ekzaminimeve biokimike mundën të imitonin dhe të prodhonin një tru origjinal artificial, ku spikasnin qendrat më të rëndësishme të «emocioneve, ndjenjave:» Talamusi, Hypotalamus, Rhinencefaloni, Korea parietale etj. Qendrat «emotive», ndonëse të krijuara nga një aliazh special metalik, «vetëvepronin» në bazë të po atyre ligjeve që udhëhiqnin trurin e zakonshëm të një qenie të gjallë. Një rrjetë e dendur metalike e degëzuar si degët e një peme, shpërndahej në sipërfaqen e trupit të robotëve. Rrjeta ishte «sistemi nervor» periferik i tyre. Ndonëse qe bërë nga aliazhe speciale, nuk ndryshonte nga sistemi nervor i kafshëve dhe i njerëzve. Po ai prag ngacmimi i receptorëve nervorë, po ajo shpejtësi transmetimi i impulseve nervorë, po ato ref-

lekse, ndonëse të gjithë së bashku, shembëllime të zbeta e primitive të receptorëve, impulseve e reflekseve njerëzore.

Robotët e tyre, Atalanta dhe Genti, mund të «shihnin», të «dëgjonin» dhe «zotëronin një llogjike» shumë elementare dhe primitive, e cila nuk mund të barazohej madje as me atë të njerëzve parahistorikë. Por robotët duke shumë më të mençur në sajë të trurit elektronik «Alb.», i cili rriste aftësitet e tyre dhjetë fish në sajë të një informacioni të parapregatitur me virtuozitet nga konstruktorët e vendit të diellit dhe që u ishte dhënë robotëve të rinj dalngadalë vite me radhë... Nëse Ditrobi krahasohej për nga dijet me një student të kurrit të fundit universitar, robotët e rinj të vendit të diellit qenë edhe më përpara.

Në një konferencë të rëndësishme shtypi, shkencëtarë i Vendit të Diellit, në emër të kolegëve konstruktorë deklaroi:

— Një tru bio-elektronik, fsheh mundësi akoma më të mëdha se një tru elektronik i zakonshëm, ja pse edhe robotët tanë Atalanta dhe Genti, janë më të arritur se robotët e vendeve të tjera...

Pjetjes, se a do të mundte Diti ta rrëmbente Atalanten, shkencëtarë i ri i Vendit të Dellit iu përgjegj, se për një çështje aq «intime» është gjithnjë vështirë të bësh parashikime, madje edhe kur është fjala për robotë. Në fund të fundit, gjithçka do të mvarej kryesisht nga robotesha. Ai s'kish përtat parapregatitur «në mënyrë të posaçme» për t'i bërë sfidë Dtit. Ai e kishte mësuar vite me radhë, i kishte dhënë një botkuptim të përcaktuar mirë dhe robotesha në mënyrë krejt të lirë e të pavarur, vetëm për vetëm, duhej t'i bënte ballë provës. Robotët e tij kishin fituar tanimë një personalitet të tyre, të cilin ai ua njihte, edhe pse qenë robotë...

Deklarata e konstruktorit të ndershëm u prit ngrohtë. S'kishte asnjë dyshim, se ai do t'u përmbahej fjalëve të tij. Vërtet, gjoja i sëmurë dhe i shtruar në spital, ai s'i takoi më fëmijët e tij, që shfaqën një farë «shqetësimi» të lehtë. E bëri këtë, për t'u treguar edhe një herë shkencëtarëve dhe opinionit publik, se ai s'do t'u bënte asnjë parapregatitje të veçantë robotëve të tij, përndryshe do t'u jepte ngjarjeve një drejtim të detyruar dhe jo të «natyrshëm».

Një gjest i tillë shumë kurajoz, s'bëri tjetër gjë, veçse e

shtoi akoma edhe më shumë kureshtjen e publikut të gjerë të vendit e të opinionit të rreptë shkencor botëror.

* * *

Nga takimi i Ditrobit me roboteshën Atalanta, s'kishin mbetur veçse pak orë. Ankthi dhe padurimi (veçanërisht i atyre, që kishin vënë baste të forta) s'kishte të përshkruar. Dukej sikur qyteti i vogël shkencor kish ndaluar frysmaqen dhe priste, priste...

Tituj të mëdhenj provokues mbushën atë mbrëmje faqet e para të gazetave e të revistave: «Soni apo konstruktori i Vendit të Diellit?», «Sonte Diti ynë do të martohet me roboteshën Atalanta!», «Milionat e Dittit do të blejnë zemrën e roboteshës së dashuruar!», «Rrëmbimi i roboteshës!», «Tundimi i roboteshës!», «Dollarë, dituri, forcë, apo dashuri!», «Robotesha Atalanta është më e ditur se Ditrobi!» etj.

Shumica dërrmuese e gazetave dhe e revistave të vendit të madh, me titujt e bujshëm diskriminues e veçanërisht me përmbarjten e formuluar nga profesionistë keqdashës, nënçmonin se s'ka më robotët e vendit të diellit, duke pohuar se s'qenë gjë tjetër veçse pjella shumë primitive, të cilave padrejtësisht, s'dihej se qysh, u ishin njohur dhe ngritur në qzell cilësi, që linin shumë për të dyshuar nëse i kishin vërtetë apo jo! Në të njëjtën kohë, ngrinin në zenit cilësitë e mrekullueshme të Ditrobit, intligjencën e tij, milionat, prejardhjen fisnike, cilësitë fizike etj. etj.

«Në qofshin vërtetë të «ndjeshëm», siç është thënë gjer tan, robotesha Atalanta — ç'emër i bukur ky për një roboteshë! — do të dashurohet qysh sonte me Ditin tim simpatik, sepse është e pamundur të mos e tërheqë pamja e tij e këndshme (unë i bëra atij një përpunim plastik të nevojshëm, meqenëse, kur e «linda», s'e kisha parë me syrin e estetikës moderne) dhe i qepa një kostum të mrekullueshëm, të denjë për t'u veshur vetem nga një president. Dijet e tij të thella enciklopedike, do ta bëjnë roboteshën Atalanta, t'i duket vetja një qenie injorante, e varfër dhe e mjerë me horizontin e saj të caktë. E hutuar, e trondituar, e shqetësuar siç ka për të qenë, pyetjes nëse dëshë-

ron të bëhet bashkëshorte, ajo s'do të dijë t'i përgjigjet ndryshe veçse me një «Pooo» të dredhur e të mallëngjyer, në pastë gjithnjë «shpirt», siç më thonë».

Kjo deklaratë mburracake e Sonit, u botua një orë përpara vizitës së shumëpritur të Ditit dhe u transmetua menjëherë nga të gjithë stacionet radiotelevizive të botës. Minutat kalojnë. Ora e shumëpritur e takimit po afronte. Tridhjetë minuta përpara lidhjes direkte të qendrës televizive me sheshin e madh të ekspositës «Progres», rrugët e qyteteve e të fshatrave, u boshatisën. Njerëzit prisin të etur surprizën e Ditrobit. Një kurreshtje e tillë s'ishte parë asnjëherë tjetër.

* * *

Ora një e natës. Robotët e ekspositës kanë kohë që «flejnë». Ndryshe nga çdo natë tjetër (sipas marrëveshjes së arritur midis të dy shkencëtarëve) ka rënë të «flejë» edhe roboti Gentit, të cilin Soni ia ka pasur frikën dhe ka kërkuar që robotesha të lihet e «lirë» në dialogun e jashtëzakonshëm të dashurisë robotiane.

Genti fle gjumë të thellë (sikur t'i kishin dhënë të pinte një narkotik të fortë). Pranë i qëndron robotesha, që lehtë-lehtë i përkëdhel faqet e prera, të metalta. Kraharoni i Gentit robot, zgjerohet e ngushtohet ritmikisht, si të ishte njeri i gjallë. Robotesha me zë të ëmbël e të qetë, këndon diçka të ngjashme me një këngë djepi. Këngë e bukur në heshtjen e magjishme të natës, me hënë e yje.

Së largu, më në fund, duket Diti. Ecje e ngadalshme tepër krenare. Në sup mban një kitarë të paçmueshme elektronike (në barkun robotian, disqe të zgjedhura këngëtarësh vëndas). Në dritë të hënës së plotë, kostumi i robotit vezullon i téri në mijëra shkëlqime, si të qe larë në ar. Robot më i bukur se ai, s'ishte parë në të gjitha ekspositat e mëparshme. Soni ishte përkujdesur t'i bënte një operacion plastik të përsosur te skulptori më i madh i vendit. Shkencëtari plak (jeta e një roboti matet ndryshe nga ajo e njerëzve), dukej i freskët, i rinuar, tërë shëndet, jetë e gjallëri. Një dashnor i vërtetë dhe i apasionuar, mbi

të cilin, i ati kishte derdhur pa e kursyer një litër esencë klonje Singapori.

Ditrobi hoqi nga supi kitarën me lëvizje të matura e të llogaritura me kujdes që më parë. Gishterinjtë metalikë luajtën të çkujdesur (siç luajnë mbi tela vetëm gishterinjtë e mjeshtërave më të mirë të kitarave), si të kërkonte t'i akordonte edhe më mirë. Fill pas kësaj, në mënyrë automatike, nisi rrrotullimin e qetë e të çpenguar, disku i parë. Tingujt e bukur të një kënge popullore spanjolle, luajtur me kitarë, u përhapën në shesh duke e bërë edhe më romantike e intime atmosferën e magjishme të natës.

Befas, robotesha ngriti kryet. Sytë e qelqtë vështruan si të habitur të porsaardhurin. Goja e rrumbullakët dhe e vogël u hap si e mahnitur. Zemra e saj, llampa inkadeshente, vezulloi edhe më shumë, shenja këto që e bënë Sonin të kërcente nga karrikja shumë i kënaqur.

Diti i tij, i kishte bërë menjëherë përshtypje roboteshës Atalanta. Tingujtë e melodisë së dashurisë andaluziane, luajtur e regjistruar mjeshtërisht, e «mallëngjen» aq shumë roboteshën e mirë, sa u ngrit dalngadalë, duke e shkëputur dorën nga i dashuri i saj, që flinte, dhe instiktivisht (në mund të quhej kështu ajo shtytje e pavetëdijshme prej robotit), u drejtua nga Ditrobi.

Të dy robotët shkuan drejt njëri-tjetrit, si t'i tërhiqte diçka. Kur s'i ndanin veçse pak hapa, disku pushoi së rrrotulluari dhe, si i lodhur, Diti e vuri përsëri në sup kitarën (të ishte njeri, duhej doemos të kishte pshëretitur e shfryrë thellë!).

— Mirëmbërëma, Atalanta dhe mirësetëgjej në shtëpinë tënde!

— Mirëmbërëma! Cili je ti, o robot i bukur?

— Ditrobi! Ditrobi i famshëm! S'ke dëgjuar?

— Po, po, kam dëgjuar. Im atë më ka folur shumë për ju. Më tha se jeni shumë i ditur.

— Po! Jam më i dituri robot në botë. Mbarova universitetin e diturisë. Po ti vete në shkollë?

Robotesha heshti një copë herë, si t'i vinte keq për mburrkat aq neveritëse të Didrobit.

— A shkon në shkollë? — ngulmoi Diti krenar.

— Po, shkoj.

— Unë, Ditrobi, e kam mbaruar universitetin dhe jam i parritshëm. Askush s'do të barazohet ndonjëherë me mua!

— Në mendofsh kështu, — iu përgjigj Atalanta, — do të mbetesh shumë prapa. Dija nuk ka fund kurrë!

Duart e çelikta të Dtit u zgjatën papritur e pakujtuar (sa nxitohej ai!) përpara, për nga robotesha, si të donte ta rrokte nga supet e ngushta e delikate.

— Atalanta! — gjëmoi zëri i trashë i Dtit. A e di përsë erdha tek ti, këtë natë të mrekullueshme?

Atalanta mohoi me kokë.

— S'e merr me mend?

— Jo!

— Unë të dua Atalanta! Të dua shumë! Qëkurse të pashtë, gjumi robotian s'më ka zënë më. Kështu si e kam nisur, merraku i dashurisë do të më brejtë vazhdimisht e i sëmurë pa shpresë, në shtrat të vdekjes kam për të rënë!..

— Roboti është i lirë të dojë gjithçka i pëlqen, gjithçka të mirë e të bukur. Askush s'i vë fre dashurisë së madhe e të dli-rë të syve, e dashurisë së pastër të zemrës si qiejtë pranverorë. Pra, edhe ju, i dashur Diti, mund të më shihni, të më doni, por kjo s'do të thotë se...

— Atalanta! Po unë të dua ndryshe. Të dua, sa s'dua tjetër gjë në këtë botë. Të dua për grua! Për grua, Atalanta!

— Për grua? — zëri i roboteshës tingëllói disi i habitur. S'e ditke? Jam e martuar me robotin tim, Gentin!

— Oh, po kjo s'do të thotë gjë! Martesa s'është zgjedhë kau. Dashuria e robotëve të rinj është diçka e rastit. Njohe më parë Gentin dhe e dashurove. Në qoftë se do të më kishe njohur mua, sigurisht do të më kishe dashruar si një e një që bëjnë dy. Por s'është kurrë vonë. Gabimet e dashurisë së hershme mund të ndreqen si s'ka më mirë!

— Pra, më thoni të heq orë nga dashuria ime për Gentin e të bashkohem me ju?

— Po, natyrisht. Interesi i yt i madh e kërkon të flijosh një dashuri të vogël për një jetë të madhe, tërë të mira. Çdo gjë të kërkjoje, në fund të botës do ta gjeja!

Atalanta buzëqeshi dhe iu përgjigj:

— Gjithçka, por jo D A S H U R I N È!

— Kam aq shumë para, sa bëj ç'të dua. Në daça, edhe

Gentin tênd e blej dhe e marr nê sherbimin tim. Një robot i tillë aq i rëndomtë, s'mund tê kushtojë më shumë, se disa qindramijëra dollarë.

— Ti, Diti, mund tê blesh robotë tê vëndit tênd, nê qenka bërë zakon tê shiten e tê blihen robotët. Im shoq nuk blihet, nuk shitet, Diti.. Ne bëjmë një jetë tê thjeshtë, por c ndjejmë veten më tê pasur se ti... Ti kurrë s'ke pér tê thënë ndonjëherë pér veten «E N D J E J» veten tê pasur!

— A mos qenkeni më tê pasur se unë??

— Jemi më tê pasur se kemi «zemër», Diti, kurse ti, s'kc! A ka tê çmuar një zemër, që hedh nê dej pa u lodhur gjakun c kuq e tê ngrohtë tê dashurisë? C'janë miliardat përpara diellit tê vogël tê dashurisë së madhe? Se zemra është dielli i dashurisë! Pa tê, trëndafili i kuq i dashurisë fishket e vdes! Ja ti, fole kaq bukur, kaq 'mirë, por pa «zemër», pa «shpirt...» Fjalët e tua m'u dukën sikur tê kishin ngrirë e tê qenë mbështjellë me akull, se ti je një robot pa «zemër» pa «shpirt!» Ku c ke «zemrën» ti? Kurse Genti im ka «zemër», një «zemër» tê bukur që di t'i flasë simes. Vështro nê kraharorin tênd, Diti! Ku e ke «zemrën?»

Diti nuk u përgjigj. Si i trullosur, i çoroditur, i hutuar, si i budallallepsur, vështroi gjoksin c vet tê zbruzur e pastaj roboteshën... Programi virtuozi dhe profetik i Sonit, s'kishte mundur tê parashikonte një pyetje tê tillë aq nënçmuesc. Kjo, ishtë një goditje e rëndë dhe e tmerrshme pér Ditrobin mendjemadh, një farë nokdauni pér tê.

Sonit mënd i ra tê fikët nga marazi. Si harroi t'i vintc një «zemër» robotit tê tij? Një zemër sa pér tê thënë? Po a do tê mjaftonte një «zemër» e çfarëdoshme apo..?

Flokët iu ngritën gjemb përpjetë, sytë iu zgurdulluan nga inati e si i çmendur Soni iu vërsul ekranit televiziv. E mbajtën, se ndryshe do ta kishte qëlluar ekranin... Ndesha e parë i kishte dhënë një goditje tê fortë. Diti i tij kishte dështuar me turp.

«S'më është dukur kurrë më teveqel sesa sot, pjella ime e përkëdhelur» — shkroi nê ditarin e tij atë natë tê shqetësuar e tê pagjumë.

«Marrëzia e Dtit!...» «Natë rrënqethëse për robotin Diti!», «Ditrobi ynë nuk ka «zemër», «Gabimi fatal i Sonit!», «Mbeten edhe gjashtë ditë?», «Diti në nokdaun?», «Soni kërkon një «zemër» për robotin e tij!», «Zemra» e roboteshës!», Atalanta ia kalon Ditrobit edhe në dije!».

Këta tituj të bujshëm të gazetave të mëngjesit, i ndezën edhe më keq gjakrat. Përkrahësit e Sonit ishin të çoroditur e të pikëlluar. Shpresat e mëdha u qenë venitur. S'kishin përfytyruar kurrë një fund të tillë aq të dhimbshëm. Por deklarata e menjëherëshe, premtuese dhe optimiste e Sonit, në një emision special televiziv, sikur i qetësoi.

«Robotesha Atalanta i kërkoi Dtit tim një «zemër», një «zemër» për mendimin tim formal, sepse ajo s'është gjithçka. Ndonëse është e vështirë, shumë e vështirë, do të thosha, i si-guroj të dashurit e mi, përkrahësit e mi, se jo më vonë se nesër në darkë, ai ka përtë pasur «zëmrën» e tij. Do të isha shumë kurioz, besomëni zotërinj në sinqeritetin tim, të dija se ç'kishte për të thënë pastaj robotesha Atalanta? Ç'i mbetet më për të thënë?

Pastaj, duke u shtirur si babaxhan i mirë e i dhembshur, kishte buzëqeshur dhe përshtëndetur me dorë telespektatorët, në një mënyrë shumë spektakolare.

Soni c' mbajti fjalën. Në mbrëmjen e tretë të takimit të dashurisë, në të majtë të kraharorit, Diti kishte një «zemër», madje shumë të ngjashme me atë të robotit Genti. Kjo i bëri përkrahësit dhe partizanët e shkencëtarit të vendit të diellit, të këronin me këmbëngulje verifikimin e menjëherëshëm të «zëmrës» së robotit Genti, nëse ishte në vend të vet, në kraharor të tij, apo mos qe vjedhur nga Ditrobi.

Një komision i posaçëm ndërkombëtar, vërtetoi se gjithçka ishte në rregull. Shkencëtarë i Vendit të Diellit pohoi se «zëmra» e Gentit ishte tamam ajo që kishte vënë me duart e veta.

Në takimin e natës së tretë të dashurisë, robotesha Atalan-

ta shfaqi shenja të hapura kënaqësie, kur në kraharorin e Ditiit pa një «zemër» të ngjashme me të sajën dhe të Gentit.

— Pra, paske pasur edhe ti një «zemër», po përsë na e fshihje? — pyeti ajo, pa ia ndarë sytë lëmshit të kuq.

— Sigurisht që e kisha. Por s'c mbaj vazhdimisht me vete, s'c ndiej shumë të nevojshme. Mund të rroj për bukuri edhe pa tē. E vë në kraharor në raste të jashtëzakonshme, atëherë kur dua të btohem duke vënë dorën mbi tē. Por, le të mos e zgjasim Atalenta. Jepmë fjälën! Këtë natë kam ardhur të të marr, ndryshe do të pëlcas e bëhem thërrime. Të dua shumë! Je e bukur dhc je e mirë... Jam bërë si i çmendur... S'mund të thuash më, se tani s'i kam të gjitha çfarë i duhen një bashkëshorti ideal: dituri të madhe po, famë botërore po, pasuri prallorre po, një «zemër» po, ç'më mungon mua?!

— O Diti krenar! Edhe sikur, papritur e pa kujtuar, të më hyje në shpirt, të tē doja e tē tē adhuroja, gjë që s'mund të ndodhë kurrë, kurrë! e tē largohesha nga im shoq, një dashuri më e madhc, MË E MADHJA DASHURI E DASHURIVE, do të më bënte t'jua refuzoja ndjenjën e lartë të miqësisë e tē dashurisë që po më ofroni. Mos harroni! Jam nga VENDI I DIELLIT! Quhem Atalanta!

— Unë s'ju kuptoj. Unë s'kuptoja asgjë, — thirri Diti. Dhe megjithëse tani kishte një «zemër», thirrja e tij pati një tingëllim të thatë metalik.

— Ta thashë shumë kjartë! Po ta përsërit pra prapë. Edhe sikur ndjenja e çmuar e dashurisë të më lindte në zemër për ty, gjë që nuk mund të ndodhë kurrë, kurrë, në pellg lotësh dalgadalë do ta tresja. Sepse më shumë se Gentin tim, më shumë se mijëra Gentë, VENDIN E DIELLIT DUA, Diti. Atje kam lindur. Më është e dashur dhe e shtrenjtë çdo grimcë e dheut. Atje, o Diti, ka shumë diell, shumë kaltërsi.

— Po ky vendi im nuk të pëlqyeka, Atalanta?! S'gjendet më i bukur në botë...

— Jo, nuk më pëlqen, se vendi im i Diellit, Diti, më është më i bukuri, më i pasuri, më i shtrenjti, më i dashuri! E s'mund të mburresh Diti, se keni më shumë diell, më shumë dritë, ajër dhe kaltërsi.

— Ohu, t'i lëmë këto! Përgjigjmu më në fund! A do të martohemi së bashku? A do të vish me mua?

— Po të jetë kështu siç më thua, «zemra» jote duhej t'i përgjigjej «zemrës» sime. Siç e sheh, as «zemra» ime dhe as jotja nuk vezullojnë, nuk ndrisin, nuk rrahin për njëra-tjetren. Pra, ti, Diti, më gënjen! Shtiresh sikur më do, kurse ti je aq i ftohtë, aq i akulltë! Përse s'të rreh «zemra», Diti? Përse s'të ndizet «zemra» — llampë? Përse? Në qoftë dashuri e vërtetë ajo që më shfaq, duhej ta kishte ndezur e flakëruar atë «zcmër» — llampë, siç e kam parë t'i vezullojë Gentit tim të shtrenjtë, kur më shfaq dashurinë.

Prapë Diti heshti. Soni s'kishte mundur përsëri, të para-shikonte me përpikmëri gjer në fund, misionin e robotit të tij. Nokdauni i dytë, ishte edhe më tronditës, edhe më i tmerrshëm. Një e tillë goditje e papritur, shkatërrimtare, i dukej gati-gati një ëndërr e keqe, një makth cilitës në gjumin e shqetësuar të etheve. Ah, sikur vërtet të kishte qenë ëndërr??!

Lotë inati i mbushën sytë. Si i çakërdisur iu afroa aparat televiziv me ngjyra. Grushti i fortë i Sonit thërmoi sa të hapësh e të mbyllësh sytë, portretin e ngrirë e të budallallepsur të Dtit dhë buzëqeshjen triumfatore të roboteshës Atalanta, që e vështronë ëmbël mc sytë e xhamtë, të bukur e të kthjetë, si qiejtë e Vendit të Diellit.

Thërrimet e ekranit televiziv, si ëndërrat e çikërruara të shkencëtarit Soni, u shpërndanë në dyshemenë plastike shumëngjyrëshe dhe atij iu duk, se grushti i tij i fortë, arriti të godiste robotin ngadhnjimtar, pjellën e dashur.

Soni filloj të ngashërej e të thoshte me vete:

«Diti im i shtrenjtë, si e pësove kështu? Ç'qe ky mbarim i trishtuar?!... Vdekja e cilit nga ne të dy ishte në fund të fundit? ... Të goditën ashpër, por të paktën ti nuk ndien, s'kupton gjësendi. Ti o Robi, s'ke «zcmër». Po unë a kam? Gjersa po qaj, duhet të kem një zemër, apo jo Diti? Po ç'zemër është ajo? Vallë i ngjan zemrës sate që nuk rreh, që nuk vezullon? Folë, folë, de!... Kush, gjer më sot, e pa vezullimin e zemrës sime? Cili, Diti? Po të pyes, Diti! Përgjigjmu!»

Si i çmendur, ai vështroi çikërrimat e thërmuar të ekranit televiziv dhe filloj t'i mblidhte me dhimbje, si të ishin koskat, mishi dhe gjaku i pjellës së tij të adhuruar, dhe qante, qante...

* * *

Komisioni i posaçëm ndërkombetar u detyrua të mblidhej përsëri, atje ku disa ditë më parë u zhvillua ceremonia madhështore e dorëzimit të kupës dhe e shpalljes së Ditrobit, president i shoqatës së robotëve.

Triumfi i robotëve të Vendit të Diellit ishte i jashtëzakonshëm. Vendet e tjera nuk mund ta kalonin në heshtje këtë të papritur të madhe shkencore... Dijetarë të njohur botuan deklarata të shkurtra, me shprehje të kursyera e të përmbajtura, ku përshëndesnin krijimin e robotëve më të zhvilluar, por se në deklaratat e tyre, si gjithnjë, nuk e harruan Ditin. Sipas mendimit të tyre, robotët e Vendit të Diellit nuk mund t'ia errësonin shkëlqimin dhe as ia ulnin vlerën zotit Ditrobi. Ai qe vërtet një robot fare i pandjeshëm, por në fund të fundit, përsë duhet të ndiente?...

Megjithatë, sa më shumë orvateshin shkencëtarët e vendeve të mëdha t'ua ulnin vlerat robotëve të dashuruar, aq më e madhe bëhej kureshtja e publikut për t'i njohur nga afër (publiku ishte mësuar të gjente të vërtetët në të kundërtat e deklaratave të bujshme, ashtu siç ishin mësuar stërgjyshërit të mirrin çadrat me vete, kur stacioni meteorologjik jepte siguri të mëdha, se koha do të ishte shumë e mirë, plot diell e ngrohtësi.)

Kështu që komisioni i posaçëm ndërkombetar u detyrua të rishikonte vendimin e tij. Pas shumë e shumë debatesh të ashpra, u vendos që në podiumin e nderit të hypnin edhe robotët e dashuruar, por jo në vendin e parë. Komisioni s'do t'ia le jonte vetes këtë pakujdesi, që hapte telashe. A mund të fyhej dinjiteti i kombit të madh, shkenca e të cilit mburrej me një supremaci shekullore!?).

Roboteshës iu propozua të ngjitej në vendin e dytë, kurse Gentit në të tretin (vendosja qe e ngjashme si në garat olimpike).

Ceremonia protokollare u zhvillua në sallën më të madhe të ekspozitës, të mbushur plot e përplot. Mizëri njerëzish e aparatësh.

Nën tinguj marshesh të njohura, shoqëruar nga koka shkencëtarësh të vendeve të ndryshme, robotët u drejtuan për nga podiumi i nderit.

Një anëtar i komisionit të ekspertëve përmendi me zë të lartë emrin e Ditrobit, si rifitues të vendit të parë. Nën ovacione të forta e thirrje entuziaste të disave dhe në mes kundërshtimesh e fishkëllimash shurdhuese të masës së gjerë, Diti ungjitet në pikën më të lartë të podiumit. U përmendën emrat e robotëve të Vendit të Diellit dhe salla u duk se do të shembet. Entuziazmi s'kishte të përshkruar. Duartrokitjet, thirrjet, vazhduan plot njëzet minuta. Robotët buzëqeshnin (aq sa mund të buzëqeshë një robot) dhe përshëndesnin me duar publikun.

Roboteshës iu propozua përsëri të zinte vendin e dytë të podiumit, por ajo e vendosur nuk pranoi dhe shtrëngoi më fort krahun e fuqishëm të shokut, si të trembej se mos e tërhiqnin me forcë...

Gentit iu propozua të zinte vendin e tretë, por roboti s'u tund, si të mos kishte dëgjuar gjësendi.

Plot dinjitet, të kapur dorë për dore, qëndruan përparrë podiumit, pa zënë asnjë nga vendet e propozuara. E emocionuar, salla buçiti përsëri nga thirrjet dhe ovacionet e forta.

Robotët po sfidonin padrejtësinë. Organizatorët preferuan të mos shtyheshin më tej, përndryshe diskreditimi do të ishte i pashmangshëm.

Kryetari i komisionit të ekspertëve, i ridorëzoit kupën e artë Dtit, i buzëqeshi dhe i shtrëngoi fort duart. Njëqind mikrofonë dhe bloqe gazetarësh e korrespondentësh të radiotelevizioneve, iu afroan sakaj gojës së tij të madhe kur ai i tha Dtit:

— Inderuar president i shoqatës së robotëve, kupa e artë, mbetet juaja! Vlera e saj, është shumë modeste, këtë ne si shoqatë e dimë mirë, përparrë diturisë suaj për t'ia pasur zilinë dhe që s'ka të çmuar. I lutemi zotërisë, të na falë për shqetësimet që u detyrua të përballojë këto netët e fundit, pa dëshirën e tij, dhe sigurisht edhe tonën.

Pastaj, kryetari, me buzëqeshje falso, iu afroa me kupën e argjendtë roboteshës Atalanta dhe robotit Genti.

— Inderuara roboteshë! — iu drejtua ai Atalantës. — Nata që shkoi ishte një provë e vështirë, shumë e vështirë për ju... Një robot i shquar shkencëtar, si Ditrobi, iu ofroi dojen e tij. Ju e treguat veten një roboteshë me dinjitet dhe per-

sonalitet tē veçantë. Komisioni ynë ndérkombëtar vendosi t'ju nderojë me një kupë tē argjendtë simbolike!.

Dy duart e fishkura, që mbanin kupën, duke u dridhur, tē pasigurta, u zgjatën pér nga robotesha, por ajo s'e hoqi krahun e saj nga krahu i shokut. Sytë e qelqtë, tē vëmendshëm c tē zgjuar, vështruan ngultazi burrin plak. Pastaj ajo i tha:

— A jeni i martuar, zoti...?

— Zoti Terni! Terni quhem...

— A jeni i martuar, ju, zoti Terni?

— Po, po... — buzëqeshi plaku, ndërsa ngrinte supet, pa kuptuar pérse i drejtohej ajo lloj pyetjeje. — Po pérse më pyesni?

— Është e ndershme dhe besnikë zonja juaj?...

— Oh, sigurisht, s'ka si tē jetë ndryshe! — buzëqeshi plaku. — Tërë jetën, një jetë tē tërë, e kemi dashur njëri-tjetrin. E kemi dashur shumë.

— Atëherë, zoti Terni, mbajeni më mirë kupën e argjendtë pér tē ndershmen, besniken dhe tē mirën, gruan tuaj.

Salla shpërtheu në tē qeshura dhe në duartrokitje inkurajuese. Plaku, i zënë ngushtë, buzëqeshi me pahir, duke u përkulur lehtë përpara roboteshës, si t'i thoshte «Si tē dëshironi, si tē dëshironi, robotesha Atalanta. Më ndjeni, më ndjeni!».

Dikush, me nxitim i dha shenjë drejtuesit tē bandës dhe muzika gjëmoi, ndërsa flamurët kombëtarë ngjiteshin ngadalë drejt kupolës së shkëlqyer tē ekspozitës. Flamuri i Vendit tē Diellit shkëlqente si dielli vetë e më madhërishëm nga tē gjithë.

* * *

Shkencëtari Soni, priti një copë herë, gjersa në daljen e ekspozitës u duk shkencëtari i ri i Vendit tē Diellit.

— Më falni zotëri që ju ndaloj, por kam dëshëruar prej kohësh tē bisedonim së bashku. Jam shkencëtari Soni (shkencëtarit tē vendit tē diellit iu duk se në vend tē tij u prezantua Ditrobi: «Jam Diti, Ditrobi, s'e keni dëgjuar?»). Krijuesi i robotit Ditrobi!

— Ju njoh, zoti Soni. Shumë njerëz ju njohin.

Soni buzëqeshi i kënaqur, pa i rënë në të ironisë së hollë të shkencëtarit të Vendit të Diellit.

— Para së gjithash, zoti...

— Ilir Arbëri quhem.

— Ah, zoti Arbër, ju përgëzoj për pjellat tuaja aq simpatike!

— Faleminderit! Unë gjithashtu ju uroj për Ditin tuaj, jo më pak tërheqës e simpatik. Por përgëzimet tuaja nuk më takojnë vetëm mua. Ato iu përkasin gjithë shkencëtarëve të vendit tim.

Një copë herë ata të dy ecën pa këmbyer fjalë. Ceremonia e zakonshme e prezantimit dhe e shprehjeve të bukura të etikës së njohjes, kishte mbaruar. Shkencëtar i Vendit të Diellit, vriste mendjen, se ç'e kishte detyruar shkencëtarin Soni t'i dilte përpara. Nga ana e tij, Soni, vriste mendjen se në ç'mënyrë t'ia hapte bisedën shkencëtarit të Vendit të Diellit...

Iliri pa me bishtin e syrit. Në duartë e shkencëtarit Soni vërejti një kuti metalike të shndritshme.

— Zoti Arbër, — e theu heshtjen Soni — më ka pëlqyer gjithnjë të jem i sinqertë me njerëzit. Edhe pse jeni një nga konkurentët e mi më të fortë, do t'ju them, pa fshehur asgjë të vërtetën, që flet kundër meje. Merreni këtë kuti!

— Mos është ndonjë minë, zoti Soni? — vërejti me dinakëri Iliri. — Kur një i huaj na ka folur me «zemër në dorë», jemi mësuar gjithnjë të presim të këqia. «Sinqueriteti i madh» i të huajve, na ka fshehur prapaskena kërcënuese.

— Zoti Ilir??

Toni i Sonit tingëlloi vërejtës dhe i pakënaqur.

— Më falni Soni, por ky është konkluzion i historisë sonë shekulllore dhe më pëlqen t'jua bëj të njohur. Ju i njihni pak historitë e popujve të vegjël. Por s'dua të bëj aluzion për «sinqueritetin» tuaj. Ju jeni shkencëtar. U kam besuar gjithnjë kollegëve me atë besim që të sëmurët maniakë pinë vetëm aspirina «Bayer».

Iliri e mori një duar kutinë. E hapi me delikatesë dhe shtangu i habitur. Në kadifenë e kuqe të shndritshme të kutisë, ndodhej një zemër artificiale.

— Është zemra e robotit tënd, e Gentit! Dhashë fjalën përpara miliona njerëzve, se Diti im do të kishte një zemër brenda dy ditësh dhe ia gjeta atë. Një natë të vonë...

— Më lejoni ta vazhdoj unë historinë e asaj nate, zoti Soni. E pra, një natë të vonë, kur gjithçka flinte në ekspositë, një mjeshtër vjedhës, në mos gaboj, asistenti juaj, kaptoi kangiellat e eksponatit të vëndit të vogël dhe i vodhi robotit tim zemrën! Robotesha lëshoi një klithmë, klithmën e alarmit. Vjedhësi i zemrave s'e priste këtë. Iu hodh së shkretës roboteshë në grykë dhe si të ishte njeri, i futi një shuk cohe në gojë. Robotesha klithi përsëri. Zëri i dilte nga çdo pore e trupit metalik. S'kishte lindur tamam njeri. Nga jashtë kangjellave të eksponatit, dikush në errësirë, dha një udhëzim të vlefshëm. Vjedhësi, mbylli një çelës në ije të roboteshës për ta bërë të mbyllë «gojën» një natë të tèrë. Duke mos e ndier veten akoma të qetë, e lidhi atë. Pastaj iu kthye robotit, që flinte. U kujdes t'i mbyllte edhe atij gojën, përpara se ta «operonte», pa ndier dhembje.

— Vjedhësi qe, siç thatë, asistenti im. Udhëzuesi, ishte, kuptohet lehtë... — foli me gjakftohtësi Soni.

Këtë gjë e kam ditur më parë, zoti Soni; robotesha ju fotografoi përpara se të vepronit. Nëse dëshëroni t'i shihni, mund t'u ja... — tha, ndërsa fuste dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës, prej nga nxori një zarf të vogël.

— Këtë s'e kisha parashikuar! — tha Soni, ndërsa shihte i habitur njérën fotografi pas tjetrës. — Mos keni synuar t'i përdorni në të ardhshmen si robotë spiunë?!

— Jo!... Veçse i kam mësuar si të vetë mbrohen. Janë robotë të thjeshtë, me «dashuri» në zemër, që lindën për t'u shërbyer njerëzve në punëra të ndryshme, të dobishme.

— Mos ma merrni për të keq shakanë! — nxitoi të justifikohej Soni. — Pjellën tuaj mund të them se e kam njojur aq mirë, sa edhe Ditin tim. Ata m'u imponuan mua dhe publikut me virtuozitetin e tyre. (Toni i Sonit ndryshoi papritur. Fytura i mori çehren e njeriut të pikëlluar, që e mundon vazhdimiشت diçka). Më flisni hapur, siç ju fola gjer tanë, përse Ditit tim nuk i rrahu «zemra» për roboteshën Atalanta dhe as ajo s'iu përgjigj me rrahjet e «zemrës» së saj, megjithëse roboti im mbante në gjoks «zemrën» origjinale të robotit Genti?

— Kurse për çudi, ndonëse me «zemër» të kopjuar e të riprodhuar prefekt nga ju, Genti përsëri ishte në gjendje t'i përgjigjësht në dashurinë e saj, roboteshës Atalanta?! Padyshim, këto gjëra ju habisin, zoti Soni?

— Sigurisht që më habisin. Vallë, mos ju i keni telekomanduar në veprimet e tyre?

Shkencëtar i Vendit të Diellit vuri buzën në gaz.

— Duhej të isha torturuar për gjumë, i dashur Soni!

— Çfarë?! — vërejti Soni, duke mos e kuptuar.

— Desha të them, se një telekomandim i tillë është absurd, i kotë dhe i pavlerë... Në një rast të tillë, njeriu duhej të bëhej dadoja e palodhshme e robotit. Robotë të tillë duhej ta ndienin veten kriesat më fatkeqe e më të pavlera të botës, pse jo edhe krijuesi i tyre? A është e mundur t'u parapri shqip në të gjitha veprimet?

— Ju akoma s'i jeni përgjigjur pyetjes sime. Përse robotësha s'i përgjigj «dashurisë» së robotit tim, Ditit, megjithëse ai kishte «zemrën» e robotit Genti? Vallë, dikush e telekomandoi roboteshën dhe e urdhëroi të mos i përgjigjej në dashurinë e tij?

Përsëri shkencëtar Iliri qeshi.

— Kaq shumë i bindur qenkeni në «trukun», që ju paskam organizuar?

— Po! Më shumë se i bindur...

— Keni dashuruar ndonjëherë?

— Ah, jo! Kam dashuruar si i marrosur shkencën. Llojtjetër dashurie s'kam njojur në jetën time.

— Më falni, po jua përsëris: Keni dashuruar ndonjë vajzë?

— U thashë, zemra ime ka rrahur për shkencën. Dashuria e njerëzve është e përkohshme. Dashuria për dijen është e përjetshme. Nuk njeh mort!

— Ahere, zoti Soni, a qenka e mundur që krijuesi t'i japë pjellës së vet dashuri njerëzore, kur ai vetë s'e ka njojur atë?

— Ç'doni të thoni?

— Pjella juaj, Diti, qe dënuar që në zanafillën e vet të mos e njihte dashurinë, se atë s'e njihte as edhe krijuesi i saj... Duke kujtuar, se dashuria e vërtetë lind në zemër, ju ia vodhët atë robotit tim dhe unë jua «lejova», sepse këtë e prisnja... Premtuat t'i bën fit Ditit një zemër perfekte brenda disa ditësh, një zemër për të cilën unë punova vite të tëra. Porse trurin e tij bio-elektronik, organin e ndjenjës së madhe, të dashurisë së vërtetë, s'do t'ju lejoja ta shtinit kurrsesi në dorë.

Nëse ju do t'i merrnit atij edhe trurin, pjella juaj s'meritonte më të quhej Diti. Ai do të ishte vetë Genti im!

— Pra, zemra-llampë ndizej në sajë të impulseve lëshuar nga truri bio-elektronik?

— Sigurisht! Ndaj dashuria e tyre dukej si e «vetëdijshme», e «natyrshme» dhe e «zjarrtë». Megjithatë Soni, ndonëse robotët janë aq të avancuar, në fund të fundit ata do të mbeten gjithnjë makina. Dua të them, zoti Soni, se sado t'i perfeksionojmë, sado «zemër» e «shpir» t'u japim; kurrën e kurrës s'kanë për të zëvendësuar plotësisht jo më njeriun, por as kanë për t'iu afruar atij...

— Edhe njeriun primitiv?

— E dija mirë, zoti Soni! Bindjet e Ditis ishin bindjet tuaja. Padashur u shprehët si Diti, kur pretendonte të kishte më shumë të drejta nga ç'kanë zezakët, duke e vënë veten mbi njerëzit...

— Diti im, megjithatë, vlen më shumë se ata...

— Zoti Soni, edhe njerëzit më primitivë fshehin mundësi të pashtershme zhvillimi e riprodhimi. Le t'ua ndryshojmë kushtet dhe ata do të bëjnë mrekulli! Kurse robotët janë, mjeshtë, janë të dënuar që në lindje të mbeten makina e asgjë më. Le t'i vëmë në shërbim të njerëzve dhe misionin tonë le ta konsiderojmë të kryer...

— Pra, edhe ju hiqni dorë nga përpjekjet tuaja për të krijuar robotë-njerëz?

— Ky emërtim s'është bërë kurrë ngâ ne! Makinat mbeten makina. Të «ndjeshëm», siç i duam të jenë, do të shërbejnë më me aftësi e përpikmëri në fusha të ndryshme të shkençës e të prodhimit; do të jenë më të pavarrur, më të ndërgjegjshëm në kryerjen e detyrave delikate, më me «sedër», e më të «ndjeshëm».

Pra Diti s'do të realizojë kurrë ëndërrën tîme? Ai s'do të bëhet kurrë një robot-njeri?!

— Ju Soni, mund ta bëni atë çfardo, një vrasës robot, një spiün robot, një vjedhës robot. Milionat tuaja mund ta bëjnë gjithçka pjellën tuaj, por njeri?! Kurrë jo!

— Po nëqoftë se më shisni zemrën dhe trurin bio-elektronik të robotëve tuaj? Shtoi këtyre dijet e mrekullueshme që zotëron Diti im, a mund të thuash se ai s'do të ndryshonte nga

shumica e të rëndomtëve njerëz, e më të thjeshtëve njerëz??

Shkencëtar i Vendit të Diellit e vështroi si ndër ethe. Ju bë se në vend të Sonit, i qëndronte pranë roboti shkencëtar, Ditrobi. Po, po, që tamam ai. Po ajo shprehje metalike dhe e ftohtë e fytyrës. Po ai zë. Një kopje besnike e të zotit.

— Ju jeni zoti Soni, apo...

— Oh, po natyrish që unë jam! Cili mund të jetë tjetër?

— Çudi! M'u bë se përpara meje ishte pjella juaj, Diti! Mendime të tilla mund të ketë vetëm ai. Thomëni të vërtetën, ju jeni shkencëtar i Soni??!

Shkencëtar i Vendit të Diellit u drodh lehtë, si i përmendur nga një ëndërr e shqetësuar. Vuri dorën në ballë. E shqetësonte ai njeri.

— Zoti Ditrobi, Soni desha të them, më ndjeni, nuk ndihem mirë. Po shkoj!

— Nuk m'u përgjigjët! Do të ma shisni trurin bio-elektronik të robotëve tuaj? Do t'ju japim miliona. Në vendin tuaj të vogël dhjetë jetë shkencëtar i s'do të mjaftonin për të fituar kaaq. Më shisni patentën, zoti Ilir!

Shkencëtar i Vendit të Diellit vështroi me përgëmim Sonin pa e hequr dorën nga balli. Qëndroi një copë herë ashtu pastaj priti taksinë. Një makine u ndal pranë tij. Hyri, duke u përkulur në derën gjysmë të hapur.

— Në agjensinë e aeroplani! — tha ndërsa ulej në sediljen e pasme.

Nga pasqyra e rrumbullakët pa zotin Soni me duar në xepa, që kishte qëndruar me këmbë të hapura në një pozë kërcenuese.

Shumë makina erdhën pas tij. Zoti Soni i humbi nga sytë. Shkencëtar i Vendit të Diellit mori fryshtë i lehtësuar...

* * *

Aeroplani nisej të nesërmën më ora dhjetë. Ai shkoi në eksponat dy orë më parë. I bëri përshtypje turma e madhe e njerëzve të grumbulluar në eksponatin e tij. Parandjeu diçka të papërcaktueshme, por të papëlqyeshme. Nxitoi hapat. Pastaj nisi të vaponte. Ciceronia e bukur e eksponatit të tij e pa nga

larg dhe u mundua t'i dilte përpara. Dukej e tronditur, e frikësuar.

— Zoti... zoti...
Ai s'dëgjoi gjë. U vërsul drejt grumbullit të madh të injerzve, që shtyhesin plot zhurmë e rrëmujë. Krahët e fuqishëm të policëve trupmëdhenj orvateshin t'i imbanin jashtë kordonit të bardhë, që kufizonte vendin e ngjarjes. Makina me shënimin e veçantë e të njohur «Police» qenë rreshtuar njëra pranë tjetrës. Një polic gjigant e ndaloi edhe atë.

— Jam... (për pak sa nuk tha «i Ati») Ja konstruktori i tyre...

Polici vështroi komisarin, që ndodhej pak hapa më tutje.
Ai i dha shenjë me sy.

— Kaloni! — tha shkurt polici.

— Oh! — ai mbylli sytë plot dhimbje.

Një përg hekurishtesh e asgjë më nga robotët e tij.

— Cili, cili e bëri këtë?! — pyeti i indinjuar. — Thomëni, thomëni, kush e bëri këtë?!

U ul më gjunjë mbi grumbullin e hekurishteve. I mori në duar, si të qenë relike të paçmuarëshme. I puthi.

— I kanë minuar! — tha me gjakftohtesi komisari i policisë. — Janë gjetur shenja të dukshme të një mine të vogël, të fuqishme... Tek cili dyshoni? Cili mund ta ketë bërë?...

— Dikush ka dashur t'u vjedhë trurin e tyre, mendimet, bindjet... Hajdutët zhvidhosën vidën e parë, pastaj të dytën, të tretën mandej... ata s'e kishin parashikuar... shpërthim, flakë, tym...

— Pranë robotëve gjetën edhe një trup pa jetë. Eksplozioni ka qenë i fortë, — vërejti komisari, që nuk shikonte ndonjë arsyё t'i fshihej shkencëtarit, i cili, aq papritur e lehtë i zbuloi të vërtetën.

— Cili qe? Asistenti i Sonit?

Komisari shqeu sytë nga habia.

— Jua thanë?

— E mora me mend... Kjo duhet të qe finalja, fundi i një historie, që s'mund të përfundonte ndryshe. Merrini! Tani s'më duhen.

Komisari mori fotografitë e jashtëzakonshme në duar.

— E ka fotografuar Atalanta, kur i vodhën Gentit zemrën.

— E pabesueshme, e shkëlqyeshme, zotérinj! Sikur robotë tē tillë tē viheshin në shërbimin tonë, do tē bënин mrekulli!

— Atyre kanë dashur t'u vjedhin «zemrën», «mendjen», zoti komisar! — ngulmoi shkencëtar Iliri. Nuk ju shqetëson ky fakt?

— T'i lëmë këto, zoti Iliri... A s'ju duket se kemi rast tē mirë pér tē biseduar pér një çështje shumë tē leverdissħme pér ju?

Ciceronia u afrua. Prapa saj vinin tre punëtorë me një arkë tē re, tē madhe e tē rëndë. Arkën e lanë pranë pиргут tē madh, që shembellente me një muranë tē freskët.

— Ngarkojeni! — tha shkurt shkencëtari i Vendit tē Dicillit me zemër tē dredhur.

— Kaq keq ju vjen?! Ju mund tē bëni modele tē tjera. Një çështje skeme, tē cilën ju tanimë e zotéroni mirë... — tha komisari.

— Më shpejt, më shpejt! — iu drejtua shkencëtari punëtorëve tē ngarkimit.

Arka u mbush dhc ata e mbérthyen. Çdo gozhdë e re mbi dërrasën e fortë, gjëmonte fort. Me nxitim, mbi arkë, me shkronja tē kuqe (shkencëtari e dëshiroi tē kuqe e jo tē zezë, siç iu propozua) dikush shënoi adresën e shkurtër «VEND I DIELLIT»... Shumë njerëz tē thjeshtë e ndihmuant ta ngrintc mbi kamion arkivolin e madh. Disa syresh mbushën sytë si tē përcillnin kufoma njerëzish e jo më robotë.

— E tillë dashuri s'qe parë e dëgjuar ndonjëherë! — foli duke u ngashëryer ciceronia. I desha e më donin shumë si tē qenë fëmijët e mi, kurse tani po i përcjell «eshrat» e tyre në vendin e vogël e tē largët tē Diellit. A s'të vjen tē qash?

Shkencëtari i ri mezi u ngjit në kabinën e lartë tē kamionit, i ndihmuar nga tē tjerët. Shoferi ia mbylli derën përbri. Sytë e mjergulluar tē Ilirit vështruan përtej xhamit kureshtarët, që afroheshin me vrapi në vendin e ngjarjes.

— Zoti, zoti Ilir! Sidoqoftë, mos harroni çka ju thashë. Do tē pasuroheni! Do tē jeni më i pasuri njeri i vendit. Në do tē porosisim qindra robotë tek ju, mijëra robotë. Robotë policë, zoti shkencëtar!

Shkencëtari s'iuh përgjigj. Komisari trokiti në xhamin e mbyllur.

— Zoti Ilir! Zoti shkencetar, a me dëgjuat?

Komisari u zgjat edhe me shumë.

— Nisu! — foli prerë shkencetari.

Si e lodjur, e pikelluar, makina u nis. Dora e madhe e komisarit rrëshqiti një copë herë nëpër xham, pastaj u lëshua si e këputur.

Qindra njerëz të thjeshtë hoqën kapelet.

Qindra duar e përshëndetën.

Makina çau përpara, drejt aeroportit.


Muret e gjata, fasadat e larta, qenë mbushur me portret e mëdha të robotëve vëndas, triumfatorët e ekspozitës «Progres». Shkencetari i vështroi me përcëmim fytýrat krenare e fodulle të makinave të përsosura.

— S'u kanë lënë gjë mangut; zotërinjve të tyre! — tha.

Nga shtëllungat e hirta të reve doli një çast dielli. Rrëzat u ranë në sy. Shoferi nxitoi të ulte strehën. Shkencetari s'e bëri këtë. Qe mësuar me diellin. Në vendin e tij kishte aq shumë diell, aq shumë kaltërsi. Buzëqeshi. Me vete, thirri gjithë shpirt: «O DIELL, DIELL, o burim jetëdhënës... O Vend i bukur i Diellit! Pritna! Nc po vijmë. Po vijmë të trc, të tre... Unë, shkencetar Iliri, Atalanta dhe Genti. Edhe të vdekur, edhe të copëtuar, edhe pluhur e hi, o vend i diellit, NE KTHEHEMI prapë te ti, vend i vogël i dashurive të mëdha!».

Dielli u fsheh përsëri prapa reve të hirta, e prapë shkencetarin e ri e mbuloi trishtimi.

Makina shkiste me shpejtësi në autostradë. Sytë e lodjur iu rënduan edhe me shumë. I mbylli një copë herë. Fjeti... Buzëqeshi në endërr. Sigurisht AI SHIHTË DIELLIN.



AI S'E PA GJER NË FUND FILMIN «BONIFACI SOMNAMBUL...»

(«KUJTO! MOS HARRO!». Kjo ishte porosia e Komitetit Qarkor të Tiranës në traktin «4 Shkurt», botuar e shpërndarë pas ngjarjeve të përgjakshme të Shkurtit 1944.)

Ishte mbrëmje e ngrohtë vere. Rruga e ngushtë përpëra kinemasë ishte e mbushur me njerëz që prisnin mbarimin e filmit.

Një djalë vazhdonte t'i binte në mënyrë monotone dhe të besdissime derës së drunjë dhe herë pas here mirre si përgjigje paralajmërimet kërcënuese të portierit të kinemasë: «Shiko, se po të dola, do të më njohësh mirë cili jam!»

Por ai, si portier me stazh, natyrisht s'mund ta bënte një gabim të tillë të pafalshëm. Sapo të hapte portën, rryma e njerëzve të grumbulluar do ta përfshinte fare lehtë, si një pendë dhe lumi i papërmabjtshëm i njerëzve do të vërvshonte brenda.

E mund të mirret me mend, se ishin bash spektatorët pabitë, që krijonin herë këtu e herë atje, ishuj të vegjël në detin e njerëzve, e që duke zgjatur me gulçim e këmbëngulje duart c' të hollat mbi kokat e të tjerëve, gati ia merrnin frymën atij që kishte ndonjë biletë të tepërt dhe donte ta shiste.

Centrifugë zérash që rrrotulloheshin me gjëmim rreth kokës tashmë të hutuar e tepër të çuditur të shitësit të rastit të biletës, duar e gishtërinj që i kërcënonin ftyrën dhe sytë.

Aleksi kishte qëndruar me shokun e tij në trotuarin e vogël e të ngushtë. Përpëra tyre një çift të porsamartuarish s'pushonin së biseduari e së qeshuri duke krijuar rreth tyre një atmosferë gazmore e tepër intime. Dukej sikur lumtëria e tyre

shtrihej rrreth e qark duke i bërë edhe të tjerët t'i shikonin me një farë zilie e malli dhe të harronin minutat që i ndanin nga fillimi i shfaqjes.

Më në fund, dritat e jashtme u hapën. Zhurmës së njerezve që prisnin, iu shtua zhurma e spektatorëve, që dilnin nga dyert anësore të kinemasë verore.

Përpara portës kryesore u grumbulluan më shumë njerez. Tensioni i atyrc që ende s'kishin gjetur biletë, filloj të shtohej. Lëviznin me shpejtësi në drejtime të ndryshme, të gatshëm të pyesnin pa u lodhur çdo njeri që u kalonte pranë.

Aleksi i shtrëngoi krahun mikut.

— Hë, e sheh ç'kërkesa ka për biletë? Kurse ti, s'e kishe më qejf...

Burri tjetër qeshi.

— Me ç'qejf ta kisha, kur ti s'i dije as titullin? Pa le siku të më thoshc se cili aktor luan. Fernandeli më ka pëlqyer gjithnjë!

— M'i sollën në shtëpi, pa i porositur. Me sa po shoh, s'paskan bërë keq.

Aleksi qeshi dhe i shtrëngoi përsëri fort krahun.

* * *

Interesimi dhe pritia e ngrohtë që i kishte bërë publikun filmit «Bonifaci Somnanbul», ku spikaste veçanërisht loja mjeshtërore e Fernandelit, e detyruan drejtorin e kinemasë ta mbante në repertor gati një muaj. Herë pas here, në sallën vërone të kinemasë, nën kupolën e qilllit të errësuar të mbrëmjes, që dukej si i spërkatur nga mijëra yje të ndritshme, shpërthenin të qeshurat kumbuese e të papërmabjtura të spektatorëve.

— Bëmë mirë që erdhëm, — i pëshpëriti shoku Aleksit — genka, më tërë mend një film i bukur!

— Shumë i mirë! — iu përgjigj tjetri, ndërsa tundte kryet në shenjë pohimi, pa e hequr vështrimin nga ekranin. Buzagaz burri vështroi një copë herë Aleksin e dhënë me mish e shpirt pas filmit, mandej u përqëndrua përsëri në ngjarjet, që sa vinin e bëheshin edhe më interesante.

Por Bonifaci ishte një i sëmurë, një i përgjumur, një som-nanbulist. Kjo e papritur e shqetësoi burrin, i cili s'i kishte dhënë ndonjë rëndësi të veçantë titullit të filmit, duke menduar se, në fund të fundit, titulli nuk përligjet gjithëmonë nga përbajtja.

Autorët e filmit e kishin vënë qëllimi që Bonifacin në situata të tmerrshme, të rrezikshme, e njëkohësisht shumë qesharake, të cilat ai i kalonte me zhërvjelltësi të pashoqe. Ai ecte atje ku edhe sorkadhja do të kishte rënë me siguri, buzë strehës së një pallati shumëkatësh, mbi diskun e madh të një llampadari që varej nga tavani, në pàrvazat e dritareve, mbi tel, mbi një dërrasë të hollë, që lidhte dy pallate të larta, prej nga kalimtarët poshtë në rrugë, duken të vegjël, të vegjël, si miza dheu...

Burri u drodh. Marnica rrënqethëse i përshkuante shtatin, si një rrymë e dobët korenti.

Bonifaci, veshur me pizhama, i përgjumur, me duar të zgjatura drejt përparrë gjoksit, ecte dalngadalë mbi një çati shumë të pjerrët.

Burri mbylli një çast sytë. I hapi përsëri. Bonifaci vazhdonte udhën përgjumësh, në shtegun e pjerrët, buzë zgripit dhe humnerës së natës. Papritur, ekrani iu zbardhëllua (si një film i këputur)... Mbi pizhamatë e Bonifacit, si në një mult, u shkruan me të shpejtë, njëri pas tjetrit, gjashtë shifra 635.478. Fytyra iu transformua çuditërisht, iu zvogëlua, iu tret, iu bë kockë c lëkurë. Skeleti vuri mbi kokë një kapuçetë të rrumbullakët, të vijëzuar. Fantazma zgjati duart drejt përparrë gjoksit dhe nisi të çapise.

Ishtë natë e ftoshë dimri.

Rojet gjermane ndezën befas prozhektorin. Tufën verbuesë të rrezeve ia hodhën në fytyrë një të internuari, i cili atë orë ecte në oborrin e kampit të përqëndrimit. I internuari vazhdoi të çapiste drejt tyre.

— Halt! Halt!

Eshtë një i sëmurë! Një i sëmurë! Bonifaci eshtë i sëmurë! Bonifaci eshtë i përgjumur. Bonif...

Sirena ngjethëse e alarmit. Mijëra fytyra të verdha c të zbehta si drita e hënës, në dritare. Skeleti i vetëm në shesh... Fare i vetëm... Rojet, prozhektori dhe skeleti i bardhë, që çapit, çapit me duar të zgjatura drejt, përparrë vetes...

Burri psherëtiu thellë. Përqark važhdonin të qeshnin. Bonifaci ndodhej në një situatë qesharake. I përgjumur siç ishte, qe përleshur me një bandë hajdutësh dhe i kishte dërrmuar.

Burri u ngrys. Diçka, si një lëmsh, si një meduzë e vogël e shtrëngonte në fyt. Frymëmarja iu rëndua, mbi gjoks sikur i vunë një pllakë të rëndë mermeri të bardhë. Mbi pllakë ishte shënuar po ai numër, gati i përjetshëm, këmbëngulës gjer në torturë: 635.478.

Duke qeshur, Aleksi u kthye një çast nga burri. E qeshura, si një melodi e stonuar, i mbeti në grykë. Fytyra e burrit qe mbuluar nga bulëza djerse, sikur qelli të kishte derdhur mbi kanalet e ngushta e të gjarpëruara të rrudhave të ballit vesën e natës. Shoku iu duk i pezmatuar dhe i zbetë, si një i sëmurë.

«Atë po e kujton infarkti i vjetër» — mendoi me dhimbje Aleksi, duke i hedhur krahun lehtë dhe me dhimbshuri mbi sup.

— Nuk ndihesh mirë?...

— Ah, jo! S'kam gjë.

— Mos ke dhembje?

— Të thashë, asgjë s'kam. Por ky film po më bën një përshtypje të çuditshme, të jashtëzakonshme. S'më ka ndodhur kështu ndonjëherë.

— Dalim?

— Nuk mund të duroj më. Të lutem të më falësh.

Ata ngritën një rresht të tërë për të dalë jashtë. Portieri i kinemasë i përcollë me sy i habitur.

Prej tri javësh që luante ai film, ai u kishte hapur derën vetëm katër njerëzve: një gruaje të re me barrë, ngërthyer nga krizat e forta të lindjes, (natyrishët edhe të shoqit), një oficeri thirrur në alarm dhe një kirurgu.

Njëri nga burrat iu duk veçanërisht i zymtë dhe disi i zbetë. (Sytë e mësuar me gjysmerrësirën e zakonshme, mund të shquanin nuanca edhe më të holla). Dhe, kur tjetri i futi krahun që të mbështetëj, portieri besoi më në fund, se atë natë i kishte hapur portën një të sëmuri.

Në sallë qeshnin. Portieri nxitoi të mbyllte derën dhe u ul në një karrige portative, aty pranë.

E shihte për të tridhjetën herë atë film, por përsëri s'e mbante të qeshurën me mimikën aq të lezeçme të Fernandelit komik.

* * *

Ata u ulën në një bar veror. Burri e ndiente veten më mirë. Rrugët e mbushura me njerëz, grupet veçanërisht të gjezuar, të çiltëra të të rinxje që shëtisnin, e qetësuani disi.

— Hë, si e ndien veten tanë?

— Shumë më mirë.

— Po ç'pate ashtu? Mos nuk të pëlqeu filmi?

— Bah! Cili s'ë pëlqen Fernandelin?! Është aktor i mrekullueshëm...

— Edhe unë ashtu them. Gati s'më besohet që ka vdekur.

— Kështu më duket edhe mua.

— Po më thuaj, vërtet, përse ndryshove papritur? Filmi po të pëlqente, mos të kujtoi ajo e vjetra? — ngulmoi Aleks.

* * *

— Një ngjarje e vjetër, të cilën koha nuk është e zonja ta shlyejë nga kujtesa, edhe pse ka ndodhur tridhjet e ca vjet përrapa. Atje, në kinema, e pashë përsëri, fare të gjallë, sikur ta kisha përrpara syve. Për t'u habitur, Aleks, filmi më zgjoi edhe detajet më të vogla të ngjarjes që dremisnin prej kohësh në kujtesë...

Kampi, ti e di, ishte pothuajse internacional. Kishte të burgosur, nga të gjitha kombësitë. Na kishte bashkuar i njëjtë fat, kishim të njëtin ideal dhe e donim njëri-tjetrin, si të ishim të gjithë nga një vend i vetëm. Jeta e një kampi përqëndrimi ka shumë ngjarje, shumë. Njëra më tragjike se tjetra. Bota s'i harron kurrë, por s'di përsë, kjo që do të të tregoj më ka lënë një përshtypje të rrallë. Mbështetje nuk u ngjan të tjerave, me gjithëse fundi i të gjitha historive të kampeve të tillë është i njëjtë: — Ja kështuuuu! — burri pshëretiu, mori frysë thelle si për të mbledhur edhe më mirë veten. — ... Qe dimër dhe ngrysej shpejt. Brenda në kamp kishte nisur lëvizja e fshehtë. Fashistët, diç kishin nuhatur dhe kjo i kishte bërë më të kujdesshëm, më të egër. Qe dhënë urdhëri i prerë. Do të qëllohej pa asnjë paralajmërim mbi këdo që do të dilte jashtë barakës pas orës 17.00 S'kishim si të bënim ndryshe gjer në çastin e volit-

shëm, kur do të vepronim. E njihnim shtazérinç c tyrc. Ujqër të vërtetë. Çdo nevojë, paskëtaj, e kryenim brenda. E përfytyron lehtë, se ç'felliqsirë ishin bërë barakat tonë shkreta. Skëterrë! Sëmureshim vetëm nga ajri i ndotur, pa le të tjecrat. Ata që vdisnin, i tërhiqnin vetëm të nesërmend. Të gjithë, ç'është e vërteta, ia kishim frikën një djaloshi që duhej të ishte një zetvjeç. Emri i tij s'më vjen ndërmend. Veçse diçka dinim për të. Ndonësc i sëmurë, — vuante nga sëmundja c të dremiturit, somnambulizëm i thonë ndryshe) nuk mundi të durojë pushtimin nazist. Grupi i rezistencës, që vepronte në qytetin c tij të lindjes, duke ia njojur gjendjen e keqe shëndetësore, në fillim nuk e pranoi në radhët c tij, me gjithë këmbënguljen c dëshpëruar të djaloshit. Të riut i erdhi shumë rëndë (nga tronditja, ato netë, u ngrit më shpesh nga shtrati, i përgjumur). Nuk mund të pranonte gjykimin e rreptë të shokëve.

«Ç'do t'u them pas luftë fëmijëve të mi?» — i kishte pyetur më në fund ai dhe pa pritur përgjigje, kishte përplasur derën përpara ftyrave të shtangura, të menduara c të pavendosurë të shokëvc.

Një javë rresht, kreu disa aksione fill i vetëm, aksionc të guximshme, aksione të bujshme, gati-gati të pabesueshme (mund të kryheshin vetëm nga ekilibristë të përsosur c sypatrembur) që tronditën armikun. Ato i bënë përshtypje edhe grupit të rezistencës, i cili me gjithë përpjekjet, s'po binte në kontakt me grupin më të ri të lëvizjes partizanc, që sapo kishte dhënë shënjas para. Ranë në gjurmë vetëm pas pesë ditësh. Aksionet i kishte kryer vetëm një njeri, një i vëtëm. Djaloshi somnambul. Atéherë c pranuan në radhët c tyrc. Ndryshtë rrežikohej më shumë.

Disa muaj më vonë, djaloshin e zunë bashkë me pesë shokë, të tjerë të grupit. E torturuan çnjerezisht dhe gjendja c tij u keqësua së tepërmi. Ishte pothuajse gjithnjë në gjendje dremitjeje, ditë dhe natë. Pesë të tjerët i pushkatuan, kurse atë, një ditë vjeshte, e sollën në kampin tonë. Na habiti të gjithëve gjumi jo i natyrshëm i tij. Ashtu si Bonifaci, ai shkonte i përgjumur nëpër korridoret e ngushta e të pistës shtretërvë prej druri. Madje, disa prej të burgoşurve, që s'dinin ç'është kjo sëmundje, kishin një farë frike instiktive nga i përgjumuri, që shpesh shtrihej të flinte tok me ta, në shtretërit c tyre. Po na

shqetësonët diçka tjetër. Dy herë e kishim parë tek përpinqej të tertiqitë drurin, me të cilin zakonisht mbyllnim derikën e barakës. Sakaq, kishim brofur nga shtretërit dhe e kishim qetësuar. Por atë natë të ftohtë dhjetori, të raskapitur siç qemë nga puna e rendë e ditës, nuk e ndiem.

Pas pak, era e ftohtë e mesnatës, që frynte nga derikë e hapur dhe flokët e dëborës, që u përplaseshin në fytyrë, ua nxorrri gjumin atyre që flinin pranë hyrjes së barakës. Njëri syresh u ngrit. Tek mori drurin dhe bëhej gati ta mbyllte, dora iu lë shua poshtë si e këputur. Shtrati i somnanbulit qe bosh... Pas pak, u doli gjumi të gjithëve. U mbërthyem në dritaret e vokëla, të veshura me rrjetë. Atë kohë, ai qe larguar shumë, nga baraka jonë. Kishte lënë mënjanë postbllokun dhe qe drejtuar nga brezi i telave elektrikë. Rojet gjermane e vunë re, por nuk e qëlluan menjëherë. Ecja e shkujdesur, çuditërisht e qetë, jo e natyrshme, i çorientoj një çast vrojtuesit, që e ndiqnin nga kabina e lartë. Ata besuan se do të ishte ndonjë i burgosur, që kishte vendosur t'i jepte fund vetes në telat elektrikë, të cilët si përbindsha të padukshëm kishin shtrirë gjymtyrët gjembacë rrëth e rrotull kampit dhe e shtërgonin papushim. Tufa e rrezeve të bardha të prozhektorëve, e ftohtë, rrënqethëse, i qe ngjitur si njollë gjigante e ndritshme. Filluam të bënim zhurmë, të thërrisnim me të fortë, t'u binim dërrasave të barakës, që ta zgjonim. Njëri nga ne u mat të dilte, t'i shkonte në ndihmë. Por s'e lamë. Kështu mund të vdisnin dy vetë. Dy vdekje të sigurta...

— Eshtë një i sëmurë! Një somnanbul! Mos qëlloni! Ju flet një mjek! — u thirri në gjermanisht, një mjek i burgosur.

Nuk morëm përgjigje dhe zhurma u bë më e fortë.

Një nga prozhektorët e drejtuan nga barakat tonë dhe plumbat rrëzuan suvatë e mureve pranë dritareve.

Thirrjet e forta të rojeve, zërat tanë, zhurma që bënim, të shtënët, e përmendën disa çape larg telave elektrikë. U drodh. Pa e kuptuar i kishte vajtur vdekjes fare pranë. Tre hapa! Kurre s'kishte qenë kaq afër saj. U kthye me fytyrë nga rojet. Prozhektori e verboi. Mbuloi me bryl sytë. I thirrëm të gjithë të vepronë, t'u shpëtonte rojeve! Ai e kuptoi dhe filloi të vraponte; kur i mbarohej fryma binte në tokë, pastaj ngrivej sërisht e bënte zik-zake, por rrodhja gjigante e ndriçme s'i shqitej. Dukej si

kthetër e vdekjes. Lart në kabinë flisnin me zë të lartë. Dikush qeshi.

— Ata po tallen, — foli mjeku — dhe kjo s'më habit.

Somnanbulin e ndanin njëzet çape nga baraka. Tani i shihnim ftyyrën. Qe bërë ujë në djersë. Mezi merrte frymë, shpresonte. I hapëm derën. Shtrirë siç qe, me sytë e bukur vështroi nga ne.

— Do t'u shpëtoj: Ja, do të shihni! — foli dhe u ngrit sakqaq nga pellgu i baltës ku qe shtrirë.

S'e ndanin veç disa çape nga dera e hapur dhe e qëlluan. Vdiq në vënd... Kufomëne ndriçuan tërë natën. Donin të na torturonin kështu. E tërhoqëm ndaj të gdhirë dhe e shtrimë në shtratin e tij. Të gjithë me radhë i vajtëm pranë.

Ja pse u mallengjeva në kinema. M'u kujtua djaloshi somnanbul... Në vënd të Bonifacit qesharak e zbavitës, shihja të burgosurin numur 635.478, «pizhamat» e tij me vija të kampit, kapuçetën e rënë pranë telave, dhe s'më qeshej më, ndonëse ailuan aq bukur, ndonëse si aktor e kam dashur gjithnjë dhe cdua.

— Qenka nga ato ngjarje tragjike të luftës, që nuk harrohen kurrë! — foli Alkesi rënë në mendime...

— Harrimi është mosmirënjohja më e madhe që mund t'u bëhet të rënëve në luftë për liri. Ndaj edhe popujt nuk i harrojnë kurrë, ndaj ata s'duhet kurrë t'i harrojnë! Hm, e habitshme, Leksi, jeta i sugjeron njeriut paralelizma interesante. Bie fjala, shembulli i somnanbulit, për të cilin të tregova, është kuptimplotë...

Por Leksi ngriti supet, duke dashur të thoshte më këtë, si ishte shumë shpejt për ta pohuar një gjë të tillë, të paktën ai vetë.

— Pak durim dhe do të më japësh të drejtë... Sëmundjet mjekët i ndajnë në të «lindura» dhe në të «fituara», dome-thënë të marra gjatë jetës... Kështu, për shembull, somnanbulisti i kampit të përqëndrimit lindi i tillë, pra i sëmure. Por ai nuk qëndroi sehirxhi dhe sëmundjen nuk e quajti as «arsye», as justifikim, për të qëndruar mënjanë, tamam në ato çaste tronditësc kur miliona të pafajshëm korreshin nga kosa fashiste, kur foshnjat piqeshin në zjarrin e luftës, kur barget e shtatzënavë, shpoheneshin mes për mes nga bajonetat e fashistëve, kur mijëra vetë

digjeshin në furrat e vdekjes të përbindshave. Si një përmendo-re e vërtetë flijimi, ai u ngrit mbi sëmundjen, mbi fatkeqësinë e tij dha gjakun, jetën, më të shtrenjtën gjë. Veçse, një mjeq më thoshte, se po thuaj të gjitha sëmundjet «fitohen», merren gjatë jetës. Foshnjat lindin gjithnjë të shëndosha...

— Për besë, unë s'po të kuptoj, ç'hyjnë këtu sëmundjet?! — E ndërpren Alkesi disi i çuditur.

— Leksi, njerëzit në botë, kudo, ngado që të jenë, sot më shumë se kurrë, nuk duhet të harrojnë rrezikun e madh të rilindjes së bishave fashiste... Njerëzit nuk kanë lindur të përgjumur, por nëse ata harrojnë gjakun e milionave, nëse ata nën-vlerësojnë të keqen, nëse jepen pas défrimeve pa fund, jetës boshe, pa ideal, ata mund të dremisin, të koten, t'i zërë gjumi, e një natë të zgjohen të lebetitur nga zallahia e përbindshave të blinduar, që befas, kanë ngërthyer kthetrat mbi tarracat e pallateve, të ministrive, mbi stacionet e radios e të televizionit, qendrat e ndërlidhjes, udhëkryqet, mbi ëndrrat e ëmbla të të vegjelë... Sepse jo vetëm njerëzit, por edhe qytetet, bile edhe shtetet mund të sëmuren, të përgjumen, të bëhen somnanbulë... Sëmundje me përmasa gjigante, sëmundje qytetesh e shtetesh, pasojat gjithashtu gjigante... *

Ai një çast mbeti si i menduar.

— Po mendohesh? — pyeti burri.

Leksi u përmend, buzëqeshi.

— Ç'thua, a ngrihemi? Mbase një shitetje e vogël do të më bënte mirë... — propozoi papritur burri.

— Mos duhet të çlodhesh edhe pak? — vërejti Alkesi.

— Ah, jo, jo, s'kam asgjë pér t'u shqetësuar! Jam bërë gjysmë doktor. E di, kur duhet të lëviz e kur jo...

Aleksi buzëqeshi.

— Si të dëshërosh, miku im. Më ke në dispozicion. Shkojmë ku të duash...

Ata paguan dhe dolën në Boulevard. Aleksi instiktivisht i futi krahun burrit, por nxitoi ta hiqte në çast, si i trembur dhe i zënë në faj. U kujtua se burri, prej më shumë se tridhjet vjetësh, në vend të dorës kishte një protezë. Ahere ia hodhi në sup dhe iu afrua me dashuri e ngrrohtësi prej vëllai, trupit të tij të madh.

LEUKOS ARBI DHE LEUKOS AGRI...

Leukos Arbi dhe Leukos Agri qenë komandantë të njohur e të nderuar të ushtrive të tyre shumëmillionëshe të rruazave të bardha. I pari qe pjesë e gjakut të një fëmije të quajtur Arben, ndaj thirrej Arbi. . . Tjetri qe pjesë e gjakut të fëmijës, që thirrej Agron, dhe njihej si Agri.

Ishin si të thuash ministra të mbrojtjes së trupit të fëmijëve. Ja pra, kaq sa për t'u njohur me ta. Kurse tani dëgjoni me vëmendje historinë e tyre të çuditëshme e të koklavitur. Shët... shët... Ja tek po vijnë!

* * *

— Vëlla, Leukos Agri, përse je kaq i dëshpëruar? — pyeti shoku i tij, ndërsa i hidhte dorën në sup me ndjenjën e dhemburisë e të dashurisë.

Leukos Agri pshëretiu thellë.

— C'më ka ndodhur mua, vëlla, mos i ndodhtë tjetër Leukosi në këtë jetë...

«C'mund t'i ketë ndodhur?» — tha Arbi me mend dhe priti të dëgjonte se ç'do t'i thoshte miku i tij.

— Gjer tani kryeja punë të rendësishme...

— E di, e di.

— ... Mbroja jetën e Agronit nga sulmet e të ligave mikrobe. Kurse tani...

— C'të ka ndodhur vëlla? Folë, de!

— Me sa duket, prindët e tij e kanë humbur besimin tek unë. Me të filluar betejën me mikrobet, me t'u ngritur temperatura dy a tri shkallë mbi tridhjeteshtatën, tamam atëherë, kur armiqjtë pritet t'ua mbathin, ata dërgojnë avionët e penicilinave.

— Kam dëgjuar se janë avionë të fuqishëm, bombardues të rëndë.

— Vërtet, të tillë janë. Kanë predha të fuqishme. Kështu që unë jam mënjanuar fare. Në betejën e fundit, gati-gati nuk mora pjesë fare. Në vend që të bombardonin një herë në njëzet e katër orë si zakonisht, avionët e theyn këtë rregull dhe në krye të dymbëdhjetë orëve bënë një bombardim të dytë. E tillë goditje s'ishte parë.

— Dhe mikrobet ua mbathën nga sytë këmbët, apo jo?

— Jo, qe tepër vonë! S'mbeti asnje mikrob i gjallë! Një bombardim të tillë as ata vetë s'e prisnin...

— Kështu që duke u mbështetur prindët e Agronit tërësisht në avionët e fuqishëm ti e ndien veten si të mënjanuar dhe të padobishëm.

— Po! Unë e ndiej veten të mënjanuar.

— Vëlla! Mos i dorëzo armët kaq lehtë! Sidomos tani, më tepër se kurri s'duhet të të zërë gjumi dhe ushtrinë duhet ta kesh në gatishmëri. E kupton se çdo të thotë të të zërë gjumi? Mikrobiosi dhe ushtarët e tij të ligj këtë duan. Të hedhësh më-njanë armët e të flesh, të flesh gjatë, shumë gjatë...

* * *

Kaluan dy vjet. Pas një beteje jashtëzakonisht të ashpër me mikrobet kokë, që u fitua nga leukocitet, komandanti Leukos Arbi i shkoi për vizitë Leuokos Agrit. Kishin kohë pa u parë dhe Leukos Arbin e kishte marrë malli shumë. Kur i qe afruar kampit të Leukos Agrit, gati s'u besoi syve. S'i shembëllente më një kampi të nderuar ushtarësh mbrojtës leukocitë. Ku kishte fluturuar e vajtur disiplina e çeliktë e vëllezërve leukocitë? Ç'kishte ndodhur me ta?

* * *

Leukos Agri gati sa nuk qeshi tek e pa fytyrën e Leukos Arbit si të damkosur nga fashot e bardha, që ç'është e vërteta e bënin të dukej disi qesharak.

I hutuar, i çoroditur, Leukos Arbi u mbërthye në prag, zemërngrirë e shpresëthyer.

— Po si qenke bërë kështu, o vëlla? Eja brenda e më trego.

Helm e vrerë Leukos Arbi vështroi Leukos Agrin.

— Gati s'të njoha vëlla! Ti qenke shëndoshur e zbukuruuar, paske vënë dhjamë.

— E si të mos vë dhjamë? Se mos po bëj ndonjë punë? Jam gati një leukocit pensionist. Ha, ha, ha...

— Dikur kjo gjë të shqetësonte shumë. Rreziku i vazhdueshmë i Mikrobiosit s'të mundon më si përpara?

— As më vete ndërmend! Lajme shumë të mira më vijnë çdo ditë. Bombardues të tmerrshëm, të fjalës më të fundit të shkencës, janë në gatishmëri të plotë, Bombardues me emra disi të ngatërruar e të çuditëshëm. Lëre se çdo të bën, po të bashkoheshin me Penicilinat! Namin do të bën!

— Pra ke braktisur gjithçka dhe e ke lënë jetën e fëmijës në duart e ilaçeve?

— Mos kërkon, o vëlla i mirë, të na kthesha qindra vjet prapa, kur të shkretët stërgjyshë mezi shpëtuan kokat nga hordhiti e të pabesëve mikrobe? Kohëra të reja kanë ardhur!.

— Po, o vëlla, kohëra të reja kanë ardhur. Të tjera kohëra do të vijnë, por një ligj i madh s'ka për të ndryshuar kurri.

— Ashtu? — vërejti me ironi Leukos Agri. E ç'ligj i madh na qenka ky?

— Mbështetu në forcat e tua, vëlla! Vetëm ato s'të lënë kurrë në baltë! Dëgjove? Kurre!

— Ç'kërkon të thuash, ku kërkon të dalësh? Mos duhet t'u dal përpara miliardave të mikrobeve? Të humbas miliona ushtarë? Në emër të cilit ideal ta bëj këtë sakrificë? Për çfarë, në fund të fundit?

— Në emër të jetës... Ne jemi betuar të vdesim duke mbrojtur jetën.

— Unë nuk them që jo! Jam gati të vdes edhe unë për Agronin tim të dashur. Por pse të rrezikoj më kot, përderisa kemi në dorë mjete të mrekullueshme? E di ç'do të thotë Penicilinë, apo jo? Fluturimi i tyre zhurmëmadh bën të oshëtijë i tërë trupi. Predhave të tyre s'u shpëton dot asnjë mikrob. Ata u ngulen në zemër dhe i lënë top në vend. Në fund të

fundit, është e kotë të vras kaq shumë mendjen. Se mos urdhëroj unë për bombardimet me Penicilinë?! TjetërkuSH urdhëron. Unë s'jam veçse një gjeneral fare i zakonshëm. Bile një gjeneral në pension...

— Po, ashtu është. Tani në fillim bombardimet me Penicilinë i urdhëron tjetërkuSH, por pastaj fjalën do ta kesh vetëm ti.

— S'të kuptoj ku kërkon të dalësh?

— Ajo që ke rrëth teje, o vëlla, s'është më një ushtri leukocitesh, por një turmë gjumashësh, pijanecësh e vagabondësh, që s'dinë veçse të flejnë e të dëfrejnë. Edhe sikur ta kuptojnë gabimin, prindët nuk do të mund të mbështeten më tek ti dhe te ushtria jote, në qoftë se nuk ndryshoni udhë. Po që se ato dhe ti, vëlla Leukos, do t'i varni të gjitha shpresat vetëm tek ilaçet, fundin tënd e shoh të trishtuar, Agri! Ti do të mbarosh keq, kurse nga ushtria jote s'ka për të mbetur ushtar i gjallë...

— Si guxon, si guxon të më fyesh kështu? Hesht të thashë, hesht, përndryshe...

— Po vëlla, unë po hesht, megjithëse duhej të të flisja më shumë e më gjatë. E në fund, dëshëroj të të them edhe diçka. Eja në vete! Mos flij, ndryshe kurrë s'ke për t'u zgjuar nga gjumi i gjatë. Mirupafshim, vëlla Agri, e nga gjumë i rëndë e tradhtar zgjuar të gjeça, me mburojë e shpatë në duar! Mirupafshim, pra!

E qeshura kumbuese dhe tallëse e mikut të vet e ndoqi një copë herë, ndërkohë që bënte udhë nëpër labirinthet e parnumërtë të çadrave të ushtarëve agriotë, që pinin, këndonin me zë të lartë e qeshnin, pa shkak. Atëherë pika loti i rrodhën në cepat e syve, që nxitoi t'i fshinte, sapo u kujtua se ushtarët e mirë dhe trima nuk duhet të qajnë e aq më shumë të dëshpërohen.

* * . *

Shëndeti i Agronit sa vinte e bëhej edhe më i keq. Mikrobiosi dhe ushtarët e tij pushtonin qdo ditë pozicione të reja. Megjithatë, këto nuk mund të quheshin suksese të bujshme.

Mikrobiosi përparonte me shumë kujdes, pa u nxituar aspak. Gjer atëherë kishte hedhur në sulm vetëm një pjesë fare të vogël të ushtrisë së vet, të cilën e përbënë repartet e kobshme e të tmerrshme të vdekjes. Në këto formacione speciale luftarake bënин pjesë mikrobet më të liga e më të poshtra të botës, armiqtë më të mëdhenj të jetës. Ato kishin vetëm një detyrë: të vdisnin! Kaq ashpër dhe me kaq guxim luftonin në trupin e Agronit të vogël, sa të krijonin përshtypjen e rreme se sulmonte jo më një pjesë e vogël e mikrobeve, por e tërë ushtria. Në të vërtetë kjo ishte taktika e tyre. Synonin të krijonin përshtypjen, e gjenjeshtërt, se po bënин një sulm gjigantesh në shkallë të gjerë. Prindët e fëmijës duke u gabuar, nxituan të nisin kundër reparteve të mikrobiosit avionët e shpejtë «Penicilini». Në qellin e turbulltë të luftës fantastike, u dukën shpejt, veç avionëve «Penicilini», aeroplanët supersnikë «Streptomicini». Bombardimet ishin të tmerrëshme! Dukej se për çdo kokë mistrece mikrobi të vdekjes qe llogaritur një bombë.

Një ushtar mikrob i reparteve të vdekjes, i lemerosur nga skenat e llahtarshme të bombardimit, ua mbathi këmbëve duke u dredhur. Duke qarë me dënesë, u ul në gjunjë përpara kryekomandantit të tij, Mikrobiosit.

— Imzot! Një i tillë sulm ajror s'është parë gjer më sot. Qielli dukej se ziente e toka të çuhej nën këmbë. Bombat na binin si breshri. Tanët binin përdhe si të kositur. Të tillë vdekje s'më kanë zënë sytë ndonjëherë.

— Po ti, o ushtar i keq, a nuk e dije detyrën tënde? A e di q'do të thotë, të kthehesh shëndoshë e mirë nga beteja duke qenë anëtar i reparteve të vdekjes? Jo? Tani do ta mësosh! Ushtarë, çarmatoseni, lidheni dhe zbatoni ligjin!

Një minutë më vonë, mijëra shpata ushtarësh mikrobe e copëtuan dhe e bënë çikë e thërrime trupin e dezertorit.

— Ja, si e pësojnë të pabindurit dhe frikacakët! Ja si e pësojnë ata, që s'njohin detyrën. Po, vellezër, detyrën tonë të madhe, taktikën tonë të famshme s'duhet ta harrojmë kurrë! Ushtarët e vdekjes provokojnë Agronin. E nxisin atë të përdorë aeroplanë antibiotikë nga më të fuqishmit. Aeroplanët «Penicilini» në fillim bënë çudira! Miliarda ushtarë të vdekjes lanë këkën nga bombardimet e tyre. Por shpikësit tanë të shquar kri-

juan mburojat e mrekullueshme «Antipenicilini» e më pastaj, kundërajrorët e përpiktë «Antipenicilini», të cilët shumë shpejt do t'i përdorim në luftën tonë pa pajtim kundër leukociteve. Veçse, ushtarët e mi të dashur e tepër të nderuar, na ka ngecur sharra në gozhdë me Leukos Arbin. Është një komandant i madh. Na ka shkaktuar humbje të rënda, ndonëse është në krye të një ushtrie disa herë më të vogël se jona. Forca kolosalë e tij, o bij, qëndron te besimi që ka në forcat e veta. Ai nuk mbësh-tet tek ndihma e të tjerëve. Shumë herë, në kulmin e betejave me ne, ilaçet i ofronin ndihmën e tyre dhe a e dini se si u përgjigjej ai: «Tani për tani, s'kemi nevojë për ju. Do të luftojmë vetë. Në qoftë se jeta e fëmijës rrezikohet, sigurisht ne do të luftojmë së bashku». Porsa ai, gjer tani, vetëm një herë e kërkoi këtë ndihmë, tamam ahene kur qe rrrethuar e s'kishte rrugëdalje. Pra, o trima, është një strateg i madh dhe kjo na e vështirëson ca më shumë luftën pa pajtim. Sa për Leukos Agrin, atij pijanezi, që i vjen era një orë larg, them se shpejt ushtrinë e tij do ta shpartallojmë, kurse atë vetë do ta zëmë rob e do ta varim me kokë poshtë, gjersa shpirti t'i dalë me të keq e me mundim... .

Spiunazhi dhe kundër-spiunazhi i palëve kundërshtare ishte në veprim e sipër. Zbuluesit kryenin me zell detyrat e ngarkuara. Kështu, zbuluesit leukocitë njoftuan me një frymë Agrin, se Mikrobiosi kishte veshur çdo ushtar të tjin me një rrobë speciale të quajtur «Peni-Strepto-rezistencë», e cila u bënte ballë bombardimeve të repta të avionëve të shpejtë «Penicilini» e supersionikëve «Streptomicini». Po këtë lajm të «zi» Agri e priti buzëqeshur. Ai sapo kishte nënshkruar një marrëveshje të fshehtë me komandantin e trupave raketë, «Tetraciklinën».

Porsa deklarata e përbashkët qe nënshkruar nga palët e interesuara, teksti i plotë i përmbytjes, pas disa orësh ra në duart e Mikrobiosit. Ndërsa ai lexonte rreshtat e parë, lëvdoi me mend punën e shkathët e të zgjuar të zbuluesve të tij. Edhe pasi mbaroi së lexuari njoftimet sekrete të spiunëve rrëth armëve moderne, që priteshin të përdoreshin së afërmi nga trupat e Leukos

Agrit, asnjëri nga gjeneralët s'e pa të dëshpëruar apo të zymtë.

«Domethënë ata do të përdorin në luftën kundër nesh raketat? Aq më mirë! Ne do të shpikim së shpejti «Antiraketat Tetriciklini». Kjo gjë do të shpejtojë rrëthimin e Agrit dhe do të afrojë fundin e tij... I shkreti Agër! Nuk e di ku qëndron forca e tij e vërtctë, se po ta dinte mirë, do t'i kisha punët vërtetë keq. Për shembull, ç'mund t'i bëj, Leukos Arbit? S'i bëj dot asgjë. Prej dhjetëra-mijëra vjetësh luftojmë kundër një-ri-tjetrit dhe gjer tani, megjithë përpjekjet që kemi bërë, s'ka qenë e mundur të gjejmë një mjet të fuqishëm dhe efikas «Antileukocitar». Dhe s'është e lehtë besa. Sa për ilaçet, ato s'më trembin aspak. Në e lënshin jetën leukocitet në dorë të tyrc, na e morën të kcjen. Eh, Agri, Agri! S'më durohet, gjersa të të shtije në dorë, pa vetë, ja me këto duar, në fytin e majmur do të ta hedh litarin dhe gazit do të shqyhem, e valle të çmendura përqark kam për të hedhur.

Tek panë komandantin të shqyhej së qeshuri, gjeneralët ndoqën shembullin e tij. Gjersa i madhi i tyre qeshtë, edhe ato e kishin për detyrë ta ndiqnin. Kur qesh komandanti, s'ka lezet të qëndrosh i vrenjtur, kjo s'bie në sy për mirë dhc, dashur pa dashur, ngjall mendime të dyshimta tek eprori. Por të qeshurat e tyre kumbuesc nuk arrinin deri në veshët e mpirë të të përgjumurit Agri... Ai gjithë qejf po festonte e po ngrinte dolli për marrëveshjen me Tetriciklinën. Shpresonte se tashmë e kishte siguar fitoren...

* * *

Sulmi i mikrobeve shpërtheu befas në mesnatë. Tridhjetë milion ushtarë të vdekjes, nën udhëheqjen e njërit nga gjeneralët më të mirë, Kokut, sulmuan para së gjithash qendrat më të rëndësishme e më nevralgjike të trupit, duke synuar të pushtonin vijat e komunikacionit, arteriet, venat, kapilarët dhe qendrën e frymëmarrjes. Rezistencë e leukocitëve agrotë që bënnin roje, qe e dobët dhe e shkurtër. Të ngathët e të pastërvitur, u tërhoqën në fillim ngadalë e pastaj ua mbathën këmbëve me të katra. Mikrobiosi nuk ngulmoi të zgjeronte ofensivën pa forcuar më parë pozitat. Leukos Agri duhej të binte në kurth.

Temperatura c trupit u ngjit me shpejtësi nga tridhjetë c gjash-të shkallë c katër vija, në tridhjetë e shtatë shkallë e shtatë vija. Për t'u dalë përpara të këqijave, Agri urdhëroi kundër-sulmin ajror...

Tamam në ora shtatë të mëngjesit, katërqind mijë aeroplanë të shpejtë «Penicilini» dhe pesëqind mijë aeroplanë superso-nikë «Streptomicini» u ngriten hije rëndë e plot kërcënëm nga pistat dhe aerodromet e indeve muskulorë të të ndenjurave. Nëntëqind mijë acroplanë në qìll, besa, edhe diellin vetë e rrësojnë.

«Çfardo mburojash të kenë veshur, me gjithë emrat c buj-shém e të frikshém që u kanë vënë, fértele do të bëhen nga bombardimet e pashoqe.» — mendoi i kënaqur Agri, ndërsa ndiqte me sy fluturimin zhurmëmadh të bombarduesve të rëndë. Në çast aeroplanët lëshuan bombat e para, bomba të rënda të kalibrit të madh. Shpërthimi qe i tmerrshém! Zhurma qc kaq c fortë dhe tronditëse, saqë Agri nxitoi të mbyllte veshët me duar. Pastaj vuri dylbitë të shihte përfundimet e kundër-sulmit të fuqishém ajror. Piste të shikonte ushtrinë armike të lebetitur duke ua mbathur këmbëve, por mbeti fort i habitur dhe i lemerisur. Ata faqezinj s'ishin prekur thuajse fare. Të veshur si djaj, me uniforma të çuditshme e të komplikuara metalike, vazhdonin të marshonin nën tinguj marshesh luftarake, shpërthime bombash, tymi dhe flake. Marshim i egër, i pabesë dhe i poshtër!. U binin pranë bombat dhe shpërthenin duke u çikëruar në mijëra copëza, por me të prekur veshjet e tyre, ciflat ktheheshin mbrapsh të pafuqishme.

Duke u dridhur, Agri ngushëlloi veten me raketat «T-traciklini», «Rezerva e fundit» — mendoi. — Do t'i shoh se si do të gajasen e do të tallen, kur t'u venë mbi kokë predhat. — tha me inat. Por sidoqoftë, është akoma shpejt. Mbasdite duhet organizuar sulmi tjetër. Veshjet e tyre speciale do të dobësohen e do të roniten, trupat do t'u sakatosen e përdhe kanë për të rënë. Lufta ajrore duhet vazhduar të paktën tre ditë e tre netë. Në mos arrifshim ndonjë sukses për të qenë, komandantja e trupave «Tetraciklini», duhet me çdo kusht të hyjë në betejë. Sidoqoftë, le të shohim se si do të vejë sulmi i mbasdites. Eh!...

* * *

Dinaku Mikrobios, u kishte rezervuar një të papritur farc të pakëndshme lëukociteve agriotë tamam në sulmin ajror të pasdites. Në prag të betejës, aty afër orës nëntëmbëdhjetë, në sheshin e gjerë të «arcnës» së luftimeve ngrijeshin pirgjet e predhave të çikërruara të aeroplanëve «Penicilini» dhe «Streptomicini». Porse kjo s'përbënte aspak një arsyé të fortë taktikë për të mos dërguar në sulmin e pasdites rezervën e freskët të sulmuesve ajrorë...

Në orën 19.07 minuta, në qìell fluturuan bombarduesit e parë. Kësaj radhc fluturimi i tyre qe i llahtarshëm. Shumë herë, me fluturime pikati, të shkathëta e të guximshme, aeroplanët gjuejtës mitralonin kolonat armike. Dhe ndodhi e pàpritura më e hidhur. Si të fantaksur mbinë befas, grykat e gjata të topave të rinj kundërajrorë, që s'vonuan të qëllonin në drejtim të avionëve.

Qitjet e përpikta e çoroditën fluturimin zhurmëmadh e krenar të flotës ajrore. Që në minutat e para, mijëra aeroplani, duke lënë pas vetes shtëllunga zik-zake tymi e flake, rrëzoheshin plot tërsëllëmë duke shpërthyer e duke u bërë thërrimë apo ndesheshin me tokën indore...

Mikrobet, për herë të parë përdornin kundërmjete të tilla kaq të fuqishme. Megjithatë, Agri s'e bëri veten përpara shtabit të tij. Ai u bëri thirrje të mos e lëshonin veten, meqcnëse shpejt situata do të merrej në dorë dhe mikrobet do të mposhteshin.

«Hëpërhë, vëllezër, s'po jua them të fshehtën. Për këtë do t'u duhet të prisni vetëm tri ditë e tri netë... Sapo të kemi aktivizuar plotësisht flotën tonë ajrore të «Pinicilinave» dhe të «Streptomicinave», do të organizojmë sulmin përfundimtar. Pastaj? Oho, keni për të parë, se ç'kam për t'u bërë! Qesh, kush qesh i fundit...»

* * *

Flota e fuqishme ajrore e «Penicilinave» dhe e «Streptomicinave», u tregua e pazonja për të frenuar sadopak marshimin triumfal mikrobian. Nga fushat e betejës indore, lajmet e këqija

pasonin njeri-tjetrin pareshtur. Prapëscrapë, deri nga mesnata, Agri c mbajti veten pa shfaqur as më të voglin shqetësim. Dhe gjersa para syve kishin një komandant aq gjakftohtë e kurajoz, s'do mend, gjeneralët menduan se ai duhej të zotëronte ndonjë armë të tmerrshme. Ç'të fshehtë të hidhur po u rezervonte mikrobeve të çmendura?!

Ah, jo! Në asnjë mënyrë tjetër, jo! Ai nuk mund, nuk duhej të priste më gjatë. Aty rrëth orës dympëdhjetë të natës, pararoja armike, duke pushtuar fortësën e ethes e ngriti si me frymë temperaturën disa shkallëzime. Një ngjitje e tillë e shpejtë që c frikshme, c pabesueshme dhe ngjethëse. Ata favezinj dukej sc i kishin vënë vetsë detyrën më të poshtër të botës së gjallë: të kalonin të gjitha shkallëzimet e termometrit e të vdisnin fëmijën, paçka se në këtë mënyrë mund të vdisnin edhe vetë. Ata kishin vetëm një dëshirë, ku përmblidhej kuptimi i jetës së tyrc, të mundnin me çdo kusht leukocitë!

Tamam në orën 12.30, komandantja e trupave raketë, Tetraciklina blonde, mori telegramin e shifruar nga Leukos Agri, ku i njoftohej ora e saktë e fillimit të sulmit.

Në orën 12.35, në quell të trupit fluturoi raketa c parë «Tetraciklini», që peshonte rrëth 250 miligram. Shoqërueshit e përhershëm të saj, «Vitaminat B kompleks», e ruanin anëve me kujdes. Një fluturim i tillë madhështor s'ishte parë tjetër herë. Leukos Agri ndiqte me ankth fluturimin e raketës i përkulur mbi hartën e trupit.

Nga pista e gojës, raketa kaloi me shpejtësi zonën e ngushtë të kanalit ajror të farinksit, s'andejmi fluturoi mbi ezofag c pastaj iu desh të bënte një pushim të detyruar prej dy-tre orësh në aerodromin e stomakut. Taktika e luftës sulmuese e kërkonte një pushim të tillë për të ç'orientuar sadopak radarët armiq.

* * *

Shpërthimi ishte nga më të tmerrëshmit. Raketa u copëzua sa të hapësh e të mbyllësh sytë në dyqindëpësëdhjetë miliard raketëza, që ndryshe quhen edhe raketëza bijëza. Këto u përhapën në të gjitha drejtimet duke qëlluar me sukses të

plotë kolonat e dendura armike. Mikrobet faqezinj shpoheshin mes për mes nga raketëzat e binin pa frymë përdhe.

Jo! Mikrobiosi dinak s'e kishte parashikuar këtë sulm të rrufeshëm, përpara të cilit ushtria e tij shumë milionëshe u gjend fare e papregatitur. Arma e re do të bënte kërdinë. Ai urdhëroi tërheqjen e shpejtë. Por gjashtë orë më vonë, në qill të trupit fluturoi raketa e dytë «Tetraciklin». Radarët armiq filluan të ndiekin zemërdredhur fluturimin e saj. Mikrobiosi urdhëroi të shpejtohej edhe më shumë tërheqja e trupave...

* * *

Tre orë më vonë, Mikrobiosi u hodh në ajër nga një shpërthim gjëmë, i pallogaritshëm. Çadra e tij dhe ato të gjeneralëve morën zjarr. Paniku i përgjithshëm nisi të bëhej i pashmangshëm. Një çoroditje të tillë s'i kishin parë sytë ndonjëherë tjeter, me gjithëse kishte kryesuar një mijë e pesëqind beteja të përgjakshme. Dhc qe e kotë të frikësoje me vrasje e varje ata që dezertonin nga radhët, sepse pa bërë disa çape kositeshin e zhdukeshin pa lënë gjurmë nga raketëzat bija, që ndryshtirreshin edhe «Tetrakse».

«Po këta zëra të largët dhe të huaj? Sigurisht janë leukocitet. Por le të çirren, le të brohorasin! S'u pritet gjersa të më presin kokën. Le ta bëjmë edhe këtë. Të paktën vdes i ngushëlluar. Ja, me këto duar, kam vrarë miliona leukocite maskarenj! Detyrën ndaj botës sonë të mikrobeve e kreva dhe mund të vdes i qetë, i qetë: Ha, ha, ha! Hi, hi, hi! Hu, hu, hu!

Ai filloj të qeshë, të qeshë si i çmendur. Ç'ia turbulloj mendjen e shkretë? Shpërthimi gjëmëmadh, fundi i turpshëm, vdekja e pashmangshme?!...

Zërat sa vinin e afroheshin. Mikrobiosi nxori shpatën dhe e puthi me mllef, (më mirë le ta quajmë kafshim atë përplasje dhëmbësh mbi metalin e ftohtë e të ndritshëm të armës vdekje-prurëse).

«Nuk do të vdes pa korru dhjetë mijë koka leukocitesh» — tha e përsëri ia krisi të qeshurit.

Ai priste tjetër gjë, kurse i doli përpara syve një pamje fantastike e pabesueshme. Ushtarët leukocitë agriotë, me të thirru-

ra të llahtarshme, djegur e përcëlluar, sakatosur e të gjymtuar, ua mbathnin me të katra. Ata bashkoheshin, përzireshin, ndaheshin e përsëri bashkoheshin me turmën e ushtrisë mikrobiac, që tërhiqej në rrëmujë e panik të plotë..

Mikrobiosi hapi sytë fort i habitur. I hapi aq sa mundi e tha vetëm një fjalë: Çudii!!.

* * *

Leukos Agri ishte bërë si i çmendur! Ajo tetriciklina budallaçkë, duke bërë llogaritjet gabim, filloj të qëllonte pa asnjë dallim pozicionet armike dhe bash edhe kryeqendrën e saj, shtabin e leukociteve. Raketëzat bija copëtonin si të verbuara e shurdhc ushtarët mikrobë e leukocitë, qeliza e inde, ç'të gjenin përparrë.

Gjendje e rëndë, tepër e rëndë për trupin e fëmijës.

Nga ekspertët mësuan se, në gjuhën shkencore, kjo lloj avarie rrënqethëse quhej «Reaksion». Madje ai u këshillua të ndalte menjëherë bombardimet me raketë, përndryshe vdekja do të ishte e pashmangshme...

* * *

Të nesërmen Leukos Agri u detyrua ta bënte këtë. Urdhëroi ndalimin e plotë të sulmit tetriciklian. Zbuluesit me një frymë i njoftuan sihariqin Mikrobosit, i cili sa s'u çmend së thirruri e së përbetuari, se tani do ta merte hakën mirë e s'do të kishte asnjë mëshirë për leukosët e bardhë.

Ai urdhëroi organizimin e menjëhershëm të ushtrisë në ikje. Misionarë të posaçëm u shpërndanë në të katër anët për të frenuar largimin e çorodit të ushtarëve mikrobë.

Kasaphana e vërtetë filloj shumë shpejt. Ushtarët mikrobë, tamam ata që largoheshin në panik, me të marrë udhëzimet e reja, i kthyen shpatat kundër leukociteve të raskapitura, që binin përdhe pa çfaqur as kundërshtimin më të vogël, qoftë për të mbrojtur edhe atë pakëz jetë që u kishte mbetur. Po bëheshin preqatitje për të parë fundin e pashmangshëm të ushtrisë agrore dhe komandantit të saj, Leukos Agrit...

* * *

Rrethimi ishte ngushtuar jashtë mase. Luftimet e fundit ishin përqendruar rrëth shtabit të leukociteve. Leukos Agri, sypërlotur kishte dalë përpara çadrës së tij dhe ndiqte zemërtthyer e shpresëhumbur, luftën e përgjakshme të gardës së tij dhe gardës mikrobiiane. Po, me sa dukej, edhe ushtarët e tij besnikë s'ë ndryshonin më dot fatin e betejës, sado heroikisht të luftonin.

Leukos Agri filloi të qante nga inati si një fëmijë, të drejtë i terti, por jo nga frika...

«Një fund të tillë e meritoja, — tha me vete i pikëlluar. Fatin tim e të ushtrisë sime ua lashë në dorë të tjerëve, ilaçeve. Pandeha se ato ishin gjithçka, se mund të mbështetesh tek ato kur të doja. Dhe ja fundi!. Tani, këta të shkretë ushtarë, mezi arrijnë të mbrojnë kokën e tyre e jo më jetën e fëmijës... Ah, o vëlla Arbi, ku je? Ku je, o i shtrënjeni vëlla? Sa të drejtë pas ke pasur!».

Dhe lotët i rridhnin çurk. Dhe zemra i rrihte fort, fort, si një zokth, që dridhet së ftohti. E këmbët gati-gati po e lëshonin. Sa të këputur që e ndiente veten!

* * *

Janë çastet e fundit. Njëqind mijë leukocite janë të detyruara të përballojnë gardën e stërvitur mirë prej pesë miliard ushtarësh mikrobë... Mikrobiosi s'pushon së thirruri, së qeshuri e së tunduri me kërcënëm shpatën në ajër. Ka urdhëruar ushtarët e tij që askush të mos e prekë me duar «strategun» e madh, më të famshmin «strateg» të kohës, Leukos Agrin. Të zihet i gjallë me çdo mënyrë. Agri i majmë do të jetë trofeu i tij i shumëpritur.

* * *

Një lajmëtar, i dërguar nga Leukos Arbi, çau me të shpejtë rrethimin armik dhe, duke qenë i goditur nga njëqind shigjeta të farmakosura, që iu ngulën në trup, i dorëzoi një pishtar të pa-ndezur Leukos Agrit.

«Nëse doni të shpëtoni ushtrinë tuaj, nëse ju ka mbetur ende një grimcë dashurie për jetën e fëmijës, që keni marrë në mbrojtje, ndizeni pishtarin dhe miqtë do t'ju ndihmojnë. Ata do t'u ndihmojnë duke shpresuar se paskëtaj do të mbështeteni kryesisht tek vetja juaj duke stërvitur një ushtri të fortë, të shkathët e të zonjën. Po qe se edhe në të ardhëshmen do të mbeteni kështu i brishtë e i dobët, mos e ndizni pishtarin! Ja, kështu më porositi t'ju them, vëllai juaj i shtrenjtë, komandanti im i madh, komandanti im i dashur!..

Lajmëtarë kishte humbur tepër gjak. Helmet bënë shpejt punën e tyre të zezë.

* * *

Garda u përgjysmua sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Unaza e rrëthimit u ngushtua edhe më shumë. Leukos Agri mori nga duart e lajmëtarit pishtarin. U mendua një copë herë përpara se ta ndizte. E qeshura neveritëse dhe e urryer e Mikrobiotis i kumboi në vesh. Shpata e tij shkëlqeu me një ndriçim të frikëshëm, ndërsa tundej e vërvitej tej në ajër si e tërbuar. Në shpirt iu zgjua befas dashuria e thellë mijëravjeçare për të mbrojtur jetën.

«Nuk duhet të vdes pa kryer edhe unë detyrën time ndaj jetës, sepse edhe në varr s'kam për të gjetur qetësi. — mendoi dhe me duart që i dridheshin ndezi pishtarin...»

Për të parën herë pas shumë vjetësh Leukos Agri nuk ndjeu aspak frikë... nxori shpatën nga këllëfi, e puthi atë dhe i ndjekur nga ata pak ushtarë, që i kishin mbetur, u vërsul mbi gardën mikrobiiane, pa përfillur vdekjen...»

Atje, një mikrob barkalec e çpoi tejpërtej me një heshtë të farmakosur dhe Leukos Agri ra në duart e ushtarëve të tij pak çaste përpara ardhjes së ndihmës të fundit.

«Puthmëni fort vëllanë tim, Leukos Arbin! I thoni se e kam dashur shumë. I thoni, po ashtu, se tani e çmoj edhe më shumë. Për fundin që pata, s'më vjen keq se këtë meritoja. Pas-këtaj do të dini ta mbroni vetë jetën, më të shtrenjtën gjë që na u besua. Vdekja ime le t'ua mësojë këtë të vërtetë të madhe, sa kohë që jeta ime s'ishte e denjë për t'u dhënë mësim më të vyer e më të çmuar se ky. Lamtumirë! Të gjithëve lamtumirë!»

Dhe i mbylli përgjithnjë sytë.

Mbi trupin e tij ushtarët agriotë të gardës kryqëzuan shpatat e vogla.

Rrëke lotësh u rrodhën nga sytë. Lotë çudibërëse që filuan ta tresnin përparrë syve të tyre trupin e madh të komandanit Agrit.

Shëndeti i Agronit të vogël sa vinte e keqësohej më shumë. Prej disa ditësh temperatura i qëndronte e lartë, oreksi i kishte perënduar dhe forcat po e linin.

Prindët e fëmijës, që u faleshin ilaçeve si idhuj të shenjtë e që i përdornin edhe pa këshillën e mjekut, u bindën se duhej të kërkonin ndihmë, bile urgjente. Po atë ditë vogëlushin e shtruan në spital. Shishet e gjakut, të serumeve, të vitaminave, kripërave, të ushqimeve, si ushtarë guximtarë, të gatshëm përtu hedhur në sulm, qëndronin të rreshtuar bri njëri-tjetrit mbi tryezën e bardhë të infermierisë.

Mjekët bënë çmos që fëmija të ushqeqejet vetë, të hante diçka. Një gjë e tillë do ta ndihmonte ushtrinë e dobësuar të leukociteve e të antitrupave, ndihmëse të Leukos Agrit, të mblidhëte vehten. Por fëmija s'donte kurresesi të fuste gjë në gojë. Atëhere, në dejtë e fëmijës Agron, vërvshuan me vrull forcat ndihmëse të rezervës, gjaku, serumet, kriprat, vitaminat dhe ushqimet e parapregatitura të lëngshme. Mjekët u detyruan të përdorin edhe antibiotikun më të fundit, të porsazbuluar, të cilin mikrobet ende nuk e njihnin. Ndodhi ajo që pritej. Në radhët e ushtrisë shumëmiliardëshe të mikrobeve u bë batërdia. Të sulmuar nga disa drejtime, kësaj radhe edhe nga vetë leukocitet agriotë, që i kishin mbledhur mirë forcat, mikrobeve faqezinj s'u mbetej veç të dorëzonin armët. Miliona e miliarda agresorë mikroskopikë jepnin frymën e fundit.

Në trup të fëmijës, filloj të fryjë flladi i freskët i shënditet të mirë, që po rikthehej me të shpejtë. Ushtritë e bashkuara të leukociteve, antitrupave mikrobikë, gjakut, serumeve, kripërave, vitaminave, ushqimeve, u hodhën në krahët e njëratjetrës e brohoritën me gaz përfitoren. Me lotë në sy, komandanti i ri agriot i falenderoi me fjalë të zjarra që i dilnin nga zemra:

«Faleminderit, vëllezër e motra të mira, që na shpëtuat jetën, që mbrojtët jetën e Agronit tonë të shtrenjtë! Por ne e kup-

tojmë shumë mirë, se nuk është kjo rruga drejt shëndetit të mire. Ne do të stërvitemi në mënyrë të tillë, që jetën ta mbrojmë vjetë, pa qenë nevoja të ndihmohemi nga të tjerët, aq më shumë nga ilaqet. Është më lehtë të mbrohesh nga sëmundjet, sesa të shërohesh prej tyre, këtë mësim të madh të jetës ne s'do ta harrujmë, jo, kurrë! Ndaj do të kalitemi, ndaj do të forcohem i aq shumë, sa Mikrobiosi të mos guxojë të na afrohet, e jo më të na sulmojë. Lavdi jetës, vdekje mikrobeve!».

Milionë zëra të fuqishëm ushtarësh mikroskopikë iu përgjigjen thirrjes së komandantit të ri. Prijësi buzëqeshi i kënaqur dhe u fut në mizérinë e tyre, që kremonin fitoren. Midis tyre e ndiente veten më të fuqishëm, më të lumtur dhe fitoren më të çmuar. Miliona duar zgjateshin nga ai dhe komandanti agriot s'lodhej së shtrënguari me dashurinë e madhe e të pastër të atij, që është gati të flijohet i pari për jetën e fëmijëve...

ÇËSHTJA E POLICIT XHON UOTËRGEIT

n o v e l ë

Tani, secili e ndien frikën në lëkurën e vet. Njerëzit, që më parë e merrnin me shaka, kur thuhet se F B I -ja i përgjon, tani edhe në shtëpinë e tyre përdorin gjuhën e robotëve automatikë.»

Gazetari amerikan

Pit Shemill

Mars 1974

«Sipas mendimit tim, tani duken sheshit përpjekjet për të shkrirë në një të vetme të gjitha elementet e shtetit politor për të bashkuar e bërë një policinë e fshehtë, zbulimin, kallëzuesit, aparaturën elektronike të dëgjimit dhe teknikën moderne illogaritëse për kontrollin e shoqërisë». *Carls Gudel*

Ish-senator, autor i librit «Të burgosurit politikë në Amerikë».

Në shkurt të vitit 1974 vetë Niksoni pohoi se në vitet e fundit, me përpjekjet e organeve të ndryshme qeveritare, janë hapur dosje të veçanta për 150 milionë qytetarë amerikanë. *Sipas «Zërit të Popullit»*

Datë 4 Qershori 1974

Dy vjet më parë, Drejtoria qendrore e zbulimit u qe drejtuar konstruktorëve dhe shpikësve më me emër të vendit, për të përsosur më shumë aparaturat e ndryshme elektronike të vëzhgimit, të dëgjimit e të ndjekjes.

Për Drejtorinë qendrore të zbulimit, sikurse edhe për Byronë Federale të Hetimeve, pajisja e rrjetit të saj të gjerë agjental me aparaturë vëzhgimi të fjalës më të fundit, kishte një rendësi të posaçme, meqenëse një varg lëvizjesh revolucionare të padëshërueshme për regjimin, si bie fjala, lëvizja e kundërshtarëve të luftrave agresive, të luftëtarëve kundër dallimit racial, grevat e punëtorëve, demonstratat e tyre dhe të studentëve, mitingjet e protestave etj. kishin marrë një zhvillim të paparashikuar dhe kërcënues për «sigurimin publik».

Kjo gjë e kishte detyruar presidentin e vendit, t'i kërkonte Drejtorisë qendrore të zbulimit të zgjeronte në masë të ndjeshtme «bangat e informacionit» dhe të forconte punën e seksionit të hetimit të veprimtarisë subversive.

Drejtoria qendrore e zbulimit iu përgjigj me zell kërkxesës urgjente të presidentit, duke e rritur numrin e bankave të informacionit nga 600 në 858 të tilla. Në më pak se tre muaj, ajo bëri një zëvendësim gati të plotë të funksionarëve të seksionit hetimor, hapi mijëra dosje të reja për të dyshimtët, shtoi numrin e regjistrimeve të bisedave telefonike, dërgoi shumë agjentë të fshehtë në qendrat e lëvizjeve revolucionare të punëtorëve e të studentëve, por megjithëatë rezultatet nuk qenë inkurajuese. Kështu që me një farë shqetësimi antarët e drejtorisë po prisin ditën e madhe, në të cilën konstruktoret dhe shpikësit do të dorëzonin aparatet e tyre të fjalës së fundit.

Bënë ç'ishte e mundur që takimin ta shpejtonin dhe ia arritën qëllimit, duke e bërë atë tre muaj më parë, nga ç'qe caktuar.

Takimi i 30 konstruktoreve me zotërinjtë e Drejtorisë qendrore të zbulimit u zhvillua pikë për pikë sipas të gjithë ligjeve të policisë: në fshehtësinë më të madhe jo në grup, por me seicilin konstruktur veç e veç. Që në fillim të takimit, drejtuesit e Drejtorisë qendrore të zbulimit pësuan një zhgënjim të hidhur me dy konstruktoret të njojur, Meksin dhe Robertin.

Drejtori rrotulloi nëpër gishta një copë herë, si me dyshim dhe i pasigurtë, një lëmsh shumë të vogël metalik, pastaj e afroi pranë veshit. Mori tinguish të çjerrë, si të dilnin nga një radio e prishur, iu përplasën me forcë e dhembje në timpan. Ai shtrembëroi fytyrën.

— Veç zhurmës, asgjë nuk dëgjoj... Mos ka ndonjë sekret ky aparati juaj? — pyeti ai, duke e larguar nga veshi.

— Po, eshtë ndryshe nga të tjerët! Ska njeri në botë që të mund të dëgjojë me të përpëra se të kalojnë disa muaj ambientimi. Veç kësaj, ai eshtë llogaritur për tu implantuar brenda në vesh.

Drejtore i vështroi ngultazi, si njeriu që përpinqet të kuptojë, nese tjetri e ka me shaka, apo flet seriozisht, pastaj me një slëvizje dore shfaqi padurimin dhe mërzinë e tij.

— Skemi kohë për të pritur dhe as për të bërë shaka, zoti Meks... Ky lloj aparati, me qitje të vonshme, nuk përligj urgjencën, me të cilën ua këruam...

— Nuk di akoma, zoti Hull, ç'kanë bërë kolegët e mi, veç përnjë gjë jam pothuajse i sigurtë. Ky lloj aparati eshtë i parritshëm dhe i pakonkurueshëm. Mendoj se gjërat e shpejtuara dhe që zgjidhin vetëm përkohësisht hallet tuaja, nuk duhet t'ju kënaqin.

Tani që bandat e kusarëve e të kriminelëve po bëjnë një mijë e njëqind të zeza (zoti Hull maskonte më shumë kujdes qëllimet e vërteta, për të cilat do të përdoreshin aparatet e fundit elektronike të dëgjimit), ne, zoti Meks, nuk kemi më durim për të pritur akoma dhe disa muaj, gjersa agjentëve tanët u mësohen veshët. Le që një aparat i tillë, sado të mirë që na e paraqisni, s'para më duket praktik. Për implantimin e tij na qenka i nevojshëm operacioni, dhe kjo pengon shpërndarjen e gjëre të tij. Ndërhyrja operatore është disi e rrezikshme dhe nes'mund t'i detyrojmë agjentët tanë t'i nënshtrohen asaj verbazi.

— Me një fjalë, zoti Hull?! — provokoi një përgjigje të formës së prerë shkencëtarit, duke u nxehur befas.

— Shkurt, tani për tani, nes'mund tua blejmë patentën e shpikjes. Më vonë mund të mirremi vesh...

— Si të doni, zoti Hull!... Me siguri, ju do të pendoheni. Policia dhe Byroja Federale janë jo më pak të interesuar se ju... Tani që ne ju bëmë të njohur shpikjen tonë, asgjë s'na pengon, që ta provojmë në jetë atë, dhe kjo të mos përbëjë një krim përshtetin. Veç dijeni, ju po humbisni...

— Zoti Hull qeshi.

— Provogeni, provogeni zoti Meks. Në daltë, siç po thoni, nes'mund t'ju paguajmë dhjetëfishin e asaj shume që do t'ju japë Byroja Federale. Rruga e marrëveshjes me ne, mbetet gjith-

një e hapur. — Veçse ju duhet të na bindni me prova serioze, por jo kështu si sot. — Shpresojmë t'ju bindim dhe jo vetëm juvë, zoti Hull. Aparati ynë «Sufi», ka përt'u bërë tmerri dhe paniku i keq-bërësve. Ndryshe nga aparatet e tjera, ai ka për të zbuluar që në zanafillën e tyre shumë akte të përbindshme. Por sidoqoftë, tani përtani ai le të mbetet për jundhei zotérinjtë, aparati me qitje të vonuar... Mirupafshim, zoti Hull! —

Mirupafshim zoti Meksi!

Të deziluzionuar nga pritja e pëftohtë që iu bë zbulimit të tyre, të mërzitur nga shuma e majme, që parashikonin të merrnin dhe s'e morën, si dhe të prekur në sedër, shkencëtarët Meksi e Robert dhe bashkëpunëtori i tyre i ngushtë, kirurgu Ferdi, atë natë rrahën mendimet gjere vonë! Meksi ishte i mendimit që aparatit t'ia inplantonin një agjenti inteligjent. Aparati «Sufi» do t'i shumëfishonte aftësitë e tij dhe shumë shpejt një njeri i tillë do të bënte një karrierë të shkëlqyer. Nga ana e tij, Roberti shfaqi dyshimin se një njeri inteligjent, i pajisur me aparatit «Sufi» mund të dilte jashtë kontrollit të tyre e të bëhej shumë i rrezikshëm edhe për ata vetë që i shpikën. Një gjë e tillë fshihte pasoja të pallogaritshme.

— Unë mendoj — foli shkencëtar Roberti, t'ia inplantojmë jo një agjenti të fshehtë dhe as ndonjë njeriu shumë të zgjuar, por një polici shumë të thjeshtë, që s'është shquar ndonjëherë për mençuri e zgjuarsi, një polici që s'ka bërë karrierë, shkurt një njeriu të cilini mund ta manipulojmë dhe ta drejtojmë si pas dëshirës.

— Nuk i dihet! — vërejti Meksi. Për shumë shpikje kështu është menduar nga kolegët, se ato do të ndodhen nën kontrollin e tyre, por koha dhe jeta i ka deziluzionuar.

— Ndaj dhë mendoj që aparatit t'i inplantohet një njeriu me zhvillim nën mesataren, i cili të shërbejë gati si një rregjistrues mekanik.

— Në fund të fundit ai është njeri dhe jo makinë. Sini tilë edhe më i pazhvilluari, në kushte të çaktuara, mund të për-

parojë. Polici që kërkojmë, vërtet mund të jetë ca i trashë, por falë informacionit jashtëzakonisht të gjerë që do të përfitojë nga «Sufi» ynë, ai jo vetëm që të duket i mençur, por inteligjenca e tij do të evoluojë e mbase mund të ndodhë edhe ajo, së cilës i trembemi.

— Çfarë mund të ndodhë? — pyeti Roberti.

— Të dali jashtë kontrollit tonë e të bëhet zullumqar.

— Ne s'do ta lejojmë!

— Kjo është një fjälë goje, Berti. C'propozoni konkretisht?

— Si të them, ah, po... le t'i inplantojmë, bie fjala, jo dy «Sufet» njëherësh... por vetëm njërin prej tyre. Pastaj shohim e bëjmë...

— S'është mendim i keq.

— Po ju, doktor, c'mendim keni? — pyeti Meksi, duke u kthyer nga kirurgu, që gjer më atë kohë i kishte dëgjuar i përqendruar, por gjithmonë i heshtur.

— Unë pres të më sillni njeriun, që do të operoj. Profesioni s'më sugjeron më shumë.

Meksi qeshi dhe i rrahu shpatullat.

— Do ta kërkojmë, doktor, dhe do ta gjejmë, bile shumë shpejt... Ankhi i dështimit s'ka për të më lënë të qetë, gjersat u provoj atyre kokëshkretëve, se ç'është në gjendje të bëjë «Sufi» ynë...

Megjithëse në vend të pesë gotave, që pinte zakonisht mbrëmjeve në pijetoren «Toreadorët» (një lokal i vogël në fund të rrugës «Trinidad», që s'mbyllej as ditë e as natë), polic Xhoni ktheu me një frymë edhe tri gota të tjera, prapëseprapë s'e ndjeu veten më të kënaqur. Ankhi i njeriut të mërzitur, që s'kishte bërë «hair» dhe që nuk shikonte asgjë të mirë në horizont, po e pushtonte gjithmonë e më tepër. Kjo gjendje shpirtërore i përsëri te shpesh kur ulej tek «Toreadorët» dhe vërente me një farë zilie njerëzit e shoqërisë së lartë, të cilët hanin, pinin, bisedonin, qeshnin me zë të lartë duke e ndier veten tepër të kënaqur e tepër të sigurtë.

Xhoni bënte bilancin e jetës së tij dhe vërente me keqardhje se trishtimi zinte kapitullin më të madh.

Ai shfreu si një buall i lodhur, duke i dhënë një të shtyrë gotës boshe, sipër mbulesën plastike.

— Edhe një, zoti Hovard!

I zoti i pijetores, Hovardi, një plak me origjinë skoceze, serioz e fjalépakë, si një makinë së cilës i janë përcaktuar përgjithnjë funksionet, me tri lëvizje mjeshtërore, shtyu drejt polic Xhonit gotën e mbushur me alkool të fortë.

I pezmatuar, duke mbajtur gotën midis gishterinxjet, si ata që bëhen gati të ngrënë dolli, me kokën që i varej poshtë si e këputur, me sytë të skuqur flakë e të përlotur, duke lidhur me zor fjalët, të cilat koka e tij mezi arriti t'i vinte sërë, foli:

— Zoti Hovard, s'bëheni merak, nuk jeni kurioz të dini ç'kam sonte që dukem si më i dëshpëruari njeri i botës?... Ti, Hovard, o plak i keq i Skocisë së fyejve, s'bëhesh merak, ti kurë s'qederosesh. Ç'fyell je ti, Hovard? S'të vjen keq për vëllanë tënd të Misisipit e të Amazonës, s'të vjen pak keq për mua? Mëso, Hovard, mësoni dhe ju o indianë qimebardhë, o indianë të çngjyrosur me kimikate, se unë jam polici më i dështuar i botës, më i humburi i botës. E kush ma var mua? E kush më pyet mua? Më pyet ti, o plak leshrabardhë e mjekërzi? A e njihni ju komisarin Grevald? A e njihni ju Grevaldin, shokun tim të fëmijërisë? Po policin Fred Soper, po policin çifut Abraham Horvic, po Pierin e shkretë, e kishit njohur?... Të gjithë shokë të një klase speciale, që të gjithë. Bashkë e nisëm rrugën, por u ndamë; ata ecën, u bënë me grada e me pozita, kurse unë... mbeta një polic rrugësh, polic i lagjeve të lëkurëzinjve, një polic që s'është i zoti për asgjë, veçse të tundë e të vërvisë shkopin prej kauçuku. Ja ç'i ka mbetur të gjorit Xhon! Një gotë, një shkop dhe rripi i mesit me revole të varur. Ja pse ti, o plak i Skocisë së akujve, ja pse ti, o mjegull e drexit, më hesht e s'di fjalë tjetër, veç «Give me! Give me! Give me!... Give!... Give!... Give!...».¹⁾

Polic Xhoni u bë si i çmendur. Duke uluritur, rrëmbeu nga duart e mpira të zotit Hovard një shishe «Shery» dhe e theu plot gjémë mbi banak. I shkreti Hovard! U struk në një qoshe të

1) Më jep mua.

banakut tē gjatë, duke u lutur që kjo zallahi tē përfundonte tē paktën me një ose me disa shishe tē thyera, por jo, larg qoftë jo, me kokën e bërë shoshë nga plumbat (qyteti ende s'e kish harruar mbrëmjen e dhjetorit tē pesë vjetve më parë, kur një i çmendur, kishte korru në një lokal, plot dhjetë vjetë, midis tyre edhe mikun e tij, atdhetarin Henrid).

Dhe ja, papritur e pa kujtar, në mes tē kësaj potereje, si kur tē kishin zbritur me parashutë nga qilli i mirësisë, dy burra iu afroan polic Xhonit, dhe Hovardi priti me ankth se ç'do tē ngjiste, si do tē zhvilloheshin ngjarjet... Njëri, ai më i moshuari, nxitoi t'i fuste në dorë një zarf tē mbushur, tē cilin Xhoni e hapi dhe e mylli sakaq, si i trembur. Plaku diç i tha në vesh, diçka tē cilën i dehuri s'dihet me siguri në e dëgjoi apo jo (Hovardi besonte se në atë gjendje polic Xhoni do tē mund tē bëhej esëll vetëm post'i dilte shefi përpara).

I bindur si një foshnje, duke shtrënguar fort zarfin e çuditshëm, duke u zgërdhirë, ndërsa lëkundej si mbi një sustë, Xhoni bëri udhë midis tryczave tē boshatisura me nxitim disa minuta më parë. Të panjohurit (Hovardi besoi edhe njëherë se ata duhej tē ishin tē dërguarit e posaçem tē policisë) e ndoqën pas tē heshtur. Ata dolën, kurse zoti Hovard filloj tē mblidhë copat e shishes dhe tē bënte llogari dëmin e shkaktuar duke mos ditur nga t'ia mbante. A ta fuste edhe shishen e thyer në llogari tē Xhonit, apo t'ia shkulte pak e nga pak?

— Kohë dreqi, Hovard! — iu drejtua vvetvetes. — Njeriu s'di kujt t'i kërkojë ndihmë. Policët janë bërë më tē këqij edhe se vetë hajdutët.

Gjithë ajo që ndodhi natën që shkoi në pijetoren «Toreadorët», Xhonit do t'i ishte dukur si endërr, po tē mos kishte në duar diçka shumë konkrete, tē cilën ende e mbante shtrënguar ndër gishterinj, zafil me 1.500 dollarë brenda dhe një adresë tē shkurtër.

Një çast i vajti mendja se ky mund tē ishte një kurth i pregatitur me kujdes nga komisari Grevald, i cili prej muajsh, s'kërkonte veçse shkakun më tē vogël për ta pushuar në vend. Mos vallë do ta akuzonin se kishte marrë ryshfet, dhe si i tillë

nuk meritonte më të bënte pjesë në radhët e policisë? Mendja e Xhonit i shkoqiste gjérat ngadalë e me vështirësi, që kur pëson një goditje të rendë në kokë; nga ajo kohë me zor mundohej të tregohej i denjë para eprorëve e ta fshihte atë të metë, veç e ndiente se rezultatet e tij qenë nga ato që s'ngrinën peshë. Ai, si i matufepsur e plak, rrallë e tek dorëzonte në policinë e qytetit ndonjë fëmijë të humbur, ndonjë zezak të gdhirë trotuarit, ndonjë pemëshitës që shkelte rrëgullat e qarkullimit.

E hodhi poshtë menjëherë dëshimin për komisarin Grevald, saporu kujtua se aikurrnac i keq, edhe për aksione me vlera të mëdha, nuk kishte për të rezikuar një shumë aqë të madhe, kurse për atë si Xhon's do të jepte qoftë edhe një çerek dollarë.

«Dhe gjersa në këtë mes s'është Grevaldi shpirtzi, unë do të shkoi në takim. Ndoshta fati më buzëqesh tanë, në fund të karrières sime shterpë» — tha më vete polic Xoni, ndërsa ngrihet më shumë mundim nga shtrati, i veshur ashtu siç kishte rënë pësë orë më parë, euforik dhe i giciluar nga ëndrra shumëngjyrëshe e përkëdhelëse. Edhe në gjumë kishte vazhduar të pinte uiski, po këtë herë i shoqëruar nga një damë elegante, e cila duke vallëzuar me të e përqafonte gjithë pasion. Një muzikë orkestre dégjohej diku dhe salla vezullonte... Pastaj që zgjuar dhe, plot trishtim e kishte gjetur veten në shtratin e tij të beqarit veshur e mbathur, më një zarf të rendë në dorë, për të cilin s'po i kujtohej qartë si e qysh i qe bërë kësмет.

Akoma mahmur, i hodhi një vështrim orës së xhepit (i kishet urryer gjithnjë, pa arsy, orët e dorës). S'mbeteshin veçse dyzetepësë minuta përt'u gjendur në vendin e takimit, tamam atje ku rruga «Sonreal» pritej si e zënë në befasi nga shëtitoreja mengjesit «Izmis».

«Duhet të nxitoj! — tha: Duhet të ndodhem atje, të paktën dhjetë minuta më parë. M'u dukën zotërinj të respektuar dhe s'duhet t'i lë të presin. Do të qe çnjerezore, një turp!

Një jetë të tërë, sidomos pas asaj traume, këtë kishte bërë, dilte kurdoherë i pari në takim. Vuante nga ajo mani që quhet kompleks inferioriteti, dhe gjithë t'jerët bile edhe fëmijët i dukeshin se qenë më të zgjuar, më të shkathët dhe vlenin më shumë se ai.

Veç të tjera vë nuk duhej t'u linte zotërinjve përshtypjen e një polici të humbur. Ndryshe, nuk do t'i besonin as edhe mi-

sionin më të vogël. E atëherë, lantumirë një milion dollarë. Si-gurisht një milion! Një paradhënie prej 1.500 dollarësh mund të jetë ekuivalente vetëm me një milion dollarë. Këtë, ai si Xhon, pamvarësish se koka i qe trashur disi, e nuhaste. Instikti i vjetër i policit i zgjonte mendime të dremitura, ndën pelerinën e ngrrohtë e të trashë të kores së trurit.

«Unë jam tepër i lodhur sot. Çfarë s'më vjen ndërmend, budallallëqe! — shfreu i mërzitur Xhoni. — Mos mendo! Asgjë mos mendo, o mendje e plakur! — i tha vetes. Ndryshe, do t'u dukesh një budalla, një i humbur... Mos mendo! Asgjë! Mos mendo! Mend... Men...»

Ai humbi në turmë. Mendimet po ashtu. I mbeteshin edhe dhjetë minuta.

«Dhjetë mendime... Dhjetë rrugë. Dhjetë katë. Dhjetë makina... Dhjetë police... Dhjetë komisarë... Dhjetë...». Kup-toi në çast se mendimet fikse po i pushtonin trutë dhe ai u mundua të nxitonte hapat, si të kërkonte t'i linte pas idetë fikse. «10 hapa... jo 11... 10 hapa... 10...»

Xhoni filloi të ekte edhe më shpejt. Duhej të ekte aq shpejt, sa të mos ishte në gjendje të numëronte.

Ata c prisnin. Polic Xhoni, i dehur siç kishte qenë, nuk kishte mundur të fiksonte tiparet e të panjohurve (edhe i papirë, Xhoni s'mund të mburrej për kujtesë portretesh, madje nga dy difekt i inteligjencës, ai besonte se i vinin breshëritë e pafund të të këqijave, eh!), por ai ishte i bindur, se ata, me-që kishin nevojë për të, patjetër që e mbanin mend, dhe veç të tjerave, ato 1.500 dollarët nuk i qenë dhënë për shpirt të babait. S'u gabua. I buzëqeshën si një miku të vjetër, duke e kundruar në sy për të hetuar reagimin e tij.

Si i përmendur, u buzëqeshi edhe ai. Pastaj ecën një copë herë të gjatë në shëtitoren buzë detit. Më së fundi ata i propozuan Xhonit diçka që atij iu duk e thjeshtë, interesante dhe që fshinte kuriozitetë të ëmbla. Madje porositë e pafund të të panjohurve për të heshtur e për të ruajtur të fshehtën gjer në varr, Xhonit iu dukën pakuptim.

— Xhon! — i kishte thënë më plaku. Tek ju pamë aq të dëshpëruar mbrëmë, tek «Torcadorët», menduan se mund t'u vijmë në ndihmë... po qe se jeni gati të pranoni marrëveshjen... Me sa duket Xhon, ju keni njohur pak ditë të lumtura në profesionin tuaj...

Xhoni pohoi me trishtim.

— Mister Xhon, ne do t'iu bëjmë policin më të njohur e më fatlum të shtetit...

Xhoni kapsalliti sytë e buhavitur, por s'pyeti se në ç'ményrë cngjëjt e mirësisë mund t'i sillnin parajsën në tokë (këtu, më plaku mendoi se trashësia e polic Xhonit duhej të rriste docmos vlerat e «Sufit» të tyre).

Plaku dha shpjegime më të hollësishme. Kështu, Xhoni mësoi se kishte të bënte me dy konstruktorë të shquar, laureatë të shumë çmimeve ndërkontakta, njëri prej të cilëve edhe i çmimit «Nobel», në fushën e akustikës. Prej disa vjetësh punonin për një aparat mikroskopik dëgjimi, i cili i inplantuar me një operacion delikat në veshin e mesëm, e bënte të aftë personin të dëgjonte biseda me zë të ulët gjer në një distancë prej pesëqind metrash.

— Kështu që, i dashur Xhon, ju presin ditë të bukura. Famë, lavdi, miliona dollarë, këto do t'i keni pa kursim!

— Kur do të më operojë Dr. Ferdi?

— Nesër mbrëma. Xhoni... «Bota e madhe e tingujve do të shpaloset përpara veshëve të tu e pa fund, sa e bukur aq edhe e tmerrshme, sa përkëdhelëse e nanuritëse, aq e ethshme, tronditëse dhe shqetësuese gjer në torturë. Fare pak tinguj është në gjendje të përceptojë veshi ynë i zakonshëm. Por kjo e metë është njëkohësisht edhe mbrojtja më e mirë. Kurse ti, Xhoni, do t'i dëgjosh të gjitha, ti do t'i zbulosh të gjitha. Vallë i lumtur apo fatkeq do të jesh ti Xhon?» — mendoi shkencëtarit plak, Ferdi, duke vështruar Xonin, që zgërdhihej, me një ndjenjë që qëndron e varur pezull dhe e ndërthurur midis dhembjes mëshirës e talljes.

— I trashë! — tha me vete. Një i mangët, që tani e tutje do të duket si më i zgjuari polic i vendit. Një gjysmëidiot që dëshëron të bëjë karrierë, që do të bëjë karrierë me siguri, megjithatë, një subjekt i shkëlqyer për eksperimentimin e «Sufit» tonë. S'ka ku të shkojë më mirë!...

— Na, merri! Janë 5000 trakte. Kujdes! Mosib jep shenja shqetësimi... — Cili është ai në qoshe, më duket i dyshimtë.

— Duket pret dikë.

— Kaq herët?

— Nisu Bredi. Njerëzit filluan të dendësohen.

I ngritur përgjysmë mbi shtratin e klinikës së doktor Ferdit, mbështetur me mundim mbi bërryl, me sytë të hapur tej masc, si i çakërdisur, me veshin «spiun» kthyer nga dritarja, polic Xhoni, të nesërmen pas operacionit, dëgjonte fare qartë bisedën. Ai që mori pakon e trakteve, nxitoi të largohej. Xhoni e kuptoi këtë nga trokitjet e forta e të shpejtuarat të këpucëve mbi kaldrëmin e trotuarit. Polic Xhoni u hodh me një frymë në dyshemënë plastike, më bilbilin në gojë dhe gishtin në këmbëz. Por nga dritarja e klinikës rruga, atë orë të hershme mëngjesi, iu duk e shkretë. Atëherë hapi dritaren për të parë më mirë. U zgjat jashtë saj dhe, megjithëse «dikush» e cte në trotuar, ai nuk shihte asgjë. Gati i shqeu sytë, gati ra nga përkulja mbi parvazin e dritares e përsëri nuk pa njeri. Çapet diku u ndalën. Xhoni dëgjoi uturimën e mbytur të makinës së porsandezur, gulçimat e para të thekshme të saj përpëra se të nisej, zhurmën e zakonshme të një makine në lëvizje e pastaj gërvimën e rrotave mbi asfalt.

Si i trullosur, i ra fort ballit me pëllëmbë. Nga kjo mrekulli Xhoni i mbremshëm meritonte, të quhej një shurdh përpëra Xhonit të këtij mëngjesi. Tani e tutje do të ishte zot i plotfuqishëm i të gjithë varieteteve të tingujve, të një zone goxha të gjërë, diametri i së cilës i kalonte të katërqind metrat.

«Ç'lumturi, ç'fat më trokiti kështu në derë? Xhon, o mbret i zërave, o mbret i tingujve, o zoti i gjithçkaje. Ç'do të jeni përpëra meje ju Soper, ju Abraham edhe ju Grevald. Nga do t'ia mbani? Se mos pak jeni tallur me mua, pak qeshnit, mos më pak më fyenit prapa krahëve?».

Filloi të qeshte e të kërcente si fëmijë. Pastaj ndërrroi mendje. Ktheu veshin «spiun» nga dritarja. Qyteti po gjallërohej. Fragmente bisedash të ndryshme i vinin në vesh. Si t'i kishin futur në një centrifugë gjigante rrotulloheshin, përziheshin, ka-

cafyteshin, ndaheshin, përllesheshin, dilnin në sipërfaqe, zhytshin, rilindnin, mplekseshin, precipitonin, sakatoseshin, fitonin forma e proporcione të reja, të gjithfarëshme, kaos, kaos, kaos.

U drodh, u tmerrua. S'po kuptonte asgjë. Fjalët, tingujt, bashkëtingëlloret, zanoret, i ndërhyrin njëra-tjetrës pa më të voglin rregull, si të mërzitura nga vendet, që zinin që në lashtësi.

Dy orë më vonë, kur lëvizjet e njerëzve e të makinave kishin arritur kulmin, polic Xhoni, si një kafshë eksperimentale së cilës i kanë injektuar një dozë të mirë striknine, hidhej e kërcente nëpër dhomë si një i çmendur, me fytyrën e shtrembëruar keqas e në mënyrë të shëmtuar nga tmerri, me gishtat tregues të futur thellë në kanalet e mëdhenj, të errët e leshtakë të veshëve, duke dashur të pengojë sado pak morinë milionëshe të tingujve, që i përplaseshin në timpan pa pushim.

— O Xhon, o teveqel i pandreqëshëm! — iu drejtua vetes! — Kërkove të bësh karrierë tani në fund të jetës sate?... Hm, deshë të bëhesh mbreti i tingujve, mbreti i zërave, i fshehtësisë, Mbreti Xhon! Zhurmë e mallëkuar, s'të duroj dot! Jo!

Polic Xhoni u përpinq të rikrijonte efektin psikologjik, që do të kishte pasur mbi qenien e tij shpërthimi i njëherëshëm dhe i beftë i 10 bombave atomike. Besoi i sigurtë se zhurma e shpërthimit bërthamor s'qe veçse një shushurimë e ëmbël dhe nanritëse fletësh të njoma, përrpara kësaj mynxyre të pafund tortura gjer në dhembje.

Pak më vonë, diku (ai ende s'orientohej dot në labirinthet e panumërt të tingujve) dikush po gjerryente me një vegël metalike mbi një mur fasade koren e trashë të bojës. Qëkurse ishte fëmijë, zhurma gjervishtëse e shkumbësit mbi dërrasën e zezë i sillte një shqetësim aq të madh nervor sa gati nuk ulërinte nga ndjenja neveritëse (një nausea e vërtetë) për të dalë mandej, me zhurmë e gjëmë nga klasa, por përfytyrimi i shkopit të mësuesit plak dhe shpulakat e mëdha të të atit ishin të mjaftueshme përtë mbajtur nën fre Xhonin e vogël.

Kësi rastesh fëmija mënd shkulte flokët nga ankthi i përshkrueshëm.

Porse kjo lloj zhurme e ashpër, e perceptuar nga veshi «spin» si e qindfishuar, ishte një farë tryele cfilitetë e mprehtë, viaskat e së cilës i rrötulloheshin me tërbim, në indin e butë të trurit.

Një zhûrmë zotëruese mbi një milion të tjera! Një ankth, një torturë qelli. Ai klithi duke hapur sytë i tmerruar, me duart të mbledhura grusht, si të pregatitej të sulmone dikë. I erdhë për të vjellë dhe volli me mundim, duke gulçuar si një i sëmurë i vërtetë. Me kokë të rënduar u var mbi pezulin e dritares, për t'u oriëntuar sado pak dhe për të marrë ajër të pastër. Veshi spiun, duke rrokur e fuqizuar lloj-lloj tingujsh, i kishte gjymtuar menjjes orientimin e saktë në hapësirë. Ndoshta gërryenin mbi fasadën e një grataçeli dyqind metra më tutje, mbasë të një ndërtese fqinje. Mbreti i zhurmave, i sëkëlldisur dhe i vrarë, i pafuqishëm, u lëshua mbi krevat. Shtrirë siç qe, me gishtërinjtë e djersitur formoi numrin e gjatë telefonik prej tetë shifrash 70263262. Pás disa sinjalesh të ndërprerë, në monitor doli shembullimi i portretit simpatik të kirurgut Ferdi.

— Hello Xhon! Ç'keni kështu? — pyeti profesori me një dashamirësi ironike.

— Nuk lokalizohej dot zhurmat dhicë kjo po më çmend!...

— Çështje muajsh, Xhon! Nga pak stërvitje çdo ditë, truri do të ambientohet me gjendjen e re dhe ti, Xhon, do të jesh një radar i vërtetë.

— Po gjer atëherë unë do të los nga mendtë. Ndaj më mirë rioperomëni dhe ma hiqni aparatin. Le të mbetem ashtu siç isha. Nuk më duhet as fama dhe as lavdia. Nuk dua të jem mbreti i zhurmës...

Profesori qeshi.

— Qenkeni lodhur, Xhon. E kuptoj gjendjen tuaj, por kjo është e përkohshme. Nesër ju presin milionat, kulmet e famës e të lavdisë, gjithçka.

— Ma hiqni, profesor! — u lut polic Xhoni si të mos kish të dëgjuar gjësendi. Hiqmani!

— Teknikisht është e pamundur. Mund të shurdhoheni plotësisht, ose mund edhe më keq, të vdisni. Pra, zgjidhni e merrni.

— Më mirë shurdh, sesa kështu — shfreu i pikëlluar polici.

Profesori buzëqeshi me ironi të hollë, si të kishte përpara një nxënës shkolle.

— Oho, kaq e lehtë qenka për ty, Xhon? Atëherë mund të vini që tanë. Të shkatërrosh diçka, është gjëja më e lehtë...

Polic Xhoni, si një pulë që porsa i kanë prerë kokën, push-

tuar nga plogështia kapitëse, lëshoi dorezën e videotelofonit dhe mbylli sytë. Papritur ndjeu t'i njomeshin.

— Për ty, vëlla Xhon, — iu drejtua vetes — s'ka rrugë tjetër. Nuk mund të kthehesh prapa. Nuk të lënë të kthehesh, veç të shurdhër, veç të vdekur. Le të bëhet si të bëhet... Edhe pse kaluan katër muaj, polic Xhoni akoma s'qe në gjendje të lokalizonte me përpikmëri vendburimet e tingujve e të zhurmave. Këtë gjë shkencëtarët Robert dhe Meks e kishin parashikuar. Llogaritjet shkencore vërtetoton edhe njëherë akoma «trashësinë» e policit të matufepsur Xhon. Sa për mikrofonin e implantuar në veshin e pollicit, ata mund t'i thoshin cilido, me sigurinë më të madhe, se ai funksiononte në mënyrë të shkëlqyer. Qenë të bindur se vetëm pas disa muajsh Xhoni do të arrinte sukseset e para. Ultramikrofoni i tyre do të kompensonte për bukuri zhvillimin e mangët mendor të pollicit Xhon dhe padyshim do ta ndihmonte të bënte një karrierë të ndritshme. Reklamë më të mirë s'kishin ku të gjenin për «Sufin» e tyre.

Në fund të vitit, polic Xhoni, papritur e pakujtuar, i dha informatën më të rëndësishme të muajit komisarit Grevald.

Ai kishte qëndruar në këmbë, ballë për ballë tryezës së shokut të fëmijërisë Grevald, duke pritur shefin të mbaronte së shtypuri një shkresë «tepër sekrete». (Ai i besonte sekretares letrat «sekrete». Ndërsa ato që emërtoheshin «tepër sekret» i daktilografonte vetë). Xhoni nuk priste që shefi ta ftonte të ulej. Grevaldi kishte vite që s'e bënte këtë.

— Hë, Xhon, ç'erë e mirë të solli?

Xhoni u përmend dhe buzëqeshi si i zënë në faj.

— Zoti Grevald, ju sjell një informatë të rëndësishme.

— Pa hë? Ç'lajm na qenka ky? — pyeti Grevaldi me indiferencë dhe ftohtësinë e komisarit të policisë, që e njeh mirë kapacitetin dhe nuhatjen profesionale të vartësit.

Polic Xhoni u skuq lehtë.

— Zoti Grevald (ai befas e ngriti kokën plot dinjitet, duke u kujtuar se me «Sufin» e tij të jashtëzakonshëm, paskëtaj).

kishte për të vlejtur sa për disa Grevaldër), nesër mbrëma do të sulmojnë depon e armëve të Betrekeldit.

— Ashtu? — vërejti kinse i çuditur komisari.

Si të mos kishte dëgjuar, ose të paktën, duke u shtrirë si kur nuk e kuptoi tonin ironik të shefit, polic Xhonit bëri një përshkrim të hollësishëm të mënyrës, se si do të realizohej ai sulm.

Grevaldi e dëgjonte me mosbesim të hapur, duke trokitur me padurim e nervozizëm këpucën e djathë mbi dyshemë, gjersa ai kallëzim i gjatë, plot hollësira fantastike, mori fund.

— Më thuaj, i dashur Xhon, — e ndërpren befas Grevaldi i mërzitur — mos ke pirë esëll disa gota uiski dhe tanë po shëndrra me sy hapur?...

— Ju siguroj zotëri se s'kam pirë as edhe një gotë! Këtore që ju them, i kam dëgjuar me veshët e mi. Targat e makinave i shënova, meqenëse mund t'i harroja. Ngjyra e makinave, këtu mund edhe të gabohem, duhet të jetë e verdhë.

Grevaldi s'e mbajti të qeshurin:

— Xhon i dashur, që kur ke filluar të shohësh ëndrra mëngjyra?

— S'eshtë koha për shaka, zoti Grevaldi! Unë po jemi paralajmëroj nga burime të sigurtë për një vjedhje të madhë! Në rast se nuk doni të mirrni masa...

Toni i polic Xhonit kësaj radhe qe energjik dhe i përcerë, gjë që e detyroi komisarin Grevald të mbante një farë serioziteti dhe t'i linte përshtypjen mvartësit se e kishte dëgjuar seriozisht informatën dhe e çmonte.

— Mirë, Xhon! Do të marrim të gjitha masat. Faleminderit, faleminderit shumë!

Falënderimet i tingëlluan disi ironike polic Xhonit, përsë bëri veten. E ardhmja e shkëlqyer, që i shtrihej përpara, dhe idëja se si do të hakmerrej kundrejt gjithë asaj ironie e atij mosbesimi të shefit, e bënë të vinte buzën në gaz. Polici 55-vjeçar po rifitonë çuditërisht dinjitetin e Xhonit të dikurshëm 15-vjeçar. S'bëhej fjalë për më shumë. Pas goditjes së rëndë të kokë, vite të shkuara, mjekët shpresonin t'i riktheheshin disi nga afëtësitë mesatare të moshës së re, që trauma i pat copëzuari e është varitur, tamam atëherë kur pritej lulëzimi i tyre; përvhivillim të mëtejshëm të intelektit të tij, mjekët neropsikiatër prej kohësh nuk diskutonin më.

Nëse vite të tëra ai qe përpjekur të mbyllte dyert e zyra ve me kujdesin më të madh, duke u orvatur të shmangete edhe kuisjen tankintare sado, të vogël të bravave, kësaj radhe e prishi me ndërgjegje këtë zakon.

Doli jashtë zyrës së Grevaldit pa e vështruar në sy e pa i buzëqeshur, pa j'u përkulur paksat, madje duke tërhequr derën e trashë me një farë shkujdesje.

«Sufi», i tij e shumëfishoi dhe e fuqizoit të mase kuisjen e bravave. Ai qëndroi një çast, duke mbajtur fryshten, prapa derës së mbyllur, duke pritur me një farë tensioni klithmat e inatosa të Grevaldit. Por ai nuk bërtiti. Xhoni dëgjoi qartë, fare qartë, si t'i kishin folur me zëstë lartë në vesh, pëshpërimën e shefit që fliste më vete.

— Idiot! A mund t'i zihet besë informatës së një idioti? 999 herë, me siguri asgjë s'ka përfshirë ngjarë, një përmijë, ku shedi.

Pastaj Xhoni dëgjoi qartë zhurmën e përsëritur të diskut telefonik dhe pas pak zërin e Grevaldit.

— Necke? Po, po, Grevaldi jam. Bllokoni me forcat kryesore portin jugor. Po, po, të gjitha forcat. Veriu? S'ka gjë. Informata është e sigurtë. Grevistët do të vinë vetëm nga jugu.. Faleminderit!..

Grevaldi lëshoi i shkujdesur dorezën mbi trupin e telefonit dhe thua jse menjëherë Xhoni dëgjoi zhurmën karakteristike të gërvishtjes mbi letër. Grevaldi shkruante. Atë çast, policia Xhoni ëndërrroi me shpirt, që, veç «Sufit», t'i kishin inplantuar brenda në sy një aparat perfekt mikroskopik pamës, përfshirë cilin, të mos ekzistonin pengesa të tillë të padëshërueshme, si mure fasadash, dyer, perde të trasha, dritaresh, gjithçka e ngjeshur dhe kompakte. Atëherë, ai si Xhon, do të qe i paarritshëm.

Endjeu s'e kish vajtur shumë larg me fëntazinë, ëndërrat dhe emirën e tij...
— Zoti më ruajtë! — mendoi i përvuajtur. Unë dëshërova të di vetëm q'po shkruan Grevaldi im! S'desa asgjë më shumë se kaq!»

Ai dëgjoi zhurmën e karriges së shtyrë nga njeriu që ngrihet, dhe nxitoi të largohej.

Doli në rrugën e gjerë të mbushur më njerëz dhe makina. Qindra-mijëra tinguj, zëra e gërvima i përplaseshin në timpan me furinë dhe egërsinë e një stuhie të vërtetë, por nuk ndjente aspak shqetësimin e dikurshëm. Përkundrazi. Mornica të emb-la gjëzimi iu derdhën trupit si një ujëvarë e ndritshme. Shumë më qartë se muajt të shkuara, perceptonte dhe qe në gjendje të veçonte njëra nga tjetra njëqind biseda njëherësh. Fati i madhi jo vetëm i kishte trokitur në derë, por si një djalë çapkën dhe i papërmabjatur, i kishte rrëmbyer dorën Xhonit dhe po e tertiqite me forcë në rrugën e famës e të lavdisë.

Nga shëtitoria «Lumturia» deri te magazina dhjetë katëshe e zotit Gregor, regjistroi dhjetë biseda intime në bllokun e vogël të shëhimeve. Bisedat iu dukën të rrezikshme e të dyshimita.

Ndoqi vetëm dy prej tyre. Mësoi vendbanimet, u interesua te fqinjët përfshirë mësuar hollësi të tjera nga jeta e tyre dhe cngjeshi bllokun me shëhime.

Kur nuk qe larguar më shumë se 200 metra, një plak, pasi pështyu përdhe me mllef e neveri, e shau me fjalët më të ndyrë që njihet si qytet, duke thënë se mbledhja e informatave që bërë epidemi e padurueshme, një torturë ferri...

Xhoni është dëgjoi. U ndal një copë herë dhe ktheu lehtë kokën, si i menduar, nëse ia viente të merrej me një plak, apo të vazhdonte rrugën. Atë kohë, 220 metra më tutje dëgjoi plakun të thoshte: «Xhon ti s'je veç një piganec e kurvar i keq që meriton plumbin si një qen rrugësh pa zot». S'duroi më. Iu afroa thuajse me vrapi plakut dhe e urdhëroi të pushonte së shari. Plaku u betua se s'kishte nxjerrë fjalë nga goja. Atëherë, Xhoni i përsëriti me pikë e presje, gjer në hollësitë më të vogla, sharjet nga buzët e plakut. Gojëhapur, i shtangur dhe i tmerruar, plaku s'e dëgjoi gjer në fund. U rrëzua pa frymë në këmbët e tij. Xhoni buzëqeshi triumfalish.

«Viktima e parë! — mendoi. — Sa të tjerë do të të pasojnë, o plak? Do të kisha dashur me shpirt që në vendin tënd të që Grevaldi faqezi! Ah, por edhe ai do të më njohe. Shpejt bile, shumë shpejt...

Depot e armëveru sulmuan pikë pér pikë sipas përshkrimit të polic Xhonit. Mbështetur në poltronë, i pafuqishëm i vrarë shpirtërisht, Grevaldi dëgjonte raportet e hollësishme të agjentëve të tij.

«O zot i madh! C'po ndodh kështu me mua? Sikur e kam parë me sytë e mi edhe njëherë tjetër këtë vjedhje. Ai, idioti i shkretë, na paskërkë pasur një telepati të çuditshme. Le që, jo rrallë, budallenjtë ua kalojnë kokave të mençura me profecitë e tyre të çmendura. Veç, në mos është ngatërruar edhe ai në ndonjë rrjetë gangosh dhe, në çastin e fundit, i trembur pér vdekje nga karrigeja elektrike, i ka tradhtuar. Hija e rëndë dhe e errët e dyshimit mbuloi fytyrën e kontraktuar nga ankthi të komisarit Grevald.

«Po sikur ai mumje të ketë paralajmëruar, ose të paktën, sikur tani të sinjalizojë ministrin pér çkujdesjen time? Nga do t'ia mbaj?

Agjenti vazhdonte të jepte një raport të hollësishëm pér rezultatet e para të ekspertizës, dhe Grevaldi bënte sikur dëgjonte. Pastaj heshtje. Agjenti në qëndrimin gatitu priste falenderimet e rastit dhe lejen pér t'u larguar. Grevaldi u përmend:

— Aha, mirë, mirë faleminderit! Mund të shkon. Tjetri!

Agjenti nderoi, duke prekur me gishtërinjtë e mbledhur strehën e kapeles republikë dhe doli, duke e lënë derën gjysmë të hapur.

Grevaldi u skuq lehtë dhe u përcoll i zënë ngushtë, kur në dhomë hyri polic Xhoni.

Instiktivisht u ngrit më këmbë si i hutuar. I shtrëngoi dorën dhe e ftoi të ulej:

Xhoni nuk pranoi.

Grevaldi u pre. S'i mbeti gjak në fytyrë. Xhoni po jepte simptomat e para të pakënaqësisë dhe të hakmarrjes.

— Nuk kam nge të ulem. Më presin akoma shumë punë: tha prerasi Xhoni, me pamjen e shtirur të njeriut të zellshëm. Për depot e armëvet nuk më dëgjuat, të paktën dëgjoni këta...

Papritur që Grevaldi t'i jepte lejë, thërriti në drejtim të korridorit.

Shoqëruar nga rojet, në dhomë hynë dy burra. Një rreth të 30-ave, tjetri mbi 50-at. Dukeshin të nxehur e të skuqur piper në fytyrë. Më i vjetri, i hodhi një vështrim të rëndë, përbuzës dhe plot urrejtje komisarit Grevald, ndërsa kryqëzonte me dinjitet duart dhe bërrylet mbi gjoks. Më i riu, pështyu përpara këmbëve e pastaj, pa ia ndarë sytë komisarit Grevald, kërciti me një zhurmë të bezdisshme e të padurueshme gjer në nausë, nofullat muskoloze.

— Që kur, policët tuaj, pa asnje shkak filluan t'u hedhin prangat qytetarëve të ndershëm? — pyeti pesëdhjetëvjeçari.

Grevaldi, në pritje të sulmeve të reja, u përkul mbi tryezë, duke studjuar me vëmendje tiparet e të porsaardhurit, ndërsa polic Xhoni buzëqeshi si një shenjtor i mirë dhe i pafajshëm. Burri, i papërmbajtur, për dy minuta rresht lëshoi në drejtim të Grevaldit, Xhonit dhe të gjithë gjithë policëve të qytetit, një breshëri sharjesh nga më të fëlliçurat, aq sa Grevaldi do t'i qe hedhur në grykë, në qoftë se Xhoni s'do ta kishte qetësuar me buzëqeshjen e përmbajtur të agjentit, që di kujt ia ka hedhur prangat dhe që pret me qetësi stoike zbrazjen e plotë të viktimitës për t'i dhënë pastaj goditjen dërmuese.

Burri tha ç'kishte për të thënë, konsumoi pa kursim të gjithë fjalorin e sharjeve dhe të shprehjeve poshtëruese dhe, i lodhur, ndërsa fshinte ballin e djersitur, i hodhi një vështrim triumfator komisarit Grevald dhe polic Xhonit, në pritje të shprehjes aq të dashur kësi rastesh «Na ndjeni!... Bëhen edhe gabime. E qortojmë polic Xhonin për pakujdesinë dhe e dënojmë me gjobë. Jeni i lirë! Edhe njëherë tjetër akoma ju kërkojmë të falur!...».

Por asnjeri nga të dy nuk lëvizi vendit. Xhoni, ndërsa buzëqeshte lehtësish, duke vështruar viktimen si gjuetari gjahun e zënë në lak, shflettoi një bllok të vogël shënimesh.

— A e njihni, atë që do të organizojë demonstratën e 1 Majit, zotin Eliks? Po zonjën Meri? Po këtë adresë të shkurtër? S'besoj që numrin e gjatë telefonik 9301838 ta keni harruar. Mos ju doli nga mendja se sonte më ora 23.00 iu pret një veturë «Klejd» me targën Nr. 0035013 përpara hotelit «Horizonti», ku do të merrni në dorëzim traktet e festës tuaj?

Duke qeshur triumfalish, Xhoni vështroi me ngulm burrin, fytyrën e të cilit e mbuloi befas një zbetësi e frikshme, si-

kur nga çasti në çast pritej t'i binte vilani ë të mbetej në vend.
— Si eshtë e mundur... si eshtë e mundur?!... Si?! — gati pëshpërithi, si ndër ethe dhe si i humbur, burri pesëdhjetëvjeçar. Këtë e kemi ditur vetëm pak vetë...

Më i riu, kontrabandist i njohur lëndësh narkotike, njëkohësisht i sëmurë nga helme të tilla, duke vështruar nëpër dhomë, si një bishë e egër rënë në pritë, dalloi dritaren paksa të hapur dhe u turr drejt saj. Grevaldi ulériu, i bëri shenjë Xhonit që ta pengonte të hidhej, por Xhoni s'e bëri qejfin qeder. Gjakftohtë dhe buzëqeshur, si gjithnjë, vështroi djalin me flokët e shpupurisur e të ngritur përpjetë nga goditja e rëndë psikike tek hipi mbi parvaz të dritares, tek qëndroi një çast i pavendosur mbi hapësirën dyqindkëmbëshe e më pastaj të zhdukej nëpër boshllékun, si të mos kishte qenë kurrë.

Grevaldi ndjeu t'i priteshin të gjitha forcat. I prekur disi, nga skena që pa dhe i stepur nga zbulimet e mëdha e të papritura të vartësit, nguli sytë i menduar, e si i shushatur në një pikë të dyshemesë.

«C'ka ndodhur me të? C'është ky gjenialitet i beftë? Mos eshtë tallur me ne një jetë të tërë dhe ka luajtur mjeshtërisht rolin e budallait? Hm, çudi, në fizionomi ka mbetur po aq i trashë, po aq i humbur. S'besoj të jetë një aktor kaq i talentuar. Atëherë, ç'është ky teveqel? Mos vallë eshtë ngatërruar me ndonjë bandë të fshehtë, që sapo ka nisur të nxjerrë kthethrat e të asgjësojë konkurentët e fuqishëm të saj? Xhon, o dreq, s'po të marr vesh. Ti po më çmend me këtë zgjuarësinë tënde në prag të pleqërisë. Xhon, o ndyrësirë, cilat do të jenë viktimat e tua të ardhshme? Më ke regjistruar edhe mua në bllokun tënd të vogël?...

Komisari Grevald iu duk polic Xhonit i menduar dhe disi i trishtuar, megjithë përpjekjet, që bënte për të mos e treguar yeten përpëra vartësit. Për herë të parë, pas shumë vjetësh, Xhoni po shijonte frutin e ëmbël të hakmarrjes së shumëpritur.

Me gjithë intuitën e plakur dhe shterpe, që s'hodhi sythe e nuk lulëzoi qoftë edhe një ditë të vetme, Xhoni s'e pati aspak të vështirë t'i bënte një autopsi të plotë psikologjike komisari Grevald, ato çaste të rënda, kur i mbështetur tëresisht në poltronë, me krye të rënduar e të varur mbi gjoks, vështronë si i përhumbur hapësirën midis dy kanateve të dritareve.

— «Grevaldi filloi tē mē ketē frikë! — mendoi polic Xhoni. — Kjo duhet tē mē bējë mē tē kujdeshëm. Me njerëz tē zot si ai; nuk mund tē bësh shaka... Ai s'më ka buzëqeshur kurrë nē jetë dhe s'më ka ledhatuar. Tani mund t'i bējë këto, duke pritur çastin e volitshëm tē më ngulë thikën. I tillë është ky Grevaldi!»

Xhoni, s'pati më kohë tē mendonte. Grevaldi erdhi nē vete. Duke turndur dorën; si tē shfajësohej, i buzëqeshi lëtë Xhonit.

— Më falnil! Filluam tē plakemi, Xhon!

Xhoni i ktheu më mirësjellje buzëqeshjen.

— Vërtet! — pohoi ai — nē filluam tē plakemi... Dhe duke e kuptuar, aty përi aty, se s'i kishte shtuar asgjë tē re mendimit tē papërcaktuar tē Grevaldit; por pati folur sa për t'u gjendur, nē muhabet, shtoi:

— Zoti Grevald, a keni vende tē lira nē burg?

— Ka kohë që burgu intanishëm po na duket tepër i vogël. Pse pyesni?

— Do tē na duhen shumë vende, së shpejti.

— Përse vallë? Ç'ka zbuluar ky ish-idioti? — pyeti vreten komisari. — Ngafjalori i policëve tanë termi: «i dyshimtë», duhet flakur si një xhungë e keqe tumoroze! — vazhdoi Xhoni.

I dasbur Xhon, ju po përparoni me ritme tē mahnitshme. Ç'po ndodh kështu me ju?

Asgjë e veçantë, maturia e zakonshme e agjentit nē prag tē pensionit. Thjesht një çështje nuhatjeje, punë qensh, diçka e përngjashme me ta.

Grevaldi qeshi përsëri, kësaj radhe me zë tē lartë, dhe Xhoni pati përshtypjen e çuditshme tē cimbisjes së thikës mbi kurrit.

Megjithatë ai ia ktheu buzëqeshjen me mirësjelljen. * * *

Për t'u çuditur! «Sufi» mikroskopik po i ngacmonte dhe guduliste ndjenjën gati tē panjohur dhe tē ëmbël tē kureshtjes, tē cilën ndryshe nga fëmijët e tjerë, s'e kishte pasur as kur kishte qenë i vogël.

Ditë e natë polic Xhoni, si një merimangë e zezë gjigantë, endej dhe kacavirrej rrugëve, autostradave, hoteleve, magazinave, bibliotekave, shkollave, universiteteve, kafeneve, kino-teatrove, stadiumeve, shesheve sportive, lokaleve të berberëve, metrove, aerodromeve, zyrave, bankave, porteve, grataçicleve, shesheve, pijetoreve, shtëpive, vilave, ministrive, kudo! Dukej si i ardhur nga një botë tjetër. Polici kthente veshin spiu si një radar të vogël, sa majtas, djathtas. Shumë rrallë ndalej për të dëgjuar më mirë. Viktimen e ndiqte në ecje. Gjithkush çuditet tek e shihte shpesh të nxitonë faqekthyer, por askujt s'i shkonte ndërmend ç'e detyronte të përdridhë me aq mundim qafën e trashë e të dhjamosur. Muajt e parë e panë shpesh të shkruante me nxitim në ecje e sipër, por kjo gjë s'bëri ndonjë përshtypje të veçantë, sepse në atë qytet, që bërej thuaje një pamje e zakonshme. Për të qenë më të sigurt, shkencëtarët Meksi dhe Berti e porositën të vinte në lëvizje kujtesën. Madje, s'qe e domosdoshme të shënoheshin hollësish në bllok të gjitha ç'dëgjoheshin. Të paktën Xhoni u ngushëllua me aftësinë e tij tashmë të sigurtë e të sprovuar mirë të prëcizionit. Orientohej për bukurinë atë lumë njerëzish. Gradualisht shkurtonte largësinë me pararendësit, në 100 metrat e fundit sigurohej për nuancat e veçanta të zërit, në të 50 metrat lokalizonte ndër njëzet kalimatë bashkëbiseduesit dhe pastaj... Sulmi i rrufeshëm. Ndjejkjet më të vështira, natyrisht, qenë ato në ecje e sipër. Ndryshonte puna, kur që fjala për ndjejkjet e qeta, siç i quante ai qëndrimet shumorëshe në trotuaret ose sheshet buzë pallateve. Këtu nuk gabonte, kur e cilësonte veten si një mjeshtër klasi. Kishte gabuar vetëm njëherë, por kjo s'ngrinte shumë peshë. Ai pothuajse nuk mërzitej. Qëndronte ngjitur me fasadën e pallatit, tamam atje ku muret e larta sapo fillojnë e hedhin shtat, një, dy, tre orë...
Mban vesh. Dëgjon muhabete të zakonshme në katën e parë. Gruaja s'paska gatuar mirë. Zëri i trashë çfaq hapur pakënaqësi dhe shtyn tutje pjatën. Në katin e dytë një dramë e vogël. Djali i mitur, i droguar, kërcënon me thikë prindët. Po në atë kat, një alkoolist është gati të vrasë veten. Mbyll derën me çelës dhe, ndërsa shkruan, lexon me zë të ulët, gati të përvajshëm qëdo radhë të letrës së fundit. Xhoni pështyn në trotuar i sigurte se alkoolisti psikopat do ta grisë letrën, sapo ta mbarojë së

shkruari. Në katin e tretë një çift i porsamartuar është futur në diskutime pa mbarim rreth një çështjeje trashëgimie. Po atje, burrë e grua, që sapo janë ndarë shumë përzemërsisht nga fqi-njët, komentojnë pritjen dhe tallen prapa krahëve me ngathësi-në e zonjës, ku qenë përvizitë...

Si një kafshë e egër, që ndien së largu erën e gjahut, Xhoni vigjëlon në pritje me muskuj të tendosur e sy të zgurdulluar. Veshi spiun, kthyer në drejtim të katit të dhjetë, majtas, në muzgun e mbrëmjes duket veçanërisht i stërgjatur, si të qe vesh i një dinosauri gjigant. Një kalimtar i shkujdesur i shkel padashur këmbën, por Xhoni i mpirë nuk ndien gjësendi. Udhëtari i kërkon të falur, por Xhoni, si i rënë në kllapi të ctheve s'dëgjon, s'kupton. Kështu, pesë minuta, dhjetë, pesëdhjetë. Pranë tij, një grup të rinjsh çapkënë shkrihen së qeshuri dhe e tregojnë me gisht, por Xhoni s'bëhet i gjallë. Në minutën e 51-të, sikur pa pritur e pakujtuar ta kishte kafshuar një kafshë e egër grabitqarc, Xhoni kërcen përpjetë dhe me vrap kalon hyrjen e dricuar të pallatit. Në ashensor një plakë është gati të niset. Si një portier i shkathët, Xhoni kërcen tre metrat e fundit, që e ndajnë nga kabina dhe hidhet mbi plakën e tmerruar që bërtet. Xhoni s'ka kohë të humbasë. Shtyp butonin për në katin e dhjetë. Plaka ulërin, thërret për ndihmë (hajdutë të veshur si policë, një modë e zakonshme për qytetin), po Xhoni brenda në kabinë, tek kalon me shpejtësi katet nuk ndihet. Thuajse i ngirrë, me veshin spiun kthyer nga dera, përpiqet të thëthijë fragmentet e fundit të bisedës intime, rrap-xhapin monoton të makinës së shkrimit, deri edhe gjërvishtjen besdisëse të pendës mbi letër. Plaka zverdhet, këputet përpara fantazmës së policot, rrëzohet sa gjatë-gjerë në këmbët e tij. Ai s'ka ndier, s'ka kuptuar, s'ka marrë vesh gjësendi. Vazhdon të ngjitet, duke u orvatur me mundim, të mos shkëpusë lidhjen. Ja më në fund kati i dhjetë.

Me një të shtënë, brava hidhet në erë. Në derën e hapur, si një përbindësh i frikshëm, shfaqet ai, polic Xhoni.

Njerëzit e dhomës janë fiksuar në pozicionet e tyre më të natyrshme. Të stepur, të trondit, të zbetë, plot ankth, vështrojnë polic Xhonin, që hyn papritur e ndodhet mes tyre. Habisja i paralizon. Ç'kërkon mes tyre përfaqësuesi i ligjit? Ar-mët, si sendet më të pavlera të botës, të turpëruara, të zhgënyiera, të trishtuara, të mbledhura kruspull, janë struktur në

xhepat e gjerë tē xhaketave. Nuk e vlen tē futesh dorën nē xhep.

— Abraham, Lenki, Kodan, zonjusha Hopkin, mos u çuditni, ju njoh tē gjithëve! Vallë, harruat se nē orën 2 tē natës, nē rrugën Kembri ju pret një kamion FORD me tre targa rezervë dhe tē gënjeshtërt? Po, po, tri roje përgjigjen pér sigurinë e magazinës së armëve tē zotit Embri. Mund tē asgjësohen lehtë, apo jo, zoti Kodan? Bindja, zoti Lenki? Një ironi e së kalluarës, megjithatë komisari Grevald mund t'ju njojë këtë si një rrethanë lehtesuecse. Zonjusha Hopkin, kaq shumë i urekkeni policët?! Po çfaj kishte polici trupmadh, që ju goditi nē kokë nē sheshin «Truman»? Shumë gjëra, zonjushë, varen nga emërtimi. Përse e quani vërshimin tuaj mbi rrugë demonstratë? Quajeni shëtitje, piknik a si tē doni dhe, ju Lenki, zjarrfikësit s'do t'ju bien më nē qafë...

Ai filloj tē qeshte me tē madhe, i pushtuar nga euforia e vçantë, si tē qe i dehur.

Njerëzit nē dhomë, vështrojnë njëri-tjetrin. Vështrimet e humbura dhc tē nemitura tē tyre dukej sikur thoshin: «Ai i paska dëgjuar tē gjitha... që tē gjitha, si tē qe brenda nē dhomë. Çudi vërtet! Ne nuk flisnim me zë tē lartë, megjithatë, ai i dëgjoi tē gjitha. Vallë harruam tē mbyllnim derën? Harroi ta mbyllë ndonjëri, apo?... Dyshimi, si një shumëkëmbësh, shtriu kthetrat e lakuara mbi njerëzit e dhomës.

Sytë pyesnin: «Cili është ai? Kush e harroi portën e hapur?...»

Ndërsa buzëqesh nē mënyrë tē shëmtuar, si tē zgërdheshej, Xhoni u hedh prangat dy prej komplotistëve, tē cilët i quan me mend si më tē rrezikëshmit.

Të tjerët i shtyn përpara...

Njerëzit e dhomës presin që nē korridor tē shoqërohen nga policë tē tjerë. Por korridori qe i zbrazur. Në kabinën e ashensorit, një plakë mezi merrte frysë. Kodani qe arrestuar edhe pësë herë tē tjera, por s'i kishte ardhur kurrë kaqë turp sa sot. Një derr i trashë i kishte vënë përpara si foshnja tē bindura. Asnjëherë s'i qe dukur vetja më i pavlerë.

— Abraham! — i pëshpëriti me zë gati tē humbur. Duhet bërë diçka. Turp e faqezezë pér ne! Pesë vetë i dorëzohemi një polici.

Abrahami s'pati kohë të përgjigjet; sepse Xhoni u gjend saqat pranë Kodanit.

— I dashur Kodian, ka muaj që nuk ma hedh më dot njëri, dëgjovë? Qenka turp për ju të pesë t'i dorëzoheni polic Xhonit? Nesër mund t'vë prangat tërë qytetit tuaj të ndershëm dhe s'duhet të çuditeni. Ju tingëllon e pabesueshme, absurde, qesharake, fantastike? Atëherë duroni edhe ca dhe atje, brenda kangujellave, do të mësoni shumë gjëra të dobishme. Ju, o bij të dashur e të dhembshur, duhet ta quani veten të ndruar e të respektuar që ju hodha prangat me duart e mia. Kur mbreti të vret me dorën e tij, s'ka vdekje më të çmuar. Se doemos, të ka vlerësuar si armik me peshë. Pra ecni përrpara, futuni në kabinë dhe mos u ndieni. Mua s'ma hedh njeri! Eh, i dashur Kodan, u turpërove që unë të hodha prangat, por më vonë do ta ndicsh veten krenar bash për këtë...

Kodian u zbeh edhe më shumë. U ul në gjunjë, në një qoshe të kabinës dhe zuri ftyyrën me duar. Kabina zbriste me shpejtësi katet. Të arrestuarit qëndronin në qoshe, si të kapitur. Ballë tyre, më një buzëqeshje idiote, me revolverët drejtuar nga viktimat qëndronte polic Xhoni.

Vështrimi i tij qe ngulur në prangat e ndriçme prej çeliku. Ndriçimi i tyre ia mori një çast sytë. Iu bë se shihte mijëra, dhjetëra-mijëra pranga të ndriçme. Mijëra duar që zgjateshiin drejt tyre. Duar të mëdha, pranga të mëdha. Si është e mundur të harroj edhe prangat e vogla? Në qytet ka edhe fëmijë. Nëse duhet myllur në burg tërë qyteti, atëherë pa humbur kohë duhen porositur pranga të madhësive dhe të llojeve më të ndryshme. Pranga përburra, grà, pleq, plaka, fëmijë të porsalindur. Pranga speciale për të sëmurë me deformacione koka-kash nga reumatizma, të gjymtar, pranga të çdo lloji...

Ai buzëqeshi, përhumbur në èndërrime. Dëgjonte qarqe fërkimine byzylykëve të çeliktë në kyçet e duarvet.

Kabina u përplas lehtë në bazamentin e saj. Xhoni u përmend.

— Çudi! — tha me vete. — Në pak sekonda njeriu mund të shohë kaq shumë gjëra. Kaq shumë pranga. Një prangë, dy... dhjetë pranga, njëqind, një mijë.

Ndjeu ta pushtonin idetë e vjetra fikse, por kësaj radhe s'u përpoq t'u shpëtonte. Ai e lëshoi veten të tërhiqej pas tyre,

me ndjenjën e lehtë, gati të ëmbël të kundërshtimit (në të vërtetë më shumë nxitës) të vajzës, kur i dashuri i zemrës chton të fshihen diku, mes gjelbërimeve, larg syve kuriozë e lakmitarë të botës. Mbështetje në këtë mënyrë idetë dhe parafytyrimet fikse të prangave, kompenzonin deri diku dëshirën gati gjysmëshekullore për të fituar para, famë, lavdi. Gjer muaj më parë ai ishte një ndër policët pa vlerë, aksionet e rralla të të cilëve mbahen mend pa vështirësi nga shefat. Kishte njohur ethet e këqija të dështimit, zagushinë e fyterjes, dridhmat e pasigurisë për të nesërmen. Dhe ja, më në fund fati i kishte buzëqeshur. Por ai s'e diente ende plotësisht lumturinë e shumë dëshiruar të ishte bërë pjesë e pandashme e qenies së tij se digjej nga dëshira përvëluese e hakmarrjes dhe torturohej gjer në palce nga fobia munduese e kohës që konsumohej pa ndier keqardhje për të pesëdhjet vjetët e tij. Ku dihej sa do të rronte, ku mund ta dinte sa vjet i kishin mbetur? (Qe në moshën, kur njeriu fillon e mendon ca më shumë për vdekjen). Muajt e fundit nuk flinte, veçse tre orë në natë, madje as edhe nuk shtrihej në shtrat, jo vetëm nga dëshira për të gjurmuar e përtë mbledhura sa më shumë të dhëna faktike të dobishme për policinë, por edhe nga mizëria e zhurmave shqetësuese të gjithfarshme, të fuqizuara gjer në maksimum, që s'e linin të bënte një orë gjumë të qetë. E parë mbyste torturën e së dytës, kështu që moria e pallogaritshmë e ngjarjeve të vogla e të mëdha, që ndodhnin pareshtur në qytetin e madh dhe që ai i mësonte i pari, i sillnin të tillë kënaqësi shpirtërore, të tillë dehje e eupori, sa gati-gati nuk po e ndiente më nevojën e gjumit. Polici Xhoni ishte në gjurmim të përhershëm, ditë dhe natë, pa gjetur prehje e çlodhje.

«100 pranga, 1000 pranga, 1 milion pranga, 10 milion...»

Polici Xhoni buzëqeshte si i humbur në një endërr joshëse. Të arrestuarit, disa metra larg tij, capiteshin me përtesë në trotuar, si vargani i gjatë duke shkuar diku.

Të arrestuarit përpinqeshin të shpëtonin si herët e tjera me argumentin e famshëm të mungesës së fakteve. Kodman qe arrestuar pesë herë dhe të pesë herët ishte liruar për mungesë faktesh, por atë natë qe vërtet i pikëlluar dhe i tronditur. I mallëkuari Xhon i dinte të gjitha. Të qeshurat tallëse dhe gazmore të komisarit Grevald nuk mund të duroheshin dhe ende i kumbonin në vesh.

«Kërkonit fakte, i shtrenjti Kodman? Pesë herë radhazi na shpëtuat, por tani s'keni nga t'ia mbani...»

Kodmani ktheu kokën. Polic Xhoni ecte si një somnambul. Buzëqeshte. Enderronte. Kodman pështyu me inat dhe shau me mllef. Xhoni u drodh, u përmend.

— Thatë gjë, Kodman?! — pyeti.

Kodmani s'u përgjigj.

— Deshët gjë Kodman?! — ngulmoi Xhoni.

— Nuk fola fare, zoti polic, ju kanë bërë veshët.

— Veshët?!

Xhoni buzëqeshi si me pahir.

— Vërtet Kodman, këto kohët e fundit s'para dëgjoj mire... U plakëm xhan, u plakëm!



Kodmani u zhgënje. Komisari Grevald e priti fthotë si të arretuar të zakonshëm. Bile Kodmanit iu duk se, në një çast, kur polici Xhon vështroi jashtë në rrugë, komisari Grevald i hodhi një shikim të vëngër, xheloz dhe tepër të errët. Vështrimet e Grevaldit e të Xhonit u kryqëzuan dhc i pari vuri përsëri maskën dashamirëse. Kodmani, njoħës jo i keq i psikologjisë së njerëzve, nuk gaboj. Kohët e fundit Grevaldi ia kishte frikën vartësit të tij, policit të thjeshtë Xhon, madje e urrente me shpirt. Papritur (ndonëse vriste mendjen ditë e natë, ai s'po arrinte t'i zbulonte shkaqet), polic Xhoni po shkëlqente me një inteligencë e sukses të pashoq. Njëzet mijë qytetarë të sekseve e të moshave të ndryshme, «fajtorë të vërtetë», qenë kapur vetëm nga ai, pra gati sa kishin kapur në tre vjet, të gjithë polici e sektorit. Përpara tij qe vështirë të mohoje shkeljen e ligjit. Edhe kur ndonjë naiv dhe i paditur guxonë ta bënte këtë, mbërrthej paq nga moria e fakteve të pakundërshtueshme, që ia radhiste polic Xhoni. Qe aq i «mençur» dhc «njoħës» kaq i thellë i psikoanalizës, sa kishte borxh t'i riprodhonte viktimitës fjalë përfjalë fragmente bisedash. Goditje të tilla përballoheshin me vështirësi nga viktimat. Me sytë e tij, Grevaldi kishte vërejtur se si ato këputeshin e binin përdhe të pafuqishme, fill pas bashkëbisedimeve speciale me vartësin e tij. Natyrishët vendin më të

madh e zinin të burgosurit politikë, ata që dyshoheshin për veprimitari prokomuniste, po, meqë zyrtarët s'kishin dëshirë ta përdornin publikisht këtë emërtim i kishin quajtur të dyshimtë për veprimitari antiqeveritare, një përcaktim i përgjithshëm ky që s'duhej të hapte shumë telashe.

Qindra letra vinin çdo ditë nga, vende të ndryshme të botës, në adresë të shtëpisë së Xhonit. Fama e tij po përfshinte kontinentet. Dedektivë të tillë si Sherlok Holmsi, Bebi Stokes, Edwin Stirt, etj., përpara tij do ta ndienin veten si nxënës shkollë përballë profesorit. Por ai, me gjithë ftesat e shumta, megjithëse i vinin në dispozicion avionë dhe jahte personale, refuzonte të largohej nga posti i thjeshtë i policit të rrugëve. Inate të vjetra e mbërthenin aty. Iu propozua deri edhe posti i Grevaldit, por nuk e pranoi, sepse dëshëronte t'i lante hesapet ndryshe me të. Një këmbim i thjeshtë posti mund të përtypej disi më lehtë nga Grevaldi zemërhekur, dhe kjo gjë nuk mund ta kënaqte polic Xhonin. Në përfytyrimin e tij, prangat më të tmerrsin me i kishte rezervuar për komisarin Grevald e vetëm atëherë, ndoshta, do të mund të kënaqeje me postin tepër të thjeshtë të komisarit të policisë. Megjithkëtë, në pamjen e jashtme as gjë s'kishte ndryshuar në marrëdhëniet e tyre, dhe kjo i bënte rivalët të tregoheshin më të kujdesshëm...

Prej tri javësh, polic Xhoni po e ndiqte këmba-këmbës komisarin. Që nga dita, kur veshi spiun thithi fragmente të një biscede të dyshimtë telefonike, që bëri Grevaldi me një bandë kontrabandistësh, ai nuk po i ndahej. Grevaldi, nën peshën e rëndë të zbulimit të bashkëpunimit, po orvatej të shkëputej përfundimisht me ta, por banda nuk pranonte ta lëshonte nga kthetrat, dhe kjo gjë po e acaronte situatën. Gjatë atyre tri javëve, polic Xhoni gjurmoi më pak qytetarë. I qe vënë pas komisarit të tij. E ruante ditë dhe natë. Për komisarin Grevald nxiheshin radhë dhe fletë të tëra. Dara e rrëthimit sa vinte e bëhej edhe më e ngushtë. Gjurmët e Grevaldit dashur pa dashur po e çonin drejt kreut të bandës, një farë Xhimi Litell. Kreu i policisë dhe i bandës qenë takuar disa herë javën e fun-

dit. Marrëdhëniet ishin tendosur së tçpërm. Mund të pritej gjithçka. Në fillim të javës së katërt, Xhoni vendosi të vepron-te. Në mesnatë, vendi i fshehtë i takimit u rrëthua nga makinat e policisë. Në aksion mërrte pjesë edhe vetë zv. ministri i brendshëm, një njeri që pëlgente sensacionet. Kreu i bandës, Xhimi Litëli, duke e kujtuar velen të tradhtuar nga Grevaldi, thirrjes së polic Xhonit përtë dorëzuar armët, iu përgjigj me dy të shtëna të befta. Mbytur në gjak, Grevaldi u përplas në tokën e spërkatur nga vesa e natës. Xhimi s'arriti të godiste tjetër njcri, se pse breshëritë e armëve automatike e shtrinë përdhë, të bëre shoshë.

Zv. ministri dhe polici Xhon i shtrënguan duart njëri-tjetrit në errësirë.

Mbi trupat e të vrarëve hodhën çarçafë të bardhë.

Zv. ministri dhe polici Xhon dolën nga strchimi, ku qenë fshehur.

Sirenat e makinave të policisë kuisnin me të madhe, duke e bërë ngjärjen edhe më tragjike. Fotoreporterët e ftuar posaçërisht, ndriçonin herë pas here me blicet e tyre kufomat e bërdha. Komisari i ri i policisë, Xhoni, me duar të kryqëzuara mbi gjoks, u përgjigjej pyetjeve që s'reshtnin të gazetarëve. Herë-herë konsultohej me bllokun e vogël, të zi.

— Thonë, se ju, z. Xhon, keni qenë për shumë vite një idiot i padeklaruar. A është e vërtctë kjo gjë, apo... — pyeti një bullafiq me syze, kryeredaktori i gazzetës më mc cmër të partisë republikane.

Xhoni mezi u përeoll.

— Nuk ju kanë gënjer, zoti Henri. Gjer në moshën 30-vjeçare nuk bija më poshtë se të tjerët, mirëpo një natë me stuhi, tek shkoja rrugës, një gangster më goditi rëndë në kokë më grusht. Pas kësaj gjëme, më thonë të dashurit e të afërmit e mi, — një kohë të gjatë, shumë vite, kam qenë gati si në gjumë. Njëzet vjet më vonë, zoti Henri, më goditën prapë, tamam në të njëtin vend dhe ja tek më keni përpara jush, të rinuar, të zgjuar e të shkathët. Zoti Henri, duhet të ruheni nga grushtat. Gjurma ndonjëherë është e pashlyeshme.

Fjalët e fundit, Xhoni i tha duke e vështruar thellë në sy Henrin, që padashur u drodh.

— Pyetje të tjera zotérinj?

— Besoni, se një ditë mund të bëheni ministër i brendshëm?

— Pyetja është provokuese, megjithatë mund t'ju përgjigjem. Ministrin e tanishëm e adhuroj dhe veten nuk e quaj aspak më të zotin për t'i zënë vëndin, veç në ma dhëntë vullnetarisht, Ha, ha, ha...

Xhoni qeshi me të madhe. Atë natë i pëlqente të bënte shaka. Edhe zv. ministri buzëqeshi, por me pahir. Sikur po i shtrinte këmbët ca si shumë ky Xhoni. Në një farë mënyre, i duhej prerë oreksi dhe i duhej treguar vendi.

Zv. ministri i vuri dorën mbrapa në shpatull dhe e shtyu lehtësish përpara.

— Boll, Xhon i përsonte. Të dhënët për çështjen u mjaf-tojnë. Ministri më pret në raport.

Xhoni i tundi lehtë kokën.

— E po, zotérinj, besoj mund të ndahemi. Faleminderit për ndihmën!

Blicet s'pushuan së hapuri sytë e bardhë, edhe kur të dy ulën në sediljet e pasme, edhe kur Xhoni i pëershëndestë me kokë duke u buzëqeshur.

— Nisu! — urdhëroi prerë zv. ministri.

Makina inkandeshente, nga shkëlqimet verbuesë të aparateve fotografike, dredhoi një copë herë në hapësirat e gjelbërtë të kopështit dhe pastaj u zhduk në errësirë.

Komisar Xhoni mirret shumë ftesa për t'i nderuar me praninë e tij në darka, dreka e pritje të ndryshme, por ai nuk shkon te gjëkundi. Inisiativat e komisar Xhonit qenë përkundrazi të rralla dhe mbasë kjo që edhe arsyja, që bënин përshtypje të jashtëzakonshme në publik. Bie fjala, ai i propozoi kryetarit të partisë republikane të merrte përsipër drejtimin e gazetës kryesore, në vend të zotit Henri Kërkesa e komisarit u prit me kënaqësi të dukshme, madje u vlerësua si një nder i jashtëzakonshëm, që i bëhej partisë së tyre. Udhëheqësit e saj të entusiazmuar shkuan edhe më tej, duke iu lutur të bëhej anëtar i partisë së tyre; por Xhoni, në një intervistë radio-televizive, pasi

që menduar tri ditë e tri netë, nuk pranoi (përsëri me mirësjellje), duke shpallur botërisht se, përsa kohë do të mbante postin e komisarit të policisë, nuk do të bënte pjesë në asnë nga partitë ekzistuese. Por la të nënkuptohej se, mbapse në të ardhmen, mund të bëhej themeluesi i partisë mjaft origjinale, me emrin fantastik — «Partia e uniformës», që merrte përsipër të zgjidhë hallet e qytetit me metoda origjinale dhe fare pak të kushtuëshme.

Zoti Henri u shkarkua që atë mbrëmje, duke u bërë mësim edhe për të tjerët, se me komisarin nuk mund të bëhej shaka. Xhoni filloi menjëherë nga puna. Mori një takim të shpejtë me njerëzit më kryesorë të gazetës dhe u bëri të njohur metodën e tij të punës, e cila ndryshonte si nata me ditën nga ajo e zotit Henri. Ish kryeredaktori e faqoste përfundimisht gazeten në ora 21.00. Shumë ngjarje tragjike të natës, për të cilat publiku ishte veçanërisht i etur, nuk zinin vënd në gazetë, megjithatë zoti Henri mburrej, se e myllte faqosjen dy orë më vonë, se kolegët e tjerë.

Komisar Xhoni i habitit të gjithë, kur u tha se faqosjen do ta mbaronte përfundimisht me dorën e tij vetëm tri orë përparrë shitjes, pra më katër të mëngjesit.

Katër faqe të plota, nga dhjetë faqe që kishte gjithësejt gazeta, ua rezervoi ngjarjeve të larmishme plot tension të natës.

Të gjithë mbeten tepër të habitur, kur në orën 23.00, në sytë e tyre, bëri faqosjen provizore. Në fillim, shkruante vetëm titullin e ngjarjes, caktonte përafërsisht numrin e rreshtave që do të zinte materiali, dhe zgjidhë redaktorin që duhej ta shkruante sipas përshkrimeve të tij të shkurtra.

«Kështu pra, le ta quajmë!» Krim i përbindshëm në rrugën Eskuell, nr. 15; «Krokodili i Missisipit kapet me presh në duar». Bukuri! Njëqind e dyzet rreshta. S'ka më mirë! Helenc, reportazhin do ta shkruani ju. Kam të dhëna të sigurta, se ngjarjet do të zhvillohen kështu:

«Krokodili i Missisipit është tradhtuar nga dashnorja e njëzetë, gruaja e një nëpunësi të thjeshtë të postave. Banda e tij do të sulmojë shtëpinë në ora — aty rreth 3-së së mëngjesit. Të shoqin ka ndërmend ta vrasë, kurse asaj do t'i lërë shenja që të mos i shlyhen kurrë. Në çastin e fundit dëgjohen sirenat e policisë dhe krokodili i Missisipit bie në kurth... Ja,

pra, e téré ngjarja me pak fjalë. Helenc! Mbylluni diku dhe shkruani. Në mesnatë të ndodheni në vendin e ngjarjes. Bëni koregjimet e rastit. Në orën 3.50' materiali i plotësuar të dorëzohet në linotip. Suksese pra, Helenc! Mirupafshim!

I hutuar, gazetari Helenc shtrëngoi dorën e komisar Xhonit dhe doli. Në jetën dyzetvjeçare prej gazetari s'mbante mend t'i ishte ngarkuar detyrë më e çuditshme dhe më e jashtëzakonshme se ajo e asaj nate.

Helenci u kthy përsëri. Hapi me ngurim derën.

— Më falni, zoti Xhon, por duke i ditur më parë këto, që do të ndodhin, policia mund të ndërhyjë në kohë dhe artikulli....

Komisar Xhoni skërmitti dhëmbët.

— Helene! S'më kanë pëlqyer ndonjëherë ata që pyesin shumë. Qartë?

— Më falni, më falni, desha të sigurohesha. Më falni! Natyrisht që artikullin do ta bëj që tani.

Xhoni u kënaq. «Qenka pastë e butë, pra i trajtueshëm» — mendoi dhe zbardi dhëmbët për të qetësuar Helencin e alarmuar.

— Oh, s'ka gjë, s'ka gjë, dhe shih, më pëlqeijnë punët e frymëzuara. Ku e lamë? Ah, po! «Doktor Henderson u shet të miturve Marihanë». Artikullin do ta shkruani ju, Beksi. Me pak fjalë ngjarjet do të rrjedhin kështu:

Dhe ai nisi të tregojë.

Që në fillim të karrierës së tij të shkëlqyer e të pazakontë, Xhoni tërroqi vëmendjen e klasës së pasur. Ajo përpiquej që af-tësitë e jashtëzakonshme, gati mbinjerëzore të Xhonit, t'i shfrytëzonte për një superkontroll të shoqërisë dhe veçanërisht të lëvizjeve revolucionare. Gradualisht, ai po shkëputej nga forca e gravitacionit e shkencëtarëve dhe po thitjej nga fusha e fu-qishme tërheqëse e monopoleve.

Xhoni merrte porosi të shumta për të zbuluar e parandaluar me kohë çdo lëvizje dhe aksion revolucionar, që kërcënonte si-gurimin e rendit publik, ndonëse s'mund të thuhej, se ai udhëhi-

qeji në të tillë veprime të shëmtuara nga ndonjë farë bindje politike e përcaktuaz. Punonte për ata që paguanin më shumë: Muajt kalonin shpejt, njëri pas tjetrit dhe Xhoni po futej dalngadalë në sferën e njerëzve që mund ta shihnin të nesërmen pa iu dridhur zemra, se mund të mbeteshin të papunë e pa dollarë. Ai po bëhej i pasur, Kësaj ai po ia arrinte shumë më shpejt se të tjerët. I paguanin shuma kolosalë për shërbimet e tij të mëdha e të parreshtura. Mendimi, se në fund të viti do të bëhej milioner, po ia përkëdhelte sëdrën dhe po i nxiste ndjénjën e lëkëmisë e të zilisë së pangopur, për të vënë sa më shumë mënjanë. Pak nga pak, pa e kuptuar as vetë, çdo ditë e më shumë, në zemër i kishte lindur e po i gatuhej një ndjenjë e çuditshme, e përzier, ankthi, frike e urrejtjeje. Në qoftë se për një farë kohë, zbulonte dhë shtypte çdo lëvizje revolucionare, që rrezi-konte sigurimin e rendit publik, i shtytur pothuajse nga asnje motiv. I përcaktuar politik, por vetëm e vetëm për para, tani tek punëtorët aktivistë e gjithë të «dyshimtët» e tjerë, ai shih-te njerëzit që do t'i bënin varrin, që do ta shkallmonin e do ta linin keq e mië keq, të papunë e pa bukë. Mbase edhe në burg mund ta fusnin, ose ca më keq akoma. Gazetat shkruanin shumë, për atë që mund të ndodhë në vend, po që se fuqinë e merrnin majtistët. Kishin shkruar edhe shumë kohë përpëra se Xhoni të bëhej i pasur, por vetëm tani ai po i merrte seriozisht këto gjëra. Një polic fare i thjeshtë rrugësh, i lënë mënjanë siç ishte dikur, nuk kishte ndonjë arsyë të veçantë t'i trembej së nesërmes, as më shumë e as më pak se të tjerët. S'kishte për të humbur ndonjë gjë të madhe. Por tani qe futur aq thellë në rrugën e krimeve, të zullumeve e të prapësive, sa çdo kthim prapa në të kaluarën, s'kishte kuptim. Veç kësaj, tani qe i pasur e duhej ta mbronte këtë të «drejtë» me të gjitha armët. Për të luf-tuar të majtë dhe të gjithë ata, që éndërronin për socializmin dhe komunizmin, sot e tutje ai s'kishte përsë të nxitej e të merrte porosi nga të tjerët. Ai do të shtyhej më tej. Do të kontrollonte jo vetëm të dyshimtët, jo vetëm ata për të cilët qenë hapur dosje të veçanta, por gjithçka dhe çdo njeri, të mëdhej e të vegjël, njerëz me bindje politike dhe pa bindje të tillë, njerëz të punës e shtëpiakë; ca më shumë të papunët. Gjithçka nën kontrollin e tij. Një supersurvejim i tillë mbi shoqërinë i dukej i dobishëm për qetësinë; paqen e sigurimin, për rendin.

* * *

I ishte ngjitur si rrodhe e bezdissħme qytetit tē tij. Ditē tē vështira plot ankth, dyshim dhe frikē po jetonte qyteti disamionësh.

Komisar Xhoni, si një fantazmë u shfaqej banorëve kudo, mbrenda nē shtëpi, nē zyrë, nē magazinë, nē shtrat, nē WC, pra kudo! Ai djall i dëgjonte tē gjitha, që tē gjitha. Tē porsaliruarit betoheshin se asaj shushunje plakë s'i shpëtonte as edhe një fjalë. Atij s'i shpëtonin as edhe bisedat më intime. Qyteti, si një orë lgigante e çakërdisur, qe hutuar e çorientuar, kishte dalë jashtë rregullit tradicional dhe e ardhmja s'dukej premtuese.

Ajri qe nginjur me aerozolet e pakapërdishme, plumb-të rënda tē dyshimit. Doemos, spiunë tē panumërt duhej tē ishin vënë nē shërbim tē tij, organizatat dhe udhëheqësit kryesorë tē punëtorëve dergjeshin prej muajsh nē burg. Ata që guxuan tē kërkonin lirinë e fjalës nē sheshet publike, u torturuan çnjerezisht dhe u dënuan me vite tē tëra.

Ai kishte përhapur nē çdo shtëpi, nē çdo zyrë, nē çdo fabrikë, nē çdo rrugë, nē çdo qoshe, retë e dendura sterrë dhe gulçuese tē ankthit dhe frikës.

Frika! Ajo kuçedër po e brente dalngadalë qytetin më keq se një leprozë.

Frymëmarrja e qytetit ishte bërë e mundimshme, e rëndë, agonike.

Pa e kuptuar as vetë, njerëzit filluan tē flisnin me zë më tē ulët, gati tē pëshpërisnin. Në qytet stuhiat zérave dhe toneve tē larta, këngëve, ritmeve, melodive tē kumbueshme ua la vendin pëshpësheve. Qyteti papritur qe urtësuar. Qyteti po përgjumej, po dremiste sikur komisar Xhoni ta kishte hipnotizuar.

Në fillim kjo e gjëzoi, se iu përkëdhiel sedrä e pushtetit pa kufi, ai po sundonte mbi qytetin, por shpejt kuptoi tē keqen që po i kërcenohej...

Polic Xhoni, me duar tē kryqëzuara prapa shpine, si një qole bajate, vërvitej si i xhindosur, ditë e natë rrugëve tē qytetit. «Sufi» i tij s'arrinte më tē perceptonte dot përshpëritjet. Shkencëtarët, madje as edhe ai vetë, s'kishin parashikuar se punët do tē arrinin gjer këtu.

U värvit kështu, pa shpresë, i telikosur, i dërrmuar për vdekje një javë të tërë. S'mundi të dëgjonte asgjë të dyshimtë. U tmerrua, u drodh i téri, kur mendoi se qe shndërruar përsëri në një Xhon pa vlerë, në policin e rëndomtë të dikurshëm...

I mybytur në djersë, marramendthi, ra në gjunjë përpara shkencëtarëve Meksi dhe Berti dhe iu lut t'i inplantonin «Sufin» e dytë në veshin tjetër.

«Shpëtomëni, shpëtomëni, një javë rresht s'kam hedhur as edhe një prangë, një të vetme. Ju lutem shumë! Jam një i mjerë, një hiç pa «Sufin» tim. Qyteti po më sfidon, qyteti po tallet me mua. Më ndihmoni, se po vdes nga pikëllimi e dhembja!...

— Na pate premtuar, Xhon, që «Sufin» tonë do ta përdorje vetëm kundër keqbérësve, vjedhësve dhe kriminelëve. Por s'e mbajte fjalën. Je bërë vegël qorre e të tjereve dhc armik i rrezikshëm i lirisë dhe demokracisë së vërtetë. Je bërë tiran dhe shtypës, Xhon... - tha Meksi i nxehur.

— Këtë e kam bërë pa qëllim... Bëra ç'më thanë... Unë jam vetëm polic fare i thjeshtë, një polic rrugësh — foli me të lutur e duke u qarë, Xhoni.

— Mirë, Xhon, shkon i tani, do ta plaqerojmë këtë punë... dhe do të të përgjigjemi...

— Si të dëshëroni, zoti Meks, si të dëshëroni — foli Xhoni, me tonin e njeriut të përvuajtur, që ia ka nevojën shumë tjetrit dhe doli gati gjysmë i përkulur.

Shkencëtarët ranë në mendime. Pastaj vështruan në hesh-tje njëri - tjetrin.

— Hë Berti, si t'ia bëjmë? — pyeti Meksi.

— Dyshoj shumë në perspektivën e «Sufit» tonë; Është një aparat i tmerrshëm në duart e policisë sekrete... Vendi s'do të ketë më liri!...

— Se mos ka tani?

— Nuk e them këtë, por të paktën aparatura e tanishmë nuk jep mundësinë e supersurvejimit mbi popullsinë.

— S'duhet të trembeni kaq shumë. Aparatura s'duhet mbi-vlerësuar. Miliona «Sufera» nuk mund të mbysin lirinë. S'është e lehtë të nënshtrosh popullin. Ai i përgjigjet shtypjes dhe tiranëve në forma të ndryshme, ndoshta jo shumë efektive, por kur ndërgjegjja e tij zgjohet, organizohet dhe drejtobet me pjetë-kuri, ai jo vetëm nuk druhet t'i shfaqë hapur bindjet e tij, por

shkon edhe më tej, dua të them në revolucion. Historia ka shumë shembuj të tillë.

— Megjithatë ne duhet t'i qëndrojmë besnik qëllimit tonë, kur e bëmë «Sufin». Ai duhet të përdoret vetëm kundër vjedhjeve e vrasjeve kriminale, shkurt, të mbrojmë të pafajshimt. Me gjithë besimin që kemi në forcën dhe vitalitetin e popullit. «Sufi» ynë s'është aspak një mjet indiferent, rrezikshmëria e të cilat nuk u dashka të mirret parasysh. Jo, Meks! Një supersurvejim i policisë sekrete mbi mendimin e lirë të popullatës do të qe fatkeqësi dhe mjerim i patregueshëm, pavarësisht se një ditë populli do ta thotë fjalën e vet.

— Keni të drejtë, Berti, por sa kohë që shpikja është në duart tona, ne s'kemi pse të shqetësohami. Jemi ne zotërit e saj. S'ka gjë të keqe, nëse vazhdojmë eksperimentin me Xhonin, duke ia bërë edhe një herë të qartë kushtet tona. Se, të thuash të drejtën, një aparat i tillë, po të përdoret ashtu siç duam, popullatës do t'i kthchej qetësia dhe paqja. S'do të kishte më vrasje, vjedhje, përdhunime, rrëmbime fëmijësh të pafajshëm...

— Utopi, utopi, Meksi! Qetësi dhe paqe të vërtetë s'do të ketë kurrë. Mund të bësh fjalë për ulje të tyre, por sa për zhdukje, bah, kjo s'duhet të të shkojë ndërmend. Çështje sistemi, ti e kuption...

— Atëherë po të pyes? Përse e shpikëm? Përse u lodhëm?

— E qartë, e qartë është arsyaja, por Xoni na bën të mendohemi thellë. Në djall shkofshin milionat e dollarëve, nëse miliona mallëkime do të bien mbi ne... Më kuption?

— Ç'të bëjmë, pra? Të heqim dore?

— S'jam për këtë.

— Ç'propozon?

— Të vazhdojmë eksperimentin...

— S'të marr vesh. Pse më kundërshtove deri tani?

— Të vazhdojmë, por me një ndryshim.

— Ndryshim the?

— Po. T'i inplantojmë një «Suf» të mangët...

— S'të kuptoj fare. Fol shkoqur!

— Një «Suf» me jetë të shkurtër, 5-6 muaj, e bën Xhonin një pjellë eksperimentale jo shumë të rrezikshme dhe të manovrueshme...

Si në fillim, shkencëtarët u panë sy më sy një copë herë
dhe qeshën me zë të lartë.

— Të lumtë, Berti! Ide e shkëlqyer. Një «Suf» i kufizuar kurrsesi nuk mund të keqpërdoret, vetëm për arsyen e thjeshtë, sepse jeta e tij është tepër e shkurtër. Ca më keq për Xhonin, nëse nuk do t'u përbahet kushteve tonas...

* * *

Me të dy aparatet «Sufi», të implantuar në veshë, Xhoni iu shfaq përsëri qytetit, si një përbindsh tekanjoz dhe i frikshëm. Shkonte rrugëve hundë e buzë. Inatet, dështimet dhe zhgënjimet e të shtatë ditëve të fundit i qenë mbledhur si një shuk të gjoks, dhe e mundonin.

«Unë nuk u bëra i gjallë një javë rresht, tamam atëherë, kur disa faqezinj filluan të pëshpërisnin, të flisnin vesh më vesh. Këtë e bënин që t'i shpëtonin gjykimit tim të rreptë e të drejtë, që të ma hidhnin. E ç'nuk thanë, e ç'emra s'më vunë, dhe cilit, mua, komisar Xhonit, ruajtësit të rendit e të qetësisë, mua që humba gjumin për t'i shërbyer drejtësisë dhe ligjeve.

Besomëni, qytetarë të ndershëm, po ju flas zemërhapur, qyteti është infektuar nga ide socialiste e komuniste. S'ka ku të vejë më keq. Jeni të pakënaqur, sepse s'keni të holla për arsim, për të paguar qiratë, për ushqimin, kur çmimet ngrihen, po këto pakënaqësi janë të rrezikshme, sepse drejtohen tërthorazi kundër sistemit tonë dhe janë gati një armë në duartë e armiqve tanë të betuar, shumë më e rrezikshme se bombat, avionët dhe raketat e tyre». Fjala që mbajti Xhoni në studion televizive të qytetit, qe e shkurtër, për toni ishte i ashpër e paralajmërues për masa të rrepta ndëshkimi për ata që s'do të bindeshin.

Që atë mbrëmje kërcënimi si një re e dendur gri, e palëvizëshme, cfilitëse dhe munduese, qëndronte e varur pezull mbi qytet.

Atë natë Xhoni arrestoi pesë mijë pëshpëritës, të cilët u akuzuan si të pakënaqur dhe si njerëz të dyshimtë. Kryeartikulli prej pesëqind rreshtash i gazetës republikane që doli të nesërmën në mëngjes, qe fryrë e mbarsur me shprehje stereotipe kërcënuese për pëshpëritësit. Kryeartikulli mbylej më premtimin solemn të komisar Xhonit se pëshpëritësit e fundit do të

imposhteshin brenda dyzetë e têtë orëve. Shkruesi s'kishte harruar të nënvizonte saktësinë dhe gjenialitetin e të ndriturit komisar të policisë Xhon që meritonte të gjitha nderet; sepse pa atë gati nuk mund të kuptohej paqja, qetësia dhe siguri i rendit publik të kërcënuar nga pëshpëshësit.

* * *

U duk sikur qyteti iu nënshtua kërcënimeve të komisar Xhonit. Njerëzit u gdhinë një mëngjes memecë. Burrat nuk flisnin, gratë po ashtu, bile edhe fëmijët nuk flisnin. Prej sheku jsh ai s'kishte njohur qetësi të tillë. Ndonëse nuk qe dimër qyteti kishte rënë në gjumë letargjik. Hija e komisar Xhonit, euforike dhe e kicilosur ëmbëlsisht në sedër, vërvitej si rrrotaxhile, triumfalish, në rrugët e qytetit të madh. Mizëri njerëzish gojëkyçur mbushnin trotuaret. Mizëri makinash shkonin në autostradë ngadalë e pa u ndier, si një kortezh funebër. Shoferët, si të ishin memecë, nuk këmbezin asnje fjalë me pasagjerët, nuk u binin borieve.

«Sufet» perceptonin vëtëm frymëmarrjen e rëndë të banorëve.

Ishte i pari njeri në botë, që ia kishte arrirë të mbyllte gjötë e shumta të një qyteti milionësh.

Dridhma rrënqethëse lumturie, iu derdhën tatëpjetë shtyllës kurri zore.

U ngazëllye. Sot kishte imposhtur një qytet, nesër, ç'do të mund të bënte? Kurora blu e presidentit vezullonte në èndrrat e tij.

«Xhon, ti që s'ke pasur në shtëpi as edhe një karrige të thjeshtë për t'u çlodhur, do të ulesh në karrigen e presidentit të shtetit. Ajo është pranë teje, Xhon, fare pranë. S'të mbetet veçse të zgjatësh, dorën! Ulu, Xhon, ulu. Uluni, i nderuar president i shtetit!»

Vizioni halucinator ishte fare i qartë, bindës dhe i besueshëm.

Ja tek qe edhe karrigia. Pse të mos ulej? Ç'të priste më. Ngërthyer nga krizat e forta të deliriumit të madhështisë, ngriu në një pozicion plastik të njeriut që tri në karrige, aty në mes

të trotuarit. Vështronte i ngazëllyer shtetasit, u buzëqeshte dhe nënshkruante herë pas here shkresa zyrtare, që ia sillnin nëpunës të përvuajtur e të respektuar.

Kalimtarët e vunë re dhe filluan të mbanin hapat. Qeshnin nën buzë. Duke u dhënë gishtërinje, shuplakave dhe shpinës së duarve, pozicione të ndryshme kuqtimplate, luajtën dhe u tallën një copë herë me Xhonin e krisur, gjersa arriti në vend mjeku i tij personal, zoti Ferdi...

* * *

Qyteti po lëvizte. Ai kishtë nisur të fliste me gjuhën e ndërlikuar të gishtërinje.

Pas një muaji banorët zotëronin pesëqind shenja folëse, shumë prej të cilave me përbajtje të dyshimit. Qyteti po i përgjigjet, qyteti po e sfidonte. Ajo që e zbaviti gjatë ditës (dukej sikur qytetarët dëfreheshin me gishtërinjtë e tyre, duke krijuar figuracione të shumëllojshme, plot humor të këndshëm e fantazi), e pikëlloi në mesnatë, kur i ulur siç qc, i lodhur e i këputur, në një poltronë lulishteje gjysmë të crrët, u kujtua se kjo mund të qe një gjuhë e veçantë e porsalindur...

Njerëz të çuditshëm, flasin me gishtërinj, qeshin pa zë, mbeturazi. E provo t'u hedhësh prangat! Ç'bëmë, ç'faj kemi bërë, të thonë. Folëm gjëscendi? Gojën na e ke kyçur zotrote. Bëmë gjëscendi? Aha, paskemi qeshur?! Si është e mundur, zoti Xhon?! Buzët na ikeni qepur prej kohësh, a mund të qeshë njeriu kësisoj? Shfajësohen, e di, ky është roli i tyre. Por le të qeshin, le të tallen, le të flasin gjuhën e djallit. Edhe kësaj pune do t'ia gjej ilaqin, brenda një kohe të shkurtër bile...

Ai pshëretiu, thithi thellësisht puron dhe treti vështrimin në yjet e mijegullta e të largëta. Kishte muaj pa i vënë re. «Kjo do të thotë se kam pasur shumë telashe tokësore këtë kohë», — tha me vete disi i habitur. U mbështet më shumë në poltronë. I buzëqeshi hënës. Një mendim dinak i vezulloi në bebet e syve. Filloi të luante me gishtërinj. Qeshi.

«Hm, një kod deshifrimi! Do të qe intercsante. Gjuhët e vështira nuk mësohen perfekt. Përkthyesit gjithmonë janë dashur e kanë hyrë në punë.»

* * *

Kur komisar Xhoni hyri në dhomën e pritjes, mysafirët e shquar u ngritën në këmbë.

— Uluni, uluni zotërinj! Keni bërë udhë të gjatë dhe me siguri jeni lodhur.

Me respekt, duke u përpjekur të bënin sa më pak zhurmë, kokat u ulën.

— Zotërinj linguistë, profesorë dhe psikoanalistë! Ju prisha qetësinë e rehatinë, e ju kërkova me ngulm, anembanë kontinentit, për një problem urgjent. Puna është se në qytetin tonë, për shkaqe të pakuptuara, janë thyer traditat shekullore të të folurit. Më thonë se gjer tani, banorët e mi kanë zotëruar pesë — ose gjashtëqind shenjëza, shumë prej të cilave me kuptim të dyshimtë... e të rrezikshëm për rendin publik... Ndaj ju thirra... Të jetoni do kohë midis banorëve të thjeshtë, të mësoni të gjitha shenjat e tyre domethënëse e më në fund të bëni një kod të sigurtë deshifrimi. Një kod i tillë do të jetë për çdo agjent dhe polic timin çelësi i dëshëruar për të marrë vesh se ç'ngjet e ç'po bëhet...

— Ju, zoti Xhon, mendoni se çdo lëvizje gishtërinjsh ka një nëtekst? — e ndërpren një profesor i shquar gjuhe.

— Pa asnë dyshim! Munda të kuptoj njëren nga të pesëqind lëvizjet e ndërlikuara të gishtërinjve. Kur gishti i madh takon të voglin e tre të tjerrë qëndrojnë drejt të bashkuar, me këtë duan të thonë se...

Zilja e fortë e telefonit qeveritar e hodhi përpjetë. Qëkurse ish emëruar komisar policie, ai telefon s'kishte tingëlluar kurrrë, aq sa i vinte të besonte se aparati ndodhej aty fare rastësisht, i harruar nga ndonjë dorë e pakujdeshshme.

Me dorën që i dridhej, mori receptorin.

— Jam presidenti i shtetit! — dëgjoi një zë, gati të mekur e të shurdhër, si të vinte nga thellësitë e planeteve. Jeni ju, Xhon?!

— Po, po, unë sër, komisar Xhon.

— Kam nevojë urgjente për ju, Xhon! Ejani shpejt! Nuk do t'ju nxjerrin pengesë... Mirëupafshim!

Presidenti e mbylli lidhjen, kurse Xhoni qëndroi një copë herë me receptorin në vesh, i hutuar, i mpirë, i çoroditur. Ba-

llin ia mbuluan bula të ftohta djerse dhe vështrimi iu mjegullua.

— Më thërret presidenti... — foli prerazi, si një i sëmurë. Më ndjeni, ju lutem. Do të bisedojmë prapë. Presidenti më prct. Ju, do të më kuptoni, Presid...

Si në klapa hapi derën e dhomës së pritjes, zbriti te pesë-dhjetë shkallët, përshkoi sallonin e madh të katit të poshtëm dhe u gjend përpara makinës së tij.

— Përse më thërret, vallë? — tha, ndërsa rrotullonte çelësin e ndezjes. Diçka e madhe duhet të ketë ndodhur, gjersa më kërkon me kaq ngut. Presidenti i shtetit, i pari i vendit, ka nevojë për ty, Xhon. Kur një president ju thërret me ngut, kjo do të thotë se ai ka nevojë të këshillohet me ju ose t'ju ngarkojë ndonjë detyrë. Kjo do të thotë, i dashur, se ti je bërë i madh dhe se ty të presin poste të rëndësishme... Përpara, përpara, Xhon! —

Makina e komisar Xhonit fluturonte me maksimumin e shpejtësisë, në rrugëzën rezervë të autostradës.

Ai provonte për të 'parën herë në jetë përshtypjet ngazë-illyese të shpejtësisë më të madhe. Linte pas dhjetëra, qindra, mijëra makina. Presidenti priste!

* * *

Çastet e para, kur komisar Xoni qëndronte ballë për ballë me presidentin (madje ai nuhaste edhe aromën e këndshme të çimçakëzit, që i pari i vendit s'e shqiste nga goja) qenë të vëشتira dhe mezi kaluan. Ku qe ulur, në kolltukun e sfungjertë, apo mbi gjemba shkretëtire?

— Zoti Xhon, këta muajt e fundit kam dëgjuar të flitet shumë për ju. Gjithkush mund të mësojë nga cilësitë tuaja të shquara. Askush gjer më sot, zoti Xhon, s'ka mundur të kyçë gojën e ndonjë qyteti. Këtë e arritët ju. Ju i nënshtruat të gjithë. Në qytetin tuaj nuk flitet për gjëra të tilla bajate, të bez-disshme e neveritëse, si bie fjala, greva, demonstrata, propagandë majtiste...

— Zoti president, një masë e tillë profilaktikë ka qenë shumë e nevojshme — foli papritur Xoni, që e kishte mbledhur veten nga pritja e ngrohtë e presidentit.

— Keni vepruar me guxim dhe zgjuarësi. Kjo na gjëzon të gjithëve. Jam i kënaqur, që më jepet rasti i lumtur, t'u komunikoj se qeveria aprovoi propozimin tim pér t'ju emëruar në një post të përshtatshëm pér cilësitë dhe zotësitë tuaja. Emëroheni ministër pér sigurimin civil! Pra, kështu, mendojmë se aftësitë tuaja do të gjejnë një fushë të madhe veprimi...

Presidenti heshti një çast pér të shikuar efektin e fjalëve. Ish-komisar Xhoni kérceu menjëherë në këmbë, përpoqi takat dhe vuri dorën në kokë (megjithse qe pa kapele).

— Uluni, uluni, Xhon, është një post që e meritoni plotësisht. Partia e jonë, d.m.th. partia Republikane, mendon se më në fund u gjet njeriu i përshtatshëm pér të drejtuar «qeverinë e padukshme». Xhoni përpëliti sytë i çuditur tej mase.

— Po, Xhon, kështu e kanë quajtur zbulimin tonë Uajzi dhe Rosi dhe ndonëse në epitetin e tyre ka një pjesë të së vërtetës, u hidhni një sy me kujdes dosjeve të tyre, sepse qëllimet që kanë janë denigruese. Mua dhe ministrat na quajnë qeveri e dukshme, kurse zbulimin, që do të drejtoni ju, qeveri e padukshme. Një përcaktim i tillë të nervozon seriozisht, sepse një shtet i madh, i drejtuar nga dy qeveri, bëhet qesharak dhe i pavlerë në sytë e botës. Kështu, pra, Uajzi dhe Rosi indirekt kanë cenuar sigurimin tonë publik dhe autoritetin tonë ndërkombe tar e pér këtë, Xhon, ju nuk duhet të rrini aspak duarlidhur!

— Si urdhëron, zoti president!

— Por s'është kjo çështja kryesore pér të cilën ju thirra. Uajzi dhe Rosi, në fund të fundit, janë peshkaqenë të vegjël, asgjësohen lehtë. Mua më shqetësojnë seriozisht zgjedhjet që po afrojnë. Demokratët po luajnë të gjithë gurët që të na shkulin me rrënjen. Ata po përfitojnë nga disa gabime që kemi bërë në qeverisje, në premtimet që kemi bërë përpara zgjedhjeve e që s'i kemi mbajtur.

— Edhe ata s'i kanë mbajtur ndonjëherë e as do t'i mbajnë — nxitoi Xhoni t'i dilte krah presidentit, që kishte filluar të merrte superxhiro.

— Mirë, mirë, Xhon, por sidoqoftë, këto e të tjera, përbëjnë armë të forta në duart e tyre.

— Ç'duhet të bëj pér tua hequr këto armë? — pyeti Xhoni, duke mos iu duruar.

— Të mos lësh gjë pa bërë, më kuption, Xhon, fiksoje në

tru këtë që po të them. Askush s'duhet të mendojë se fotografitë me satelitë e bëjnë të panevojshëm zbulimin e njeriut. Është e vërtetë se askush s'është në gjendje të fotografojë qëllimet, por kjo duhet arritur me anë të zbulimit të fshehtë normal njerëzor. Zbulo dhe më informo për çdo gjë që ka të bëjë me zgjedhjet. Mëso shtabin drejtues të tyre, jetën intime të anëtarëve të tij dhë pikat e dobëta të tyre, fondet që u janë vënë në dispozicion, përbajtjen e të gjitha bisedave të tyre të fshehta, itinerarin e turneut elektoral, shkurt, gjithçka!...

— Si urdhëron, zoti president!. S'do të lë gjë pa mësuar. Kaq shumë lajme e informacion do t'ju sjell, sa, do t'ju duket se keni qenë i pranishëm në të gjitha aktivitetet e tyre sekrete... Bile, bile, sikur fushatën e tyre elektorale ta kishit drejtar u vetë.

— Ju lumtë, Xhon! Partia jonë ka besim të madh tek ju. Në qoftë se ne do të jemi përsëri partia drejtuesc e vendit, s'do t'ju harrojmë kontributin tuaj të vyer dhe do t'ju shpërblejmë pa u kursyer. Punë të mbarë, Xhon!

Duke e kuptuar se presidenti i kishte dhënë fund bisedës, Xhoni u ngrit dhe duke u përkulur, shtrëngoi dorën që u zgjat në drejtim të tij.

* * *

Për secilën nga të pesëqind lëvizjet e ndaluara, ministri i brendëshëm Xhon kishte parashikuar dënimë dhe ndëshkime të ndryshme.

Në rrugë njerëzit shkonin duke lëvizur vetëm këmbët. Me fytyrat pa asnjë shprehje, të ngrira si maska, me duart e krahet të ngjeshur pas trupit, njerëzit shembëllenin me marioneta të vërteta.

Ministri i brendëshëm Xhon, brenda në makinë, shkonte ngadalë, fare ngadalë, buzë trotuareve. Marionetat mbushnin rrugët, megjithatë mbretëronte një heshtje e plotë. Askush nuk fliste, askush nuk queshte. Madje nuk e kthenin kokën as majtas e as djathjas, edhe kur ngjiste diçka e pazakonshme. «Duhet të jenë të kënaqur me rolin e thjeshtë e pa telashe që u kam caktuar! — tha me vete polic Xhoni. — Qyteti nuk flet, qyteti

nuk bën lëvizje të pamatura! Çdo të dëshëronte më shumë se kaq një ministër i brendëshëm me dy pare mend në kokë?... Ç'mund të bëjë më tepër një ministër i brendshëm?! Të bëhet president i shtetit, president i përjetshëm i shtetit?! Oh, mos Xhon, nuk bën të mendosh kështu. I porsaemëruari ministër i brendshëm nuk duhet të vejë kaq larg në ambicjet dhe ëndrrat e tij».

Ai qeshi me vete. Nxori dorën jashtë dritares së hapur dhe u përpoq të tërhiqte vëmendjen e kukullave kalimtare.

— Hej, hej! E dashur Marionetë! Të dashura kukulla!

Nuk iu përgjigj njeri. Një marionetë e bukur përpëliti vëtëm sytë, por kokën nuk e ktheu nga ai. Ministri e ndoqi një copë herë me sy, buzagaz.

«S'ka lëvizje më të këndshme, më kiciluese e joshëse se ccja e femrave!» — mendoi i eksituar pa ia ndarë sytë vajzës që ecte në trotuar.

Xhoni nisi të fërshëllente melodinë e tij të preferuar të një lokal i nate. Marioneta e bukur i kishte zgjuar befas instikte të vjetra që dremisin prej muajsh.

Makina mori një kthesë të shpejtë e të papritur, duke kli-thur si e plagosur, dhe u nis në drejtimin prej nga «Sufet» e tij rroknin tinguj të ëmbël e të qetë të një muzike vallzimi. Kishte filluar të ngrysej.

* * *

Më në fund, pas një viti, u duk se populli «e kuptoi» drejt ministrin e brendshëm, masat e rrepta të jashtëzakonshme që i kishte marrë në emër të «lirisë» e të «demokracisë së vërtetë». Numri i atyre, që e mburrnin dhe e përshtënesnin me «zemër», po merrte çdo minutë përmasa astronomike. Të mërzitur, me sa duket, nga heshtja e gjatë torturuese, njerëzit s'bënин tjetër veç flisnin, flisnin pa rreshtur për ministrin Xhon. Ndjenjën e urisë njëvjeçare të të folurit s'po e ngopnin dot. Dukej një qytet i penduar thellësisht përfajet e tij.

Atë mëngjes të djele, shtrirë në krevat, ai po lexonte përfë parën herë me një ndjenjë të lehtë dyshimi, artikullin e një farë Iti Kronikëll, ku midis lavdërimeve pa kursim, ndiheshin nota të lehta ironie.

Ai e lexoi dhe e rilexoi me një fryshtë artikullin e zotit Kronikell dhe u bind, pa asnje dyshim, se qyteti i kishte shpalitur përsëri luftë, këtë herë me armët e ironisë dhe të nënteksttit. Kuptoi në çast se «sufet» e tij nuk do t'i vlenin një gresh në këtë lloj të ri lufte, se ai s'do të mund t'i bënte ballë as edhe një muaj furtunës së talljeve të holla të mendjeve të zgjura, se s'do të mund të provonte në asnje mënyrë «fajësinë» e të pandehurve. Ata kishin filluar të thoshin se Xhoni është i mirë, është i dashur, është mbrojtësi më i madh i lirisë, atdhetar i shqar, e shumë lëvdata të tjera të këtij lloji, dhe ai, natyrisht, nuk mund të thoshte, se nuk qe i tillë, megjithëse mund të betohej pér atë quell e pér këtë dhe, se ata e vinin në lojë e talleshin si me një lolo budalla.

Dikur e kishte shumë më të lehtë. U riprodhonte viktimate fjalë pér fjalë fragmente bisedash dhe i mbërthente paq. Po tani? Si, ku do të kapej? «Pér çfarë na akuzoni, zoti Xhon? Ne folëm aq mirë pér ju, ju thurëm lavde, ju ngritëm në quell? A mund të dënohet njeri pér këtë?». E ai do t'u bërtiste: «Jo, jo, nuk ju besoj! Toni juaj ishte ironik, qesëndisës, poshtëruesh!». «E si mund ta vërtetoni?». Nuk kishte si ta vërtetonte dhc pér këtë e ndiente veten të dëshpëruar, të humbur...

Dhembja e fortë e kokës e detyroi të rrrotullohej në shtrat. Qytetet po e shtrëngonin në darën e hakmarjes tamam atëherë, kur kishte nisur të besonte se i kishte mposhtur. Tëmthat i rrihnin, iu duk se nga shtrëngimi i fortë i kërcitën koskat e kafkës. Ulëriu fort nga dhembja therëse.

E përfytyroi me mall atë kohë, kur s'qe veçsc një polic i thjeshtë. Atëherë flinte i qetë dhe s'dinte ç'ishte dhembja e kokës.

Atë çast, poshtë në rrugë, një turmë studentësh kaloi duke kënduar e duke brohoritur. Lumturia e tyre ia theksoi dhe më shumë vetminë Xhonit.

U përpëlit më keq në shtrat, si një zog me kokë të prerë. Pastaj mbuloi kokën me jorgan. Me turmën u bashkuan të tjerë. Brohorisnin pér të. Zëra pleqsh, të rinjsh, fëmijësh.

Tashmë dara, duke i thyer koskat e kafkës, i hyri thellë në tru. Ai bërtiti, kërcue nga shtrati, u soll rrrotull nëpër dhomë. Jashtë brohorisnin. Tëmthat i hidheshin përpjetë. Ndodhej ballë pér ballë me murin e bardhë. Iu kujtuan të burgosurit e tij. Kokat e përplasura... Kovat e ujit...

Si një bishë e egërsuar, pasi qe larguar 5-6 hapa, iu vërsul murit. Koka i buçiti, iu duk se iu thërmua në një mijë copëza. Pastaj, për shumë çaste, humbi në një humnerë të pafund e të errët si nata. Nga koka e plagosur i varej tatëpjetë ftyrës një vazhdë e zezë gjaku. Gërhiste, për të parën herë pas shumë vjetësh. Xhoni flinte... jashtë brohorisnin...

* * *

— Erdhi në vete vetëm të nesërmen në mesditë. Iu desh kohë gjersa të përmendej mirë. Me mundim dhe përtesë, duke rënkuar si një plak i sëmurë, u ngrit nga shtrati dhe qëndroi disa çaste gjysmë ndenjur, me këmbët lakuriqe mbështetur mbi qilimin plastik.

Pastaj, duke u munduar të mbante ekilibrin, iu afroa pas-qyrës. Gati nuk e njohu vetveten. Koska e frontalit kishte kë-çyer përpjetë, si një xhungë e keqe tumoroze, qe nxirë e deformuar, sytë i qenë fryrë e ënjtur, curilat e gjakut të mpiksur, si përrënji dredharakë e gjarpërues, i vareshin tatëpjetë lëkurës së rreshkur e të tharë. U praps befas, pothuajse i trembur, duke mbuluar sytë me pëllëmbët e mëdha që i dridheshin. Maramendsh, mezi iu afroa shtratit dhe u lëshua i pafuqishëm, i vrarë e i dërrmuar mbi të. Nuk mundte, jo, nuk mundte kurresi të duronte më!... Çdo nerv dhe degëzim të tij, njerëzit e këqinj dhe tinzarë, ia kishin minuar me të pabesë dhe ai kishte vite që e cte mbi ato rrugë zigzake të pasigurta, me parandjenjën ogurzezë të vdekjes së beftë.

Sinjalet ritmike dhe këmbëngulëse të telefonit i shëmbë-lyien me të rëna kambanash gjigante kishash. S'kish as fuqi, e bile as dëshirë, të zgjaste paksa dorën për të ngritur receptorin. Numëroi me vete dhjetë të rëna. Në të njëmbëdhjetën e mori receptorin në dorë dhe e afroi me përtesë pranë gojës.

— Hello! Ju dëgjoj...

— Ministri i brendshëm Xhon? — dëgjoi zërin e një gruaje, së cilës nuk u mundua t'i përcaktonte moshën, siç kishte bërë mijëra herë të tjera.

— Po, po!. Unë jam — u përgjigj me përtesë dhe fare pa qejf, duke zvarritur fjalët.

— Zoti Xhon! Tre vjet tē shkuara, me dorën tuaj më keni vrarë burrin dhe djalin tim tē vetëm, pér idetë e tyre komuniste. Nuk ua fsheh dot, zoti ministër i brendshëm, ju kam urryer si vdekjen dhe trupi më digjej nga dëshira e flaktë e hak-marrjes. Tē mundja, do t'ju kisha vrarë një mijë herë. Por koha bën tē sajën, zoti Xhon. Ajo më bindi se ju gjithçka e keni bërë pér popullin tuaj tē dhembshur, pér sigurimin e ditëve tē tij më tē bukura dhe tē së ardhmes së tij tē pasosur, si vetë gjithësia. Ndaj, jua fal me gjithë shpirt, gjithçka më keni bërë dhe ju uroj jetë shumë tē gjatë e tepër, tepër tē lumtur! Me këtë rast, zoti Xhon, kam ftuar në shtëpinë time edhe njëzet vejusha tē tjera. Edhe ato janë tē lumtura t'ju përshëndesin, zoti ministër!...

Dhjetëra zëra grash brohoritën pér tē, por toni i tyre iu duk Xhonit kërcënues dhe i ftohtë si akulli.

«Histeria e vejushave!» — mendoi Xoni me mllef dhe lëshoi receptorin mbi shtratin e vet.

Me duart e kryqëzuara ndën kokë, me sytë e mëdhenj e të hapur jashtë mase, ngulitur në tavanin blu, pas pak, ministri Xhon ra në mendime tē thella.

«Tē gjithë po tallen me mua, që tē gjithë! Oh kjo është kaq e tmerrshme, kaq e mundimshme!...

Mbushur gjer në grykë, me inate tē vjetra e tē reja, mbreti i tingujve Xhon përplasi grushtin mbi dërrasën e lëmuar e të shndritshme tē kreyatit.

Papandehur fizionomia e fytyrës i ndryshoi, iu çel e iu kthjellua çuditërisht.

«Një aparat pér tē kuptuar që në embrion mendimet e njerezve! Fantastike! Një mrekulli! Tē jesh mbret i tingujve, s'është asgjë, por tē jesh mbret i mendimeve, zot i plotfuqishëm i mendjeve njerëzore, kjo është mbi tē gjitha. Pér mua s'do tē ketë më sekrete. Xhon! — iu drejtua vetes — ti do tē jesh gati një perëndi. Perëndi e sekreteve, e tē fshehtave. S'ka më, s'do tē ketë më intriga, prapaskena, komplotë, aksione tē fëlliçura, fjalë dhe shprehje tē poshtra pér rendin publik, tē gjitha morën fund. Sapo që një koke gjeniale tē shkencës i lind një ide epokale, fap, unë ia rrëmbej nga koka dhe ia komunikoj botës i pari; një shkrimtar me famë botërore, ka përpunuar prej kohësh subjektin e një romani, unë tak ia përvetë-

soj, madje e kërcënoj për plegjiatë... Shkrimtari i gjorë, i trembur për vdekje dhe i habitur, do të më pranojë bashkautor të veprës së tij. E kështu, brenda një kohe tepër të shkurtër, do të jem gjenia e padiskutueshme e njerëzimit në fushat më të ndritura të dijes dhe të artit njerëzor. Njeri më të madh e më të shquar se unë, njerëzimi as ka njojur e as ka për të njojur. Veçse... (këtu Xhoni u pikëllua befas) çdo gjë, e ardhmja ime,jeta ime, varet nga shkencëtarët Robert, Meks dhe Ferdi. A do të pranojnë të punojnë për një aparat të tillë? Ta zëmë se pranojnë, a do të munden ta bëjnë? Po sikur? Por s'kanë nga t'ia mbajnë. Do t'i detyroj me zjarr dhe hekur! Aparatin, ose jetën! Përpara kësaj alternative, ata do të bëjnë të pamundshmen! Pastaj, do t'i zhduk pa lënë gjurmën më të vogël, përndryshe shqetësimet dhe dyshimet e daljes në shesh të së vërtetës, s'do të më linin asnje çast të qetë.

Xhoni rrëmbeu telefonin.

Pas disa sinjalesh të ndërprerë, më në fund, dëgjoi zërin e njojur të profesor Meksit.

— Profesor Meksi! Ju lutem!...

— Jam ministri i brendshëm, Xhon. Profesor Meksi! Merrni me vete dy të tjerët dhe ejani sa më shpejt tek unë!. Kam nevojë urgjente për ju.

— Mbase e keni më të lehtë të vini ju tek ne, zoti Xhon?!

— foli me zë të mekur dhe të pasigurtë tjetri.

Ministri i brendshëm Xhon përplasi qëllimi i receptorin, duke mbyllur linjën. Vështroi orën.

«Pas dhjetë minutash ata do të ndodhen këtu! — tha me vete me një ndjenjë sigurie dhe superioriteti. Ata s'mund të bëjnë shaka. Do të vijnë patjetër këtu, madje brenda pak minutash. Dy fjalë të vetme, vetëm dy... Aparatin indikator të mendimit, ose jetën! Do t'i lë të zgjedhin lirisht...

* * *

Shkencëtarët Robert, Meks dhe Ferdi, dëgjuan deri në fund, gati të mekur e pafrimë, kërkesën e shkurtër, absurde, të të çmendurit Xhon.

— Pra, mos harroni, zotërinj shkencëtarë: aparatin e zbu-

limit tē mendimeve! Ju pres këtu, pas një muaji. Asnjë ditë e asnjë orë më shumë. Besoj se më kuptuat mirë?!

— Ju kuptuam si s'ka më mirë, zoti Xhon. Për aparatin mos u shqetësoni asnjë grimë. Tani mund tē flini i qetë. Pas një muaji na keni këtu. — foli shkencëtar Meksi me një ton tē hollë ironik.

— Ja pra, as vetë s'e kishit parashikuar, se takimi ynë do tē ishte kaq i shkurtër dhe se ne do tē mirreshim vesh kaq lehtë e kaq shpejt, — tha ministri i brendshëm Xhon, duke u ngritur nga poltroni dhe duke i zgjatur dorën shkencëtarit Meks e pastaj me radhë dy tē tjerëve.

Shkencëtarët u skuqën. Xhoni po e tepronnte, a thua se kish-te përballë tij sklevër e shërbëtorë tē mjerë e tē bindur dhe jo më koka tē shquara tē dijes njerëzore. Shtrënguan fort nofullat dhe nuk bënë zë. Me atë tē çmendur s'bëhej shaka. Tek kapton-te pragun e derës së jashtme tē vilës, Meksi psherëtiu thellë i lehtësuar.

— A do tē mund tē shpëtojmë kokën nga ky rrith i maliquar ku jemi ftuar? — pyeti Berti me merak.

— Berti! — i bërtiti Meksi me qortim.

Duke u kujtar, i tronditur, Berti kafshoi fort buzët.

Xhoni e dëgjonte.

— Unë kam menduar një jetë tē tërë pér një aparat tē këtillë. Ja që, rasti e solli, ta pregatisim pér zotin tonë tē dashur e tē respektuar, Xhon. Çdo gjë, do tē na vejë mbarë zotërinj! Aparatin do ta bëjmë deomos.

Berti u luajti syrin. Dy tē tjerët, ndërsa buzëqeshnin lehtë, me zë tē lartë thanë se qenë tē një mëndjeje e se s'do tē kurse-nin as dijen e as djersën pér t'ia arritur qëllimit.

Xhoni buzëqeshte i kënaqr.

* * *

Që atë natë shkencëtarët dhe familjet e tyre u larguan fshe-hurazi nga atdheu pér në një drejtim tē panjohur.

Ministrin Xhon e njoftuan tē nesërmén, tamam në kohën kur po u jepte udhëzime tē veçanta agjentëve si t'i ruanin ditë e natë tē tre shkencëtarët. I ra tē fikët nga tronditja dhe mezi e

sollën në vete, duke i hedhur ujë të ftohtë. Kur u përmend, kërkoi t'i shporreshin të gjithë nga dhoma dhe ta linin vetëm. Do të donte të çirrej, të ulërinte si ujk i uritur bjeshkëve ditëve të dimrit, të thyente, të prishte e të shkatërronte ç'i shihte syri, t'i vinte minat qytetit, ta shndërronte në gërmadhë, në pluhur kozmik, në hi, ta bënte rrafsh me tokën.

Sekondometri i orës së murit, kapërcente ndarjet e vockëla në mënyrë ritmike. Ai orvatej të mos shkëpuaj. Çdo kërcim i sekondometrit, një goditje e fortë e kokës mbi tryezë. U nxi i téri në fytyrë. U ënjt, u fry si kacek. Xhunga të mëdha i mbinë befas në fytyrë e në kafkë, si kërpudha të hirta. Pas çdo goditjeje të kokës mbi tryezë, sytë e kuqëremtë të të së-murit, ndiqnin të ethshëm, plot etje e tension, kapërcimet e sekondometrit mbi shkallëzimet. Filloj të numëronte: 1, 2, 3, ..., 10, 10, 10.

S'bënte më tutje. Ideja fikse po e torturonte. Sekondometri po e linte pas, pa ndier aspak keqardhje. Sekondometri vraponte si atlet duke i kërcyer pengesat një nga një. Xhoni ishte rrëzuar në pengesën e dhjetë. Sekondometri nisi të qeshte. Të tallej. Numrat po ashtu. Njëshi i orës, dyshi, treshi, dhjeta. Njëshi qeshte duke përkulur kokën sa para prapa. Treshit po i binte të fikët nga gazi, me duar në hije; pesa qe bërë lak e gati s'po shqyhej; gjashta qe kuspusullosur, dhjeta s'kishte duruar më e qe ndarë më dysh. Barku i rrumbullakët i hidhej e i këcente si top, hop këtu e hop atje.

Xhoni vërviti mbi orën e murit ç'i zuri dora.

Xhami u kthyte në goditjet e para, fusha krisi, por sekondometri vërvitej si e xhindosur, si i pushtuar nga paniku, si të donte t'u shpëtonte bombardimeve të rrepta. Xhoni s'duroi më. Brofi në këmbë.

Iu afroa sakaq e nisi ta godiste fort me grushta. Anët e mprehta të xhamit i hynë në mish dhe gjaku nisi t'i rridhët curk, por ai s'e vuri re dhe iu duk se gjaku dilte nga përbindshi orë, me të cilin ai po ndeshej për jetë a vdekje.

Pastaj e mori në duar. E ngriti lart, e përplasi me sa forcë pati. Të brendshmet e orës u shpërndanë përreth. Numrat qesharakë qëndronin të paepshëm. E ngriti sërisht nga dyshemëja, pastaj mbi kokë dhe, me tërbim të çmenduri, kësaj radhe e përplasi në mur. Njëshi, treshi dhe pesa, ranë të «vdekur» për-

dhë, me kokat e copëtuara keqas dhe trupat e gjyntuar për ibret.

Më duart e gjakosura nxorri revolverin nga brezi dhe mori në shenjë, para së gjithash sekondometrin. E goditi pesë herë radhazi! E bëri copë-copë. Pastaj ekzekutoi të tjerët: dyshin, katrën, gjashtën, tetën, nëntën, dhjetën. Barkun e dhjetës e bëri shoshë. Boll kishte qeshur e ishte tallur. Për shtatën i erdhi keq! Ju duk e penduar. Por nuk e fali. E goditi të fundit, me një plumb në ije.

Pastaj, i këputur për vdekje, si pas një beteje vigane, u shtri gjatë e gjerë në dysheme, në pellgun e vogël të gjakut.

Nëpunësit guxuan të hynin vetëm disa minuta më vonë, kur prapa derës së zyrës dëgjuan të gérhiturat e forta të Xhonit. Jeta e ministrit të brendshëm ishte në rrezik. Nga damarët, gjaku i zi vazhdonte t'i rrnidhe pa rreshtur...

Ministri i brendshëm Xhon i bëri përsëri sfidë vdekjes dhe s'u dha rast nështetasve e armiqve më të afërt të buzëqeshnin të kënaqur e të lehtesuar për humbjen e tij të papritur, dhe të derdhnin rrëketë e gjëzimit në gotat e dollive të zgjatura, gjer pas mesnate. Bash për këtë arsy Xhonit i erdhi mirë që s'u nda nga kjo botë e mallëkuar. Po për një mijë arsyet të tjera (që veç ai i dinte), mendoi se nuk do të kishte qenë keq të mos qe zgjuar fare. Një javë më vonë, agjensitë e ndryshme të lajmeve, radio-televizionet dhe gazetat më me emër të botës, transmetuan ose botuan të plotë rrëfimin e sinqertë dhe autokritik të shkencëtarëve në mërgim, Robert, Meks dhe Ferd, që vendosën të hiqnin dorë përgjithnjë nga shpikja e tyre, sekreti i së cilës do të varrosej bashkë me ta. Brenda disa orësh, mbarë njerëzimi mësoi jetën e çuditshme të polic Xhonit dhe karrierën madhështore e njëkohësisht qesharake, në sajë të aparatave ultramodernë, «Sufi».

Xhoni e dinte mirë ç'e priste. Qindra gazetarë të bezdishëm, që shtynin me duar e supe njëri-tjetrin për të arritur gjek ai, blice verbuese, prozhektorë, aparate filmimi, aparatë televizivë, mikrofonë, pyetje ngulmuese, të zgjaura e dinake, bllo-

qe të bardha shënimesh, zagushi e padurueshme inkadeshente, djersë, palpitacione, dispnë, përpëlitje, marramendje...

Mblodhi me nxitim plaçkat dhe doli fshehurazi nga dera e prasme e vilës. Rrugën gjer në hotel e bëri me këmbë. Makinën ia njihnin edhe çiliminjtë. Zuri një dhomë në katin e 100-të, dhe kërkoi që ta fshihnin, duke premtuar se do të paguante mirë. Pas një jave gjakrat do të qetësoheshin, dhe ai mendonte të organizonte një konferencë shtypi, ku do t'i përgënjeshtonte të gjitha; madje do të kërkonte nga shteti fqinj arrestimin dhe dorëzimin e tre provokatorëve. Eh, sikur t'i shtinte edhe njëherë në dorë, pa e dinte ç'kishte për t'u bërë!...

Gjer në mesnatë dëgjoi stacionet e ndryshme të radiove dhe ndoqi programet e ndryshme televizive.

«Çështja e polic Xhonit» zinte vëndin kryesor të lajmeve. E tërë bota fliste për të. Intervista, komente, tregime njerëzish, që e patën njohur së afërmë, biografi të hollësishme, gjer në gjërat më të vogla e të parëndësishme të jetës, mendime të ndryshme psikoanalistësh, mjekësh, psikologësh, konstruktorësh mjetesh dëgjimi etj. etj., të gjitha për të, vetëm për të. Në shumë raste, fantazia u punonte jashtë mase dhe trillonin gjëra, të cilat ai, si Xhon, s'i kishte bërë kurrë. Megjithatë ai ndjeu, për t'u habitur, një farë kënaqësie e gjëzimi të brendshëm, që s'i shkonin aspak për shtat gjendjes së tij për të qarë hallin. Një popullaritet aq të madh s'e kishin njohur veçse astronautët e parë. Por gjëzimi i tij nuk qe e thënë të vazhdonte gjatë. Për herë të parë, pas shumë muajsh, zëra qytetarësh të zemëruar kërkoni arrestimin e tij dhe gjykimin e çështjes nga organet e drejtësisë. Ai përcaktoi me precizion banesat prej nga dëgjoeshin zërat dhe nxori bllokun të mbante shënim. Por pas gjysmë ore, qe e pamundshme ta bënte një gjë e tillë, sepse zërat u shumëfishuan në mënyrë të papritur e të habitshme. Njerëzit vërvshuan rrugëve, autostradave, rrugicave, parqeve, shesheve publike, duke manifestuar e thirrur. Kërkoni vdekjen e tij. Arrestimi dhe burgosja s'u hynin më në sy...

Në mëngjes herët, presidentin e njoftuan për ngjarjet e natës dhe për shifrën e demostruesve. Presidenti u drodh. Kërkoi t'i jepnin në telefon komisarin e ri të polisë.

— Ç'kërkojnë tjetër, veç atij kokëderrit?

— Tani për tani, s'duan asgjë tjetër, veç dorëzimit të tij.

— Po ç'prisni? Të shpërthejë ndonjë skandal? Gjejeni sa më shpejt, ku është fshehur, dhe jepuan. Policia të hapë sytë.

— Si urdhëron! Si urdhëron! — u dëgjua zëri i komisarit të ri të policisë, që lako mbi qysh tani postin e lirë të ministrit të brendshëm. Do ta gjejmë me çdo kusht.

Ranë në gjurmë në mbrëmjen e natës së dytë. Turmat e inatosura mbushën sheshin përpëra hotelit. Opozita po i nxiste me të gjitha forcat, të bërtisnin sa më shumë kundër Xhonit dhe kundër qeverisë që e kishte përdorur atë.

Turma nuk pranoi t'u hapte udhë makinave të policisë, por komisari u dha fjalën se do t'ua dorëzonte me duart e tij Njerëzit brohoritën dhe hapën shteg të lirë. Policë të armatuar u hodhën nga makinat mbi shkallët e përparme të hotelit dhe u sullën drejt hyrjes së madhe. Tre ashensorë mbushur plot e përplot me policë ngjiteshin pér në katin e njëqindtë. Supërvë u rëndonin automatikët e zinj. Sytë ëndërrues të komisarit të ri qenë ngulitur në tabelën e ndritshme të ashensorit, ku nxirrin kryet një çast e zhdukshin sa kaq numrat e bardhë të katëve që këpërcenin.

«Kati i njëzetë — polic. Kati i tridhjetë — përgjegjës trupë! Kati i pesëdhjetë — zv.komisar. I shtatëdhjeti — komisar policie. I nëndëdhjeti — zv.ministër i brendshëm, i 95-ti, i 96-i, i 97-i, i 98-i, i 99-i!»

Kabina u ndal qëtësisht. Pritën disa sekonda, gjersa të hapeshin dyert. Komisari doli i pari në korridorin e heshtur e të ngushtë. Ja dhoma e tij, atje në fund, numër 2011. Informatë cësigurtë.

Komisari s'i besoi revolverit. Në çastin e fundit, i rrëmbët policot që kishte më afër, automatikun dhe c drejtoi pér nga brava e fuqishme e derës me numër 2011. Duart i dridheshin.

Mbrapa i qëndronin në formë gjysmë rrethi njëzet policë, të gatshëm pér t'i bërë shoshë dërrasat e trasha të të dy dyerëve të dhomës.

— Xhon! Dorëzohuni! S'keni rrugë tjetër! — bërtiti komisari.

Nuk mori asnjë përgjigje. Xhoni s'po bëhej i gjallë. Policët vështruan njëri-tjetrin në sy. Mos i gënjen!

Breshëria e automatikut i hodhi përpjetë.

Komisari nisi të qëllonte me tërbim mbi bravën që s'hapej.

Kur mbaroi karikatorin kerkoi t'i jepnin një tjeter. Poshtë turma therriste.

Duke kontraktuar tej mase muskujt e nofullave, duke ckermitur dhembet, komisari zbrazi karikatorin e dyte. Brava automatike dha shpirt e copzuar në dhetra pjesë metalike, që ende leshonin tym të hirtë dhe erë të rendë. Dera e parë e dhomës u hap ngadalë, duke kuisur, si portë e një kështjelle të lashtë dhe zbuloi një korridor, ku zotëronte një heshtje e rendë e ngjethëse. Edhe dera tjeter që e kyçur. Komisarit, si mbetej veçse t'i vinte shpatullat, bashkë me të tjerët, për ta shperthyer. Ai ngriu një copë herë të gjatë përpëra saj, i pa vendosur, gati i pezmatuar. Komisari e kishte përfytyruar ndryshe takimin me rivalin e tij. Ai kokëshkëmb s'do të jepej lehtë. Bresheri të shtenash nga ata dhe ai, policë që rrëzoheshin pa frymë e pastaj, ballë për ballë, si në një film kaubojs. Komisari do të tregohet më i shpejtë. Ishte i ri dhe qites i shkëlqyer. Duke kli-thur, me duart mbi bark, mbledhur kruspull nga dhembjet, vetëm me një ah të lemerishme, Xhoni, do të përplasej përdhc. Pastaj, do të dilte në dritaren e hapur triumfator. Me duar të ngritura lart do të përshëndeste turmën.

— Xhon, hapeni derën! — foli komisari, si i zgjuar nga kllapia e endërrimeve.

Xhoni përséri s'u përgjigj.

Komisari goditi fort me shqelm derën. Nuk mund të durronte më. I duhej dhënë fund asaj historie.

— Hapeni, Xhon! Do të qeljoj! Hapeni!

Që prapa derës godisnin fort me shqelme. Rrahjet e derës i shëmbellyen Xhonit me të shtëna topash. Pastaj një bresheri e shkurtër arme automatiku. Dera u hap me vrull. Silueta njerëzish ngrinë në prak. Grykat e zeza të vdekjes drejtuar nga ai. Duke u dridhur, me fytren e shtremberuar nga tmerri, ai kishte qëndruar në parvaz të dritares e luhatej si pendul, gati në të rënë. I duhej të zgjidhte llojin e vdekjes. Pas pak me një klithmë ngjethëse dhembjeje e dëshpërimi e lëshoi trupin drejt hapësirës së bardhë. Ndërsa binte poshtë si vetëtima, «Sufet» e tij pëceptuan të thirrura njerëzish. «Atyre s'u besohet që unë zgjodha këtë lloj vdekjeje. Ata gati s'po u besojnë syve» mendoi midis kateve gjashtëdhjetë e pesëdhjetë. Në katet dyzetë «Sufet» pëceptuan klithma gjëzimi dhe hareje. «Askujt

s'do t'i vijë keq për mua, askush s'do të më mëshirojë e s'do të qajë për mua — mendoi ndërmjet kateve tridhjet e njëzet. Fryma iu mbajt në katin e dhjetë. Turma kishtë hapur një vend në trotuar.

Një përplasje e mbytur dhe një ungërimë e thellë.

Dikush kërkonte me ngulm «Sufet» e tij.

* * *

Një mëngjes, pesë ditë pas vdekjes së Xhonit, në muret e fasadave të ndërtesave, restoranteve, kioskeve, qenë ngjitur mi-jëra, trakte. Qytetarët lexonin me etje, me një gëzim të brendshëm dhe shtrëngonin grushtet.

Qytetarël

Cështja e policit Xhon Uotergeit duket sikur mori fund, kurse në të vërtetë ajo sapo ka filluar. Me vdekjen e tij nuk u zgjidh asnjë problem jetik. Ai qe lojë e verbër në duart e monopoleve të fuqishme. Kush përfitoi prej tij? Partia që është sot në fuqi, dhe qeveria e shfrytëzuan plotësisht për qëllime politike, kurse zbulimi i ndonjë bande apo keqbëresi qe vetëm një maskë bajate për të mbuluar veprimet e tjera të shëmtuara.

Tani vëndin e Xhonit e ka zënë Xheni, por Xhon dhe Xhen janë pothuajse e njëjtë gjë! Kështu që qyjeti ynë nuk fitoi thuajse asgjë me luftën e tij të sfidës, ironisë, sarkazmës e të izolimit. Një luftë e tillë është e paefektshme. Në këtë mënyrë, Xhonrit e Xhenrit do të mbeten sunduesit tonë të pamëshirshëm shekullorë. Pra, mbetet e vëtmja rrugë e rrugëve drejt lirisë së vërtetë: *Udha e armëve, REVOLUCIONI!* . . .

Me copërat e porsagrisura të trakteve, shtrënguar grushtave, ministri Xhen, në konferencën e tij të parë të shtypit kërcënoi me të madhe:

— Hakmarrja jonë do të jetë e tmerrshme, masat tona do të jenë shumë-shumë të rrepta! Kjo farë bastarde dhe e shëmtuar mund të lindë kudo, por këtu kurrë, kurrë! Përpara se të jetë bërë rrafsh e hi me tokën, përpara se uji t'i dalë e ta mbysë. . .

Dhe s'mundi të mbaronte ligjératën e tij. Një eksplozion i fuqishëm e përplasi mbi trotuar. Gjuhëza gjigante flake përpinë qellin.

«Depot e municionevel!» — mendoi me dëshpërim Xheni, duke ngritur sytë nga qielli i përflakur. — O Zot i madh, ki mëshirë pér ne të shkretët! A është e mundur të fillojë edhe këtu?».

Dhjetëra blice u ndezën mbi të, shtrirë siç qe mbi trotuar.

— Qëromuni nga sytë! Shporruni ju thashë! — bërtiti ai, duke u ngritur në këmbë dhe duke u drejtuar armën. Do t'ju vras të gjithëve llafazanë të këqinj, në shkrofshi qoftë edhe një fjalë pér këtë natë! Më dëgjuat, apo jo?! — ulëriu ai, si një skizofren i vërtetë.

— Është e kotë zoti Ministër! — foli një gazetar plak. — Ata po e shkruajnë vetë historinë e natës së tyre të kuqe. Vështro gjuhëzat e zjarrit! I lexoni, zoti Xheni! Një fjalë shkruajnë, REVOLUCION, dhe, pér fatin tuaj të keq, ju s'keni pér ta ndalur — dot...

Një e shtënë e beftë e këputi plakun si lis të prerë, në këmbët e Xhenit. Duke e lënë plakun në mes të pellgut të gjakut, Xheni u hodh mbi njérën nga makinat e policisë, që e prisnin dhe u largua me shpejtësi, duke i rënë sirenës së alarmit pareshtur, drejt gjuhëzave të zjarrit.

Sytë pa jetë të plakut, ngelën një copë herë mbërthyer në atë pjesë të largët qielli, që kuqëlonte ende nga flakët, gjersa dikush ia mbylli lehtë me duar, si të donte që në retinën e syve të të porsavdekurit ai shëmbëllim të mbetej i pacenuar dhe i përjetshëm.

— F u n d —